Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi

D I J A

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 15/2016, viti XIV, Ulqin
Numri 1 doli më 2003

Këtë numër e redaktuan
Gani Karamanaga
Gazmend Çitaku

Redaksia
Dr. Gani Karamanaga
Dr. Simë Gj. Dobreci
Dr. Maksut Haxhibrahimi
Dr Bahri Brisku
Ma Liridona Sinishtaj
Mustafa Canka
Edita Nimanbegu
Jaho Kollari
Ali Llunji – Prishtinë
Gjovalin Çuni – Shkodër
Hajro Ulqinaku

ISSN:2336-9310: Dija
COBISS.CG.ID 22278416

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi.
Është themeluar më 12 nëntor 2002, në Ulqin.
U riregjistrua: Ministria e Punëve të Brendshme,
Podgoricë, Vendimi nr. 6308, më 13.02.2013.

Ky numër u botua me ndihmën e Kryetarit të Komunës së Ulqinit, z.Nazif Cungu

Ne s'mund të bëjmë gjëra të mëdha
vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe
(Shën Tereza – Gonxhe Bojaxhiu)

Më e mirë është sharja jote
Se lavdata e të tjerëve
(Xhelaledin Rumi)

PËRMBAJTJA

LETRARE

POEZI
Lirikë e traditës
Naim FRASHËRI
Jetimi 13

POEZI SHQIPE
Shen TEREZA / Gonxhe BOJAXHIU
Lutje për atë që mbjell 14
Esad MEKULI
Gjykimi 14
MIGJENI
Kanga e dhimbës krenare 15
Frederik RRESHPJA
Vjeshtë 1990 16
Vinjetë 16
Mimoza AHMETI
Është çudi kur je femër 17
Rrustem BERISHA
Mendohej Shaban Jashari 17
Rrahman DEDAJ
Matja e largësisë 18
Jaho KOLLARI
Gjyshi 19
Kurbetçari 19
Nexhat HALIMI
Amshimi 19
Ali GEJÇBRITAJ
Plisi im 20
Arjan Th. KALLÇO
Gjurmë 21
Flutur MUSTAFA
Me të dasht' 21
Edmond TUPJA
Të prek 22
Afërdita SALIHU
Ulqini 23
Flutra AÇKA
Trust me 23

Skënder OSMANI
Ulliri 24
Mirko GASHI
Rozafati 24
Hajredin KOVAÇI
Koha javore 25
Sali BASHOTA
Baladë për Ymer Agë Ulqinin 26
Eqrem BASHA
Ethe larg shtëpie 26
Fatos ARAPI
Elegji për babanë 27
Skënder SHERIFI
Herën tjetër 28
Argëzon SULEJMANI
Ishte bardh e zi 29
Visar ZHITI
Shiu i Prishtinës 29

POEZI E BALLKANIT
Pavle GORANOVIQ
Vargjet e largëta 30
Dragana TRIPKOVIQ
Maska në vend të fytyrës 31
Sanja MARTINOVIQ
U zgjuam e së bashku 32
Senad KARAGJUZOVIQ
Mullinjtë e erës 33
Dubravko BRIGIQ
Pikë gjaku Sarajeve 33
Borislav JOVANOVIQ
Poetika e atësisë 34
Tanja BAKIQ
*** 34

POEZI BOTËRORE
Bob DYLAN
Trokitje në portën e parajsës 35
Leonard KOHEN
Suzana 35
Guillame APOLLINAIRE
Ura Mirabo 37

Johann Wolfgang von GOETHE
Si erdhe ti? 37
James JOYCE
Kujtimit të lojës së aktorëve në një pasqyrë në mesnatë 38
Gabriel Garcia MARQUEZ
Letra e lamtumirës (Kukulla) 38
Anders JOHANSSON
Pamjet 40
Kahlil GIBRAN
Kujtime 41
Jacques PREVERT
Paris at night 41

PROZË
Jaho KOLLARI
Homeri 42
Edita NIMANBEGU
I mbushi pesëmbëdhjetë vjet 45
Gazmend ÇITAKU
Ali Kaceni – trim mbi trima 49

PROZË BASHKËKOHORE MALAZEZE
Andrej NIKOLLAIDIS
Ardhja - E gjashta kaptinë 55

PROZË BOTËRORE
Gunter GRASS
Zjarri 61
Haruki MURAKAMI
Sa e njohim ne burrat vetveten?! 63

ESE
Arian LEKA
Nuk i duam! Na duhen shkrimtarët 66
Jovan NIKOLAIDIS
Kuptimi në pakuptimësi, 'kundër dada-s secili është dadaist i vërtetë'70

EX-LIBRIS
Gëzim Puka
Disa arsye të mira pse duhet lexuar proza e Jaho Kollarit 75
Rrustem BERISHA
Kurorë e poezive për Ulqinin 80

Mustafa CANKA
Për librin „Zgjimi“ të autorit Dr.Gani Karamanaga
ndërlidhja e sinqeritetit dhe punës 85
Dr. Stavri TRAKO
Parathënia e librit me proverba e Ruzhdo Agaj 86
Ali LLUNJI
“Rrënjët”- Gani Karamanaga 88
Asllan BISHA
Deti - frymëzim, detarët e peshkatarët – dëshmi 90
Zuvdija HOXHIQI
Per botimin e librit ”Nga kërkimet dhe hulumtimet në arkivin e bibliotekës së Ulqinit” – të autorit Fadil Kroma 91
Ardita RAMA
Mbi botimin e antologjisë *Merre hisen tënde të diellit* 92
nga përzgjedhësi Hajro Ulqinaku
Hajro ULQINAKU
Merr Perla 93

LIBRI
Mr. Haxhi SHABANI
Problemet e librit shqip në Malin e Zi –
Origjina, botimi, njohja, integrimi 94
Doc. Arjeta FERLUSHKAJ
Sfidat e lexuesit sot 96
Dorian KOÇI
Rrugëtim drejt Evropës përmes librit 98
Msh. Liridona SINISHTAJ
Format e toposit dhe kronosit në prozën shqipe në Mal të Zi 104

HISTORIKE
Prof.as.Dr. Simon LUFI
MA Marsel NILAJ
Zgjedhjet e vitit 1923 në Shqipëri dhe veçoritë në lidhje me Shkodrën 113
MA Anton LULGJURAJ
Trashëgimia arkeologjike e krahinës “Hotit” 122
Dorian KOÇI
Arapët në Shqipëri 128
Gani KARAMANAGA
Dorëzimi i Ulqinit 131
Fadil KROMA
Zhvillimi i veprimtarisë botuese dhe i librarive në Ulqin 136
Moikom ZEQO
Konica për Servantesin shkruante 1900 145

TRADITË

Prof. dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI
Mbi disa familje detare ulqinake 147
Dr Bahri BRISKU
Ullishtaria dhe mullinjtë e ullirit në Ulqin me rrethinë 157
SAMI MISHERRI
Sinonimet e Ulqinit: Ullishtaria, lundrimet, tregtia 176
Muhamet NIKA
Dy fjalë për dimensionin shqip të emrit grek
Hipos (kalit) dhe Aga (Imerit) 181
DR Simë DOBRECI
Fjalë flori të shestanasve 183
Shevqet DRAGAJ
Ngjarje dhe ndodhi në Anë të Malit 189

PORTRET

Gazmend ÇITAKU
Mark Dobreci mjeshtri shqiptar i violinave me famë botërore 192

TURIZMOLOGJI

Dr Nexhat AVDIU
Turizmi si fenomen zhvillimor dhe prirjet e sotme të tij me ndikimin e tyre në hapësirën e marrë në studim 196

ARKITEKTURË

Korab KRAJA
Kulla e Balshajve nën këndvështrimin arkitektonik 202

LETRARE

POEZI

TRADITË

Naim FRASHËRI

JETIMI

Kur mendoj se ç'heq i varfëri jetim,
Zemrën ma pushton i thelli pikëllim.

Nuk ka nënë ditëziu as baba,
Nuk ka njerëz, nuk ka motër, s'ka vëlla.

Është i vetëm, i brengosur, i urishëm,
Si një gur në mes të lumit të furishëm.

Ne vallëzojmë plot harè nga qelqi i verës,
Ai qan, si plepi dridhet në mes t'erës.

Kush e bën atë të qesh' i ngazëlluar,
Padyshim të vetën zemër ka gëzuar.

Zemra që nuk çahet nga i tiji vrerë,
S'është zemër, gur i thuaj njëmijë herë!

S'është zemër, po nuk njohu dhembshurinë,
Është baltë n'është se nuk do njerinë.
.....
Dridhu zemër, nga ky ah, nga ky rënkim!
Dridhu, o njeri, o qiell, pa pushim!

POEZI SHQIPE

Shen TEREZA / Gonxhe BOJAXHIU

LUTJE PER ATE QE MBJELL

Zot,
bekoje këtë burrë dhe copën e tij të tokës,
me qëllim që fara e hedhur
të sjellë fruta shumë.
Bekoji frutat e kësaj toke
me qëllim që ai dhe familja e tij
të ushqejn jetën dhe uria të humbë.
Ashtu si ti që ke ndarë me ne të gjitha
dhuratat e mbretrisë sate,
bëj që dhe ky burrë
të ndajë bollëkun me ata
që s'kanë as tokë e as ç'të mbjellin.
Jepi këtij fermeri,
O zot,
e të gjithë neve
një shpirt të dëlirë,
me qëllim që mbjellja jote
të sjellë kallinj mirësie në jetën tonë.

Esad MEKULI

GJYKIMI

Do të vijnë mbas nesh fëmijët tanë e fëmijët
e fëmijëve tanë
dhe ata do të flasin për ne, ata do të gjykojnë
për ne-
(Breznitë veprat i gjykojn .. -ka thanë nji njeri i
madh!)-
dhe nuk do t'na dënojn, e dij, për belbëzimet
tona, shtërzimet'
për gabimet-t'vogla e t'mëdha-për të
mbërrimet tona…
Pse-kush ka faj që prindet s'na lanë gadi kurrgja

-pos vorreve dhe padijes;
kush ka faj që aq kohë-errësija dhe vetmija-
si mrazet e pranverës kanë mbyt filizat mu në farë?!
Do të vijnë mbas nesh fëmijët tanë e fëmijët e fëmijëve
tanë-breznitë,
dhe ata do të dijnë për ne, se ne jemi pjella e Ditës
së Re-dhe plot diell e dashni;
do të dijnë për ne, e dij, dhe do t'ua kallxojnë me
binduni fëmive të vetë
si kemi ngallnjye, nga hini dhe vjetërsia,qytete t'reja,
fabrika dhe katunde…
si kemi shkrue kangë, si kemi thurë tregime-
tue belbzue ebecenë dhe gjuhën vetë…
(Dhe, ani, që të gjithë jemi marrë me çd! o gja, si me
qenë mjeshtra çollakë,
me pak dije po me shumë e shum vullnet…)

MIGJENI

KANGA E DHIMBËS KRENARE

O dhimbë krenare e shpirtit që vuen
dhe shpërthen ndër vargjet e lira…
A deshte, vall, për t'u ngushlluem
tu' e stolisë botën me xhevahira?
0 dhimbë krenare ndër vargjet e lira,
që kumbojnë me tinguj të sinqertë…
Vall, a do të prekish kënd ndër ndijesina?
Apo do vdesish si vdes gjethi në vjeshtë?
0 kangë e dejë e dhimbës krenare…
Mos pusho kurr! Por bashkë me vaje,
si dy binjakë këndoni mjerimin
se koha do t'ju bijë ngushllimin.

Frederik RRESHPJA

VJESHTË 1990

Qanë dreri në korije dhe lotët bëhen shi
Trishtohet era mbi shkëmb
Nuk ka më gjethë të gjelbra. Po bien
Ëndërrat e pyjeve një nga një.

Ikin zogjtë nga shkretimi i drurëve:
Lamturmirë, o pyje të Ballkanit!
Vëç nën një ferrë kaltëron ende
Vjollca e fundit e këngës së bilbilit

Ardhtë një vjeshtë pa shtegetim zogjsh!
Ardhtë një Zot, vented ore mbi stinët!

VINJETË

Një shelg i vetmuar, mbuluar me dimër
Braktisur nga zogjtë dhe gjethet:
Era, si ketër kërcen mbi drurin
Me bocën e shiut ndër dhëmbë

Netët e lumtura, si zilka
Tringëllijnë në degët e kujtesës…
Vizatohen në sfond të vetëtimave
Hënëzat që hëngrën dhentë e vjeshtës

Rënë nga xhami i thyer i qiellit
Kristal i akullit yllëzon netëve
Dhe mbi pastelet e borës mardht
Shelgu i trishtuar, fatkeq si Serembe

Mimoza AHMETI

ËSHTË ÇUDI KUR JE FEMËR

Mua tani më vjen për të qarë. Më duket sikur
shkarkesa yjesh më janë grumbulluar te sytë.
Dot nuk duroj,
ndërsa çengelat e nervave nderas tërhiqen
kundrejt njëri-tjetrit.
Kangur me foshnjën në xhep
duket figura ime së largu
këtu në bregdet.
Më vjen për të qarë. Jam bërë barrë.
Me siguri molusqet e buta tani
lëvizin kapakët e fortë brenda ujit
dhe kandilet e kuq
kushedi ç'udhëtim të mahnitshëm
kanë marrë
Është çudi kur je femër…
E keni parë natyrën kur tmerrohet, fryn
e shkatërron!
Kur si përbindësh shkrifëron gërmadhat
e mohimit…
Pastaj, kur pastaj, e lehtë dhe e trandur,
me sytë e mëdhenj plot hije
pret një vazhdim, një lindje fëmije
buzë detit ku i vjen për të qarë, për të qarë,
ngaqë se si është, është me barrë.
Në ato orë të ditës kur molusqet e buta
hapin kapakët e fortë brenda ujit
dhe kandilët e kuq
kushedi ç'udhëtim të mahnitshem kanë marrë…

Rrustem BERISHA

MENDOHEJ SHABAN JASHARI

Ne po vdesim në luftë, kullën e trand tërmeti
Të vrarë ne mbesim, të vrarë armiqtë përballë
Dhe kur të bie heshtja nuk bëhet kiameti
Ne me kullën tonë mbesim prapë të gjallë.

Do të mbesim të gjallë në shrimin shqip
Kur arkivat tona të mbushen me thesar
Në këtë skaj të fshatit përmendore pip
Do të flasin armët tona po kulla më parë

Kosova do të ndritet nga yjet e lartë
Nga e madhja dëshirë, nga e jona fuqi
E pastër do të bëhet e jona hartë
Tani bie heshtja, s'duam tjetër lavdi.

Rrahman DEDAJ

MATJA E LARGËSISË

Sa rrugë paskam bërë
Në kurrëfarë largësie.

Ç'i duhet drurit kujtesa
Çdo fund është një lloj fillimi
Heshtja le të pijë ujë shërues

Çdo kush kishte rol kryesor
Në pakohësinë aktuale

Kur bie gjethi i sëmurë
As trungu s'është i shëndoshë
Rrënjës s'i duhet dëshmi

M'u zhvendos mendimi
E mbeta pa asgjë

Sipas mirëqenies njerëzore
Ligjin e çdo fjale
S'e parnon besimi

Zogu i mbetur në kafaz
Këndoi zëshëm
Derisa i harroi njerëzit

Jaho KOLLARI

GJYSHI

gjyshi im lundroi
me shekuj...

pastaj u struk
në shtëpinë prej gurit
dhe rriti nipin
që ia ka frikën detit

(1983)

KURBETÇARI

e dija se do të rrosh shkurt
por se do të *mërdellësh* kaq shpejt
s'ma mirrte mendja

ti zatën i vdekur ishe
përderisa braktise *taprakun*
dhe erdhe të kërkosh kuleçë nëpër therra...
(mërgim, 1992)

Nexhat HALIMI

AMSHIMI

Dhe ja, arritëm, vogëlushe.

Ky është Ulqini mes ujit e qiellit,
Mes pulëbardhës e kalasë,
Mes ulliri, e fiku, e pjeshke...

Rrënja i arrin prej amshimi
Te lulja bedençe, te ylli agon!

- Pagëzoje lindjen tënde,
- shkruama emrin, ëndrrën

e gjatë,
vogëlushe!

Krejt çka i takon dashurisë
do të jetë e amshuar:

- lulja dhe flutura,
- uji dhe fëmija me mollë në dorë,
pastaj buka, ajri,
e një mall, e një mall,

për ata që nuk janë këtu.

Ali GEJÇBRITAJ

PLISI IM

Malet i kemi kufinj me plisa të bardhë
Rumia me fesin bilur përshëndet Cukalin me kësulë
Pelerina e zezë s'ka vend në majë të bjeshkës
Në bardhësinë e lartë shqiponjat kanë çerdhet
Plisi i bardhë në Rumi kurrë s'do bëhëj i zi
Korabi me barinj-kapuçbardhë
Luboteni, Sharri, Dajti, Tomorri...
Gjerë në Palëbadh, Luginë, Tivar, Çamëri...
Reflektojnë bardhësi
Plisi i bardhë mendësi i odave tona
Fjalërrënjë në trojet e pajtimit
Bardhësi në çdo zemër trimi
Plisi i bardhë ndër mote shtroi sofër
Me bukë kripë e zemër bujare
Ngrohtësi dhuroi në vatër
Në Kullat nga guri që s'shemben kurrë
Kristal si bora në bjeshkë
Në rrugëtim shtroi mirësi, urtësi e bujari
Burrëri në logje, urtësi në kuvende
Emblemë e përjetshme gjithandej mbete
Në vargoin e pakëputur të jetës

Arjan Th. KALLÇO

GJURMË

Gjurmë të panumërta
mbi rërën e lagur nga vjeshta
që ende nuk janë fshirë. Askush
nuk ia ka më ngenë plazheve
të braktisura ku tundimet e pashpirt
s'tërheqin më askënd.
Era duket se ka mbetur
diku e panisur, as deti dot
nuk i paska larë.
Dikur kam ecur edhe unë
mbi këtë rërë, kushedi
sa të tilla koha i ka fshirë !
Memece s'shqiptojnë më asnjë fjalë,
vetëm me kujtimet flasin, fort mirë
e dinë se në vargje jetojnë gjallë.
Të dy ne një ditë, Unë dhe Ti,
rruga në Ulqin do na sjellë, dakord
do të jenë të tjera gjurmë,
dy shpirtra në një, jo s'thjeshtohen,
shenjën e bëjnë më të thellë,
shumë…shumë…

Flutur MUSTAFA

ME TË DASHT'

Ti
Më mësove me ndje,
Me ditë,
Me dashtë.

Unë
Duke të dashtë ty
Njoha përjetsinë e nji dashnie të thjeshtë.

Teksa ti plakesh
Unë rritem.
Rritem me shikimin e amël tandin,

Me përkëdhelje të valve
E puthje të hanës lozonjare.

Ramë në dashuri.
Bashkë ngritëm gotat kur na u thyen zemrat.

U betova
Që tjetër qytet nuk do dua më shumë se ty !

E dashuritë
Do na kthehen
Një ditë ...

Edmond TUPJA

TË PREK

Të prek me duar
Të prek me sy
Të prek me zemer
Dhe e di
Që ti s'ke emër
Se më ke mua
Në këtë hon
Dhe të them
Që të dua
Përgjithmonë
Kur jam vetëm
Kur jam me ty
Kur të prek me zë
Kur të fus në sy
Kur të marr sipër meje
Të puth të përkëdhel
Me butësi rrufeje
Kur të zotëroj thellë
Kur e tejshpoj me afsh
Trupin tënd si mëndafsh
Kur të trondis në shpirt
O trishtim kaq i brisht!

Afërdita SALIHU

ULQINI

A keni dëgjuar për Adamin e dytë
Që këputi degën e ullirit?
E krasiti, ndërtoi velanije
Në pyje të pishave frymoi mushkëritë.

Ulqin, mbi valët e tua te detit
20 shekuj, rresht, shikojnë lartë mbi ty
E ti, si zojë e rënde, duke i'a kaluar Zojës së Lurdës
Nikoqire e mirë, nuk shtron tryezë pa fiq e ullinj.

Fisi taulant hijëshon lartë mbi shkrepa
Zili të kanë gjurmë sllave, bizantine e romakësh
Gjumuar janë pafundësisht në thellësi detesh
Kalaja si plis mali me borë, është rojë varkash.

Ti Ulqin, je me fat, me në ballë Gjirin e Valdanosit
Dëgjova tek këndojnë burrat peshkatarë e gratë shamibardha
Ne na vesh supeve me valë deti, ne bijave Kastrioti
Bekimi ra mbi ty shqipërisht, nga rrezet diell rralla.

Perlë kaltërore, nga qielli zbritur margaritarë
Dhe thellësia mbanë këtë emër, lashtësi arbërore
E hëna që ka sy, vetëm për ty, ty për të parë
Se me bukurinë qe ke, piramidat nga gjumi zgjove.

Një poemë e pambaruar
ULQIN!

Flutra AÇKA

TRUST ME

Trust me!
Një zë shpirti tretet në frymë,
Duar që flasin morsin e ethtë,
Gojë zemërake që përbijnë
Lojën e lëngët në rimth,
Lëkurë që kthehet në fërgëllimë,

Dhe e bën të dukshme
Të praptën gjymtyrë erektike.
Të lugëtat thellina
Zbulojnë të errëtat femëroret fshehtësina.

Më e papesha peshë peshon,
Mbi trupin që e ka humbur rëndesën,
Qelizë e kriptë grua,
Grimcë Krausi burrë,
Asfare fikur,
As sosur kurrë.

Trust me!
Jam burrë që të dau.
Mbamende: Të dua!

Skënder OSMANI

ULLIRI

Po t'ia shkulësh rrënjët ullirit
S'len pa bë kokrra.
Po ta cungosh në kryq
Rrënjët i mbushen fruta.
Ulliri na zemrën e gjerë porsi deti
E jetën e gjatë si Ulqini

Mirko GASHI

ROZAFATI

Secili i falëm nga diçka
Kush emrin
Kush eshtrat i la

Nga gjaku
Nga zjarri
Koha sa herë eksplodoi

Rreth diellit tonë
Sytë shpella i bëmë
Në bjeshkë s'pushuan tupanët

Se secili i falëm nga diçka

Armikut ia shtruam rrugën
Me kufoma
Deri te zemrat tona

E ai kurrë se shkeli
Perënditë tanë
Kurrë s'mund i arriti

Se secili i falëm diçka
Kush emrin
Kush eshtrat i la

Hajredin KOVAÇI

KOHA JAVORE

Unë gjithmonë mësyj
Një qoshe të banakut
Në kafeterinë "Arb"
Shikoj punën time
Lexoj shtypin e ditës
Kuptohet në gjuhën joamtare
Sigurisht jo me fajin tim
Gjashtë ditë në javë lexoj
Pi një ekpres edhe një tjetër
Pres në rend për gazetën

Të enjten blej "Kohën"
Lexoj lexoj lexoj
Sa për gjashtë ditë
"Koha" është krejt e imja
S'ma merr kush tjetër
Të tjerët në "Arb" vazhdojnë
Me avazin e vjetër.

Sali BASHOTA

BALADË PËR YMER AGË ULQININ

Ulqini ha e vetëm vjell
Ditën që s'vjen dot
Nga gjëmimi i thell[i detit

Po Ymer Aga vret
Një shpend të keq
Si në rapsodi të moçme
E zgjohet nga gjumëharresa

Ulqini fle kur fryn e vetëtin
Buzëmbrëmja lëneshë
Kur Konstandini kap kokën me duar
Dhe pështyn diçka

Tashti dhimbja e truallit lëviz
Sakaq mbështjell gurin e besës
Emrin e përndjekur
Nga erërat e varret

Ulqini ha e vetëm vjell
Ditën që s'vjen dot
Nga gjëmimi i thellë i detit

Eqrem BASHA

ETHE LARG SHTËPIE

Zgjohem me teket e të mërguarit,
Dhe them
Kam mik vetëm jetën
Dhe vdekjen

Tërë ditën numëroj hapat
E patrullës së shpirtit
Më ruajnë edhe kur pi
Nga gota me akullin
E ballit të ftohur.

Zgjohem herët
Dhe numëroj rrathët
Në kurmin që ende rron
E s'është mik
As me hijen e vet

Fatos ARAPI

ELEGJI PËR BABANË

Ti nuk je më.
As do të na shohësh,
as do të shohim,baba, më kurrë.
Ti nuk je më..
Emrin tënd e mori ky gur,
Vdekja – si vdekje ,
gjithmonë e dhimbshme,
gjithmonë e verdhë…
Me një kordhele
tufa kujtimesh në zemër na lidh.
Tufa kujtimesh
edhe elegjish.
Jam i trishtuar dhe më mori malli.
Dhe mbi trishtime e mall duke ecur,
ngjita rrugën e ngushtë të fshatit.
Shtyva derën e varrezës së vogël
dhe t'erdha te varri…
C'fjalë të pathëna do të më fiasësh?
C'fjalë të reja dëshiron të dëgjosh?
Prej këtij varri
tani, baba, c'do të më japësh?
Atë ditë të thatë janari:
përpara teje Halil Alija
e mercenari.
Prapa shtëpia në zjarr e flakë
Duart e tua në pranga,
plak i ngartë?
Erdha të marr
cfarë perket prei këtij varri.
Kujtime të dhimbshme.
Vuajtje krenare.

Ti mos më thuaj:
“Biro… ianë të trishtuara”.
Baba i gjorë!
Unë, pa ato,
do t’isha në jetë edhe më i trishtuar.
Dhe kur të vdes
s’dua asgjë
vec një varr të thieshtë.
Atje në bregdet,
ku nëpër net
bisedojnë yjet me qiparisat.
Dhe fjalë të kaltra
flet e shprëndan
deti matanë.
Fjalët që i njohim,
që i kuptojme,
unë
me babanë…

Skënder SHERIFI

HERËN TJETËR

Shiko, herën tjetër
Kur të zgjohem i dehur nga shtrati im
Në agun e errët të mëngjesit të përhitur:
Dashurom ”à la” kinezisht

Shikuo, herën tjetër
Kur të gdhij i magjepsur nga drita e verës
Dhe kur ta ndjej gëzimin e të qenit:
Rrëfimi do të thëna si di vetë.

Shiko, herën tjetër
Kur të vallëzoj me të gjithë zogjtë e tokës
Midis pafundësisë kaltër e blertë:
Thuajmi ca vargje të prekshme

Shiko, herën tjetër
Kur të bëj shaka deri në çmenduri
Midis një Veshi të prerë dhe një Pikture:
Më ngop me tableta gjumi të thellë

Argëzon SULEJMANI

ISHTE BARDH E ZI
(Migjenit)

Do doja të më kishte mbuluar ajo botë
Brigjet ku ai vetmonte me cigare e qiprik
Aty ku kishte kthyer e thyer ndonjë gotë
Më i ri s'bëhej dhe i thoshin**:** *i lig*

S'i shihte vajzat veç prej gjoksi e beli
Rrudhte paksa sytë për sytë delikatë
Shati i thoshte lapsit: *ç'dembelì*
Në kokë plot, i mangët në shtat

Lus shajnitë ta sjellin sërish në Tivar
Këmbëkryq le të meditojë portrete
Kofshët le t'i ngjyejë në barin e paBar...
Bythët në tokë, mendjen mbi planete

Visar ZHITI

SHIU I PRISHTINËS

Le të më lagë shiu i Prishtinës,
ecjen ma bën të perëndishme.
Perlat e tij si emocion shndritës
ranë mbi supet e ardhjes time.

Mos më futni në klube, çadër nuk dua,
le të më lagë shiu i Prishtinës.
Dhimbja ime kaq shumë u gëzua
ashtu si shpirti i vetëtimës.

Vështroj statujat, i tëri goditës,
u heq shpatat, të hekurtat këmisha.
Le të më lagë shiu i Prishtinës,
i shenjtë, i shenjtë si përtëritja.

Humba mes resh, anonim i gjithë,
si vjeshta u bëra, më mahnitës.
Që fatin tim të njoh, të bukurisë,
le të më lagë shiu i Prishtinës.

Pavle GORANOVIQ
(Mali i Zi)

VARGJET E LARGËTA

O, vargje të largëta, kryesisht të dala nga diçka
Ose nga ato ditë kur gjërat vetveten kanë shqiptaur,
Kanë shpikur emra të tjerë.
Tani të mbështetur në një kujtim të hollë,
Po gjurmoj pas të afërmve tuaj:
Ashtu vjen i verbëri tek ndjenjësia e tij.

Askund të shkruara nuk i gjej rrokjet e kota.
Nuk ka më aso netësh të largëta që më kanë dhuruar vargjet,
Fjalët që në ditët e kaluara më kanë përcaktuar jetën.
Nuk i shoh të mbërthyera për renë e qetë
As në sipërfaqen e ujit të errët të liqenit të vetmuar.

O, letrat e mia të largëta çifteve,
Rrokjeve të kota që dikur me ëndërra më frymëzuan.
Sikur dikush tjeetër ju ju ka krijuar,
Sikur edhe mua tani si një të huaji u paraqiteni.
A jeni të shpërndara me erë nëpër detet e largëta
Ose përjetë të humbura
Mes korrespodencave të hedhura më herët në dritë hëne?

O shenjt, për shkak të kujt kjo ditë quhet e bekuar;
Ma kthe këmbënguljen e biografëve të vjetër
Dhe më jep forcën e Fernando Morientesit
Për të hyrë përsëri në hapësirat e shenjta të gjumit,
Dhe për të ringjallur ato vargje të largëta.

(*përktheu Dimitrov Popoviq)*

Dragana TRIPKOVIQ
(Mali i Zi)

MASKA NË VEND TË FYTYRËS

E dini, mua asnjëherë nuk më kanë
thënë se mund të gënjej.
Kjo nuk do të thotë se gënjej
më keq se të tjerët.

Ti ke njëmijë maska.
Do thoja se je mjeshtër
por vetëm, i maskimit.
Që të dy e dimë se
në të vërtetë ti ske fytyrë.

Ty askush nuk do të të dojë
në të vërtetë. Ajo diçka do zgjasi
Deri sa nuk të ndërrosh makiazhin,
sepse ata dinë të gënjejnë
dhe nuk mund t'i mashtrosh.

Ata nuk e duan fantazinë dhe
mosekzistencën. U duhet një
formë të fusin *rrushin*. Ata
kërkojë ashtin që ta thyejn
dhe mishin ta mavijosin.

Më fal që po them të vërtetën
por nuk më thanë se
mund të gënjej. Zgjedh
sonte kostumin tënd më të mirë
dhe më shoqëro në qytet.

Unë edhe ashtu gjithmonë dashuroj
pa ndonjë arsye.

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Sanja MARTINOVIQ
(Mali i Zi)

U ZGJUAM E SË BASHKU

U zgjuam e së bashku me ne
disa fjalë të përditshmërisë.
E pimë kafenë. Diçka hëngrëm.
Shkove.
Unë isha shtrirë. Ti erdhe.
E me ty disa fjalë të përditshme.
Doja të të thoja se
nuk kam më shoqëri.
E se kjo më dhemb.
Dhe nuk e di se ku kam gabuar.
Jo, vendosa të mos e hap gojën.
Është më lehtë.
Shikuam një film të parëndësishëm.
Shkove.
Edhepse ke dëshirë të shkosh vetëm me mua.
Të cilën më sollën lejlekët
Nga një planet tjetër.
Unë isha shtrirë. Ti erdhe.
Dhe disa fjalë të përditëshme.
Vazhduam të shikojmë atë filmin e njejtë.
U shtrive pranë meje.
Dhe ma ktheve atë shpinën tënde të madhe.
Më the se më don.
Edhe unë ty, të thashë.
Dhe ta ktheva shpinën

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Senad KARAGJUZOVIQ
(Mal i Zi)

MULLINJTË E ERËS

Nuk doja të shpjegoja:
Era dhe mullinjtë e erës
Vërtetojnë
Funksionalitetin e vet
Edhe pa Don Kishotin.
Dulçinën time
E interesonte
Çdo detaj,
E ishte e dënuar
Të mos kuptonte asgjë.

Ajo dëgjon,
Unë përsëris,
Ajo nuk kupton,
Vetëm dysheku
Kohë pas kohe
Nën ne kërcet
Sikurse kërcimat e mullinjëve të erës.

(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Dubravko BRIGIQ
(Bosnjë dhe Hercegovinë)

PIKË GJAKU SARAJEVE

Qershor është – mu sikur të mos ishte luftë
bliri kundërmon.
Në bregun e majtë të Milackës,
në varrezat e vjetra jevreje,
duhet që edhe tani, sikurse nga kënga,
të kundërmojnë vjollcat e bardha.
Nga aty, për ku fluturon dallëndyshja,
mua për kryq të dylbirit
më gjurmon syri i snajperistit.

Dhe vera, ja, tashmë e treta
për te, si për altar,
unë, pikë e gjakut, mëngjeseve përgatitem.
Sarajeva derisa kaltëron detin e Kuq.
Edhe unë jam i përzgjedhur, pa dyshim:
shkela valët –
pika do të më mbytë.
(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Borislav JOVANOVIQ
(Mali i Zi)

POETIKA E ATËSISË

Frika nga I Ati është frikë e Zotit. Frika e Të Birit nga i biri i vet.
Frika e fjalës që të mos braktiset.

Kjo është frika e Të Atiti nga I Ati i vet. Frika e të njëmendëve
të cilët nuk janë. Frika e vendosur mes drithmës kozmike dhe
domosdoshmërisë atësore.

Gjithmonë në fillim të vjershës absolute. Me shpengimin
reciprok për përvojë të njejtë
(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Tanja BAKIQ
(Mali i Zi)

***
Fshehtas valët dhe era
Putheshin
Kurse ne tërë kohën
E dinim
Era qëndronte
Buzë lumit në barë
Gjurmët e tradhëtosë
Duke i fshirë pas
(*përktheu Gazmend Çitaku)*

Bob DYLAN

TROKITJE NË PORTËN E PARAJSËS

Mama hiqe prej meje këtë dekoratë
Nuk mundem më ta përdor si eskortë
Po errësohet,është shumë errësirë të shoh
E ndihej se po trokas në të parajsës portë.
Tak tak tak në të parajsës portë...
Mama groposi armët e mia
Nuk mundem mbi ata të gjuaj fortë
Reja e zezë po zbret tashmë
E ndiej se po trokas në të parajsës portë.
Tak tak tak në të parajsës portë...

(E përgatiti dhe përktheu Flurans Ilia – Flurka)

Leonard KOHEN

SUZANA

Suzana të merr për dore, tatëpjetë,
Pranë lumit, tek vendi i saj i fshehtë,
Ku sirenat e anijeve mund t'i dëgjoshë,
Ku për gjithë natën pranë saj të qëndroshë,
Dhe ti e di që ajo është gjysëm e çmendur,
Arsye që e shtyn kureshtjen e pagdhendur,
Pikërisht ajo ç'ka do t'i rrëfesh asaj tashti,
Këtë natë: nuk të ka ngelur fare dashuri.
Dhe ajo pa folur të merr në valët e saj,
Duke lënë lumin të t'përgjigjet pasandaj,
Që ti gjithmonë ke qenë i dashuri i saj.
Dhe ti dëshiron të udhëtosh me të,
Të përshkoshë i verbër hapsirën, pa zë,
Ajo verbërisht të beson veç ty, këtë natë,
Po qe se ti, trupin e saj mbart në imagjinatë,

Edhe i madhi Krisht ishte lundërtar,
Ndërsa ecte përmbi ujë, shkëlqente si far,
Të tjerët nuk e besonin, dhe s'kishin si ta dinin,
Vetëm të mbyturit e përposhtëm mund ta shihnin,
Ndërsa thoshte " Gjindja do t'bëhen lundërtarë,
gjersa deti nën vetvete do t'i çlirojë, duke i marrë" !
Ndërsa brenda vetes zemrën e kishte të thyer,
Përpara se vështrimi i Qiellit drejt Tij te ishte kthyer,
I dorëzuar, i kryqëzuar, veçse si qënie humane,
Mbyste, përpos vetes (si deti) urtësinë vigane.
Dhe ti dëshiron të udhëtosh me të,
Të përshkosh i verbër hapsirën, pa zë,
Ti verbërisht beson veç tek Ai, këtë natë,
Po qe se Ai, trupin tënd mbart në imagjinatë,

Suzana, prej dore të ka zgjuar prej gjumit,
Ajo është e vetmja lidhje midis teje dhe Lumit,
Ajo është e veshur me rrecka-endacake,
Të shqyera prej të sajave ditë-bredharake,
Dhe ndërsa dielli pikon si mjalti mbi jetë,
Zbardhëllon krejt gjirin e Zonjës së vërtetë,
Të tregon se ku duhet vetveten të fiksoshë,
Përmes plehrave dhe luleve të vrojtoshë,
Atje poshtë algave në thellësi, ka të mbytur heronj,
Fëmijë që shpresës së mëngjesit, i qepen me thonj,
Në ankth ëngjëllor, për pak më tepër dashuri,
Kështu pritja ka për të qenë në pafundësi,
Ndërsa Suzana përball teje mban pasqyrën,
Dhe ti, përplot një jetë udhëton me të,
Verbrisht e di, se beson tek ajo këtë natë,
Kur ajo trupin tënd mbart në imagjinatë.

(E përgatiti dhe përktheu Flurans Ilia – Flurka)

Guillame APOLLINAIRE

URA MIRABO

Poshtë urës Mirabo lumi Senë shkon
pse m'u kujtua vallë
dashuria jonë
pas hidhërimit gaz kishim gjithmonë
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Kapur dorë për dore le të rrimë përballë
ndërsa poshtë
urës së krahëve tanë
e lodhur vështrimesh, vala para çan
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Ikën dashuria si ky ujë që rrjedh
ikën dashuria si kjo jetë e qetë
dhe si shpresa që është kaq e sertë
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj
Treten ditët, edhe javët treten
as kohë e kaluar
as dashuritë s'kthehen
poshtë urës Mirabo shkon lumi i Senës
Le të bjerë nata ora të kumbojë
ditët seç po ikin, unë këtu qëndroj

Johann Wolfgang von GOETHE

SI ERDHE TI?

Si, erdhe ti?! Plot mall syte s'i ngrita
Dhe s'te dallova, kur u ktheve, jo!
O çast i lumtur e qe s'kthehesh! Ç'prita?
Mos jam i verber? Si me ndodhi kjo?

Ti mua do me japesh pak te drejte
Ne do mundohem te te ngushulloj
Kur afer je nga syte me shket lehte
Kur ndodhesh larg me shfaqesh para, moj!

James JOYCE

KUJTIMIT TË LOJËS SË AKTORËVE NË NJË PASQYRË NË MESNATË

Goja është shprehëse e dashurisë suaj. Kërcëlloni
Dhëmbin e trembëdhjetë
Për të hapur gojën vesh më vesh së qeshuri. Kruajeni
Zgjeben dhe qelen tuaj, lakminë lakuriqe të mishit.
Fryma e dashurisë në ju është bajate, e thënë apo e kënduar,
E thartë si fryma e lopëve,
Ashpërsia e gjuhës së tyre.

Kjo gri që na kqyr nuk shtrihet
Dot, është asht e lëkurë e mpirë
Buzët e tyre të lyrëta formojnë puthjet e tyre. Askush
Nuk do t'ia donte ato gojë që kini mbi fytyrën tuaj.
Uria e tmerëshme pllakos orën e saj.
Nxirreni zemrën tuaj tej, gjakun e kripur të saj, frut i lotëve.
Merreni dhe kapërdijeni!

Gabriel Garcia MARQUEZ

LETRA E LAMTUMIRËS (Kukulla)

Nëse për një çast Zoti do të harronte se
jam një kukull lecke e
do të më dhurojë paksa jetë, ka gjasa se
nuk do të them gjithçka që mendoj,
por patjetër do ta mendoj çdo gjë që do ta them.

Do t'iu jepja vlerë gjërave, jo për vlerën që kanë,
por për kuptimin që kanë.

Do të flija pak, do të ëndërroja më shumë,

e kuptoj se për çdo minutë që i mbyllim
sytë, humbim gjashtëdhjetë sekonda dritë.

Do të ecja përpara kur të tjerët do të ndaleshin,
do të rrija zgjuar kur të tjerët do të flinin,

do të dëgjoja kur të tjerët flasin dhe
dhe sa do të shijoja një akullore të mirë çokolate!

Nëse Zoti do të më dhuronte paksa jetë,
do të vishesha thjeshtë,
do të shtrihesha në pishë të diellit duke lënë zbuluar jo vetëm
trupin tim por edhe shpirtin tim.

Zoti im, nëse do të kisha një zemër, do ta shkruaja
urrejtjen time në akull dhe
dhe do të prisja që të shkrihej në diell.

Do të pikturoja me një ëndër të Van Gogut
sipër yjeve një poemë të Benedettit
dhe një këngë e Serratit do të ishte serenata
që do t'ia kushtoja hënës.

Do t'i ujitja me lotët e mi trëndafilët,
për ta ndjerë dhimbjen e gjembave të tyre
dhe puthjen e mishtë të petaleve të tyre…

Zoti im, nëse do të kisha paksa jetë…

Nuk do të lija të kalonte qoftë një ditë të vetma
pa iu thënë njerëzve se dua,
se i dua. Do t'i bindja të gjithë burrat e gratë
se janë të parapëlqyerit e mi dhe
do të jetoja i dashuruar nga dashuria.

Njerëzve do t'ua provoja
sa gabojnë tek mendojnë
të heqin dorë së dashuruari
kur plaken, pa e ditur
se plaken kur heqin dorë së dashuruari.

Një fëmije do t'i jepja flatra,
por do ta lija ta merrte fluturimin vetë.

Të moshuarit do t'i mësoja
se vdekja nuk vjen me pleqërinë
por me harresën.

Kaq shumë gjëra kam mësuar nga ju, Njerëzit!

Ka mësuar se e gjithë bota adhuron të jetojë
mbi majën e malit,
pa e ditur se lumturia e vërtetë
është në ngjitjen e shpatit.
Kam mësuar se
kur i sapolinduri shtrëngon me grushtin e tij të vogël,
për herë të parë, gishtin e babait të tij,
e mban shtrënguar për gjithmonë.
Kam mësuar se një njeri
ka të drejtë ta vështrojë një tjetër
nga lart poshtë vetëm
kur duhet ta ndihmojë për t'u ngritur.

Janë aq shumë gjëra
që kam mundur të mësoj nga ju,
por realisht,
nuk do të më shërbejnë shumë,
sepse kur do të m'i vendosin
brenda asaj valixheje,
palumturisht do të jem duke vdekur.

Anders JOHANSSON

PAMJET

Dikur moti
ëndërroja shkallë të larta, të paqëndrueshme
të zgjatura drejt qiellit.
Tash më afër barit
vras nganjëherë mendjen
nëse një skeletdruri kah drita
më do dicka mua.

Ndoshta është pamja e një zjarri
ajo ngrohtësi që cdo njeri
mund ta ndjej për vetvetën.

Nëse mund ta shihte vetvetën nga largësia
dhe t'ia lakmonte vetës atë jetë të jetuar.

(përkthyer nga Rizah Sheqiri)

Kahlil GIBRAN

KUJTIME

Nuk do të lë që as edhe një fantazëm e kujtimeve të mia
Të ikte bashkë me retë
Janë këto vuajtje të së shkuarës
Që shpesh më sjellin dhimbje
Por nëse do më duhej të zgjedh mes gëzimit dhe dhimbjes
Nuk do të këmbeja dhimbjet e zemrës sime
Me gëzimet e botës mbarë
Kënga e zemrës
Kënga e zërit është e ëmbël
Por kënga e zemrës
Është zëri i pastër i qiejve

(Përktheu: Ermira Shpëtimi-Zaganjori)

Jacques PREVERT

PARIS AT NIGHT

Tri shkrepse të ndezura ,
një nga një në errësirë
E para për të parë
fytyrën tënde,
e dyta për të parë
sytë e tu,
e fundit për të parë
gojën tënde
dhe tërë nata për të mi kujtuar përsëri
duke të të shtrënguar në krahët e mi

PROZË

Jaho KOLLARII

HOMERI

Fakti se Homeri ishte i verbër (gjë që njihej botërisht), konfirmonte atë se ai me siguri duhej të kishte qenë edhe shurdh! Nëse s'qe total pa veshë atëherë, pa dyshim, veshët e kishin lënë shumë më përpara se mbaroi Iliadën!? Kjo vërehej tek analizohet eposin që sot ekziston!... Madje këtë plagjiat të shëmtuar të Homerit e quaj një imitim të keq, për më tepër, vjedhje, ku Homerit ia jap epitetin e hajnit (kujtoni vetëm faktin se në histori pothuaj gjithherë njerëzit më të njohur dhe më të zotë qenë hajna!?).

Ndërsa, pra, fillova me Odisenë, shfaqa habi përse Homeri shkruan për ilirët! Shpjegim do ' ishte: ose ishte vetë ilir, ose kishte dëshirë që ilirët t´i armiqësonte me popuj të tjerë. Me këtë ai deshi të arrijë dy qëllime: një-ta kënaqte gopin e vet, pra, të bëjë shokë, ndaj Odiseun e shtyri ta verbojë Polifemin, dhe dy-duke verbuar Polifemin (anipse Odiseu përdori emër të dykuptimtë) qiklopët t´i armiqësojë me ilirët. Homerin, pa dyshim, që në Odise kishin filluar ta lëjnë veshët, apo më mirë: të bëhej matuf. Nga leximet, pra, analitike të të dy epeve, përfundoj se autori(!) i tyre si teveqel nëpër terr, me plot prapavi tendencioze kapte copëzat e epeve ilire duke ua veshur petkun grek!

Tek Iliada vura re diçka që, ma kap mendja, edhe filologëve u qe përvjedhur!? Së pari titulli i epit Iliada, *në të vërtetë duhej të ishte* Iliriada*! Rrokja* ri *duhej të ketë mbetur dikund, apo më qëllim e larguar, çka sërish e fajësoj Homerin, i cili, si qorr që ishte, pa dyshim* s'e kishte vërejtur*!? Iliriadat ishin tubime e manifestime, pra rite të ilirëve!*

Më tutje vjen Troja, *e cila në realitet quhej* Droja*! Një fortesë, pra, e pamposhtur ilire, të cilës grekët ia kishin drojën. Si po shihej, edhe këtu Homeri na del fajtor. Ky, jo vetëm s´e njihte mirë gjuhën ilire, por nga arsyeja që nuk dëgjonte mirë (ky është fakti më i gjallë se ai s'qe veçse një shurdh) në vend të shënonte* Droja, *shënoi:* Troja. *Sipas Homerit, për ta mposhtur Drojën grekët u shërbyen me* Kalë të drunjtë *(që është larg çdo të vërtete, meqë Troja, përkatësisht, Droja nuk është mposhtur kurrë), të cilin Homeri e ka trilluar. Kjo nga fakti se, si plak matuf siç ishte, lozte shpesh me lodra të fëmijëve, ndër të tjera edhe me kuaj të drunjtë!*

Homeri veç që ishte qorr e shurdh ai duhet të kishte qenë edhe sakat!? Fakte të gjalla janë ngushtimet e tepruara, pra, tkurrjet që ua kishte bërë epeve. Kjo flet në favor të supozimit, e mbase edhe të faktit, se s´kishte pasur mundësi të lëvizte aq sa duhej (informatat që ia sillnin kasnecët s'qenë të mjaftuara).

Nga e gjithë kjo del ajo popullorja: me qorra e sakatë mos paç punë*! Ndaj mendimin se tipa të këtillë hajnash duhen zbuluar (këtë u përpoqa të bëj), përdhosur dhe* veprën *e tyre duhej vënë në teh të briskut...*

Tek i palosi këta rreshta, Meritonit s'i vajti në kokë se tani i duhej të gjejë së paku një qorr, shurdh, e mbase edhe sakat e t'ia botojë këtë llomotitje mbi epet e Homerit. Menjëherë duhej thënë se Meritoni s'qe i vetmi që u *orvat* ta kritikonte Homerin, por duhej pranuar se mënyra e tij s'ishte e përçdoditshme. Ky kishte harruar sa net s'kishte vënë gjumë në sy për të realizuar e gjithë këtë. Është këtu edhe diçka tjetër: përse Meritoni Odisenë e rreshtoi të parën, kur dihej tashmë se kur përmendet Homeri dhe veprat e tij, Iliada vjen e para?! Kjo ka ndodhur ndofta nga arsyeja se Meriton Dajaku të gjitha gjërat i kap bythëprapa!... Sipas këtij të fundit ka gjasa që Homeri të dy epet t'i ketë hajnuar njëkohësisht, ndonëse më vonë erdhi në përfundim se, megjithatë, Odisea duhej të ishte vjedhur e para. Këtë e dëshmonte me atë (makar përpiqej ta dëshmonte) se Homeri në Iliadë e kishte humbur fare: ishte bërë më qorr se të verbërit, më shurdh se të paveshët dhe më matuf se seniliteti akut! Me tjera llafe: gjepurat që i qenë ngatërruar nëpër këmbë në Iliadë, çojnë ujë në mulli të supozimit se Homeri s'qe veçse një hajdut pulash!

Llomotitja e Meriton mbi epet e Homerit doli në dritë. Ia botoi një revistë, e cila të vetmen rubrikë serioze e kishte horoskopin. Për fat, apo mjerisht, kjo revistë vinte tepër rrallë në qytet. Kur i ra në dorë, Meritoni lozi me të më se një javë përpara hundëve të njerëzve. Disa ia kishin përplasur për fytyrë revistën, por Meritoni e kishte ushqim shpirti t'ia bënte vetes me sy. *Jam kritik i madh...* dëgjohej shpesh nga goja e tij. *Madje, hiperkritik...* ia kishin bërë disa. Kjo i jepte shteg ta shikojë botën nga një lartësi marramendëse. E keqja ishte se provinca valonte nga të tillë bandillë. Madje s'duhej vajtur hiç më larg se kafiteria e Dashamirit e të të *kënaqej* syri.

Durim Shamata me një frymë e gëlltiti *Analizën kritike të epeve të Homerit*. *Të lumtë*, i kish thënë ky dhe ia kish shtrënguar dorën, të cilën Meritoni rrallë e hiqte nga xhepi. Durimin e kënaqi aftësia e të nuhaturit, për më tepër, thellësia veneruese, me të cilën Meritoni qiti në tepësi imposibilitetin që Homeri të mashtrojë botën!? Pra ky *imposibilitet* bëri të mundshme që Meritoni të vetëkënaqej. Mbasi i ra në dorë revista dhe diç më vonë tek u takua me Meritonin, Tafë Tofi shfaqi një simpati ndaj punimeve të këtilla. *Bile*, i kishte thënë ky, *humori pothuaj origjinal që del nga punimi yt, tejkalonte sarkazmin shabllon të të përditshmes provinciale...*

Meritoni duke luajtur biliardo (duart pothuaj s'i hiqte nga xhepi), e dëgjoi Tafën dhe shprehu çudi përse ky i fundit s'e kishte kuptuar brendinë e punimit. Tek kujtoi aftësitë e këtij të fundit, Meritonin e hangri miza se Tafa e kishte kuptuar fare mirë, por si kishte zakon të përqeshte çdogjë, vuri në lojë edhe punimin e tij! Biliardo vazhdoi të lozë Meritoni edhe pasi doli nga

kafiteria e Dashamirit (është interesant të thuhej se steka me të cilën luante ishte variabile. Ajo herë bymehej e zgjatej, e herë tkurrej e shkurtohej).

I pakënaqur nga opinionet e shumicës së kolegëve, Meritoni u dëshprua së tepërmi. *Më mirë është të shkoj në shtëpi e t'i gjuhem në prehër gruas*, mendoi, *ajo, ndonëse shpesh më ka gënjyer, asnjëherë nuk më ka zhgënjyer*... Dhe u nis drejt shtëpisë, me kokë të lëvarur...

Ndodh kështu, bile ndodh shpesh që mashkulli kur të martohet ta humbasë fare. Këto gjëra në provincë kualifikohen si dobësi karakteri. Kur janë në pyetje shkollarë, siç ishte Meriton Dajaku, thuhej: *s´ka faj i shkreti, shyqyr që ka rënë në pelë*, ose, *gjynah, i paskanë vajtur trutë pas qafe para vaktit*, apo, *fukarait, i paska hipur gruaja*... Kështu thonë njerëzit e thjeshtë, elita s'ka kohë të mirrej me kësi punësh! Më saktë: gjynah të humbasë kot kohë e kaq përcipët të lërojë. Ajo, pra, zgavërron më thellë, gati deri ndër veshë, si urithi, duke hapur e mbyllur hulli. I thërrmon e i grinë plisat, thua i bën pluhur, pedologët të kenë punë pastaj. Këto bën elita në pushimet në mes dy shterpësive... Elita ka nevojë edhe për horizontalitet edhe për vertikalitet, ka nevojë domosdo edhe të ngërthehen këto dy përmasa në një udhëkryq bosh! Andaj nuk ishte e tepërt ajo çfarë kërkoi njëri prej tyre: *të lidhen në vijën profesionale*! Sakaq, ky propozim hasi në rezistencë nga disa të elitës, të cilët tashmë ishin të lidhur profesionalisht! Menjëherë duhej thënë se rezistenca nuk erdhi nga *të lidhurit*, por prej atyre që dëshironin të jetë zogj, mbase edhe shtegtarë.

Kështu provinca i kalonte ditët. Netët kalonin vetvetiu. Ato i shtynte gjumi apo pagjumësia akute.

(1994)

(Prozë e shkëputur nga libri „18+“, Jaho Kollari, Diti&Oli-Libraria ARTI, Ulqin, 2016)

Edita NIMANBEGU

I MBUSHI PESËMBËDHJETË VJET

Sija. Ishte ajo një bukuroshe, me sy të zez e të shkruar, flokët e gjata të dredhura iu dridheshin mbi supe, kishte një shtat të vogël shumë joshës.

I mbush pesëmbëdhjetë vjet, por dukej më e rritur. E gjallë dhe punëtore, punonte nëpër oborre duke ndihmuar nënën e motrat.

Nga vrimat e murit, në oborrin fqinjë, me bukurinë e saj magjepsej Ceni, një djalë shtatlartë me sy të zez, flokë krela-krela.

Ceni vinte te motra e tij dhe, sa herë që në oborr ndiente zërin e saj të ëmbël, i dridhej trupi dhe e kaplonte një ndjenjë e çuditshme të cilën nuk dinte si ta shpjegonte.

Motra e vërejti një kohë të gjatë Cenin se i vinte shumë më shpesh dhe gjithë kohën e kalonte tek ajo vrima e murit.

- Eh, do të futesh në bela kot, - i thoshte e motra, - nuk është ajo për ty!

- Pse? - e kundërshtonte Ceni, - ti do ma kërkosh atë mua për nuse.

- Eh, Ceno, Ceno! - i thoshte ajo: - *Merre lulen në kopshtin e vet*!

Mirëpo Ceni ra në dashuri dhe nuk dëshironte asnjë tjetër për nuse përveç saj. Gjente justifikime të ndryshme, veç të vinte tek e motra dhe të ketë fat ta shohë edhe një herë atë bukuroshe. Nuk gjente mënyrë t'i afrohej, sepse ajo gjithmonë ishte në shoqërimin e dikujt nga familjarët, se ishin familje e madhe. Por ai kënaqej dhe me përcjelljen nga vrima e murit që ndante dy shtëpitë fqinje. Ushqehej me zërin e saj të ëmbël.

- Je i ri, dashuria do të kalojë, ka plot vajza të bukura, motra ty do të ta gjejë edhe më të mirë se këtë - mundohej ta qetësoj e motra. Tentonte e shkreta t'ia largojë nga mendja e nga zemra atë vajzë, se e dinte që do i thehet zemra.

Por më kot, me sytë e tij shihte vetëm atë, në zemrën e tij u rrënjos ajo bukuroshe e paprekshme për te. E gjet belaja, nuk dinte asnjë zgjidhje. Në një gjë ishte i sigurt, se nuk e imagjinonte dot jetën pa te. Meqense ishte tepër i ri nuk u bindte se mundë dikush të ndalojë diçka. Asgjë nuk i dukej e pa arritëshme.

Pasi që motra i njihte mirë si fqinjë, e dinte që ata për të bijën kërkonin djalë fisi, se e kishin veç njërën të fejuar në goxha familje. E dinte e mjera që vëllai do të vuajë, se ata vajzën nuk do t'ia jepnin kurrë. Andaj mundohej në çdo mënyrë t'ia largonte prej mendjes dhe zemrës, çka ishte e pamundur.

Që të qetësoj zemrën e të vëllait, ajo u zgjua herët një ditë të enjte, fali sabahun duke u lutur që t'ia prijë Perëndia të mbarën në qëllimin që kishte.

Pasi që shkonin e vinin me fqinjët, nuk ishte e çuditshmet të shkojë herët në mëngjes, zakonisht u mblidhnin fqinjët të pinin së bashku kafenë e mëngjesit. E vendosur e motra duke pirë kafenë, filloi ta sjellë bisedën për të vëllanë, që

është shumë djalë punëtor, që e lusin për shumë vajza, por atij i pëlqente vajza e tyre. Ia propozoi vëllanë por, siç ia morri mendja, i thanë: "Nuk kemi ne vajzë për fejesë". Këto fjalë i kuptoi fare mirë e motra, e dinte që me këto fjalë në mënyrën më të sjellshme e refuzuan, që mos t'i lënë tentime të mëtejshme.

Nga këto fjalë Ceni u nevrikos shumë. Nuk e kuptonte si vendosën pa njohur djalin, pa takuar fare ate. Cili është kushti për tu plotësuar që të meritoj vajzën e tyre. Disa ditë ishte si i humbur, u fut thellë në mendime dhe nuk guxonte askush t'i thoshte asnjë fjalë. Të gjithë e dinin çka e mundonte të shkretin, por nuk mundin si ta ndihmonin, prandaj dhe sjelljen e tij në një farë mënyre e justifikonin.

Ajo ishte bijë prej familjes së pasur detare, që në atë kohë kishin anijet e veta. Ishin me zë dhe nuk pranonin dhëndër pa merita. Sipas kërkesës së tyre, ta fejosh vajzën në familje jo të rangut vet, është nënvlerësim i familjes. Nuk ishte i rëndësishëm as njeriu e as pasuria, veç emri dhe prejardhja.

Familja e Cenit ishte po ashtu e pasur, por e pasur me toka.

Gjyshi i Cenit kishte pasur pasuri të madhe në Turqi, mirëpo vendosën të shpërngulen në Ulqin. Pasi që ishte djalë i vetëm, dhe kishin kushërirët në Ulqin aty gjetën vendin e duhur për jetë. Motrën e kishte vite më parë të martuar aty. Dëgjuan që Ulqini është vend i qetë e i vogël dhe jeta aty iu duk lakmuese. Kur u shpërngulën nga Turqia, babai i Cenit ishte fëmijë i vogël. U vendosën në Ulqin, blenë toka dhe nisën jetën prej fillimit. Aty rritën fëmijët dhe i martuan.

Babai i Cenit poashtu djalë i vetëm martohet. Pesë vite nuk kanë fëmijë. Gruaja e dëshpruar që nuk arrin t'ia gëzojë prehërin të shoqit, vendos dhe i gjen burrit një vajzë të re për grua. Shpirti i saj e di se si, por e vendosur sjell në shtëpi nusen tjetër burrit. Vazhdon jetën i shoqi me dy gra. Pa u bërë viti i martesës së dytë gruaja e re mbetet me barrë. Njëherit mbetet shtatëzëne edhe kjo e para, çka ishte mrekulli se as që mendonte më se do ketë fëmijë. Kur solli gruan tjetër në shtëpi, ajo vendosi të rrisë fëmijët që do kenë ato, si të sajët. Por jeta nënshtron sakrifica. Nusja e re lindi vajzë, pas tre muajsh lindi edhe vajza e dytë në atë shtëpi. Shtëpia që deri atëherë shterrej për fëmijë, gjallëroi. Vitin tjetër përsëri lindi vajzën e dytë gruaja e parë dhe më në fund për së treti lindi djalin. Gruaja e dytë nuk pati më fëmijë por vazhdoi të jetonte së bashku në atë familje. Vajzat lindën njëra pas tjetrës dhe gëzimi më i madh qe kur lindi Ceni. *Djalë pas tri vajzash, u gëzuan dhe gurët e rrugës*. Pas tij lindi dhe djali tjetër, por vendin e Cenit s'e zinte kush.

Pas disa vitesh, i vdes babai dhe e le të vogël, prandaj ai, që në fëmijëri së bashku me nënën, kujdesen për të gjitha. Nëna mbeti të kujdesej për familje, dhe duhej të kryente të gjith punët e një burri. Kudo që ishte e nevojshme të shkonte, nëna e merrte atë me vete sepse një femër vetë të bredhë rrugave nuk dukej bukur . Edhe pse i vogël, i përkiste gjinisë më të privilegjuar, kishte më

tepër të drejta se gjinia tjetër, pa marrë parasysh moshën. Andaj ai u rrit i mësuar të ballafaqohej me njerëz dhe situata të ndryshme. Ishte pak dhe i lazdruar, ishte mësuar të fitonte të gjitha çka dëshironte. Që me humbjen e të shoqit, nëna nuk ia prishte qefin, ngase ishte më i madhi.

E gjithë familja ra në hall, por, "Do t'i kalojë - thoshin ato, - është i ri, *koha do ta bëjë të vetën*".

E motra i propozoi të mos shkojë një kohë tek ajo, në mënyrë që t'u shmangej takimeve, që të qetësonte ndjenjat. *Larg syve - larg zemrës*, me shpresë se do t'i kalonte.

I rralloi vizitat te ajo. Nuk e përballonte dot, ta shohë, t'ia ndiej zërin, e të mos sajoj ëndrra për të.

Siç thonë: "*Pema e ndaluar është më e ëmbël*", ashtu dhe Ceni nuk hiqte mendjen nga ajo. Vështirë kontrollonte ndjenjat, u mësua së paku zërin t'ia dëgjonte. Sa i gëzohej vizitës te motra, çdo herë shkonte me zymbyla plot e përplot, shtirej se vinte të shihte fëmijët e motrës, që e donin shumë dajën e vet, sepse nuk donte që vjehrrit e motrës ta kuptonin ardhjen e tij të shpeshtë.

Derisa u qetësua pakëz gjendja, ai nuk foli me njeri, sajonte një plan në vete dhe nuk kërkonte ndihmën e askujt, prej frikës që mos t'ia prishin planet. Nuk i besonte askuj. Njeriu i dashuruar është i gatshëm për çdo gjë, ajo po ndodhte dhe me Cenin.

Meqë u tërhek në vehte më tepër kohë kalonte në punë nëpër ara, të gjithë e harruan dashurinë e Cenit, duke menduar që i kaloi meraku.

Mirëpo Ceni përgatitej për diçka të madhe, por nuk e diskutonte me askënd.

Përcjillte çdo lëvizje me kujdes. I u kushtua punës më së tepërmi që të largohej prej mendimeve. Vendosi të marrë vetë iniciativën, pa konsultim me askënd. Nuk ishte i sigurt a vepron në mënyr të duhur, veç vendosi sa më parë të zbatoj qëllimin.

Në atë kohë kur vajzat dilnin, merrnin punën e dorës të mbështjella në një bohçe dhe shkonin tek daja, halla, të rrinin disa net. Dala e vetme që bënin varzat ishte vizita e fqinjve.

Ishte pasdite, koha kur dielli po mblidhte rrezet, Sija u nis me të motrën tek daja. E gëzuar se me ditë nuk dilnin nga shtëpia, ajo mezi që priste të kënaqej ke daja me vajzat e dajës. Deshi t'i përcillte i vëllai, por i kishin ardhur disa miq, e pasi që daja nuk jetonte larg, ato patën guximin të shkonin vetë.

Po afrohej terri, njerëzit që gjendeshin në rrugë shpejtonin hapat se mos t'i zinte nata. Tak-tuk shihej ndonjë këmbësor. Rrugicat ishin të errëta dhe të ngushta. Ishin nisur pakëz vonë, por shpejtonin hapat që të mbërrinin më shpejt.

Duke ecur me hapa të shpejtë, se veç po bëhej terr, u dukej se do hapa po i afroheshin, apo ndodhej rastësisht ndonjë kalimtar që ishte vonuar si ato. Sija e shtrëngoi fort dorën e së motrës dhe nisën të shpejtonin. Ndihej prania e dikujt

në afërsi, por mungonte guximi të kthenin kryet mbrapa që të shikonin. Ato ecnin, dikush ecte pas tyre. Në kthesë, tek një rrugicë e ngushtë, papritur dikush e shtrëngoi për dore. Nuk arriti as të kthehej ta shikonte, një dorë ia mbylli gojën. Motra e pa dhe nisi të bërtiste.

- Largohu që këtej, shpejt, përndryshe do të vras ty dhe motrën tënde! - iu drejtua Ceni motrës së Sijes, e cila e hutuar nisi të vrapoj me të madhe kah e çonin këmbët.

Sijen e mori peng, duke i vënë grykën e pushkës te kraharori.

- Të vras po ta dëgjova zërin! - i tha asaj, kurse zëri i dridhej nga ngjarja dhe emocionet.

Ai po e grabiste një vajzë, po bënte një krim ndaj personit që dashuronte. Në mbrendësi të vehtes ndiente knaqësi që po realizon qëllimin, por në anën tjetër ndihej fajtor për hapat që po bënte.

U errësua bajagi, dëgjohej veç zëri i motrës e cila vraponte për në shtëpi duke bërtitur. Gjithkah përreth ishte terr. Duke iu afruar shtëpisë, Ceni nisi të porosis Sijen, që nuk guxon të tregojë mënyrën se si mbërriti aty. Ajo duhej të thotë që erdhi me dëshirën e vet, se përndryshe Ceni e kërcënoi se do t'ia vrasë vëllanë.

E hutuar nga se ç'e gjeti, nisi të fshinte lotët dhe të merrte pak veten. E mjera, kah t'ia mbante, ishte terr përreth, për sherr asnjë kalimtar atypari që së paku t'i gjendej në ndihmë. Ecte si e hutuar nga ajo se ç'po i ngjante. E kërcënoi me vrasjen e vëllait, ç'të bënte e mjera! Mjafton të bartë vetë telashin, se ky njeri, siç është nisur, mundë të bënte ndonjë krim ndaj familjes saj.

Mbylli sytë fort, duke menduar që është një ëndërr e hidhët dhe që ajo do të zgjohej, por më kot, ajo po e përjetonte këtë në të vërtet, e grabitën.

Kur mbërritën në prag të derës, Ceni nisi të thërrasë nënën, duke i thënë:

- Dil, nënë, se ta solla nusen!

- Çfarë nuseje, bir, hyr se tamam po përgatitemi të hamë darkë! - u dëgjua zëri i nënës.

As që ia merrte mendja se djali i saj ka grabitur dhe sjellë në shtëpi vajzën që e dashuronte. As nuk e imagjinonte se i biri do të jetë në gjendje të vepronte në mënyrë të tillë. Shërbente si shembull djalë i sjellshëm e i urtë, ai nuk është kriminel, - mendonte e ëma.

(Fragment nga romani "*Shtigjet e fatit"*, Diti&Oli-Libraria ARTI, Ulqin, 2015)

Gazmend ÇITAKU

ALI KACENI – TRIM MBI TRIMA

Ulqinakët janë shumë të njohur si detarë të shkathtë dhe ujq të vërtetë deti. Kështu në popull qarkullojnë edhe sot e gjithë ditën legjenda për detarë të mëdhenj dhe të shkathtë. Një ndër legjendat më të dashura që qarkullojnë ende sot në përrallat që tregojnë gjyshet tona është edhe ajo e Ali Kacenit.
Aliu nuk ishte një detar i rëndomtë, ai ishte një ujk i vërtetë deti i cili kur delte në detë në ekuipazhin e tij dëshironin të jenë të gjithë detarët ulqinakë. Kur Aliu kthehej në Ulqin ahengu nuk ndalte tri ditë e tri netë. Anëtarët e ekuipazhit përveç pagës të cilën merrnin nga kapedani ulqinak ata gjithashtu shpërbleheshin me peshqeshe të ndryshme. Kthimit të kapedanit i gëzoheshin të gjithë qytetarët sepse edhe për ta kishte peshqeshe e sidomos atij më së shumti i gëzoheshin fëmijët jetimë baballarët e të cilëve kishin humbur jetën në detë.
Vit pas viti, përveç tregtisë që bënte Aliu shpeshherë ndodhte që ai të përleshej me anijet të ndryshme nën flamurin e Venedikut apo edhe të shteteve tjera. Kapidan Aliu falë shkathtësive të veta lundruese ia delte që anijet konkurrente t'i zaptonte kështu që të gjithë mallin që kishin i përvetësonte dhe pasi kthehej në Ulqin ia jepte hisen obligative administratorit të qytetit, ndante në hise të barabartë ekupiazhit si dhe një pjesë të konsiderueshme e ndane për bamirësi.
Aliu si detar nuk përleshej vetëm me anijet që mbanin flamurin e Venedikut por edhe me ato të Perandorisë Osmane kështu që shpesh i sillte kokëçarje edhe vetë sulltanit në Stamboll.
Në një rast kur sulmet e piratëve të kohës u bënë të pa durueshem, kupën e mbushi sulmi i piratit grek Karallampo i cili sulmoi anijen që transportonte pelegrinët të cilët ishin nisur në haxhillëk dhe me këtë rast pirati i keq jo vetëm që i plaçkiti të gjithë por ai edhe ua fundosi anijen kështu që edhe i mbyti të gjithë. Me këtë rast hidhërimi i Sulltanit mbërriti kulminacionin dhe dha urdhër që ai i cili do të sillte piratin mizor do të shpërblehej mirë nga sulltani.
Për shkak të kokëçarjeve të mëparshme të cilat ia kishte sjell sulltanit ky ishte një rast shumë i mirë që Ali Kaceni-Ulqinaku të rehabilitohej nga sulltani dhe të vazhdonte lundrimin e vet i lirë dhe pa drojë jo vetëm në Adriatik por edhe në Mesdhe. Prandaj, ai vendos që të dalë në detë dhe ta ftojë në dyluftim piratin mizor.
Në Ulqin u përhap lajmi për vendimin e kapidanit ulqinak dhe tellalli thirri:
Oj gjidi hoj, oj gjidi hoj
Pa dëgjoni ju o popull
Kapidan Ali Kaceni ka vendos që të dalë në detë dhe të ftojë në dyluftim piratin Karallampo. Lundrimi do të jetë shumë i rrezikshëm dhe ka mundësi që edhe të mos kthehet në Ulqinin tonë. Ekuipazhi standard me të cilin gjithmonë lundron

nuk është obligativ që të vijë por le të vijnë ata të cilët janë të gatshëm për luftë fyta-fytas.
Ooooj gjidi hoj, ooooj gjidihoj
Pa dëgjoni ju o popull
Kapidani porosit të gjithë ulqinakët me këto fjalë:
Në rast se gjallë nuk kthehem mos më qani por më kujtoni si gjithmonë me këngë e valle.

Pas lajmit, heret në mëngjes para velanijes së kapidant ishin mbledhur i gjithë ekuipazhi pa dallim moshe e përvoje si dhe të gjithë detarët tjerë ulqinakë të cilët ëndërronin që së bashku me Likacenin të luftonin kundër Karallampos.
Aliut iu bë zemra mal dhe falendëroi të gjithë bashkëqytetarët e vet për besimin e dhënë dhe mori ekuipazhin e vet të përhershëm dhe u nis në detë. Atë ditë moti ishte shumë i mirë dhe fryente një erë e lehtë e cila disi jepte me dije ulqinakëve se pas këtij momenti asgjë nuk do të ishte si ka qenë më heret.
Anija e ulqinakut lundronte qëllimisht nëpër ujërat të cilat i kontrollonte pirati Karallmpo mirëpo ai nuk shihej gjëkund. Pas një jave anijet u takuan. Pasi që Karallampoja territorin e Moresë e konsideronte si të veten ftoi Ali Kacenin të jetë mysafir i tij për herë të fundit para dyluftimit. Aliu pranoi ofertën.
Në mbrëmje Aliu shkon në anijen e Karallampos dhe hyn në kabinën e nikoqirit ku ishte shtruar një darkë e veçantë. Në ndërkohë piratët e Karallampos sollën një fuçi baroti dhe mbi te vendosën qiriun e ndezur. Ky veprim i Karallampos kishte për qëllim që të frikësonte ulqinakun mirëpo kjo i dështoi pasi që trimit ulqinak nuk i bëri përshtypje ky lloj veprimi dhe darkoi si më mirë duke injoruar qiriun mbi fuçinë e barotit. Karallampoja e pa se kishe të bënte me një ujk deti të vërtetë të cilit syri çap nuk i bënte. Pasi hëngrën e pinë mirë e mirë dhe pas llafeve e muhabeteve që kishin bërë erdhi koha që Aliu donte të kthehej në anijen e vet dhe ky dëshironte që nderin të ia kthente piratit kështu që e ftoi Karallampon të ishte musafir i tij neser.
Të nesermen Karallampo kur shkoi në anijen e ulqinakut pa hyrë në kabinen e Ali Kacenit vërejti që e tërë anija e ulqinakut ishte përplot me barot dhe qirinj dhe parqiste rrezik që anija çdo çast të fluturonte në erë. Refuzimi i Karallampos u kuptua dhe njëherit paraqiste frikën e Karallapmos. Kështu Ali Kaceni ia mori zemrën Karallampos dhe në këtë dyluftim ulqinaku doli fitues.
Kapidan Ali Kaceni dha urdhërin që velat e anijes të drejtohen drejt Stambollit mirëpo më parë u kujdes që kokën e Karallampos ta vendosë në një vend ku do të ruhet mirë dhe për një kohë më të gjatë.
Posa mbërriti në Stamboll i dërgoi sulltanit fjalë për qëllimin e ardhjes së tij.
Sulltani e ftoi në pallatin e vet dhe kapidanit ulqinak si dhe të gjithë ekuipazhit i shtroi një darkë dhe aheng të paparë me vallëtare nga Armenia, zbutës tigrash nga India, akrobatë nga Samarkandi etj. Edhe pse njëri nga piratët më famëkeq veç kishte shkuar në histori Sulltani nuk ishte i kënaqur sepse ai kishte urdhëruar që ai i cili do ta robëronte Karallampon atë ta sillte të gjallë në

Stamboll ndërsa detari ulqinak duke hetuar dredhinë e sulltanit atij i kishte sjellë vetëm kokën e piratit.
Sulltani kishte urdhëruar që gjatë darkës në mënyrë të fshehtë dhe pa u diktuar kapidanit ulqinak t'i hudhet pluhuri i gjumit në pije dhe pas alivanosjes të hudhet në qelinë më të errët të kullës jugore të kazamateve në pallat. Kështu edhe ndodhi në mëngjes Aliu u zgjua në burg dhe atij asgjë nuk i kujtohej vetëm se bukuroshja armene e cila vallëzonte e këndonte para tij.
Ekuipazhi ulqinak ishte mbledhur në anijen e vet dhe priste kapidanin të vinte në anije dhe të merrnin drejtimin e Ulqinit.
Kaloi një ditë, kaloi e dyta, e treta e kështu me radhë e Ali Kaceni nuk shfaqej.
Në qelinë e burgut ku trimi ulqinak ndodhej ai u bind që sulltani e kishte tradhëtuar dhe se veç pritej që edhe koka e tij të fluturonte. Prandaj, ky vendosi të përdorë një dredhi. Thirri gardianin e burgut dhe i tha se po që se do ta lironte ky do ta shpërblente me flori dhe se kësi lloj shpërblimi me pagën të cilën ia jep sulltani kurr e për ymër nuk do ta mbledhë. Në fillim gardiani refuzoi dhe nuk dëshironte të dëgjonte mirëpo lajkat e ulqinakut dhe fjalët bindëse që i përdori bëri që ky të luhatet. Këtë moment Likaceni e shfrytëzoi dhe i tha që gardiani të shkonte në anijen ulqinake dhe tu thotë që të bëhen gati se shumë shpejt kapidani do të vijë dhe do të lundrojnë për në shtëpi. Kështu u tha dhe kështu u bë. Gardiani shkoi në anijen e Likacenit dhe përcolli fjalët e kapidanit.
Haliti, nipi i Aliut shkoi deri në kabinën e kapidanit dhe gardianit i solli një qese me flori. Gardiani mbeti i habitur me sasinë e florive dhe në mendje i shkoi menjëherë tradhëtia. Mirëpo, Haliti i regjur në jetë dhe detë ia lexoi mendimet gardianit dhe vendosi t'i japë disa këshilla. U ulën në tavolinën e improvizuar në kuvertë dhe filloi t'i tregojë gardianit se këta kanë dijeni se ky jeton vështirë dhe se shtëpinë dykatëshe e ka në lagjen Topkapi, ku bashkëshortja e tij, Nazlija, jeton me dy vajzat adoleshente të cilat ishin shumë të bukura. Andaj nëse diçka e papritur do t'i ndodhte kapidanit ulqinak atëher edhe familja e tij nuk do të ishte e sigurt, kurse në të kundërtën do të merrte edhe dy qese tjera të njejta.
Tosun agës iu çuan flokët në hava, kishte dëgjuar për trimërinë dhe besën shqiptare andaj vërejtjen e mori me shumë seriozitet dhe u zotua se enkas do të angazhohet që Likaceni të mbërrijë shëndosh e mirë.
Sapo u takua me Likacenin, Tosun aga filloi t'ia tregojë planin e ikjes dhe rrugën se kah duhet të kalonte. Pasi planifikuan ikjen e Likacenit me rastin e marrjes së ushqimit, pas daljes nga qelia së pari duhej të ngjitej murit të lëmuar të kullës së burgut deri në majen e saj ku duhej ta çarmatoste rojen. Pastaj duhej të nisej kah bedemet veriore dhe në kullën e tretë nga një lartësi afro 30 metra të hudhej në detë dhe të notonte deri ke sanalli i ulqinakëve të cilët do ta presin aty. Me ndihmën e Tosun agës dhe falë shkathtësisë dhe përgatitjes fizike të Likacenit ia arritën që misionin ta çojnë deri në prezencën e tyre në anije.

Aty Likaceni falendëron Tosun agën për gadishmërinë për ta ndihmuar dhe ia jep edhe 2 qese me flori ashtu siç i kishte premtuar. Njëherit duke qenë i vetëdijshëm për shkathtësitë dhe gjetshmërinë e Tosun agës ai i ofron atij që të vijë me lundru në anijen e Likacenit e njëherit të jetojë në Ulqin. Pasi u përshëdeten u zotuan se pas tre muajsh do të takohen në molin e Stambollit ku Tosun aga do të vijë për Ulqin me familjen e vet.
Në ndërkohë rojet zbulojnë ikjen e Likacenit dhe jepet urdhëri që të ngritet zinxhiri mbrojtës në portën kryesore në mënyrë që asnjë anije të mos mundet të hyjë e as të dalë pa u vërejtur dhe pa marrë leje paraprake. Meqenëse më heret për qëllime tregtie kapidani ulqinak kishte blerë grurë jep urdhërin që tërë sasinë e grurit para se të mbërrijnë ke zinxhiri mbrojtës ta zhvendosin në pjesën e *kiçit*. Ashtu edhe vepron ekuipazhi dhe bashi i anijes ishte çuar shumë lartë nga uji deri në atë nivel që kur mbërritën me shpejtësi ke zinxhiri mbrojtës anija me shpejtësinë që ishte duke lundruar hipi deri në gjysmën e anijes mbi zinxhirin mbrojtës dhe aty u ndal. Në atë moment kapidani jep urdhrin që shpejt grurin ta zhvendosin në pjesën e përparme, në *bash*, dhe kur gruri zhvendoset në bash anija me turi fillon të zhytet në ujë dhe me këtë dredhi ia arritën që ta kalojnë pengesën e sinxhirit ndërsa osmanët mbetën të habitur me një ide të tillë për kalimin e pengesës e cila konsiderohej e pakalueshme deri në ato momente.
Ekuipazhi posa kaloi pengesën lëshoi dy plotune nga topat e anijes në mënyrë që të përshëndesin sulltanin. Me shpejtësinë më të madhe anija ulqinake mbërriti në Ulqin ku lajmi për burgosjen e Ali Kacenit dhe për tradhëtinë e sulltanit veç kishte mbërritë, ulqinakët duke mos shpresuar se do ta shohin më të gjallë Likacenin kishin vendos që t'i piqnin hallve dhe ena në të cilën kjo hallvë zihej ishte aq e madhe sa që përzihej me rrem.
Kur anija e Likacenit u paraqit në horizont, i pari që e ndjeu prezencën ishte detari plak i verbër i cili sytë i kishte humbur në një përleshje mes anijesh, ai filloi të thërrasë emrin e Likacenit dhe filloi të këndojë këngën e Likacenit si në vazhdim:

Ç'jan këto gjama që po bjen era
Po luftojn dy barka me vela
Priten burrat merren krena
Likaceni trim si rrfeja
Shum grekinja la të veja

Karallampon kush e myt
I nap mall sa i shofin syt
Karallampon kush ma bje të gjallë
I nap xhevahir i nap ar
Gjith gjemxhit pa baxhdar

Ket luftë që po ndini sat
Pushka has zjarmi n'barat
Barka tuj lundru nepër valë
Llampoja para n'aj ka dalë
Dorzonu more shqiptarë

Likaceni trim me halle
Çe muloj grekun me marre
Karallampos i bani ballë
E lidhi me gjith detarë
Ja kallxoj xenatin grekut
E lidhi n'maje t'dyrekut

Likaceni ujk i gjall
Si vetim detin ka marrë
Mrrin në portin e Stamollit
Likaceni aj zog sokolit
Ali Kaceni më thojnë mue
Ndyrekë t'barkës e kam varë
Karallampon grek zullumqarë

U ndal sulltani bani mendim
Ky arnaut qenka shum trim
Mas ma leni mu kthy n'Ulqin
Nuk i nap këtij asnji flori
Asnji grosh asnji inxhi...
Kërclloj dhambët sulltani turk
Likacenin e hedhi n'burg!

Likaceni trim sokoli
Thej burgun edhe doli
Rraplloj barka me detarë
Natës errët t'uj çu valë
T'uj këndu për këtë t'mirë
I takoj barka n'sinxhirë...
Në bash mallin e batojnë
Prej sinxhirve mir shpëtojnë

Lamtumir mare sulltan plak
S'paske pas ti besë aspak
Nuk ke pa azganë ulqinak
Qi si lidh hapsi e s'han dajakë
Si kan frig kulshedrat e detit
Ja se ja klyshat e dauletit

Shkëlqej dilli nelt n'hava
Çou Ulqin e këndo me za
Likaceni përmbi barkë
-Mir se ju gjeta ulqinakë
-Mir se na vjen trimi jon
Ty të paçim përgjithmonë

Likaceni mbërriti edhe një herë në Ulqin shëndosh e mirë. U kthye fitimtar ndaj piratit famëkeq grek Karallampo si dhe fitimtar edhe ndaj tradhëtisë së Sulltanit

(Fragment nga libri në dorëshkrim "*Tregime nga Ulqinit"*, Diti&Oli-Libraria ARTI, Ulqin, 2017)

Burimet:
Dr Bahri Brisku, Deti, detarër shqiptar, Instituti albanologjik, Prishtinë, 2000
Vildana Dervishi, Kapiten Likaceni, Ulqin, 1995
Intervistë, Xhemile Çitaku lindur Kasneci, 15.03.1938. Biseda u zhvillua më 20.06.2008
Xhod Beja, Likaceni, arratisja nga burgu i Stambollit, Durrës, 2014
Cano Lazoja, filmi Ulqinakët në Durrës, Ulqin, 2014
Sami Misherri, Shika detin e shif perëndinë, Ulqin, 2015

Andrej NIKOLLAIDIS

ARDHJA - E gjashta kaptinë

Frati Dolçino, siç të thashë, në manastirin françeskan në bregun e Bunës e ka lënë shkrimin për ringjalljen e vet. Atë shënim e ka fshehur në murin e konakut. Fshehtësinë e vet, kur është parë e qartë se rezistenca e rrethimit të novarasve dobësohej dhe ishte e kotë dhe se para tij qëndron vetëm dështimi dhe vdekja, atë fshehtësi ua ka besuar vetëm disa nxënësve të vet.

Atëherë kur, në kopshtin e sarajit të mbretit në Stamboll, në pyetjen e Sulltanit: ku dëshiron të të dëbojmë, është përgjigjur: në Ulqin, Sabatai Zevi e ka pasur ndër mend fshehtësinë e Dolçinos.

Atë që sot e lexojmë si biografi të Sabatai Zevit, ndoshta i përgjigjet të vërtetës historike mbi të. Në anën tjetër, ndoshta e shumë çështjeve që i dimë për të, duke filluar nga viti i lindjes deri te viti i vdekjes së tij, vetëm ajo çka ka dashur ai që të dimë ne, Sabatai Zevi ka qenë një manipulues i madh, një figurë *uajldase* para *Uajld*-it – jeta e tij ka qenë një kryevepër e tij. Sjelljet e tija, herë-herë të pakuptueshme, herë-herë qesharakë dhe jobindëse, por që gjithherë veprime spektakulare, kanë qenë pjesë të projektit grandioz i cili ka pasur për qëllim që të bindë hebrenjtë se ai është *Mesia*. Se ai për veten ka besuar me të vërtetë ashtu, për këtë nuk duhet dyshuar.

Si vit i lindjes së Zevit shënohet se ishte viti 1626. Se vërtet ishte ashtu, apo Zevi ua ka diktuar atë vit biografëve të vet, se mos ajo datë do të vërtetojë statusin mesianik të tij, duke ditur për besimin hebraik se *Mesia* do të shfaqet në përvjetorin e rrënimit të Tempullit? Loja me vite, gjë më e rëndësishme hebraike, vazhdon: *Mesia i vetëshpallur* është i lindur në Smirnë, më 9 gusht. Ishte *sabbath*. Ka vdekur në Ulqin, më 30 shtator 1676. Ishte *yom kippur*.

Ka vdekur dhjetë vjet pasi u shpall profecia e tij kryesore, ajo sipas së cilës ai është dashur të ishte *Mbret*, i cili popullin hebraik do të kthente në Izrael. Kjo duhej të ndodhte, parashihte Zevi, në vitin 1666. Ai gjithsesi llogariste në tre asociacionet që zgjojnë tri gjashtat. E tërë biografia e tij, fundja, qëndron në tri gjashta: viti i lindjes së tij, mospërmbushjes së profecisë së tij, si dhe të vdekjes, mbarojnë me 6.

Që në fëmijëri, thonë librat, Zevi ka pasur vështirësi të hyjë në shoqërinë e fëmijëve të tjerë, me të cilët mësonte për *rabin*. Periudha të melankolisë së madhe ndërrohen me periudha të një euforie të egër. Doktor Schulz-i në ato simptoma sigurisht do të dallonte një depresion të manisë. Në atë kohë, me ato shenja shumë njerëz besojnë se djaloshi është *I Zgjedhuri*. Në moshën njëzetepesë-vjeçare, Zevi shpall: *Unë jam Mesia, unë do ta kthej popullin tim në Izrael*. Dhe menjëherë paralajmëron heqjen e *Ligjit*. Dishepujt që tuboheshin

rreth tij, i ftonte të hanin ushqimet e ndaluara. Bën një performansë lunare – publikisht ve kurorë me *Torën*. Në fazën e mëvonshme të çmendurisë së vet mesianike, Torën e shqyen dhe e shkel, ndërsa *tefilinët*, lëkura e të cilëve ka ruajtur vargjet e shenjta, i përdhos. Burri të cilin e kanë lënë dy gra, sepse nuk ka shfaqur kurrfarë interesimi për ta, bëhet seksualisht i pakënaqur. Prej të gjithë dishepujve kërkon t'ia sjellin të bijat e virgjëra, bën harem. Mbi të gjitha pohon se ai mund të ketë marrëdhënie seksuale me virgjëresha dhe ato të mbeten si të tilla!

Teologët e Zevit shënojnë: "Deri sa në tokë të sundojë tabuja në lidhje me gjaktrazimin, është e pamundur të bëhet bashkimi nga *lart*. Me heqjen mistike të ndalimit gjaktrazimit, njeriu do të bëhet i ngjashëm me Krijuesin e vet në fshehtësinë e Pemës së jetës së vet".

Derisa Zevi gëzohet me kënaqësitë e gjaktrazimit, Sulltani brengoset. Ditën e 6 shkurtit 1666 ai jep urdhër për burgosjen e Zevit. Profeti hebraik është bërë i rrezikshëm për fronin e tij. Hebrenjtë nga e tërë Evropa derdhen në Perandori, duke shkuar pas *Mesisë*. Ata të tjerët janë të gatshëm të shesin të gjithë pasurinë e vet dhe të shkojnë pas tij në shtëpi, në Izrael. Shumë të krishterë, në mesin e tyre edhe të ditur, me vëmendjen dhe shpresën më të madhe presin aprovimin se Zevi është *e vërteta*. *Heinrich Oldenburg*-u i shkruan *Spinozës*: Të gjithë këtu flasin për kthimin e hebrenjve në tokën e tyre. Nëse del i vërtetë ky lajm, do të shkaktojë një revolucion në të gjitha çështjet!"

Në vend që Zevi të çonte në revolucion, atë e sjellin të lidhur para Sulltanit. Që ia komunikon se mund të zgjidhte: *ose islamin ose vdekjen*. Nëse nuk dëshiron ta përqafojë islamin, sulltani me dëshirë do t'i bindej fuqisë së tij: një shenjëtar i zoti do të merrte në shenjë gjoksin e tij, ndërsa *Mesia*, s'ka dyshim, nuk do ta ketë vështirë të bënte mrekullinë dhe ta ndalte shigjetën. Zevi nuk hamendet as për një çast: nga koka e heq *"ymamulke"-n,* kësulën hebraike dhe qet *turbanin* turk.

Mesia në çastin e fundit e ndërroi fenë.

Aziz Mehmed Efendia, siç është quajtur Zevi pas kalimit në islam, judaizmin nuk e ka lënë plotësisht, as sinqerisht, por gjithsesi jo me dëshirë dhe pa detyrim. Ka vazhduar të kryej ritet fetare hebraike dhe, madje, të predikonte nëpër sinagoga. Fakti se u bë mysliman, nuk e ka penguar që për vete të pohonte se *është Mesi hebraik.*

Sulltani, i cili pas kthimit të Zevit në mysliman, ka shpresuar se ai do të kthejë edhe shumë hebrenj të tjerë, dhe gjithnjë e më pak ka pasur mirëkuptim për karnavalet e tija mesianike. Në fund, vendosi ta dëbonte. Siç duket, ishte mu ajo për të cilën Zevi kujtonte se do ta gjente.

Sundimtarin e bind se Ulqini është qytet ideal për ekzil – në cep të Perandorisë, në fund të të gjitha udhëve, në atë kala mbi det, do të jetë mjaft larg dhe mjaft i fshehur.

Në atë kohë në Ulqin vendosen kusarët – algjerianë lokalë. *Ai është qyteti më i pabindur në tërë Perandorinë. Ulqinakët nuk i frikohen as Zotit as*

Mbretit. Të egjër dhe të rreptë siç ishin, do ta vizitojnë Zevin, nëse i mbushet mendja të lodhet me marrëzitë e veta, kujtonte Sulltani. Le të jetë Ulqini, thotë.

Është një kohë, them, kur Sulltani s'dinte ç'të bënte me padëgjueshmërinë e kusarëve ulqinakë. Në vitet që do të pasojnë, mosmarrëveshjet e Stambollit me kusarët e rebeluar do të marrin formën e një konflikti të pashpallur dhe të egër.

Pashai i Shkodrës, sipas urdhrit të Sulltanit, do t'i sulmojë dhe do t'u vejë flakët nja dhjetë lundrave ulqinake. Kur vitin tjetër në Ulqin arriti çaushi që sillte një letër të Sulltanit, i cili kërkonte të digjeshin edhe anije të tjera, kusarët e mbytën dhe kufomën e tij e hodhën nën bedenat e Kalasë.

Në një letër të qeveritarëve venedikas, dërguar Sulltanit, shkruan: "Të gjithë banorët e Dalmacisë dhe Arbërisë, habiten sesi kusarët ulqinakë me aq urrejtje refuzojnë urdhrat tuaja!"

Barka me vela që bart Zevin me 29 familje të dishepujve të vet, i avitet Ulqinit. Udhëtarët me çudi shikojnë renë e zezë që pezullon mbi qytet. Ndërsa zbarkojnë, në plazhin në kështjellë, shpesët e bardha nuk luajnë vendit në rërë. Sikur i masin të ardhurit, të cilët i lëshojnë këmbët e duart u dridhen. Sikur të jemi ankoruar në Ferr, thotë njëra nga gratë. Nga shpellat nën Kala, të cilat do t'i mbyll tek tërmeti i vitit 1979, si trumë dalin shpesë të zeza që krrokatin dhe fluturojnë mbi kokat e Zevit dhe përcjellësve të tij. Derisa hipim shkallëve me kalldrëm drejt portës së Kalasë, qielli mbi ne është në një turbullirë e zezë. Shikimet e përcjellësve të tij shfaqin frikë dhe dëshpërim, por në sytë e Zevit shoh vetëm gëzimin – ai në tufën e zogjve ka parë *shenjën*.

Dishepujt e Fratit Dolçino nuk kanë ditur ta ruajnë fshehtësinë të cilën ua ka besuar. Do gojë të dehura kanë folur, do veshë kureshtarë kanë dëgjuar. Ashtu siç dinë kallëzimet t'i gjejnë ata të cilët duan t'i dëgjojnë, ai për fratin Dolçino dhe shkrimet e tij të fshehura ka arritur deri në Smirnë. Zevi me mërzi i shikonte ata të cilët për Dolçinon flisnin si për një të çmendur, mashtrues dhe kuletëprishës. Ai e di se Dolçinoja e ka fshehur *Librin*, sepse ka për qëllim të kthehet. Por *Mesi* mund të jetë vetëm njëri. Prandaj, detyra e tij, e Zevit, është që Librin e të Dërguarit të Rremë – ta zhdukë.

Ditët e veta Zevi në Ulqin i kalon duke shkruar dhe lutur. Në gurin në murin e kullës së vet e ka skalitur *Yllin e Davidit*, para së cilit ka folur me Zotin, prej të cilit kurrë s'ka hequr dorë. Vetëm dy herë Zevi e ka lënë Ulqinin. Një herë shkoi në Buenë, që në muret e rrëzuara të konakut françeskan të provojë të gjente Librin e Dolçinos. Herën e dytë shkoi në Tivar, që në Arqipeshkvi të provojë të gjejë ndonjë gjurmë, së paku të gjejë shpresë se hulumtimi i tij do ketë fryt.

Zevi për shënimet e Dolçinos ka qenë i gatshëm të shkonte në fund të botës: ka shikuar në largësi, se mos do ta dallonte librin. I cili, siç dukej, gjithë asaj kohe ka qenë para syve të tij.

Njëzet vjet pas vdekjes së Zevit, ndizet Lufta e Moresë. Barkat venedikase vijnë para Ulqinit. Dita është, po them, 10 gushti i vitit 1896. Shkrimet

historike thonë se "qëllimi i sulmit ka qenë të marrë kalanë dhe të asgjësojë folenë e kusarëve, por që të gjitha përpjekjet e venedikasve për të zmbrapsur kusarët kanë qenë të pasuksesshme".

Rrena të ftohta të historisë! Derisa rreshton barkat në det para Ulqinit, gjenerali *proveditori*, *Daniel Dolfino IV*, i kujtohet dita kur daja ia ka kallëzuar fshehtësinë e Fratit Dolçino. Daja fliste ngadalë, djaloshi e shikonte me vëmendje, duke e përpirë secilën fjalë të tij. Ndërsa ajri rreth tyre vezullon, është një ditë e shkëlqyer vere, pikërisht si dita kur gjenerali me ushtrinë e tij më në fund ishte afër librit për të cilin ishte betuar se do ta kthente në duart e të krishterëve.

Gjenerali proveditor besoi se librin do ta gjente në murin e kishës, të cilën njerëzit që s' dinë për Zot e kanë shndërruar në kishë. Kur është rrënuar kisha në Buenë, dikush nga françeskanët që dinte për fshehtësinë e Dolçinos, librin e ka çuar në qytet, dhe prapë e ka fshehur në kishë. Por Ulqini kishte rënë në duart e muhamedanëve. Në pazarin para kishës ata tash shesin robër, shesin njerëz të cilët i kapin robër në lundrimet e tyre prej kusarie, mendon Daniel Dolfino IV. Mbi shesh ngrihet kulla në të cilën deri në vdekje ka jetuar profeti i cili u bë muhamedan. Punë tradhtie, kujton gjenerali. Me ndihmën e Zotit, rregulli do të bëhet së shpejti edhe në këtë pjesë të botës. Anijet në Adriatik do të jenë të lira nga terrori i jobesimtarëve, Ulqini prapë do të jetë i krishterë, e ai më në fund do të shtijë në dorë librin që aq vite ia ngacmon mendimet, librin për të cilin beson se i ruan përgjigjet në aq shumë pyetje të cilat njeriu vetëm me frikë merr guxim t'i shtrojë.

Është mesditë, pas barkave venedikase nis maistrali. Derisa qëndroj pranë gjeneralit, në sy ia dalloj vetëm këmbëngulësinë. Zjarr! – komandon ushtrinë e vet. Shtetrrethimi i Ulqinit ka zgjatur gati një muaj. Në fund, ushtria venedikase është barkuar dhe është kthyer në Bokë. Venedikasit ia kanë dalë ta marrin dhe t'ia venë zjarrin gati tërë qytetit dhe ta ndalin ujësjellësin.

Po kështjella e kusarëve nuk ka rënë.

Shiu rrihte dritaret e *Zmajevi*qëve në *Perast*. Brenda, në bibliotekë, gjeneral *proveditori*, Daniel Dolfino IV, u shkruan raport eprorëve të vet: "Ulqini nuk u morë, por në qoftë se qëllimi kryesor i këtyre përpjekjeve ka qenë të dënohet guximi dhe trimëria e këtyre kusarëve, mund të thuhet se përpjekja ka qenë e suksesshme".

Librat historikë fushatën ushtarake të cilën e ka drejtuar do ta përshkruajnë si sukses të pjesshëm. Por vetëm ai e di sa e madhe, sa e plotë është disfata e tij. Të gjitha nderimet, e gjithë fama e kësaj bote për të tash e tutje do të jenë të pavlera. Deri në ditët e fundit të jetës së tij në këtë botë ai do të ëndërrojë për kishën e shndërruar në xhami.

Lart, në kështjellën që s'ra të Ulqinit, e hap librin, shkronjat e tij e marrin për dore dhe e çojnë atje ku arrijnë vetëm të përzgjedhurit.

Zevit që në Smirnë i lind ideja se të gjitha librat dhe dituritë njerëzore janë të tepërta, por edhe barrë e djallit në shpinë të njerëzimit. Gjatë dhjetë vjetëve

të qëndrimit në Ulqin, ajo ide e ka preokupuar. Dituria, u fliste ai dishepujve të vet, na pengon ta dëgjojmë Zotin, ta dëgjojmë porosinë e qartë të Hyjit. Kjo nxit të supozohet se Zevi ka ditur për mësimet e *Thomas Muntzer*-it. "*Bible, Babil, Babel – Bibla, llomotitje, Babiloni*", ka shkruar Muntzer-i, "të gjitha ato duhet lënë mënjanë dhe duhet përkushtuar Zotit. Mjafton, mendojnë të diturit, që të gjitha të jenë të shkruara në libra, që të mund të pështyjnë ashtu rreptë si lejleku ushqimin me sqep zogjve të vet në çerdhe".

Muntzer-i ka qenë nxënës i *Luther*-it, një intelektual i pashoq, i cili është djegur në urrejtje ndaj çdo gjëje që ka ngjasuar në intelekt. Nuk e kanë quajtur kot "apostull i të paditurve". Kur ka qëruar hesapet me libra, Muntzer-i vegjëlinë e paarsimuar e ka shndërruar në shpjeguesin e vetëm të autorizuar të Biblës. Me dobësimin e autoritetit të Kishës katolike, dobësohet dhe e vërteta e saj, që ishte kurrizi i botës së asaj kohe. Në vend të atij kurrizi, lëvizjet e *Ditës së Gjyqit* venë proteza, të farkuara në punishtet e farkëtarit, në stalla, pyje dhe shpella. Ajo e vërtetë me proteza është sakate, topalle dhe e gjymtë. Populli çështjen e merr në duart e veta - nëpër Evropë bëjnë kërdi turma të ndryshe të udhëhequra nga idetë – shëmtirat. Në trupin e idesë së krishterë, populli ka intervenuar me ndërhyrje kirurgjike, të bëra me mjeshtri prej kasapi. Pas intervenimit mjeshtëror të popullit, krishterimi në Evropë i përngjan *Frankeshtajn*-it. Nëpër tërë Evropën digjen qytete, komuna të shumta të rebeluarish liturgjinë e kuptojnë me perversione seksuale, kanibalizmi ndokund e zëvendëson kungimin, toka më nuk është në gjendje të përpijë tërë gjakun e derdhur. Atje ku sundojnë milenistët, "tokën e vërshon rrëkeja e gjakut që do të arrijë deri te koka e kalit".

Për ndryshim nga Muntzer-i, i cili ishte kundër çdo libri, Zevi botës ia rekomandon një titull, atë i të cilit autor është ai vet. Por ai, siç e ka quajtur: *Libri i ardhjes*, do të lexohet tek kur ai të ringjallet dhe të sjellë të vërtetën. Deri atëherë, në botën e rrenës, e lë librin e rremë, *Lavdinë e kthimit*, të cilin e ka shkruar netëve të gjata të kaluara me dritën e qiririt, para Yllit të Davidit, në kullën e tij. Ai libër, në të cilin shpjegohen mësimet e tij dhe ardhmëria e popullit të tij, konsideronte Zevi, përmban aq të vërtet sa mund ta bartë njerëzimi. Dishepujve të vet, të cilët fjalët e tij do t'i bartin prej goje në gojë, nëpër shumë gjenerata deri në ditët e sotme, le në trashëgim një detyrë të vështirë: para se të kthehet dhe të sjellë *Librin shenjte*, duhet të zhdukin veprën e tij të rremë, si dhe veprën e *Mesisë së rremë*, të fratit Dolçino. Librat, i porosit, duhet t'i gjejnë dhe t'i djegin, përndryshe *ardhja* e tij do të jetë e penguar, ndërsa populli i tyre do të vazhdojë të endet botës, pa plëng dhe pa qetësi.

Zevi e lëshon Ulqinin ashtu siç ka ardhur në të – në mënyrë spektakolare. Kur është zbarkuar nën kështjellë, janë ngritur në fluturim shpesët e zeza që ta prisnin. Ditën e fundit të ditëve të tij, në shoqëri me dy dishepuj të vet, ai shëtitej nëpër qytet. Disa njerëz, duke qarë, janë tubuar rreth ullirit. Një nënë e mbante para duarsh fëmijën që kishte rënë nga fiku. Zot, ka thënë atëherë Zevi,

ktheje këtë fëmijë dhe më merr mua! Fëmija i ka hapur sytë dhe ka qarë, Zevi është shtrirë i vdekur në kalldrëm. Derisa njerëzit me çudi dhe duke lutur Zotin, e kanë bartur trupin e tij, plimi i çafkave ka fluturuar mbi ta.

Tash i di të gjitha. Biblioteka e Ulqinit është djegur, sepse në të, fshehur mes titujve të pavlerë, rrinte libri i Dolçinos. Daniel Dolfino IV kishte të drejtë: shkrimi i Dolçinos me të vërtetë ishte i fshehur në murin e kishës të shndërruar në xhami, në Qytetin e Vjetër.

Punëtorët të cilët, pas tërmetit shkatërrimtar të vitit 1979, e kanë meremetuar kishën, e kanë gjetur librin, që më pastaj është ruajtur në Bibliotekën e Ulqinit dhe, duke mos ia ditur vlerën, e vendosin në një depo të cilin s'e intereson askënd.

Pas Zevit në Ulqin kanë ardhur dhe nja njëqind pasues. Edhe pse të gjithë, formalisht, e kanë përqafuar islamin, në zemrat e veta kurrë s'kanë hequr dorë nga judaizmi. Janë shpërndarë nëpër tërë botën: disa janë kthyer në Smirnë, disa kanë shkuar deri në Australi. Kanë vdekur, e pasardhësit e tyre janë të mësuar të heshtin për ta dhe për varret e tyre, në kodrën pas qytetit, ku janë varrosur.

Nga kanë ardhur të bëjnë detyrimin dhe të presin Mesinë? Kush do ta dijë.... Ndoshta nga Turqia, ku i thërrasin *Donmeh*... Ose nga Kalifornia, ku nga vendlindja Galata ka shkuar në Stamboll *Ykov Leib HaKohain* – i, që atje të grumbullojë nxënës dhe t'i përgatisë për pritjen e Zevit.

Kur e ka parë se po i afrohej fundi, Zevi me një grup nxënësish ka dalë fshehurazi dhe ka hyrë në varrezë. Atje, duke bërë adetet e moçme, *Libri* i tij është futur në një varr. Që, kur Mesia të ringjallet në Ulqin, ku është varrosur, pranë vetes ta ketë *Librin shenjtë*.

Nga shtëpia e Vukotiqve, të cilën e kanë blerë në një *auksion* në Londër, është vjedhur *Lavdia e kthimit*, libri fals i Zevit. Dishepujt e tij janë për dreq dinakë: që të fshehin djegien e njërit libër, ia kanë vënë flakët tërë një biblioteke. Që të fshehin hajninë e librit të dytë, e kanë vrarë tërë familjen dhe kanë lënë gjurmë të rreme.

Prej shtëpisë së Vukotiqve kanë shkuar drejt në varret e hebrenjve ku, të fshehur me pyll dhe harresë, i ka pritur *Libri i ardhjes*. Në varrezë, librat e vërtetë të Zevit, me një rit të caktuar nga vetë Mesia, e kanë djegur shkrimin e tij fals.

Një Libër është djegur në Bibliotekë. Libri i dytë është djegur në varrezë. Libri i tretë më pastaj është nxjerrë nga varri.

Tash: *Mesia* prapë mund të vijë.

Përktheu dhe përshtati Hajro Ulqinaku

Prozë botërore

Gunter GRASS

ZJARRI

S'më mbetet gjë tjetër veçse të përsëris atë që shënova edhe në procesverbal. Nuk kam qenë e dashura e tij. Në çdo rast e besuara e tij, nëse ekziston një term i tillë. E ashtuquajtura jonë besueshmëri, për të cilën do të pyes pareshtur, përkufizohej në profesionalizëm. Kjo do të thotë: nga profesori de Groot mësova më tepër unë se zonjusha Manthey, të cilës i ishte dhënë leje nga muzeu Kassler, ashtu si dhe mua nga muzeu Wallraf-Richartz, sepse që të dyja duhet të përfundonim studimet me një kurs restaurimi gjysmëvjeçar në Amsterdam. Profesori de Groot ishte një gjeni i shquar ndërkombëtar. Gjithë nxënësit si dhe zonjusha Manthey, e cila u shpreh se ishte ndier e shpërfillur, u janë mirënjohës mësimeve të tij.
Vetëm dy herë më është dhënë mundësia ta ndihmoj profesor de Groot për përzgjedhjen e sfondit të pikturës në studion e tij private, pjesën tjetër të kohës, ashtu siç pohoi dr. Janku, punonim të gjithë së bashku, në sallën e restaurimit. Gjithsesi, është plotësisht e vërtetë që nga të gjithë nxënësit, profesori de Groot më merrte vetëm mua kur aparati i tij fliste për rënie zjarri në qendër të qytetit. Për fatin tim, jo gjithmonë këto shënime më shkëputnin nga puna, të cilën e ndiqja me mjaft interes. Kolegët e mi mund të vërtetojnë se sa më nevrikosnin këto parapëlqime, por, për këtë gjë nuk mund të mërziteshe hapur me profesorin de Groot.
Siç është e njohur gjithkund, edhe mësuesi ynë, kur ulej të punonte, dëgjonte vazhdimisht stacionin e njoftimeve policeske. Për këtë veçanësi të tij, kisha dëgjuar të flitej e të tregohej në Këln. Atje thoshin: "I zoti, por tekanjoz". Aksidentet automobilistik, zënkat e të shtunës, po edhe vetë vjedhjet në dyqanet e argjendarive kurrë nuk e linin profesorin de Groot të ngrinte vështrimin nga puna, sidoqoftë atë e shkëpusnin komentaret me sarkazëm që ne i përqeshnim, puna delikate e tij nuk mund të shkëputej nga ajo sallatë gjuhësore që vijonte e që na ishte bërë zakon. Dr. John e kuptoi që ne e parodizonim atë, padisnim djegien e një dërrase të çatisë. Ende e shoh profesorin de Groot duke rrëmuar në xhepin e xhaketës dhe duke tringëlluar çelësin e makinës: "Do të vini zonjusha Schimmelpfeng?"
Gjatë një gjysme viti pashë 4 zjarre të mëdhenj - 2 në Heeren Gracht, një në Dirnen pranë kishës ë vjetër dhe një në Waterloo Plein - krahas këtyre edhe një dyzinë zjarresh të mesëm, sepse në Amsterdam bie shpesh zjarr. Profesori de Groot i shihte këto zjarre qetësisht dhe me gjakftohtësi, shpeshherë disi i zhgënjyer, por përherë i interesuar shkencërisht, siç e mësova gjatë punës në sallën e restaurimit. Këto zjarre - kjo është thënë dhe, nëse dëshironi, është shënuar edhe në procesverbal - shpesh kundër dëshirës sime, më shqetësonin, madje, më nevrikosnin aq shumë sa shpeshherë më ngacmonte ideja e

pamotivuar se profesori de Groot e vazhdonte këtë lojë me mua për një qëllim të caktuar. Me vendosmëri vërtetoj: kjo gjë përjashtohet plotësisht.
Unë dështova kryekëput. E papjekur dhe pa shumë qëndresë, lashë të më shkiste nga duart çdo disiplinë shkencore. Profesorin de Groot, me vetëpërmbajtjen e tij të theksuar mund ta kisha shembull: kur luftohej me zjarrin, ai zakonisht heshtte. Dhe nëse fliste, biseda vërtitej gjithmonë rreth piktorit të tij të preferuar Turner, veçanërisht për pasionin e zjarrit, pikturuar më 1835, djegia e parlamentit, ose djegia e Romës, pra, për çdo pikturë pikturuar nga Turner i frymëzuar nga djegia e parlamentit, që e kishte parë me sytë e tij. Për këtë, dhe vetëm për këtë gjë thashë, po, kur në maj të një viti më parë, profesori de Groot pati mirësinë të më ftonte për një ekskursion tre ditor në Londër. Shumë kohë qëndruam në galeri. Në të famshmin libër skicash të Turnerit, gjetëm shumë herë e rastësisht të sipërpërmendurën djegie të parlamentit dhe u ndalëm gjatë tek ajo. Nëse tani do të them se mësuesi im, profesori de Groot u miqësua me mua gjatë atyre ditëve të shkurtra dhe të lumtura për të dy, vetëm mund të shpresoj se me këtë thënie, jo çdo dyshim përtërihet dhe është i gatshëm për gjykatën e lartë. Nuk e dija që, edhe në shtëpi, profesori de Groot dëgjonte stacionin me lajme policore. Për shtëpinë, ai fliste përgjithësisht rrallë, kurse në Londër nuk foli kurrë për të. Vjet u ftova dy herë për darkë nga e shoqja në shtëpinë e tij, një të diel qershori dhe një të diel të fillimkorrikut. Gruaja e profesorit de Groot më krijoi një përshtypje të ndrojtur, të ngurtë - më dukej e lodhur, e dërrmuar - por kurrë nuk do të më kishte shkuar ndër mend se radioja, vesi i zakonshëm i çdo nxënësi, kishte varrosur shëndetin e saj, sepse profesori de Groot - sipas mendimit tim - çdo natë e linte ndezur aparatin me të gjithë volumin e zërit dhe ndërkohë që ai flinte, e shoqja mezi vinte gjumë në sy.
Kështu që ashtu sapo e mora vesh njoftimet për rënie zjarri, të gjitha njoftimet për rënie zjarri e zgjonin menjëherë dhe e shoqja, shpesh pa dëshirë, ishte detyruar të vishej dhe ta shoqëronte atë në vendet ku njoftohej për zjarr. Sa më shumë e gjykoj këtë gjëegjëzë, aq më tepër e bëj të vlefshëm vërtetimin se vetëm interesat profesionale, pra ato shkencore - si parësore, studimet e lartpërmendura të Turnerit - i ofruan profesorit de Groot këtë sjellje të pazakontë. Sot, kur e di se si u dogj në shtëpinë e vet mësuesi im, Henk de Groot, kur duhet të pranoj se ai ka dëgjuar në radio për zjarrin në shtëpinë e tij, kur përfytyroj pareshtur se si është përpjekur të shpëtojë vetë dhe dorëshkrimet nga dhoma e gjumit të katit të sipërm për në papafingon e shtëpisë, e cila si gjithë shtëpitë e vjetra të qytetit digjet nga poshtë lart, sot, kur nuk mund ta shfajësoj dot gruan e profesorit de Groot, e cila paditet për vënie zjarri me paramendim për qëllim vrasjeje - sepse më kujtohet vazhdimisht vërejtja gjatë darkës, afërsisht "Ndonjë ditë do të djegësh gishtat...", sot e kësaj dite qortoj veten që nuk u përpoqa të ndikoj me maturi tek mësuesi im aq më tepër që isha e sigurtë për besimin e tij, edhe pse kurrë nuk kam qenë e dashura e tij, siç hamendësohet, as edhe në Londër gjatë ekskursionit të shkurtër treditor. Së fundmi, alibia ime tregon qartë që gjatë natës së zjarrit, unë me kolegen time, zonjushën Manthey, ishim në kinema, në një shfaqje të orëve të vona.

Përktheu: Ornela Canaj

Haruki MURAKAMI

SA E NJOHIM NE BURRAT VETVETEN?!

Tani do t'ju rrëfej pak për veten time. Sigurisht, kjo histori është për Sumirën, jo për mua. Megjithatë, unë jam ai me sytë e të cilit tregohet historia-rrëfenja, se kush është Sumirja e çfarë a bërë ajo, ndaj dhe duhet të shpjegoj pak gjëra edhe për narratorin. Me fjalë të tjera për veten time. E kam shumë të vështirë të flas për veten. Përherë zihem gafil nga paradoksi i përjetshëm kush jam unë? Padyshim,askush nuk di më shumë për mua se sa unë vetë. Por kur flas për veten, gjithë llojet e faktorëve të tjerë - vlerat, standardet, caqet e mia si vëzhgues më bëjnë mua, narratorin, të përzgjedh dhe eliminoj gjëra rreth vetes sime, subjekt i narracionit. Gjithmonë më ka përndjekur mendimi se nuk do të jap një tablo shumë objektive të vetes. Kjo gjë duket se nuk e shqetëson shumicën e njerëzve. Kur u jepet rasti, njerëzit janë të drejtpërdrejtë në mënyrë të habitshme kur flasin për veten. "Unë jam i ndershëm dhe i hapur gjer sa të shqyhesh gazit", të thonë, ose "Kam dy pare cipë unë dhe nuk para marr lehtë jetën". Ose: "Jam shumë i zoti për të kuptuar ndjenjat e vërteta të të tjerëve". Por edhe shumë herë të tjera kam parë njerëz që thonë se të tjerët i lëndojnë lehtësisht pa ndofarë arsyeje për të qenë. Njerëz të vetëquajtur të ndershëm dhe pa komplekse, pa e kuptuar se çfarë po bëjnë, përdorin gjithë ngazëllim justifikime egoiste për të arritur çka duan. Dhe ata "të zotët për të kuptuar ndjenjat e vërteta të të tjerëve", mbyten në lajkat më të tejdukshme. Vetëm kaq më mjafton të pyes: sa mirë e njohim në të vërtetë vetveten?

Sa më shumë që e mendoj, aq më shumë më pëlqen të bëj një kontroll të temës unë. Dua të di më shumë rreth të vërtetës objektive të gjërave jashtë meje. Sa e rëndësishme është bota e jashtme për mua, sa e mbaj unë masën e ekuilibrit kur kam të bëj me të. Kështu do të kisha një kuptim më të qartë të asaj se kush jam unë. Këto janë llojet e ideve që më bredhërinin në mendje kur isha adoleshent. Si një mjeshtër ndërtimi që shtrin të tendosur spangon dhe vendos tullat njëra pas tjetrës, edhe unë ndërtova këtë këndvështrim - një filozofi jete, për të fuguar më shumë. Arsyeja dhe spekulimi kanë luajtur pjesën e vet në formimin e këtij këndvështrimi, por në më të shumtën ai është ushqyer në përvojat e mia. Dhe, meqë ra fjala për përvojën, shumë episode të dhimbshme më mësuan se përçimi i këtij këndvështrimi te njerëzit e tjerë nuk ishte gjëja më e thjeshtë në botë. Rezultati i gjithë kësaj ishte se në fëmijëri fillova të skicoj një kufi të padukshëm mes vetes sime dhe të tjerëve. Pavarësisht me kë kisha të bëja, unë mbaja një largësi të paracaktuar, duke vëzhguar me kujdes sjelljen e personit që ai të mos afrohej më shumë. Nuk e gëlltisja dot lehtë atë që më thoshin të tjerët. Pasionet e mia të vetme ishin librat dhe muzika. Siç mund ta merrni vet me mend, bëja një jetë të vetmuar. Familja ime nuk shquhej për ndonjë gjë të veçantë. Normale deri në rëndomësi dhe në fakt, nuk di nga t'ia nis... Unë vetë u linda në Suginami, por u shpërngulëm në Tsudanuma... Lagja ishte plot me familje nëpunësish si e jona. Ime motër ishte përherë më e mira dhe nuk dilte

as një milimetër jashtë fushës së saj të interesit. Ajo nuk e nxori kurrë shëtitje - qoftë dhe një herë të vetme - qenin tonë.
Unë isha e kundërta e motrës sime, s'e çaja kokën fort për mësimet apo i sati isha në klasë. Nuk doja që prindërit të pikëlloheshin, ndaj bëja si bëja dhe shkoja në shkollë, mësoja minimumin e mundshëm dhe sa për të kaluar. Pjesën tjetër të kohës luaja futboll dhe plandosesha në shtrat kur kthehesha në shtëpi, duke lexuar romane të tërë. Asnjë kujdestar, asnjë orar i rëndë studimi pas shkolle. Edhe me këtë regjim notat e mia nuk ishin aspak të këqija. Atëherë, me sa kuptova, me këtë nivel, mund të shkoja në një universitet të hajrit, pa u stërmunduar me studime e provimin e pranimit. Dhe ndodhi pikërisht kështu.
Fillova universitetin dhe zura një apartament të vogël më vete. Edhe kur jetoja në shtëpinë në Tsudanuma, as nuk kisha bërë ndonjë bisedë të ngrohtë me familjen time. Vërtet jetonim nën një çati, por prindërit dhe motra më dukeshin si të huaj dhe as që i kisha idenë se çfarë kërkonin nga jeta. E njëjta gjë ishte edhe për ata - as që ia kishin idenë se ç'njeri isha unë apo se çfarë doja të bëja. Jo se unë vetë e dija ç'kërkoja në jetë - as unë nuk e dija. Më pëlqente të lexoja romane për të hequr mendjen, por nuk shkruaja aq mirë sa një shkrimtar; edhe të qenit një botues apo redaktor nuk diskutohej, sepse shijet e mia ishin ekstreme. Romanet duhej të ishin thjesht për shijim personal, arsyetoja unë, jo pjesë e punës apo e studimit të njeriut. Kjo ishte dhe arsyeja pse u diplomova për histori dhe jo për letërsi. Nuk kisha ndonjë interes të veçantë për historinë, por si fillova të studioj, m'u duk një subjekt shumë interesant. Nuk planifikoja të vazhdoja më tej studimet pasuniversitare dhe t'ia kushtoja jetën historisë apo diçkaje tjetër, edhe pse udhëheqësi im ma kishillonte një gjë të tillë. Më pëlqente shumë të lexoja dhe të mendoja, por zor se mund të quhesha tipi i akademikut. Siç e thotë edhe Pushkini:

Nuk kishte shtysë të rrëmonte për fitore
Thellë në pisllëkun që kishte shtruar koha.

Gjithë sa më sipër nuk nënkuptonte që unë të gjeja punë në një kompani normale, të mbërthehesha në rrugën e konkurrencës së pamëshirshme dhe të përparoja hap pas hapi në rrëpirën rrëshqitëse të piramidës kapitaliste.
Ndaj, si proces i eliminimit, përfundova mësues. Shkollën e kam vetëm pak stacione larg me tren. Ndodhi që im ungj ishte pjesëtar i bordit të edukimit në atë qytet dhe më pyeti në doja të bëhesha mësues. Si kisha ndjekur të gjitha leksionet e detyrueshme për pedagogji, ndaj më punësuan fillimisht si asistent: por pas një periudhe të shkurtër punë, u kualifikova si mësues me kohë të plotë. Nuk e kisha bërë me plan të bëhesha mësues, por pasi u bëra, zbulova një respekt më të thellë dhe dobësi për profesionin që as e imagjinoja se mund ta kisha. Në të vërtetë, më me saktësi, duhet të them se ndodhi që zbulova vetveten.
Unë rrija para klasës, ku në ciklin e ulët jepja mësim mbi gjëra themelore, si gjuha, jeta, bota dhe zbulova se në të njëjtën kohë, po i mësoja vetes edhe njëherë këto fakte elementare- të përthithur mes syve të mendjeve të këtyre

fëmijëve. Kur bëhej në mënyrën e duhur, kjo ishte një përvojë rigjallëruese. Madje dhe e thellë. Shkoja mirë me nxënësit, nënat e tyre, si dhe me kolegët e mi mësues.
Por ende më pengonte pyetja qendrore: Kush jam unë? Çfarë po kërkoj? Për ku jam nisur? Iu afrova me shumë përgjigjeve të këtyre pyetjeve kur bisedova me Sumirën. Edhe pse, më shumë se duke menduar për veten, e dëgjoja shumë i përqendruar atë që tregonte. Më bënte gjithfarëlloj pyetjesh dhe po të mos i përgjigjesha ose nëse përgjigja ime nuk kishte kuptim, ajo më thoshte troç. Ndryshe nga të tjerët, ajo donte të dëgjonte ndershmërisht, sinqerisht, çfarë kisha për t'i thënë. Bëja ç'ishte e mundur t'i përgjigjesha dhe bisedat tona më ndihmonin t'i hapesha më shumë për veten - në të njëjtën kohë, t'i hapesha edhe vetes sime. Kalonim orë të tëra duke folur. S'lodheshim kurrë së biseduari, nuk dilnim kurrë nga temat - romanet, bota, peizazhi, gjuha. Bisedat tona ishin më të hapura dhe intime si të çdo çifti të dashuruarish. Përfytyroja se sa e mrekullueshme do të ishte po të ishim menjëmend të dashur. Digjesha për ngrohtësinë e lëkurës së saj mbi timen. E përfytyroja sikur ishim të martuar dhe jetonim bashkë. Por duhej të përballesha me faktin se Sumirja nuk kishte ndjenja të tilla romantike për mua, e jo më pastaj interes seksual.
Kishte raste që edhe flinte në banesën time, pasi kishim biseduar deri në orët e vona, por nuk ishte shfaqur kurrë as shenja më e vogël e romancës. Si vinte ora 2 a 3 e mëngjesit, asaj i hapej goja dhe plandosej në krevat, zhyste kokën në jastëkun tim dhe e zinte gjumi menjëherë. Ndërsa vetë hapja ndonjë shtrojë në dysheme dhe shtrihesha, por nuk më zinte gjumi, kokën e kisha plot fantazi, mendime të pështjelluara, të neveritura mbi veten. Ndonjëherë, reagimet e pashmangshme fizike më pikëllonin pa masë dhe rrija zgjuar si një mjeran gjersa të zbardhte.
Ishte shumë e vështirë të pranoja se ajo nuk kishte pothuajse asnjë ndjenjë, ndoshta fare-fare, për mua si burrë. Nganjëherë kjo më lëndonte aq shumë, sa më dukej sikur dikush më gërryente angrrat me thikë. Megjithatë, koha që kaloja me të ishte më e çmuar se gjithçka tjetër. Ajo më ndihmoi të harroja ngjyrat e vetmisë së jetës time.
Zgjeroi zgripet e jashtme të botës sime, më ndihmoi të bëja frymëmarrje të thellë, të lehtësuar. Vetëm Sumirja do ta bënte këtë për mua. Që të lehtësoja dhimbjen dhe më shpresën të zhdukja çdo tension seksual mes meje dhe Sumirës, fillova të shkoja me femra të tjera. S'po them se isha një talent i madh me gratë: nuk isha. Nuk isha ai që mund të quani mashkull që çmend femrat dhe nuk kisha pretendime për ndonjë bukuri të veçantë. Megjithatë, për çfarëdo arsye, disa gra tërhiqeshin prej meje dhe zbulova se po t'i lija gjërat të merrnin rrjedhën e vet të natyrshme, nuk ishte shumë e vështirë që ato të më vinin pas. Këto spërdredhje të vogla nuk ma ndezën kurrë pasionin e zjarrtë, më së shumti një lloj rehatie.
Marrëdhëniet e mia nuk ia fshihja Sumirës. Jo se dinte çdo gjë me detaje, thjesht në vija të përgjithshme. Kjo gjë dukej sikur nuk e bezdiste fare...

Fragment nga romani "E dashura ime Sputnik".

ESE

Arian LEKA

NUK I DUAM! NA DUHEN SHKRIMTARËT

"Në Francë të gjithë shkrimtarët janë të rëndësishëm. Në Shtetet e Bashkuara, vetëm shkrimtari i suksesshëm është shkrimtar i rëndësishëm. Në Angli asnjë shkrimtar nuk është i rëndësishëm. Në Australi duhet të shpjegosh se ç'është një shkrimtar…"

Nëse do e pranonim si të mirëqenë këtë thënie të Geoffry Cotterell-it, do besonim edhe se miti i shkrimtarit, në mos është shembur përfundimisht, ka pësuar krisje. Emri i tij nuk është më ndikues, ndërsa "profesioni" i shkrimtarit nuk kuotohet si dikur në bursën e vlerave të qytetërimit tonë. Kjo botë, gjithmonë e më pak e parashikushme, duket se i ka drejtuar sytë dhe veshët gjetiu. Ku? Te njerëzit e medies, ndoshta. Te shkrimtari, jo më.

Gjeografia e gjerë sugjeruar nga Cotterell, mbi vendin dhe rolin e shkrimtarit në kulturën dhe shoqërinë perëndimore, të bën të mendosh se bjerrja e statusit të tij nuk është pasojë e ndonjë sistemi të caktuar politik. Gjendja e tij nuk paskërka të bëjë dhe aq me rendin botëror apo me format e qeverisjeve. Fjala, vepra, gjestet e shkrimtarëve e paskërkan humbur gjithkund cilësinë. Në këto kushte shkrimtarit i duhet t'i bindet asaj "urtësie", me të cilën Boris Pasternak kështillon mjekun-poet Juri Zhivago: të përshtatet, që të mbijetojë! E, nëse për Francën, Anglinë, Shtetet e Bashkuara dhe Australinë e kemi hëpërhë një përgjigje se ç'është shkrimtari, mbetet të pyesim mbi domethënien e kësaj pyetje për shkrimtarin në Ballkan? Po të jesh shkrimtar në Shqipëri apo të qenit shkrimtar shqiptar në vendet fiqnje me Shqipërinë (Kosovë, Itali, Maqedoni, Mal i Zi) ç'kuptim ka?

Vijmë nga e njëjta kulturë: kultura e heroit. Nuk kam parë kund tjetër, përveçse në Ljubianë, që sheshi më i rëndësishëm i qytetit, t'i lëshohet poetit, siç i është lëshuar France Prešeren, në sheshi që mban emrin e tij, në qendër të kryeqyteit slloven.

Sipas përfytyrimit tradicional që trashëguam nga kultura romantike dhe socialiste, shkrimtar i mirë është njeriu që jeton në gjendje të jashtëzakonshme, njeriu i gatshëm për t'iu përgjigjur thirrjes "nën armë" sa herë që kombi, shteti, udhëheqësi, populli, vegjëlia, pushteti, të shpërfillurit dhe të munduarit të kishin nevojë për fjalën e artikuluar prej tij. Por nevojat e shtetit, kombit dhe popullit kanë më së shumti natyrë politike dhe jo estetike. Arti i kompromisit (siç është e tillë dhe politika) bëri që detyrimi të zërë vendin e lirisë, siç në ligjërimin poetik, urdhërorja "duhet" zë vendin e dëshirores "dua".

Ndërkaq, përjetimi epik i të qenit shkrimtar në Shqipëri, artikuluar prej Lasgush Poradecit në formën "poeti mban përgjegjësi për gjithçka", përveçse u

keqkuptua edhe u keqpërdor. Nga njëra anë ky përjetim lëshoi mbi supet e shkrimtarëve një bekim-mallkim: komplesin e Atlasit, bartësit të vetëdijës titanike të shpëtimtarit, të atij që veç fatit vetjak mbart edhe fajin kolektiv. Një mënyrë e tillë, ajo e të vetëndjerit hero, ngarkoi me përgjegjësi sociale edhe aradhën e shkrimtarëve që ngatërruan kohën për të folur me kohën për të heshtur, kohën e shkrimit me kohën e dëshmimit, duke mbjellë në shoqërinë shqiptare atë farë të dobët, që sot harliset si kulturën e konformizmit. Druaj se edhe sot, pas mëse 100 vjetësh kjo mënyrë e të menduarit dhe ky përfytyrim nuk ka ndryshuar shumë. Ne nuk i duam shkrimtarët. Ata na duhen. Ne nuk i çmojmë ata. As nuk i përçmojmë. Thjesht i përdorim. Kur na lejojnë, ne edhe i shpërdorojmë ata.

Sa herë që na lipset kadencë atdhedashurie dhe patriotizëm i kulluar, kthejmë sytë nga shkrimtari dhe kudo: në sheshe e salla solemne, lexojmë me zë të lartë e me dorë në zemër vargjet e Naimit apo Fishtës a të poetëve të mëvonshëm patetikë. Sa herë që atdheu na pikëllon me marrëzitë, kapardisjen dhe trashamaninë qesharake, siç ndodh jo rrallë në Ballkan, ne u drejtohemi jo shtetarëve, por shkrimtarëve përsëri. Ndaj dhe e përmendim aq shpesh Konicën, Nolin, Mid'hat Frashërin. Ndërsa kur duam të shprehim mosbesim dhe dhimbë krenare për një popull, nën lëkurën e të cilit pakkush beson se rreh zemra e një kombi "që ndërton diçka të re", lexojmë Migjenin dhe hakërrimat e Ali Asllanit. Shkrimtarët e periudhës së socializmit nuk citohen. Për ta ka kohë, është ende shpejt.

Por atë çka la pas si trashëgimi romantizmi do i hynte në punë totalitarizmit shqiptar. Mes tyre vërehen dallime ideologjish, por jo kodesh dhe modelesh. Pikërisht kjo trashëgimi romantiko-totalitare, që e vendos shkrimtarin në qendër të vëmendjes, që e thërret shkrimtarin nën armë dhe e vështrin atë si mbartës i fajit kolektiv, ndikon edhe sot në përcaktimin e marrëdhënieve që shkrimtarët shqiptarë kanë krijuar me të vërtetën, me veten, me tjetrin, me të ngjashmin, me të ndryshmin e vet, me kundërshtarin, me vendin dhe me rolin e tyre në këtë shoqëri.

Të thirrur, të ftuar apo të vetëblatuar, shkrimtarët shqiptarë i janë rikthyer jo rrallë modelit të shkrimtarit të urdhëruar. Mes tyre, ata që përjetuan privimin e plotë të së drejtës për liri njerëzore, por edhe ata që u privuan nga çdo liri e të shprehurit; ata që u gjendën ndërkohë - këtej dhe andej perdes sonë të hekurt - bashkë me më të fundmit mes breznive të shkrimtarëve - "bijtë pa mëkatin fillestar", siç e cilëson Adam Michnik brezin e lindur pas vitit 1991, u pozicionuan si kudo në Europën Lindore sërish në dobi të kauzës sociale dhe të interesit publik.

Rreshtimi në tribuna, uniformiteti i veshjeve, unifikimi i gjesteve dhe i pozave epike, tonet kushtrimore të ligjëratave të tyre ruanin ende diçka nga reminishencat e një kohe që si duket e kemi ende shumë pranë për ta harruar. Roli i tribunit dhe i shpëtimtarit që shpërndan nder e drejtësi, i atij që i del për zot fateve të vendit, i atij që shprehet mbi gjithçka dhe që shndërrohet në forcë

të madhe morale, i atij që ndëshkon padrejtësitë, u rishfaq përballë shkrimtarit, dhe ai këtë e pranoi jo sikur të ishte një rol, një gjest, apo akt i shkëputur në jetën e tij, por shfaqi si të ishte qëllim jete.
Por jo vetëm në Shqipëri ndodhi kështu. Ky fenomen u rishfaq në të gjithë vendet ish komuniste. E veçanta jonë është se, ndryshe nga shkrimtarët e tjerë të Europës Juglindore e Qendrore, që iu bashkuan nismave publike, lëvizjeve dhe rrjedhave demokratizuese në vendet e tyre, së bashku me ata që shërbyen gjer në krijimin e formatimin e shtetit ligjor, shkrimtarët shqiptarë nuk iu ndanë këtyre rrjedhave as në momentin e duhur, që tashmë kaloi, as çastin që flasim.
Përfshirja e një mase të gjerë shkrimtarësh në përbërje të Kuvendit të parë pluralist të Shqipërisë, ishte jo vetëm e mirëpritur, por edhe e përligjur për vitet e para të pluralizmit. Por shumëfishimi edhe në vitet e mëvonshme i skemës së plotësimit të vendeve të Parlamentit me "njerëz të gojës", të cilëve as që iu dëgjua ndonjëherë zëri, përveç rikthimit të kulturës së të shërbyerit dhe gjendjes nën armë, risjell në kujtesë shakatë që bëri komunizmi në fund të përvojës së tij të hidhur, kur i mbushi organet më të larta të shtetit dhe të partisë me kuadro inkompetentë dhe besnikë, kostot patetike të të cilëve një vend i vogël dhe i varfër si yni, i pagoi shtrenjtë.
Duke e parë se dukuria e rikthimit të angazhimit për përfshirje në jetën politike vazhdon të shfaqë prirjet e një psikoze në rritje brenda "esnafit" të shkrimtarëve dhe duke vërejtur se të qenit në shërbim të politikës po i rizgjon ndjesitë e hershme të vënies nën shërbim, dilemës sime nuk i mbetet tjetër veçse të besojë se edhe pas 100 vjet shtet, pavarësimi i mendjeve tek ne do të mbetet dhe për shumë kohë një shpresë utopike.
Profili i shkrimtarit të sotëm shqiptar nuk e ka tejkaluar ende atë të shkrimtarit të angazhuar. Prirja e tij për të qenë me çdo çmim "njeri publik" dhe i mediatizuar, paraqitet si hakmarrja më naive ndaj shpërfilljes që shoqëria e re i bën (sigurisht me të padrejtë dhe padenjësisht) shkrimtarit dhe "produktit" të tij letrar. I çmësuar me të qenit jashtë vëmendjes shoqërore, shkrimtari i sotëm jashtë përfilljes së medieve ndihet me status të kërcënuar. Ndaj, si të ushtronte një lloj vaksinimi nga shpërfillja, shkrimtari shqiptar e kërkon përkrahjen, strehën, përkatësinë, anëtarësimin dhe mbështetijen jo tek letërsia dhe tek lexuesi, por tek tribunat, ekranet dhe te politika. Duke i dëgjuar se si shkrimtarët shprehen në tribuna dhe se ç'gjuhë përdorin ata në forumet e partive, lexuesit i lëkundet besimi në mundësinë e rikthimit me lehtësi të kësaj gjuhe nga mjet politik në mjet estetik. Kjo drojë dhe ky dyshim e bën të krijojë ndaj shkrimtarit një marrëdhënie dyfishe: pëlqim-mospëlqimi ideologjik. Kaq duhet që marrëdhëniet me të, si shkrimtar, të ndërpriten dhe ai të vështrohet jo si njeri i lirë, por si makineri me xheton, që paguhet sa herë që flet – sidomos kur fjala e tij u jep pushtetarëve një *jackpot.*
Por të shërbyerit nuk është vetëm i llojit politik, nga ai që i konverton lexuesit në votues të shkrimtari, siç shndërron vetë shkrimtarin në një krijues ideologjik. Por ky lloj shkrimtari ka edhe talent pragmatik. Ai e vë veten në

shërbim të tregut të emrave të përfolur, kuotohet në bursën e emrave, duke u shumëfishuar përmes çmimeve, faqeve të gazetave dhe hapësirat televizive. E megjithatë…, e megjithëkëto, nuk është shkrimtari delja e zezë e shoqërisë, siç shpesh priren ta shohin. Le ta kthejmë tani përmbys argumentin e nisur. Nëse do të ekzistonte qoftë edhe një vatër mirënjohjeje për kultivimin të elementëve shpirtformues në kulturë dhe sidomos në ngulmimin ndaj shenjave identitare, kjo mirënjohje duhet të shkojë pa mëdyshje ndaj njerëzve të letrave. Kaq përsa i përket kësaj fushëpamjeje.

Por një shoqëri si kjo e jona, e trashëguara, po aq sa dhe kjo e sotmja, shkrimtari është vështruar si njeriu të cilit nuk i zihet besë. Kjo shpjegon pak edhe nga fakti pse marrëdhënia e shkrimtarit shqiptar me pushtetet nuk është aspak një vals, por një bashkëjetesë fatale me më të fuqishmin. Të jetë kjo marrëdhënie e tendosur shërbimi dhe ndëshkimesh vazhdë e dëshmive të një konflikti moral të shoqërisë? Është pazotësi apo pamundësi e kësaj shoqërie për të dashur, pranuar apo kuptuar shkrimtarin? Apo kemi të bëjmë me një parashoqëri sadomazokiste, që kënaqet duke parë se si "ndërgjegja e dështuar dhe e parrëfyer e kombit", përpëlitet dhe shqyhet përditë nga dhëmbët tipografikë të shtypit, nga çatallët dhe bulçitë e medieve televizive apo edhe nga varfëritë jo virtuale, në të cilën jetojnë shumë syresh?

Shkrimtari shqiptar (ky fëmijë jo i shumëdashur, por jo përherë i mirëpritur mes nesh - fatin e të cilit shpesh e lakmojnë, por pa ia njohur mundin dhe pa qenë të gatshëm të paguajmë privimet e tij) mund të thotë se i kanë munguar përkëdheljet, por jo ndëshkimet, që i kanë ardhur përherë me shumicë. Përballë tij është vendosur thuajse përherë një shoqëri dhe një shtet shpërfillës, i pavëmendshëm ose hakmarrës. Si paradoks, përkrah tij është vendosur edhe një publik i papërgatitur për ta dashur shkrimtarin, për ta marrë nën mbrojtje kur ai ka pasur nevojë, qoftë edhe në mënyrën më të thjeshtë dhe më të drejtpërdrejtë që kështillohet në këto raste: respektimin e shkrimtarit përmes leximit të veprave të tij dhe mbajtjes gjallë të asaj kujtese që e mbron këtë marrëdhënie jodetyruese.

Drejtimi i gishtit të fajit në mënyrë përjashtimore vetëm ndaj shkrimtarëve, përndjekja, kërkimi i patentës së virgjinitetit vetëm ndaj tyre në një shoqëri të inkriminuar, hetimi i tij si sjellësi i vetëm i fatkeqësisë, tradhtari i kauzës, atij që gëzon famën e ligë të atij që nuk kënaqet kurrë, që vetëm kritikon dhe dyshon, i ngjan përndjekjes homofobike. Shpirti cinik, gjetja e fajtorit, por moskuptimi i gabimit, nuk do të na ndihmojë të jemi një shoqëri më e lumtur, as më e drejtë dhe as më e mirë. Mendja qortuese na lipset të mos i rikthehemi gabimit historik.

"Në Francë të gjithë shkrimtarët janë të rëndësishëm. Në Shtetet e Bashkuara, vetëm shkrimtari i suksesshëm është shkrimtar i rëndësishëm. Në Angli asnjë shkrimtar nuk është i rëndësishëm. Në Australi duhet të shpjegosh se ç'është një shkrimtar…" Po në Shqipëri…? Në Shqipëri të gjithë janë shkrimtarë. Ose, njëloj si në Ballkan, të gjithë ndihen nga pak të tillë.

Jovan NIKOLAIDIS

KUPTIMI NË PAKUPTIMËSI, 'kundër dada-s secili është dadaist i vërtetë'

1. Sot, pra, në Festivalin DADA-Eist, po mundohem të shpalos vlerat dhe rëndësinë e lëvizjës së fillim shekullit të XX, lëvizjen Dadaizëm, e cila i mohonte shumë vlera të vendosura të asaj shoqërie. Nuk e fsheh dëshirën që për atë që do them këtu para jush, të komentoj edhe një pjesë të devijimeve sociokulturore të ditëve të sotme kundra njerëzimit dhe lirisë së tij në përgjithësi. Të mbërthyer në iluzionet për të drejtat e njeriut dhe të drejtën e zgjedhjes personale në shoqëri, e në Ballkan edhe për shkak të historisë së tepërt, civilizimi i sotëm po vendos një lloj burgu global gardianë të të cilit janë kapitalizmi i ngurtë dhe shoqëria e pabesë bankare, ku kapitali i tërësishëm korporativ po zbaton agresion në drejtësinë sociale dhe lirinë e njeriut në shoqëri. Mendoj, duke shpresuar se do ta kuptoni metaforen time poetike, që bota e sotme e civilizimit perëndimor, por edhe Ballkani perëndimor është në po të njejtën botë, jetojnë në një lloj kampi global të përqëndrimit në të cilin hyhet përmes dy dyrëve. Duke kaluar nëpër njërën derë mbërrijmë deri te **konsumimi i imponuar**, ku na ofrohet pafundësi e ushqimit, pijes dhe kënaqësive, gjëra të pafundme për përdorim të përgjithshëm, e deri te dehjet sensuale dhe kënaqësitë e të gjitha llojeve. Ne jemi bërë të burgosurit e **shpenzimit**, e dikur kemi qenë **prodhues të të mirave**. Kemi hyjrë në kurthën e përplotë të epsheve të panevojshme dhe helmuese, për shpëtimin e shpirtit tonë fatkeq. Nëpërmjet derës tjetër na joshin **lugetërit bankar** të cilëve duhet tu ofrohemi thjeshtë sepse të gjitha rrugët tjera të qeines tonë janë të mbyllura me budallakinë dhe grykësinë njerëzore. Përmbi këtij lloj kampi që po e përmendi qëndron si rojtar vigjilent **Zoti i Ri i Luftës**. A do të mbërrijë, kur do të mbërrijë, ne këto as nuk munden e as nuk dëshirojnë të na i zbulojë askush nga themeluesit e kampit modern të përqëndrimit. Për fat të keq, as ne nuk kemi përgjigje në pyetje, edhe pse jemi të gatshëm që gjatë shoqërimeve dhe bisedave me dëshirën më të mirë të merremi vesh për rrugët e reja që arti bashkëkohor duhet të shkojë. Që të jetë i dobishëm dhe i krijuar për njeriun.

2. Ne sot, më duket, se duhet të thërrasim: Dadaizmi është i vdekur, rrnoftë POSTDADAIZMI! Edhe nëse kjo britmë ndaj realitetit qoftë virtual sikurse jetët tona, ditë për ditë më shumë bëhen: embrione të androidëve të së ardhmes. Neoliberalizmi sot prodhoi **inteligjencën**, artistët të cilët janë bërë rob ose shërbëtorë të sistemeve destruktive politike dhe **intelektuale**, pakicën e revoltuar e cila nuk dorëzohet; këta sot edhe janë një lloj postdadaistësh – vetmitarë të dinjitetshëm dhe rebel por të refuzuar, apostuj të njollosur që kanë humbur besimin. Ata vërrasin: **non serviam**, por pak kush i dëgjon. Zhurma e globalizmit e mbyt fjalimin e tyre, ua copton dorëshkrimin. Më lejoni të pranoj:

Unë jam një ndër këta të margjinalizuar. Zotërinjë, ky civilizim na i mbyti disa nga veçoritë më të mira njerëzore: na vodhën **fshehtësinë, parandjenjën, entuziazmin** dhe **ëndrrën**. Kapitali i palodhshëm prodhon edhe administartorin e mendimeve tona, dhe mes njerëzve ka mbërrit teknologjia ultimative komunikuese. Po ku është dadaizmi?

3. Dadaizmi, siç e dimë të gjithë, lindi në Zvicër më 1916 mes artistëve të cilët u strehuan aty nga tmerret e luftës pushtuese në Evropë. Të mllefosurit, të irrituarit, të zemruarit në llumin (hiçin) aktual evropian u quajtën dadaistë. Marsel Dishani, Gijom Apolineri, Hugo Bali, Tristan Cara, Maks Ernsti, Sofi Tojberi, etj... Kurse ”dada”, lëvizja e tyre prej kafe ”Kabare Volter”, shënoi, siç e tha Tristan Cara në mënyrë djallëzore, ”fjalë e cila nuk don të thotë asgjë”. Kjo ”asgjë” i rrinte pezull në domethënien e termit DADAIZËM sikurse gijotina ndaj qafës të të gjitha bashkëpunimeve në art dhe në shoqëri të asaj kohe, pakputimësinë, pajtimin dhe apsurdin e të cilëve dadaistët i përqeshnin. Me nihilizëm, refuzimin e traditës, me shfaqjen ekstreme të pakuptimësisë. Rebelimi anarkist i rinisë së atëhershme ndaj çdo gjëje në shoqëri pa ndonjë logjikë apo drejtësi. Anarkizmi i tillë benign i rebelëve kushtëzoi një kredo të re në art – u lind antiarti. E gjithë kjo në kuloaret e atëhershme shkaktonte tërbim, përbuzje dhe ndjekje. E në të vërtetë pakuptimësia e realitetit aktual vetëm çka vërtetonte qëndrimet e dadaistëve që arti aktual legjitim ishte vetë thelbi i pakuptimësisë. Këtë shumë mirë e thekson Georg Grosz me qëndrimi që e pa moralshmja, e pa drejta dhe dhuna, në kapitalizmin në rritje duhet të kritikohet pikërisht me të keqen dhe grotesken. Parulla paradoksale të cilët dadaistët theksonin qartë flet edhe për pamjen e re të atëhershme për artin: ’dadaistët janë edhe kundër dadës’.

4. Në hapsirën e Jugosllavisë dadaizmi ka gjetur shumë përkrahës. Menjëherë me shfaqjen e dadistëve në Zvicër, Francë dhe Gjermani, u shfaqën grupe ndjekësish të dadaizmit e më së shumti në Beograd dhe Zagreb. Poetë, piktorë, punëtorë të filmit. Performansa dhe instalacione. Në Zagreb më 1921 u shfaq manifesti i Lubomir Miciqit lidhur me Barbarogjeninë, si variantë lokale e futurizmit italian. Rasti deshi që avangardën më radikale në Kroaci ta mbjellë një serb, ashtu sikurse që fuqinë e ekspresionizmit e futi Miroslav Kërlezha. Që të dy që atëherë predikonin fundin e Evropës dhe muzgun e perëndimit, në të vërtetë jo edhe aq sa e ndjellte Hugo Blati në librin ”Ikja nga koha”, krijim apokaliptik i përkryer gjuhsor dhe mendor. E gjitha çka ka shkruar në librin e përmendur qëndron edhe sot, sikurse paralajmrimi i skalitur në gurë që shpjegon lakuriqsinë e mjerimit të moqenies së sotmes. Antun Branko Shimiqi në dy libra të shkëlqyeshme ”Vorbulla” dhe ”Shakullina” në të vërtetë rikëndoi estetikën e gjermanit Der Shturm, ashtu sikurse Kërlezha në dramat ”Kraleva”, ”Kristofor Kolombo” dhe ”Mikelangjello Buonaroti” mbolli hullinë e rebelimit origjinal ekspresionst dhe klithjes. Shfaqen Josip Sisseli, Vinko Gecani, Vishnja Kranjçeviq, Augustinçiqi, Hegedushiqi, Ruzhiçka, Tabakoviqi... U

lindën ravista e përrreth tyre edhe përkarhës të tendencave të reja. ”Zenit”, “Dada-Tank”, “Dada-Xhez”, “Zenit –Ekspres”. Në Zagreb i pari u aktivizua ”Salloni i Pranverës” i aktivistëve avangardë, ”Zenit-i” del në Zagreb (1921-23) dhe në Beograd (1924-26). ”Gjeli” i Donadinit (1916), ”Letrari” (1924), ”Flaka” e Miroslav Kërlezhës dhe August Cesaricit (1919). Në Serbi Lubomir Miciqi propagandon avangardizmin në letërsi, muzikë, pikturë dhe film, duke afirmuar ”zenitizmin” si sintezë e shpirtit ballkanas dhe lëvizjeve bashkëkohore evropiane (futurizmi, ekspresionizmi, dadaizmi dhe surealizmi). Në Beogradin e atëhershëm lindin një numër i krijimeve artistike të cilat kanë me bollëk poetikë dadaiste: intertekstualitetin, polimorfozitetin, devijimin dhe apsurditetin, meta-gjuha. Kurse produkt i kësaj është metateksti. Lënda sipas gjinive është e shumëllojshme: poemë, tregime, romane, drama, filozofi, daktilokarikatur, antireklamë, pamflet, manifest, tekst arkitetektorik, tekste/eseje. Rade Drainaci, Stanislav Vinaveri, Dragan Aleksiqi, Branko Ve Poljanski, Ljubomir Miciqi, Petar Palaviçinini. Në Serbi dadaizmi në thelb ishte mantër e zgjeruar e surealizmit e cila konfirmonte fuqinë e dy poetëve të mëdhenjë, Oskar Daviçit dhe Vasko Popës.

I vetmi dadaist malazias të cilin unë di është poeti dhe prozatori Risto Ratkoviqi. Është thelues i vargjeve moderne në letërsinë malazeze. Që nga 1923 në Beograd ai shoqërohet me avangardistët e atjeshëm dhe shkuran në harmoni me poetikën dadaiste.

5. Ke dadaistët fjala *antiart* ka qenë shëmbëlltyra e qenies dhe rolit të artit. Sot termi *art* shpeshherë bie në konsumerizëm, krijimtari antiarti, pra,: jonjerëzore. Kaosi dhe pakuptimësia ke dadaistët ka qenë programi revoltues i tyre, sot pakuptimësia dhe kaosi në masë të madhe janë bërë thelbi i jetës sonë. Anarkizmi i atëhershëm dadaist, cinizmi dhe ironia, satira dhe loja e fjalëve, sot i gjasojnë çmendurisë apokaliptike të shoqërisë konsumuese. Kalëthi dadaist i drurit para nesh shndërrohet në kuçedër, dinosaurusin anarkoliberal. Poetët, të cilët janë më të pakët në botë, në sytë e neokonformistëve janë djaj që shërbejnë pikësëpari për nxjerrjen e territ nga barku i vet. Kush di sot për ta, kush i dëgjon? Tristan Cara, ai rumun i njohur, i cili i këndoi Parisit më bukur se sa simbolistët francez, shkruajti: ”Dada lindi nga nevoja morale... prej ndjenjës së thellë në mënyrë që njeriu i cili gjendet në mes të të gjitha krijimeve shpirtërore, do duhej të vërtetonte inferioritetin e vet ndaj dijeve të varfëruara për qenësinë njerëzore, ndaj gjërave të vdekura dhe gjërave të përfituara keq.” Me këtë rast më duhet të përmendi edhe vargjet e intelektualit të madh, vargjet e bukurisë së pafundme dhe të vërtetës së rëndë:

”Kaluan njëmijë vjet,
Dhe ishin
Vetëm
Një
E vetmja
Natë”

Sot nga dadaizmi na kanë mbetur vetëm lojërat performuese reklamuese prej botës së hiçit, pasqyrime të shtrembëruara të lojërave fëminore me idhujt me trup të fortë dhe kokë bosh. Nëse janë mimika, tallja dhe gjestet skandaloze, intervenime në trupin e njeriut dhe rrethinë e që në dadaizëm ishin funksionale, sot i kemi të gjithë këto nga e para të shfaqura në një banalitet të skajshëm. Nga çmenduria e marketingut deri ke ne hap gojën pakuptimësia karizmatike. Pothuaj të gjitha punët e tregëtisë dhe blerjes i mori kapitalizimi i ngurtë, përmes medieve dhe TV-pamjeve, kapitalizmi i kontrollit ndaj kërkesës së njeriut për të mirën dhe lirinë. Kapitalizmi intelektual është mes nesh. Dëshira jonë është zbatimi i tyre, sepse pothuaj të tëra ia lëshuam shpirtërat **data-izmit** *(dataism).* Deri në fund dataizmi do ta vjedh mendjen tonë. Njerëzit e sotëm janë një masë e hirtë të cilët zotëruesit nga **smart-ferri** i imigrojnë deri në pikën e fundit të kësaj planete. Të tjerat për vete i kanë marrë shërbimet informativo-përgjuese neoliberale. Njeriu është më i largët, makina më e afërt. Së shpejti do bëhemi zombi, jashtëtokësorët do shetisin tokës. Në ne është duke vdekur e gjithë parandjenja e zakoneve të mira, ne nuk shoqërohemi, ne merremi vesh me ajfona. Bota e çmendur ecën rrugëve, në veshë mbajnë copëza plastike dhe flasin vet me vete. Mbi ta qëndrojnë satetitët.

6. Dadaizmi i Berlinit i viteve të njëzeta të shekullit të kaluar ka qenë fari i lirisë dhe paralajmërues i qartë i së ardhmes. Pa dadaistë nuk është e mundur të kuptohet pse sot mendimet për makinat mbizotërojnë ndaj ideve për mundësitë e pafundme njerëzore. Këso lloj krijimesh 'të përparimit' mbysin ndjenjat e vërteta njerëzore të dashurisë dhe shoqërisë. Ne në Ballkan dëshmojmë agresionin e strukturave të përkryera jonjerëzore: urrejtjen kolektive, atavizmin, të keqen fisnore dhe ekstremizmin fetar. Nga tradita synojmë vetëm kah shkatërrimi dhe nga to ndërtojmë mitologji të reja, njejtë shkatërrimtare për dinjitetin njerëzor dhe në përgjithësi lirinë e mendimit dhe veprimit.
Nga e kaluara e thellë dhe e largët mbërrijnë deri ke ne, të qetë dhe dërrmuar – vuajtja dhe klithmat e dadaistëve. Edhe atëherë edhe sot botëkuptimi i dadaistëve është i mbështjellur me moskuptimin e botës dhe pakujdesit ndaj synimeve të veta. Anarkizmin e çmuar të dadaistëve e ndërruan terrorizmi dhe kaosi. Ballkani sot kënaqet në gënjeshtrat e politikanëve diletant si dhe shitjes së mendëve të turmës së mjerë me inteligjencë të blerë e cila sot besueshëm din vetëm një gjë: të rrahë shuplakë. Bravo. Bravissimo!. Politikanët tanë më së miri dinë të këndojnë këngët e turbo-folkut dhe të luajnë valle popullore. Populizmi po shndërrohet në formë dhe masë kulturore e kolektivit.
7. Më lejoni që në fund të paraqitjes time, për pak të largohem nga tema, dhe të jem anakronik. Dikur kishim një parti absolutiste e cila ndërtoi vendin e shkatërruar, punësoi njerëzit dhe u siguroi një periudhë të mirë arsimore, e që për mua është më i miri në historitë tona përplot me tërmete.
Sot kemi parti të panumërta. Dhe shih për çudi – të gjitha demokratike. Ato tash një çerek shekulli nuk bëjnë asgjë përveç se shesin e stërshesin, dhe ende

nuk ia arritën të shesin të gjitha ato që partia totalitare në kohën e njëmendimsisë krijoi. Por, ne nga bota na porosisin: zhvillimi i qëndrueshëm demokratik nënkupton që në vend të një partie të gjithëfuqishme të gjitha të investojmë në partitë e vogla dhe të mesme, e të gjitha këto në emër të të drejtave njerëzore dhe lirisë së shprehjes së lirë.
Parti, pra kemi aq sa edhe kioska. Askush, në të vërtetë nuk e ka të qartë se për çfarë shërbejnë të gjitha ato parti, çfarë dëshiron kjo fantazi e politikave lokale, por mbi të gjitha është e nevojshme të sigurohet pluralizmi dhe lëvizja e lirë politike. Për atë që më mirë është të kemi një sistem që e përbëjnë shumë trapa jokompetent, se sa që për të gjitha të vendosë dikush nga njerëzit e mençur dhe serioz. Pas një çerek shekulli jete në demokraci, nuk do të duhej që askujt t'i dëshmojmë, ne u bëmë viktima të anarkisë dhe gjysmë të vërtetave. Gënjeshtra rri pezull mbi ne, e në ne topi i shpraztë i pikëllimit.
Të kuptohemi: ndoshta mendja ime është e infektuar, por për atë kohë unë nuk kam nostalgji. Edhe unë isha i dënuar me titizëm. Sikurse çdo gjë, edhe ai rregullim shoqëror u shkatërrua për shkak të gjërave të duhura. Sikur të kishte mundur, ende do të ishte. Asnjë urdhër nuk është i mire. Çdo gjë që rrethohet me murë, bie: atë e dinë edhe nihilistët e kuq edhe teologët e krishterë edhe fundamentalistët islamik.
Unë e di që është e pafat dhe nën dinjitetin e njeriut të rrihet shuplakë me rastin solemn të hapjes së kioskave dhe pemtarive. Çfarë na duhen ne fabrikat? As Perëndimi nuk i ka më, janë zhvendosur në të gjithë botën si 'teknologji ndotëse'. Le të punojë fukaraja nga bota pasive për një dollarë në ditë në mënyrë që demokracia të thithë ajër të pastër dhe kundërmon kosmosin. E di që është e trishtueshme dhe nën dinjitetin njerëzor që pas një çerek shekulli, pas importit të rregullave demokratike, të vërrasim parolla dhe fraza demokratike të faqezillykut; të përsërisim atë që, ja, neoliberalizmi nuk është i përkryer, por është rregullimi më i mire i njohur. Ja mu kështu kemi thënë edhe për socializmin!
Zotërinjë, hedhjani një sy, kandidatëve dhe partive që garojnë për votat tuaja. Edhe kjo është, apo jo, më e mira që njerëzimi ka mbërritur?
Eee, trishtimi ynë postdadaist.
Ballkani a nevojë për **një bashkësi mbinacionale**. Ajo nuk prish as veçoritë etnike e as kulturologjike të asnjërit prej popujve të Ballkanit. Bashkësia mbinacionale vetëm na bën më të shkathtë që në Europë të hyjmë të përgatitur, të vetëdijshëm për kualitetet e përgjithëshme, si regjion i integruar sociokulturologjik. Dëshiroj të besoj që një mision i tillë i intelektualëve ballkanas është i mundur.

(Kjo ese u lexua në Festivalin POETEKA - dadaEAST - dadaDAYS - 26 - 30 Shtator 2016 në Tiranë)

Nga gjuha malazeze përktheu dhe përshtati Gazmend Çitaku

EX-LIBRIS

Gëzim PUKA
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

DISA ARSYE TË MIRA PSE DUHET LEXUAR PROZA E JAHO KOLLARIT

Përpara se të vija në këtë veprimtari promovuese nuk e kisha njohur personalisht Jaho Kollarin. Shkrimtarin ma prezantoi sonte për herë të parë botuesi Gazmend Çitaku. Ky i fundit më shumë se një vit më parë botoi një kumtesë timen tek revista "Dija"për vëllimin me poezi të Kollarit "Poeti i mijëvjeçarit të tretë". Përmes këtij vëllimi u njoha me këtë autor ulqinak.
E bëra këtë hyrje për të shfaqur idenë se sa pak ndikojnë tek tekstet letrare njohjet, ndërhyrjet apo miqësitë. Autorët e gjejnë vetë lexuesin. Kjo është mrekullia e komunikimit të letërsisë.
Libri në prozë i Jaho Kollari "**18**$^{+}$" që na prezantohet sot më ngjan i frymëzuar nga ngjarje apo ndodhi të jetës së vetë autorit, i cili sjell përshkrime të mrekullueshme referenciale për një zone etnike dhe një popullsi që nuk ka zënë akoma vendin e duhur në historinë tonë, në të njëjtën kohë përmes këtij libri shfaqet edhe kredoja e një krijuesi që "provokon" sistemin letrar shqiptar. Shkrimi i tij me një stil të drejtpërdrejtë, i mbarsur me ndjenja të fuqishme aq sa më ngjan se e kap për gryke lexuesin duke e befasuar dhe tërhequr njëkohësisht. Lexuesi përmes këtij libri percepton shqetësimin, zemërimin dhe zhgënjimin e personazheve që vijnë nga Jaho Kollari. Protagonistët e këtyre historive vënë në dukje një dobësi të madhe, ata kanë një ndjenjë thyerjeje shpirtërore që i bashkon dhe mbase kjo i bën edhe të veçantë.
Titujt e copëzave tërheqin vëmendjen së bashku me datat e shkrimit të tyre:
Orkestra e çakorduar deri në vyshkje dhunonte një evergreen (2016); Efekti i topit të borës (1994); Homeri (1994); Secili pret radhën e vet të heshtjes (1997);Panelisti (1994);18^{+} *(1994); Lloftari (1994); Halli (1994); Genti (1998); Mbledhëtari (2006); Big Brother (1994); Eni (1990); Borxhi (1993); Bredhje pas identitetit, -njerk(ë)dheu i tretë Prolog; Mëmëdhe quetë toka; Epilog (2015); Zënka (1998); Valdanosi (1997); Gëzimi (2000); Dhunimi (2004); Trimëria (1999); Kalimerja (1998); Hafija (1999); Vrasja (1998).*

Kënaqësia e leximit rrjedh nga mundësia e pushtimit emocional që letërsia ofron. Përsiatjet letrare lejojnë të bësh kapërcime në kohët dhe botët e ndryshme shpirtërore. Narracioni i Kollarit apo përmledhja e tregimeve të tij

ndjek disa hapa nga rrethana nistore e bashkëkohësisë "*Orkestra e çakorduar deri në vyshkje dhunonte një evergreen";* duke kaluar tek një thyerje e ekuilibrit si tek "*Halli"; "Mbledhëtari"; "Big Brother"; "Eni"; "Borxhi", etj*., si dhe tek disa zhvillime ngjarjesh me protagonistë të përfshirë në peripeci përmirësimi apo përkeqësimi; tensioni rritet përmes elementeve rrëfimtare dinamike tek *"Zënka"; "Dhunimi"; "Trimëria"; "Kalimerja"; "Hafija"; "Vrasja".* Ndërsa situata finale e strukturës së narracionit, ajo që do të duhej të ishte diku nga fundi i librit, na shfaqet diku nga mesi i tij nën titujt: "*Bredhje pas identitetit, -njerk(ë)dheu i tretë"; "Prolog"; "Mëmëdhe quetë toka"; "Epilog".*

Narracioni i Kollarit, rrjedha e ngjarjeve dhe gërshetimi i tyre nuk i korrespondon logjikës dhe kronologjisë. Narratori shpesh na shfaqet ***in medias res***, thënë ndryshe në mes të ngjarjeve. Lëvizshmëria në boshtin kohor krijon efekt tek lexuesi në aspektin e gjallërimit të rrëfimit. Shpesh na ofrohen prolepsa përmes të cilave rrëfimtari na paralajmëron për ngjarje që do të vijnë më pas. Po citoj këtu ***Zënka:*** *"Atë mbrëmje pas një hezitimi të rëndë, i strukur në një qoshe të shtëpisë ku ndizte cigare pas cigaresh, Shaqë Mani zuri t'i rrëfejë të shoqes dhe të birit se ç'kishte ndodhur sot atje në Mëhallë të Re:*

-Nuk di si do të bëhej puna e Demit. Atë që dëgjova sot nuk ishin isharete të mira...

-Ç'ka ngjarë?!-pyeti me gjysmëgojë e shoqja e Shaqës.

-Mjaft dhe përsëtepërmi. Kam frikë se ai djalë (fjala ishte për Demin) do ta marrë në qafë, në rend të parë veten dhe familjen e vet, e pastaj edhe tërë farefisin!

E shoqja e Shaqës u drodh pas këtyre fjalëve, kurse të birit kjo nuk i bëri përshtypje, meqë ishte hala i vogël ta kuptonte seriozitetin e situatës, por e ndjente me tërë qenien e tij tensionin psikik të prindërve.

Ndërsa disa faqe më pas tek copëza e titulluar *"Vrasja"* kemi: "*Kjo që ngjau, pra, vrasja e Demit, nuk qe diçka krejt e papritur për Shaqë Manin dhe farefisin e tij. Megjithatë, Shaqës i vajti zemra deri në fund të barkut nga brenga, por nuk u trishtua e tremb. Demi, vëllai i tij i vogël, kaherë ishte fërkuar vrazhdë me Selë Bajrakun. Zënka e tyre, pra, e kishte zanafillën qysh se Sela ishte vendosur në Ulqin."*

Sekuencat narrative i referohen fakteve që përbëjnë historinë e ngjarjes dhe janë sekuenca të natyrës dinamike. Citoj nga Panelisti: ***"****Përparim Avashi ishte shndërruar në një vraposh të vërtetë dhe me një laps e bllok në dorë mblidhte mendimet nga publiku, siç i mbledhin topat ata vogëlushët rreth terrenit të tenisit. Tek e pa, Fitim Qederit iu mbërthye në ngërç buzagazi. Ky në asnjë mënyrë nuk mund ta pranonte shëmtinë t'i hajnohej zanati sy më sy. Kur radha i erdhi autorit, të cilit po i promovoheshin veprat, cirku ishte shndërruar në një*

vorbullë kolaptike. Ky zuri të flasë duke e marrë qesim fjalën. Meqë askujt s'i kishte shkuar përdore, fytyrëlëmuari me marifet të paparë dhe me plot mjeshtri e ndolli ogiçin (xhepat i kishte pasur përplot pesha). Kopeja iu qep nga pas, si zagari..."

Narracioni i Kollarit ndërthur sekuenca përshkruese që lidhen me ambientin, personazhet, objektet dhe sjelljet domethënëse dhe që duken si sekuenca statike, por të tilla janë edhe sekuencat meditative, që ftojnë në rrëfim mendimet e personazheve ose të rrëfimtarit për ngjarjet. Citoj nga "*Prologu":*

"Gjyshi im, ta zëmë, duke mos e larguar këmbën nga Ulqini, kishte qenë qytetar i nëntë shteteve!!?? I lindur, pra, në Ulqin në fillim të viteve gjashtëdhjetë të shek. XIX dhe vdekur në po të njëjtin qytet në fund të viteve katërdhjetë të shek. XX, ai ishte qytetar i Perandorisë Osmane, i Malit të Zi, i Austro-Hungarisë, i Mbretërisë SKS, përkatësisht, Jugosllavisë mbretërore, pastaj i Italisë, Gjermanisë, përkatësisht, Shqipërisë dhe, në fund, i Jugosllavisë komuniste!

Babai im kishte përjetuar Austro-Hungarinë, Mbretërinë SKS, Jugosllavinë e midis Luftrave Botërore, Italinë, Gjermaninë, Shqipërinë dhe, në fund, Jugosllavinë e pas Luftës së II-të. Pra, edhe ky ishte shkapetur nëpër shtatë shtete, pa e larguar çapin prej qytetit të lindjes!

Unë për veten time, kisha lindur në Jugosllavinë e pasluftës, ku isha rritur e shkolluar (pjesërisht), pastaj shkolluar dhe pjekur në Jugosllavinë e pastitos, pata përjetuar edhe një Jugosllavi të tretë, të ashtuquajtur, federale, me dy njësi, ku njëra ishte bërthama dominuese, e tjetra një satelit lozonjar dhe qesharak sa s'bën më. Që e gjithë kjo të mos mjaftojë (pra, të qenit qytetar i disa shteteve pa e larguar këmbën nga vendlindja) unë vajta një hap më tej: e braktisa qytetin tim në fillim të viteve nëntëdhjetë të shek. XX. Tani ia nis, pra, shtjellimi i ngjarjes, si dhe rikthimi i problematikës së shpërnguljeve individuale e kolektive, braktisjeve dhe ekzoduseve, hemorragji, kjo, që vazhdon sot e gjithë ditën.

... Çudi e Zotit dhe e robit që ne u shkulëm të gjallë nga ai lokal gjakpirësish dhe një ditë më vonë u larguam nga shteti i ëndërrave boshe."

Sekuencat dialogjike përmbajnë shkëmbimin e replikave të personazheve. Alternimi i këtyre tipeve të ndryshme të sekuencave përbën ritmin e rrëfimit të Kollarit, ku mbizotërojnë sekuencat narrative të ritmit të shpejtë, ndërkohë që prezenca e sekuencave të gjata refleksive, përshkruese dhe dialogjike e ngadalësojnë shtjellimin e ngjarjeve të rrëfyera. Vlen të theksohet se në tekstin e Kollarit nuk ka një rregullsi apo një ndarje të saktë se ku duhet të fillojë njëra dhe ku duhet të mbarojë tjetra nga llojet e sekuencave. Është e rëndësishme të kuptohet se pas rrjedhës së ngjarjeve të historive që tregohen, fshihet një "makinë" e montuar sipas një prosedeje narrative mjeshtërore.

Një tjetër komponent që pa dyshim përbën një aspekt për t'u shënuar tek ky tekst letrar është aspekti kohor. Narratori nuk rrëfen ngjarjet në rrjedhën si ata

ndodhin, por siç e thamë edhe më sipër përdor teknikat e analepsës dhe prolepsës. Në planin e gjatësisë kohore ai operon me teknikën e përmbledhjes përmes shkurtimit të kohës së rrëfimit përballë kohës së ngjarjes. Citoj nga teksti i titulluar "Eni": *"Kaloj edhe ky sezon. Turizëm s'pati aq shumë. Pati, megjithatë, mjaft fjalë të këqia, rrena, mashtrime, hajni, kurvni, punë tjera të ndyra..."*

Narratori përdor edhe kapërcimet kohore duke sjellë një kuptim ose ndjenjë, duke ndarë e përshkruar një e nga një elementet që përbëjnë tekstin. Për të bërë këtë atij i duhet të përdorë fjalën e shkruar, shumë më ngadalë se mekanizmat e të menduarit dhe duhet të bëjë një analizë që ka si rezultat një ngadalësim të kohës së veprimit përballë realitetit. Kjo ndodh në hyrje të copëzës së titulluar *"Prolog".*

Personazhet e Kollarit qëndrojnë dhe përzihen në kufirin mes tipave të personazheve që përshkruhen nga narratorri nga një pikëvështrim i jashtëm dhe nga personazhe ku narratori jep hua pikëvështrimin e tij.

Personazhi *Durim Shamata* shfaqet si një protagonist i tipit kafkian, i cili pret për të hyrë. Zemreku i kësaj proze është paraliza para një protagonisti tjetër: *Të Rëndësishmit*. Gjendja e personazhi të Kollarit nuk ka kohë dhe hapësirë. Një njeri i atrofizuar në shumë pikëpamje, me një ankth të vazhdueshëm, i përjashtuar dhe i padobishëm. Kjo prozë karakterizohet nga një stil pa asnjë lloj zbukurimi. Një ndër interpretimet që mund t'i bënim domëthënieve të kësaj proze dhe këtyre përsonazheve është tëhuajësimi i njeriut të sotëm nga ritmet e jetesës sipërfaqësore.

Në këto tekste sidomos në ato që mbyllin këtë libër, duhet bërë një ndarje midis autorit dhe narratorit, të cilit siç duket i është dhënë e drejta të rrëfejë. Në këto tekste si në ato të Prustit, Xhojsit, Svevos shpesh narratori di aq sa dinë edhe personazhet e tij. Ai identifikohet me personazhe të ndryshëm dhe impostohet sipas këndvështrimit të tyre, duke u përfshirë kështu brenda historisë. Në këtë rast mund të flasim për fokalizëm të brendshëm, i cili përqendrohet më shumë tek analizat e ndërgjegjes.

Tek "18+" sfilojnë personazhe që përgjatë viteve dalin me të njëjtat emra dhe të njëjtat karakteristika në faqet e këtij rrëfimi. Janë disa burra dhe gra që nuk po arrijnë të jenë me hapat e kohës dhe qëndrojnë mënjanë në kthina apo periferi të ngjarjeve.

Duke e lidhur me parantezën që bëra në fillim të kësaj ligjërate, desha të theksoj se e gjej me vend opinionin e ngritur se fundmi në shtyp për sistemin letrar shqiptar, nga ku duket se brenda këtij sistemi letërsia shqiptare e diasporës ka krijuar një profil të sajin, që nuk është ndikuar shumë nga letërsia që bëhet në Tiranë dhe në Kosovë.[1] Në këtë kontekst duhet ta shohim apo ta soditim pa asnjë kompleks edhe krijimtarinë e Jaho Kollarit, duke e veçuar si një letërsi të mirë.

[1] Shih: "Pse vuan letërsia e diasporës në ditët tona?!", Gazeta Shqiptare, e diel, 15 maj 2016.

Të lexosh këto proza të Kollarit do të thotë në njëfarë mënyrë të zhvishesh nga hipokrizia para penës së tij, e cila shkruan pa filtra, pa turpe. Boja e shkrimit që njollos letrën e bardhë të librit të tij do t'u udhëheqë drejt historive, rrethanave, botëve që i ngjajnë aq shumë edhe jetës suaj. Mbase nuk do t'u pëlqejnë të gjitha historitë, mbase do të lexoni vetëm disa prej tyre, por për një gjë dua t'ju paralajmëroj; nëse e lexoni këtë libër, nuk mund të mos provoni emocione: zili, zemërim, admirim, turbullim. Do të ishte e pamundur të qëndronit indiferentë përballë këtij teksti.

Jaho Kollari do t'u lërë një mesazh atyre që do ta lexojnë. Citoj: *"Duke kundruar situatën nga një këndvështrim asnjërës, por me një lidhshmëri shpirtërore, kam vënë re se, në këtë çerek shekulli, prej arratisjes sime dhe prej kohës së shpërbërjes së njëmendizmit politik, trevat etnike, sidomos Ulqini me rrethinë, kanë ecur një hap para e dy prapa! Ky konstatim imi, lexuesve do t'i bëhej më i qartë dhe më i plotësuar, sa më tepër që t'i depërtohej në thelb kësaj shkrese. Meqë, gjatë këtyre 25 vjetëve, është lindur dhe rritur një brez, i cili, po e gjitha të shprehej në një mënyrë figurative, gjendej midis dy brigjeve, në një anije që lundron në një det të shqetësuar. Njërin breg e kishte braktisur që moti, por kurrsesi të arrihej ai tjetri, për t'u ankoruar barka dhe të zbarkohen në një tokë të premtuar."*

Teksti letrar i Kollarit qoftë me elementet biografike, historike, filozofike apo imagjinare, na ripohon atë që Aristoteli kishte në mendje kur i referohej artit të fjalës dhe deklaronte se arti është më i vërtetë se historia.

Fjala që vjen përmes këtij libri është e vërtetë për nga ndjeshmëria, ironia dhe bukuria.

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit 18+ të autorit Jaho Kollari. Botoi Diti&Oli, Libraria ARTI, Ulqin, 2016)

Rrustem BERISHA

KURORË E POEZIVE PËR ULQININ

Poeti që po e prezentojmë është krijues i suksesshëm, i cili prirjet shkrimore i ka shprehur në shumë gjini letrare. Ndjeshmëria dhe humaniteti i tij komunikojnë.

Do theksuar këtu se ai është krijues me stil të veçantë dhe krejt origjinal për çka vepra e tij don analizë serioze. Duhet parë dhe qartësuar mundësitë e veprës për të komunikuar me masën lexuese, sepse shkrimtari me stil të tillë i shkakton lexuesit mund më të madh si në kuptimin e përmbajtjeve ashtu në përcjelljen e porosive.

Mosha e Nexhatit, i lindur më 1949, deri këtu rradhitë në krijimtari afër 40 vepra. Këto vepra i shquajnë karakteristikat e tyre specifike: zgjedhja e tematikës, format e reja shprehëse, zgjedhja dhe krijimi i figurave stilistike, tërë leksiku poetik i freskuar me fjalë e krijime të reja.

Sintaksa e gjuhës së Nexhatit është vetëm sintaksë e ligjërimit të tij dhe asnjë krijuesi tjetër. Me disa konstatime dhe vlerësime do t'i afrohemi librit poetik "kërcimi i drenushës". Përmbajtja e librit e vërshon lexuesin me dhimbje e herë-herë me qëndresë, fitore e humbje, por është plot forcë e rezistencë kundër padrejtësive që ia bëri barrë historia popullit dhe atdheut të poetit. Në këtë drejtim është i mobilizuar ligjërimi i veprës që të kundërshtojë dhe të rezistojë derisa të egzistojë e folmja jonë, sepse është rrëfim epik më tepër dhe është e tëra qëndresë e luftë. Këtë jehonë e sjell leximi i "kërcimi i drenushës". Libri ka marrë rrugën që t'i pavdeksojë këta njerëz dhe këto vise. Ngrehinës krenare, bukuroshe të Ulqinit, i turren katastrofat natyrore, por edhe ato të lakmuesve armiq, që janë me përmasa biblike, por konstrukti i ndërtimit të tij, shpirti i banorëve të tij, e kanë ruajtur imazhin konstant qindra mijëra vjet. Një fizionomi me tipin e feniksit është krijuar në vepër dhe e bën të vlefshëm mundin e përmbajtjen që autori e ka investuar këtu. Tematika e librit, të shumtën, është luftë kundër të këqijave që me shekuj i vrasin njerëzit dhe e vrasin vendin, të cilët ishin të pajisur me famë nga lashtësia, por koha i shtriu mjerueshëm.

Libri është për Ulqinin dhe gjymtyrët e tij: për njerëzit, detin fshatërat, çdo fjalë, çdo varg e çdo poezi me zërat e tyre poetik sjellin djhembje e dashuri. Këto zëra kanë forcë të çuditshme, sepse pikojnë gjak dhe prodhojnë gjak.

Porositë e librit janë të qarta për breznit, kuptimet e tyre lidhen me realitet historik gati ashtu si i ndodh në rend kronologjia e ngjarjeve.

Vepra është hartim modern artistik.

Diçka do të përmendim shkurt nga këto ligjërime duke i shquar vende – vende vlerat e tij.

Ato që do të mbesin pa u thënë, mbesin hise e të tjerëve.

Hyrja në këtë ligjërim, poezia e parë, përkufizon pozitën e qytetit dhe shpreh mallëngjim, një lloj nostalgjie, që përgjan më vonë në mbishkrim varri për ata që nuk marrin frymë në Ulqin. Pra, një është madhështia e qytetit dhe dy, pikëllimi për të larguarit qoftë me mërgim e qoftë me rrugën që kanë marrë në botën e amshuar. Pra, kjo poezi është një pjesë himn, një pjesë epitaf, është një konceptim i poetit që vërtetë ka dhunti shkrimi.

Në vijim rradhiten poezi që e përshkruajnë Ulqinin herë me petka të vjetra antike, herë të mbushur me frute të cilat i gëzojnë banorët. Në përgjithësi Ulqini merr pamje të qytetit të begatshëm. Ai duket i varfër e i mjerë atëherë kur e rrahin dridhjet e termeteve apo e sulmojnë armiqt. Por, nga ato kataklizma del dhe gjallëron me njerëzit e vet, natyrisht duke i bartur gjatë lëndimet e atyre plagëve. Po, ringjallet.

Pamja përshkruese e sjell qytetin midis pjesëve të natyrës i qiellit, yjeve, hënës, diellit: midis objekteve të arkitekturës, kalasë, urave, shtëpive me dritare me qemer; midis frutave, ullinjëve, shegave, fiqvë, hardhive. Të gjitha këto e stolisin Ulqinin.

Vërtetë dukja e tij është pamje e qytetit mbretëror. Këto tabllo i zgjojnë poetit asociacione për viset e Toplicës dhe të Çamërisë, sepse ai atje e ndien gjëmën e tyre të mbytur. Simbolika e mollës së Kuqe pikë e coptuar në gur për poetin do të thotë se viset e jeta atje janë shuar. Ky emocion i vjen me afrimin midis plagëve që bartë trupi i atdheut.

Nëpër endje të pa ndalshme poeti familjarizohet me Ulqinin. Udhëton nëpër rrugët e tij me vjazën e vogël Dea. I vjelin kënaqësitë që ka qyteti. Ndërkaq, te ankorimi i barkave e tret shikimin dhe pret letër nga vajza tjetër në mërgim Zana. Krijohet rrjedhë e nostalgjisë me pikëllimet në familje dhe për copat e humbura të atdheut.

Toplica, Çamëria, Ymer Prizreni, Isa Boletini, Zana, janë ndërhurje dhe afrim i historisë që nga mbretëresha Teuta, kujtim për tërësinë e dramës që është luajtur mbi atdheun. Shikojmë vende fatprera e personazhe tragjike. Këtyre pikëllimeve u jep zë poezia e Nexhatit.

Kur t'i themi këto, do të pohojmë se "Kërcimi i drenushës" ka simbolikë tjetër fare, jo atë të qenies së bukur. Drenusha në lëvizje fizike kalon mbi ylberin. Kjo është qëndresë dhe fitore. Drenusha është personazh shprese.

Kompleksiteti poetik e bën veprën me infrastrukturë origjinale të ligjërimit që është një cilësi e shkrimit modern të autorit.

Oqeani fle, ti larg gjithësisë i prek yjt.
Njëri yll është ëndrra jote syri yt,
Është pika e ujit nga të ik nëpër fyt.
Ja përmbi pemën e krojit sesi bën dritë.

Edhe pas ndonjë episodi lirik në poezi siç është shembulli i cituar, autori kthehet tek kujtimet e rënda për fatin e qytetit, sepse edhe vonë, bajlozat

hedhin topuzat mbi kokat e banorëve, prandaj breznitë vazhdojnë të lagen nga shiu, nga lotë, nga gjaku. Kjo është brengë e pakëputur në shpirtin e poetit.

Ka edhe poezi që na befasojnë, si fjala vjen, "ni lule për nënën" është poezi xherdan i çmuar që flet se nuk duhet nëna me puthje e përqafime tradicionale, por me paisjen e saj me cilësi e gjymtyrë të natyrës, të kozmosit dhe të fuqive të lashta legjendare. Flet për dashuri të madhe për një nënë të gurtë në themelet e Rozafatit. Nuk është dashuri me lule, por me jehonën e hapave të historisë dhe të legjendës që nëna të bëhet monument – përmendore:

"trëndefil në flakë amshimi të Rozafatit"

Disa poezi japin përfytyrim të ngjarjeve kaotike, të apokalipsit, të hapsirës kohore prej lashtësisë deri sot dhe përjetime në forma të ndryshme për fenomenin e rëndë. Dhe këto kataklizma mbyllin në vete dhimbje.

Nyjësimi (hermetizëm) në të kuptuar paraqet edhe poezia "sonte veç ty". Fantazia që e orienton poetin midis botës së gjallë dhe asaj të vdekur, kthen kah optimizmi:

"jo sonte kthehet edhe ajo që ra
Me ritëm të pikës së gjakut në hi"

Po "Kërcimi i drenushës" mund të konsiderohet personifikim i shtojzovalleve apo i zanave të mira që dalin pranë ujërave apo në fushë të logut dhe krijojnë ambient të gëzueshëm. Kërcimi i krijesës mbi ylberin është forcë simbolike që personazhin dhe poetin i bënë ngadhnjimtarë:

"apo pylli i fjalës së pa Thënë
Në syrin tënd zgjon Ulqinin"

Atributi që mund t'i jepet këtij ligjërimi të vargjeve do të ishte i drejtë të kuptohet forcim i egzistencës së qytetit, i cili gjallëron me banorët dhe me reliev të fortë të gurit. Ndoshta mund të jepet edhe supozim tjetër, por i forcuar gjithsesi me optimizëm. Stili i plotëfigurshëm i veprës mundëson supozime e zgjedhje të situatave e të ngjarjeve në më shumë mënyra, kështu forcohet bindja për seriozitetin dhe kualitetet krijuese të autorit. Është e sigurtë se ëndërrimi i poetëve është liri e tyre ashtu sikurse është edhe zgjimi i tyre. Ata me imagjinatë e fantazi i qasen realitetit, i takojnë kategorisë së të saktifikuarve, por e prodhojnë amshimin. Krijimtaria e Nexhat Halimit sajohet nga përvoja e gjatë dhe përpjekjet e pakursyera.

Leximi i kujdesshëm na e forcon bindjen se vepra është kryekëput modern "gjarpëri pa i sy rikthehet mëngjesin detit ia pi". Shifet këtu se kjo krijesë nuk vjen si mik i vatrës me respektin e totemit qysh e konsideron tradita jonë.

Probleme të rënda ende na sjell historia, sepse pas gjarpërit shfaqet Gjergj Elez Alia i vdekur e i nevojshëm për ta forcuar traditën për mbrojtjen e nderit dhe të vendit. Autori plotëson vakume duke hipur e zbritur ëndrrës, po

qëllimi i tij është që pikat e rëndësishme historike ti bëjë pjesë të idealit e të përpjekjeve të sotme.

Në nismën e qëllimeve për ta mbajtur të fortë qytetin ka krahë fshatarin, zejtarin, fëmijët, madje e ka edhe mikun poet nga Ulqini. Lyp qartësuar se nga uniteti kronologjik i përmbajtjes së librit temat e vogla bashkohen me atë për Ulqinin dhe na japin poemën e gjërë kushtuar qytetit. Nuk do mend se dashuria e shprehur dendur në poezi e krijon me arealin artistik mburojnë Ulqinit. Këndohen gjërat që i kanë dhënë jetë Ulqinit: gurtë, ujë, kripa, rrënjët e gjaku.

Pjesë defilimi është vrasja në pabesi e Isa Boletinit, figurës shembull të historisë sonë dhe të zëshmërisë fatlume nga taborri i atyre personaliteteve që erdhën me çilsat e pavarësisë së Shqipërisë. Na freskohet kështu kujtesa për sakrificat e personaliteteve të çështjes kombëtare.

Bashkë me këto qëllime vendeve të molisura në aspektin egzistencë, autori u jep eliksir shëndeti përqendrim në trojet e stërgjyshërve. Në ato fshatra e sheh se po paksohet popullsia. Autorin e ngacmojnë frymëzimet për detin, për barkat që hepohen mbi dallgët e rrezikshme, për drejtuesit e tyre, për kthimet e gëzueshme në brigje. Ai dëshiron fotografi të përbashkët me detin që arsenalin e tij ta ruaj në shpirt. E i dalin përpara kafkat e ndryshkura mbi gjakun e derdhur dhe i mbesin brengë librat e ndaluar. Poezia e Nexhatit lufton t'i mposhtë kotësitë, sepse butësia e zemrës sjell lule në çdo kohë e çdo vend që do të thotë jeta nuk shuhet. E nuk janë të gjitha frymëzimet pa dëshprim. Rruga e pa shënuar, e pa rrahur, e pa gjetur për njëqind vjet është ulurimë e ligjërimit pas gjurmëve të Ymer Paçarizit. Këto fotografi do gjenden e ruhen në brendi të maleve dhe në thellësinë e detit të shënuara me pika gjaku.

Poeti hulumton, ecën e frenohet, po nuk le pa e thënë atë që ia thotë zemra me guxim fizik e moral në çastin e kërkesës së historisë:

Deti dhe dhembja kosovar mbesin njejtë yje

Fatit i rëndojnë bredhjet mërgimtare që ngjanë me bredhjet dhe brengat e Odiseut. I kthyeri flet në gjuhë të huaj në vendin e vet, sepse ikja ia kishte rrëmbyer të gjitha dashuritë.

Bredhjet e poetit prodhojnë shumë pikëllim. Në takimin me Risanin, në rrugën Ulqin – Shkodër shef lot, shi, pika gjaku si të ishin krua mijëvjeçar.

Kudo e gjen forcën poeti për t'i mundur kotësitë.

Poezia kumton me fjalor të pasur. Fjalët: gjak, diegie, ujë, lot, gur, kështjellë, kala, bedena, dallgë, deti, perdet e hekurta, pulëbardhat, zogu, gjarpëri, kali, hardhia, ulliri, fiku, shega, rrugeja, ëndrrat, flaka, pylli, kambanat, shpatat, atdheu, zotim im, thikat, fanarët, antika, kumria, verbëria, robëria e shumë të tjera poetizohen në mënyrën më artistike duke shprehur konotacione të forta, janë të figurshme, domethënëse me vlerë dhe mendime solide.

Personazhet e kësaj lirike, një pjesë janë epike që përdorin ose e nxisin poetin që të flet me naracion interesant dhe origjinal.

Porosia e poezisë është porosi humane: shprehet dashuri e thellë për vendet dhe njerëzit. Shprehet respekt për figurat e ndritshme e të përjetshme në historinë e kombit. Ai na e freskon kujtesën dhe na e forcon adhurimin për të gjitha ato që populli i deshi dhe i çmoi.

Prandaj, jehona e tyre në poezi na vjen e dhemshme, na vjen edhe dashuri forcuese.

Poeti na shkruan, pra, edhe pjesë të jetës dhe pjesë të historisë.

Llojllojshmëria e rimave e strofave, teknikat e tjera të vargërimit, fjalët e vendosura jo me rendomësi ligjërimi por në vendin me kuptim të ri, na bindin për talentin **e pa kontestueshëm** të Nexhatit.

Përmendja e shpeshtë e pikave të gjakut vjen si refren që prodhon qëndresë. Vetëm kështu mund të kuptohet, kursesi dështim dhe kursesi pesimizëm. Forcën e tillë e tregon lidhja e poetit me këtë vend dhe, fundi, dëshira e tij aq e shpeshtë që e përmendë varrin e tij këtu.

Unë nuk heq dorë nga ti Ulqin deti
Pa rënë nga unë çdo gjë deri në hi.

Dashurinë e Nexhatit për këtë trevë nuk ka kurkush të drejtë ta mohoj, sepse vargjet e cituara janë betimi i tij i shenjtë.

Ai i këndon gjërësisht Ulqinit dhe detit dhe bukurive të tij të florinjta.

Ai i këndon Ulqinit e detit dhe plagëve që bartin me shekuj.

Ashtu si iu bashkangjit Tomorrit Çajupi dhe e bëri front të perëndisë, apo sikurse Naimi që bekoi male e fusha të Shqipërisë, apo më vonë Lazgushi që u tret në ujin dritëshkëllyes të liqenit të tij, e ngjashëm edhe Nexhat Halimi njëhsohet me Ulqinin dhe gjymtyrët e tij. Kjo pjesë e viseve është personifikuar e bërë bashkëligjëruese e poetit.

Besoj, është e drejtë të thuhet se këto poezi e ndërtojnë një monument të dashurisë së tij për Ulqinin dhe për njerëzit që jetuan e për ju që jetoni këtu.

Ta themi një urim ngjashëm me thënien e popullit:

Ulqin, me shëndet të qoftë ky gjerdan margaritarësh!

(Recension i lexuar me rastin e përurimit të librit "Kërcimi i drenushës" të autorit Nexhat Halimi. Botoi Diti&Oli, Libraria ARTI, Ulqin, 2016)

Mustafa CANKA

Për librin „Zgjimi“ të autorit Dr.Gani Karamanaga
NDËRLIDHJA E SINQERITETIT DHE PUNËS

Është i mirësepritur mundi i Dr. Gani Karamanagës që para publikut të gjërë të dalur me pamjen lidhur me aktivitetet katërvjeçare gjatë mandatit në krye të Bashkësisë Islame të Ulqinit (2003-2007.) Me siguri, kjo gjë do të hedhur dritë plotësuese në punën e këtij institucioni, dhe do të jet edhe një kontribut i saj për me qenë sa më e hapur para qytetarëve. Pas një kohe së gjatë , këtij institucioni ky drejtim është shumë i nevojshëm.

Për arsye se kjo Bashkësi e vogël ka se me çka me u paraqitur „*urbi et orbi* „(qytetit Ulqimit edhe botës). Më së pari ftyrën e saj të bukur: besimëtarë të vërtet dhe tradiocional, objektet fetare të rregulluara, mesazhat e paqës. Tolerancës dhe mirëkuptimit ,

Dr.Gani, më një durim të lindur , në kohën e kaluar ka dhënë një kontribut të veçant. Ka qenë e nevojshme mirëmbajtja dhe vazhdimësia e jetës fetare, rregullimi dhe rindërtimi i xhamive, duke u takuar dhe me qenë këmbënguls me rrymat të ndryshme të cilat janë munduar që islamin ta kuptojnë ndryshe.

Ndodhjet të më vonshme, e kanë vërtetuar faktin se Dr.Karamanaga ka qenë në rrugë të drejt, çka nënkupton edhe susksesin në punën e tij. E vlerësoji shumë të rëndësishëm ruajtjen e unitetit e Bashkësisë Islame në të gjithë teritorinë e saj.Gjithashtu edhe organizimi i tubimeve shkencore si edhe mbërmbjeve fetare, të cilat ja kanë ofrua qytetarve Ulqinit diturinë fetare dhe ngritur besimin. Këtu do të përmenden edhe mardhëniet e mira me Meshihatin e Bashkësië Islame në Mal të Zi.

Qëndrimet e mira si edhe udhheqësia e vërtetuar me një insitucion të rëndësishëm siç është Shtëpia e Shëndetit e Ulqinit , paraqesin çelsin e suksesit të Dr,Gani Karamanagës.

„ *Punët e mira vlerësohen sipas qëndrimeve të mira* “, ka thënë i nderuari Muhammed s.a.v.s.

Edhe kur është e ditur se shembulli më i mirë është që „*njërzit janë në gjumë“,* kuptohet edhe titulli i këtij libri të Dr.Karamanagës „***Zgjimi“.***

Të zgjohesh për Zotin e dashur, të largohesh prej gjumit të rëndë, prej harresësë dhe të veprojsh sipas këshillave Tij, ta njohtosh këtë edhe botën tjetër , të rikthehej paqën dhe kënaqësinë në zemrënë tënde , lidhjen me Zotërinë e të gjithë botërave. Për këto flet ajeti në suren Sebe (46): „***Thuaj: Unë ju këshilloj ngrituni sinqerisht ndaj Allahut“*** (Sebe, 46)

Unë jam i bindur se Dr.Karamanaga gjatë *zgjimit të vet,* i ka ndihmuar edhe *zgjimit* të disa njërzëve, si edhe të qëndrojnë të zgjuar në BI të Ulqinit.

Kjo libër, njëkohësisht flet për këtë gjë.

Në Ulqin, 9. Janar 2016.

Dr. Stavri TRAKO

PARATHËNIA E LIBRIT ME PROVERBA E RUZHDO AGAJ

Është fat të jesh i pari që të bie në dorë një thesar etnografik i tillë që u qëmtua dhe mblodh për një jetë të tëre nga ulqinaku Ruzhdi Hasanaga. Ishte djalosh Ruzhdiu kur mbaroi studimet e larta dhe u laurua si dr.med.vet. (dr. i medicinës të veterinarisë) Universitetin e Zagrebit - Kroaci dhe u kthye në vendlindje për të punuar në mbrojtje të shëndetit të gjeve të gjalla që mbarështronin bashkëatdhetarët e tij për të mbajtur jetën e kombasve që nuk merrnin rrugët e kurbetit dhe që jetën e tyre e kishin te lidhur me detin dhe tokën e tyre.

Këtij shërbimi ia kushtoi gjithë jetën e tij dhe nuk ka shtëpi dhe sofër bujare të Ulqinit, të Krajës, të Shestanit dhe shumë fshatrave të rrethit të Tivarit e më gjërë ku ofroi dijet dhe ndihmesën e tij që të mos ta ketë pritur dhe ta ketë përcjellë si mikun dhe djalin e vet. Ruzhdiu u mbrujt dhe u formua në dashuri të ndërsjelltë dhe të sinqertë me njerëzit bujar të dheut të tij. Sofrat e shqiptarëve janë jo vetëm mikëpritëse, si askund tjetër ndër fqinjtë e Ballkanit, por dhe shkolla kuvendi ku me fjalë arit përftohen jeta shpirtërore dhe morale, e tërë filozofia e jetës së tyre, të cilën e trashëgojnë gojë më gojë si mençuri popullore.

Të veçantën e këtij thesari etnografik e dallon çdokush që është i interesuar ta ketë në bibliotekën e tij që do t'i shërbejë për të mësuar dhe përdorur fjalën e artë të mençurisë popullore të bashkësisë gjenetike shqipe për të kuptuar se cilës etni i përketë. Është një libër me vlerë për çdo studiues të kulturës dhe gjuhës për të njohur pasuritë etno-kulturore, sintaksore dhe gramatikore të paçmuara që ay sjellë dlirësisht. Çdo mik bujtës në këto sofra dhe troje do ta kuptojë pse ai është i sigurtë te Sofra e shqiptarit që është e Zotit dhe e mikut. Te çdo lidhje krushqie me këta njerëz do të gjejë pikërisht këto fjalë arit që e sigurojnë miqësinë e lidhur me këta njerëz autokton me sjellje, moral qytetar dhe me filozofi jete të admirueshme. Por edhe çdo bir a nip i kësaj bashkësie gjenetike shqipe, e veçanërisht atyre që i përkasin kësaj toke do të gjejnë Edenin e shpirtit të tyre të lashtë që duhet doemos ta përftojnë dhe ta ruajnë në mendjen e zemrën e tyre, se ato janë rrënjët e tyre të lashta, ashtu si i kishin ruajtur edhe ata burra të mençur që ia kanë kumtuar autorit të këtij libri.

Ky thesar do të jetë i sigurt dhe i pa hajnueshëm sa kohë që njerëzit e bashkësisë gjenetike shqipe do ta ndrynë në mendjet e tyre për ta mbrojtur dhe përdorur sa herë t'u duhet. Kur ky thesar i mençurisë popullore s'do të jetë vetëm në biblioteket tona por edhe në mendjet tona as e djeg moti, as e than bora dhe as e lag shiu por, as hajnat s'kanë çfarë t'i bëjnë, sa kohë do jetojmë ne njerëzit e kësaj toke dhe për sa kohë do ta flasin dhe do të trashëgojnë gjuhën e tone të bukur shqipe ndër breza. Po prezantojmë në vijim, për kureshtjen tuaj, shkurtimisht përmbajtjen e këtij thesari me fjalë arit.

- Duhet së pari të jesh njeri i mire që të bëhesh mjek i mirë.

- Nuk ka të ardhme për një komb që nuk njeh dhe nuk respekton historinë e tij.

- Zemra nuk blihet po falet.

- Bukuria kënaq syrin , morali terheq zemrën.

- Kur ta kalosh hendekun atëhere thuaj hopa.

- Këmbanat bien për t'i dëgjuar të gjthë.

- Uji çmohet kur shteret pusi.

- Ku ha miku e shton zoti.

- Më mire i fikun sei koritun.

-Gjuha, kultura dhe historia janë shenja të vetme që kallzojne se kush je.

- Fjala vret me shumë se plumbi.

- Gjuha bashkon kombin dhe ruhet atje ku shkruhet.

- E vërteta ka dy anë është e mire t'i shohësh të dyja anët.

- Zemra nuk plaket kurrë.

- Edhe pula qorre e gjen kokrrën e gruri.

- Nëna edhe në qoftë e keq është gjithmonë nëna jote.

- Nga sofra nuk duhet me u çu edhe në ardhtë dhe mbreti se ajo është e zotit dhe e mikut.

- Mund të bëhesh i pasur por babe dhe nanë nuk gjen dot.

- Martesa është akti më i shenjtë për shqiptarin prandaj i këndohet nuses, atje ku kale këmbët atje të rënçin dhëmbët.

- Para se të martohesh hapi të dy sytë mirë, mbas martese mbylle njërin sy.

- Moralin e fsheh nata pas perëndimit të diellit.

-Është i nemur ai katund ku pulat këndojnë si gjelat.

- Fëmijëve mos u jep pasuri po dituri.

- Të kushton më shtrenjtë gjëja e lirë.

- Kur miku të kthen paratë gëzohu për të se ai është bërë i zoti dhe është në gjendje t'i fitojë vet.

- Si e mira si e keqja duhen pritur me zemërgjërësi jo gjithmonë e keqja vjen për të keq.

- Respektoji ata armiq që t'i thonë gabimet në sy.

- Për zjarr është i mirë druri i lsit për grua zgjidhet vajzë prej fisi.

- Zanati nuk mësohet por vidhet.

- Në politikë nuk ka miqësi ka vetëm inters.

- Kush mbjell erën, stuhi dhe furtunë do të korrë.

- Kjo përmbledhje që shoqëron këtë recension u përgatit: për ty bir dhe bijë e kësaj bashkësie gjenetike shqipe, për ty mik i sofrës bujare etnike për tju siguruar se do ta pasuroni bibliotekën tuaj me një thesar të vogël etnografik, filologjik dhe filozofik të gjenezës shqipe .

Ali LLUNJI

“RRËNJËT”- GANI KARAMANAGA

Kur lexohet dorëshkrimi i Dr.Gani Karamanagës me titull simbolik “Rrënjët” me një frymë dhe shumë lehtë,nuk ka se sit ë mos tualëve ulqinakë të cilët autorit i dhanë zemër ,guxim e shkas t'i rreket në pune obligative dhe morale,të natyrës heterogjene që për t'u realizuar kërkon mundë,përpjekje dhe përgjegjësi.

Ishte nxitja e shkrimtarit Hajro Ulqinaku, me moto dhënë autorit: ”Ty të takon ta shkruash monografinë për familjen Karamanaga”. Dhe pse jo edhe ajo e fuqishme e publicistit Ismet Karamanaga, kur të parafrazohet mendimi i publikuar i tij...:“Të shkruhet libri monografik për familjen Karamanaga që detin dhe lundrimtarinë e pati profesion jetësor...”.

Gani Karamanaga,primarius në kohët tona edhe publicist ,na delprën e tij të gjashtë “Rrënjët”.Në të,objekt studimi dhe prezantimi të denjë,ka familjen e styrgjyshërve të tij, Karamanaga, patronim ky me jetë shekullore në Ulqin dhe më gjërë. Autori është gjetur në rrugët me disa dilema ,kur kredhe filleve të rrënjës familjare: nga Xhamia e Plumbit-Shkodër apo në lagjet e ndryshme buzë detit dhe së fundi në zemrën e Kalasë mijëravjeçare të Ulqinit?!

Ka diçka në dilemën e parë të rrugës, por kur vendosë të elaborojë se ku jetuan dhe me çka u morën pjesëtarët më të herëshëm dhe të tanishëm të kësaj familje detare dhe ullishtare ,nuk ka më dilemë,veç se fakti që familja Karamanaga nga fundshekulli XVIII e këndej, në mbyshtetje të dokumentave zyrtare është ulqinake.Jetën e saj e zhvilloj në disa lagje buzëdetare. Liman, Meteriz dhe nguliti në Kalanë e Ulqinit. Autori nuk i shmanget as intervistave dhe provave marrë e bërë me të moshuarit e pjesëtarëve të familjes Karamanaga e as atyre që kanë lidhje farafisnore të ngushta me këtë familje detarësh. Por është edhe koshient në këtë rast, kur konstaton në parathënie se...”Autori që shkruan monografi për familjen e tij, nuk mund t'i shmanget subjektivitetit...”.

Në materialet e shkruara të tij nuk ka emocione ,por ka rrëfime të sakta,që,herë-herë, me muanca nostalgjie për jetën e rëndë dhe të vështirë të detarëve Karamanagas. Dhe nuk është e papritur që vepra e Dr.Gani Karamanagës ka në vertebër detin, lundrimet, peshkatarinë dhe ullishtarinë, lloze këto nga gjallëruan dhe mbijetuanë familjartë e tij të parë.Përkrah tyre qëndron njeriu i fesë ,imam në disa xhami ulqinake-gjyshi i autorit. Pra,krahas erërave të rrezikshme detare, velave, rremave, tratkave, shkon edhe leximi i Kur'anit, zë përdorin të mësuarit në mejtepe dhe lexim-shkrimi me alfabete të ndryshme të kohës.

Lënda e shtruar me akribi na bën të mundshme të kuptohet thellësia e veprimtarive jetësore të pjesëtarëve Karamanaga, gjithnji në konteksin e

rethanave historike të shekujve më dramatikë për qytetin e lindjes së tyre –për Ulqinin. Këtë e shoqërojnë një det dokumentesh të shkruara në gjuhët me alfabet arabo-osman dhe kroato-malaziase. Ilustrimet e shumta fotografike, janë edhe një plotësim më shumë e bindës që nga fillimi i shek.XIX e deri në këtë XXI.

Gjeneratat më të vjetëra dhe shtyllat qendrore të ditëve tona, apo të mëvona të familjes Karamanaga, janë objekte të pomohueshme për të cilat shkruan autori, Dr.Gani Karamanaga. Padyshim që të gjitha këta të gërshetuara rrjedhshëm, vetëvetiu flasin për punën e palodhshme vetëmohuese, për guximin, durimin dhe akribinë në ndriçimin dhe sistemimin e kësaj materie interesante të autorit.

Familja e tij, Karamanaga, ndër më të mëdha të me pjestarët të saj,të shpërndar kryesisht në Ulqin, aq edhe pak në Tivar e Shkodër e ka ndihumar dhe vulosur lashtësinë e krahas saj, së bashku me shumë familje të tjera ulqinake, ndërvedi të lidhura, u përpoq të ruaj dhe të mbrojë identitetin e vetë kombëtar.Autorit i dëshiroj shëndet duke i uruar punë të sukseshme e dobiprëse.

Asllan BISHA

DETI - FRYMËZIM, DETARËT E PESHKATARËT – DËSHMI

Shkrimtari Ulqinaku i bëri artikuj, portrete, për të vënë në pah punën e tyre, për të shpëtuar nga harresa veprën e tyre. Ai skaliti portrete në fjalë, pa ndryshuar gjë, pa shtuar, E çka t'u shtosh këtyre kolosëve, ujqve të detit, që i rritën zulmin Ulqinit të lashtë, traditës e detarisë?" Fatkeqësisht kjo traditë u zbeh, por nuk u shua, sepse deti dhe dashuria për të është ende në zemrën e Ulqinakut. Dhe tradita – shkruhet... Këta ujq të detit janë përmbledhur në libër, edhe pse numri i detarëve dhe kapitenëve ulqinakë është i madh. Është shkruar dhe janë përmendur edhe në libra të tjerë, sepse lashtësia, tradita ulqinake, nuk mund të përmblidhet në një libër. Ajo është e madhe. Pjesa tjetër e këtij libri është ajo e peshkatarëve, e njerëzve që derdhën djersë për të fituar bukën dhe, rrahin detin edhe me shirok edhe tramontanë. Ata vazhdojnë zejen e vjetër sa dhe bota, peshkimin. Dhe peshkimi është preokupim i shkrimtarit H. Ulqinaku, në fëmijërinë buzë Rane, në dashurinë për të zënë peshkun e madh, atë peshkun e Hemingvejit. H. Ulqinaku me dashuri të rrallë dhe përkushtim shkruan për peshkatarët ulqinakë...

Libri i shkrimtarit H. Ulqinaku është risi dhe dëshmi për detarët dhe peshkatarët ulqinakë. Ka vlerë, prandaj lexohet me një frymë. Është shkruar me dashuri për njerëzit e vendlindjes. Ata hynë në historinë e lashtë të këtij qyteti, ndërsa shkrimtari i futi në libër – për t'i bërë të pavdekshëm

Zuvdija HOXHIQI

Per botimin e librit ”NGA KËRKIMET DHE HULUMTIMET NË ARKIVIN E BIBLIOTEKËS SË ULQINIT” - të autorit Fadil Kroma

Fadil Kromën, dashamirin e librit, punëtorin e dalluar shoqëror dhe kulturor e njoh prej kohësh po thuajse që para 5 dekadash. Më së miri e njoh si punëtor dhe drejtor të bibliotekës në Ulqin në krye të së cilës ishte qysh nga viti 1967 e deri me 1984. Gjatë kësaj kohe këtë institucion me librat e saja të gjetura ose madje më mirë do të kishim thënë të burgosura 2000, ai e pasuroi me 60.000 tituj të rinj, në gjuhën serbokroate dhe në gjuhën shqipe përmes botimeve periodike, publikimeve, revistave, etj... Dhe para së gjithash duke formuar fondin krijues të vedlindjes për Ulqinin, historin e tij me të shkuarën e bujshme, të tashmen dhe personaliteteve të dalluara që lidhen me një material të pa zëvendësueshëm për të gjitha ata të cilat merren me Ulqinin. Bëri edhe mbledhjen e materialit në gjuhët e huaja duke e përpunuar dhe e rregulluar atë. Fadil Kroma, këtë e arriti duke punuar po thuajse ditë e natë me afshin e dashamirësit, por me një përkujdesje dhe përkushtim shumë të madh duke u lidhur me institucione të llojit të vet si dhe me persona të veçantë e gjithë të tjerët të cilët i mahniteshin punës së tij duke e përkrahur për këtë.Ai bibliotekën e ”shëndroi” jo vetem ne ”shtëpi të librave”, me kushte teknike të dalluara për punë, por në një institucion unikat të kulturës, në të cilën rregullisht mbaheshin mbrëmje letrare, promovime dhe ekspozita të artit, mbrëmje të muzikës serioze, recitime, takime të letrarëve të rinj, konkurse dhe simpoziume. Kurse në atë ishin mysafir akademikë të njohur si Llalliq, Kostiq, Vukoviq, Asanoviq e deri te ata të cilët në të ardhmen do të shohim se bëhen emra të perveçëm të kuklturës malazeze dhe shqiptare. Që libri të binte në duart e lexuesve, kryesisht te të rinjve dhe më të rinjve bëri më shumë se të tjerët. Ai pati sukses në këtë çështje.Pak biblioteka ne Mal të Zi do të mund të krenoheshin me shërbimet që ka ofruar dhe ofron ashtu si biblioteka e Ulqinit.

Për punë të këtilla nuk munguan as falenderimet e shumta dhe të rëndësishme nga – Shoqata e Bibliotekistëve të Malit të Zi, bashkësive kulturore të arsimit, ShKA-ve, nga qyteti i Ulqinit, Biblioteka e Cetinës, Tivarit, Kosovës, Shqipëris dhe institucioneve të rëndësishme tjera. Edhe para se të shkonte në pension, fadil Kroma kish filluar të mbledh material për institucionin të cilin ai e kryesonte. Prej ditës së themelimit e deri në ditët tona, kur biblioteka e Ulqinit , shenon një jubile jo të përditshëm 130 vjetorin! Kështu me kalimin e kohës u formua edhe ky libër të cilin autori me modesti e quajti ”Nga kërkimet dhe gjurmimet në arkivin e bibliotekës së Ulqinit” edhe pse fjala është për monografi të llojit të vet. Deri me tash e vetmja, por jo për këtë edhe më të mirës. Duke e ditur rëndësin që ka më mirë se askush ai vendosi ta botoj. Për këtë kuptohet se është e nevojshme kontributi financiar. Duke e vlerësuar se për çfar vepre është fjala (dhe duke i ditur edhe rrethanat në Ulqin), jam i bindur që fondi i pakicave do të ndaj mjete për botim. Këtë sa ia kemi borxh vetes edhe neve, ia kemi edhe këtij njeriu modest por në fakt njeri i madh.

Ardita RAMA
Udhëheqëse e Bibliotekës Popullore – Ulqin

BOTIMIN E ANTOLOGJISË *Merre hisen tënde të diellit* nga përzgjedhësi HAJRO ULQINAKU

Veprimtaria e Hajro Ulqinakut ka lënë e po lë gjurmë me vlera të pamohueshme në letërsinë shqipe. Një bibliotekë, qoftë publike, qoftë private, nuk mund të paramendohet pa librat e tij për fëmijë, e jo vetëm. Mjafton vetëm të përmendet emri i tij dhe menjëherë të kujtohen aventurat e fëmijëve të detit, margaritarët e guacat, piratët e peshkatarët. Mirëpo, Hajro Ulqinaku nuk është vetëm shkrimtar për fëmijë. Në veprimtarinë e tij shumëvjeçare letrare spikaten edhe antologjitë e shumta, me poezi e prozë kushtuar tematikave të ndryshme, të përmbledhura aq bukur, ashtu siç di vetëm ai.

Edhe libri i tij i radhës, që e ka përgatitur për botim, është Antologjia me titull *Merre hisen tënde të diellit.* Është përmbledhje e poezive dhe prozave më të bukura në revistën *DIJA*, nga shkrimtarët e njohur jo vetëm shqiptarë, por edhe nga letërsia botërore. Gjejmë këtu: Naimin, De RDËN, Podrimjen, Arapin, Çapriqin, Krajën, Kiplingun, Tagoren, Nerudën, Preverin, Asanoviqin, Nikolaidisin e shumë të tjerë. Ulqinaku nuk e ka pasur të lehtë të përmbledhë një antologji të tillë. Duhet shumë mund e dije, kohë e njohuri, përkushtim dhe profesionalizëm të seleksionosh e të radhitësh autorë e vepra, nga një opus shumë i gjerë i letërsisë botërore. Vetë fjala *antologji* do të thotë *mbledhje e luleve më të bukura*, pra *përmbledhje e më të bukurave*, prandaj mendimi im është që edhe kësaj radhe Ulqinaku arrin të krijojë një vepër, e cila menjëherë do të gjejë rrugën te lexuesi dhe që padyshim do të jetë edhe një perlë në veprimtarinë e gjerë të tij dhe të letërsisë në përgjithësi. Këtë e them jo vetëm të bibliotekave, por në radhë të parë si librofil, që ndër librat e parë që kam lexuar kanë qenë librat e Hajro Ulqinakut, ndërsa sot me kënaqësi lexoj dhe mbaj në raftet e bibliotekës antologjitë e përzgjedhura nga ai.

Hajro ULQINAKU

MERR PERLA

Antologji është fjalë e madhe. Të bësh një antologji do të thotë: të bësh një *përzgjedhje* të autorëve dhe të veprave të tyre kulmore, të bësh një kryevepër. Edhe radhitja duhet të jetë rigoroze, sipas vlerave letrare.

Ashtu është në teorinë, estetikën letrare...

Të mësojmë, së pari, kuptimin e fjalës *antologji*.

Mikel Ndreca, në *Fjalorin e fjalëve të huaja*, e jep shpjegimin: *antologji, - a* – vjen nga dy fjalët greke: *anto* – lule dhe *lego* – mbledh, zgjedh, që do të thotë - lule.

Lazar Vujaklija në *Leksikon stranih reči i izraza*, shpjegon shkurt: greqisht: *mbledhje e luleve më të bukura*.

Në versionin elektronik, leksikografi eminent, e jep shpjegimin e zgjeruar:

Antologjia (greq. *anthologia*) mbledhje e luleve, lulishte; përmbledhje e këngëve, sidomos, lirike; në përgjithësi: përmbledhje e të gjitha pjesëve të zgjedhura sipas kritereve të caktuara; përmbledhje e më të bukurave.

Kjo *Antologji* është: përmbledhje e poezive dhe prozave më të bukura - të botuara nëpër faqet, numrat e kaluar të revistës sonë "DIJA".

Si mbledhtaret që nxjerrin kokrrat e arta të ullinjve nga ferrat e akulli, me ditë e vite, qëmtova e vola dhe e mbusha këtë shportë me margaritarë letërsie: nga krijimtaria më e zgjedhur: shqiptare, e popujve të Ballkanit dhe ajo botërore.

Këtu janë: De Rada, Naimi, Mekuli, Ujko, Di Magjo, Arapi, Camaj, Zhiti, Podrimja, Shkreli, Apoloni, Vinca e Çapriqi; Zogoviqi, Sijariqi, Matoshi e Ratkoviqi; Sapfo, Kiplingu, Tagore, Neruda, Kavafisi, Preveri, Brodski e Grasi; Ndoc Nikaj, Migjeni, Kraja, Kollari e Bisha; Asanoviqi, Jovan e Andrej Nikolaidisi, Hoxhiqi - Berisha... etj.

Bien në sy akademikët, spikasin nobelistët...

Poezitë dhe prozat këtu janë të *përzgjedhura*.

Edhe autorët, pra, janë *të seleksionuar*.

Këtu nuk ka zënë vend ndonjë (shumë) autorë, shkaku është se nuk kanë qenë prezantuar në "Dije".

Edhe pse, një kaçile, sado e madhe qotë ajo, nuk mund t'i zërë të gjtha kokrrat e arta që i mbledh...

Unë shpresoj se kjo *Antologji e "Dijes"* do të pëlqehet nga lexuesit.

Kështu qoftë!

Unë mblodha, ti zgjidhi perlat që të pëlqejnë dhe mbushe sepetin tënd.

Libri

Mr. Haxhi SHABANI

PROBLEMET E LIBRIT SHQIP NË MALIN E ZI ORIGJINA, BOTIMI, NJOHJA, INTEGRIMI

Tri probleme themelore ka libri shqip në Malin e Zi: problemin e botimit, qarkullimit dhe njohjes edhe pse në trevat ku jetojnë shqiptarët, ka dëshmi të rëndësishme se libri i shkruar në gjuhën shqipe ka origjinën e tij.

Origjina

Libri në gjuhën shqipe në trevat shqiptare që sot janë në kuadër të Malit të Zi ka një origjinë të hershme dhe fillestare të tij. Vetëm po të përmndim tre fakte të rëndësishme të historisë së lashtë të shkrimit të shqipes siç janë: Dëshmia e atë Brokardit e vitit 1332 (Tivar) për ekzistimin e shqipes dhe shqiptarëve të cilat kanë një gjuhë të ndryshme nga latinshtja por që përdorin këtë alafabet, pastaj Fjalorthi i Arnold fon Harfit në vitin 1497 (Ulqin) dhe më në fund libri i parë në gjuhën shqipe Meshari i Buzukut 1555 për të cilin besohet se mund të ketë qenë nga ndonjë katund i Tivarit apo Ulqinit, dëshmojnë qartësisht se libri i shkruar në gjuhën shqipe në këto zona ka fillet e origjinës së tij. Edhe vazhdimi i prezencës së tij të shkruar, ndonëse njeh periudha shterpe, është ekzistues si: me autorët, përkatësisht librat e tyre, fjalorët apo përkthimet (duhet përmendur emrat si Ali Riza Ulqinaku, Hysejn Bushati-Ulqin dhe vëllezërit Ivanaj-Tuz).

Botimi-qarkullimi-integrimi

Prezenca e librit shqip te shqiptarët në Malin e Zi, duke pasur një histori të vonshme të tij nën censurë (gati gjatë një dhjetëvjetshi 1981-1990) dhe herë-herë edhe të ndjekur, ka shkaktuar pikërisht absurdin që një popullatë, siç janë shqiptarët në Malin e Zi, të humbë kontaktin me librin shqip në gjuhën amtare, në ato përmasa që nënkupton botimi, qarkullimi, njohja përkatësisht komunikimi normal i libirt si mjet themelor i kulturës për lexuesit e këtushëm. Kjo duket paradoksale, por është reale. Në mjedise të këtilla, në të cilat siç dëshmon historia e librit shqip, mund të ketë lindur, ai ka rënë deri në atë nivel sa është mohuar nga shtresa të caktuara të vetë popullatës shqiptare. Nëse kjo situatë mund të arsyetohet në sistemin e kaluar monist deri në vitet e nëntëdhjeta të shekullit të shkuar, atëherë duket jo normale, që ajo vazhdon në njëfarë mënyre edhe pas 25-vjetëve sistemi shumëpartiak. Kjo duket vërtetë kështu, por nëse shikohet gjërat më thellësisht, atëherë edhe sa i përket librit dominon një logjikë e tregut të mallrave: sa më pak e ke një gjë, aq më pak ke nevojë që ta kesh.

Po të merret një krahasim sipas këtij modeli, ai i konsumimit aktual të Coca-Colës nëpër familjet tona, ajo pihet dhe konsumohet aq shumë, jo për faktin se nuk e dimë se ajo nuk është e shëndetshme , por për faktin se e kanë dhe e servojnë të gjithë në tryezat tona dhe nuk është aq e dëmshme. Libri shqip, ndërkaq është konzervuar nëpër biblioteka (e vetmja librari, në të cilin kishte edhe libra shqip, mbyllet vetëm pas disa vjetëve sepse s'është rentabile). Librat më të rinj që i kanë këto biblioteka janë të viteve të tetëdhjeta të shekullit të kaluar, me përjashtim të dhuratave që Biblioteka e Ulqinit merr herëpashere. Ndërkaq, libraritë në trevat shqiptare në Malin e Zi që shesin fletore e stilolapsa, materiale zyre e çfarë jo, librin shqip ose e kanë raritet, ose s'e kanë fare.

Duket pak paradoksale, por disa nga njerëzit që krijuan partitë politike shqiptare që ishin ankuar se shqiptarët në Malin e Zi janë të diskriminuar edhe për shkak të censurimit të librit shqip, kur arritën në pushtet, po për këtë libër nuk ndajnë fonde të veçanta financiare.Gjatë këtyre 25-vjetëve pluralizëm, kur ka me dhjetëra shtëpi botuese në Shqipëri e Kosovë, të cilat kanë botuar me mijëra tituj dhe kur ka edhe ndonjë botues në shqip në Malin e Zi, siç është Art Club-i dhe kur së paku juridikisht embargoja ndaj librit shqip në Malin e Zi është hequr, fondi libror edhe bibliotekat në Ulqin, por sidomos në Tuz, Plavë e Guci është pasuruar minimalisht. Si rezultat i këtyre rrethanave, por edhe i konkurencës së internetit nuk është e papritshme që numri i lexuesve në Ulqina po Tuz ka rënë në dhjetëra lexues. Nëse përjashtohet organizimi i panaireve të librit në Ulqin, libri në gjuhën shqipe në këtë qytet shitet vetëm nga ndonjë shitës ambulant.

Teza se media e shkruar, televizioni apo së fundmi interneti, janë mjetet kryesore të marrjes së kulturës në botën e civilizuar është tejkaluar me kohë, duke përfunduar se këtë rol e ka pasur dhe do ta ketë libri. Në këtë drejtim nëse kemi të drejtë të kërkojmë që të krijohet një shtëpi për botimin e librit shqip financuar nga qeveria e Malit të Zi që janë mjete edhe të takspaguesve shqiptarë, atëherë pse nga komuna e Ulqinit nuk krijohet fondi për mbështetjen e librit. Funksioni i këtij fondi që do të krijohej përmes taksës së librit do të ishte jo vetëm për botimin e librit shqip në kuptimin e qarkullimit të tij nga qendrat shqiptare në viset shqiptare në Malin e Zi, por edhe anasjelltas. Kështu, do të mund të fillonte edhe zgjidhja e problemit të pranisë së përheshme të librit shqip, e jo të pritet panairi siç pritet shkuarja në det e kontinentalistëve njëherë në vit. Në anën tjetër, shkrimtarët që shkruajnë librin shqip në Malin e Zi nuk do të kishin nevojë të marrin rolin e lutësve për mëshirë për të botuar librat e tyre.

Doc. Arjeta FERLUSHKAJ

SFIDAT E LEXUESIT SOT

(Në aktivitetin "*Libri, udhërrëfyes në jetë*")

Çdo libër ka një destinacion individual. E konceptuar me këtë intuitë, libri duhet të ishte më afër lexuesit, si kushtim por edhe si receptim. Mirëpo ajo çfarë i ndan apo i bashkon është leximi si proces. Në funksion të temës së këtij aktiviteti, do të flasin duke u nisur nga përvoja, duke shmangur me dëshirë teorizime apo fjalime krejt larg realitetit, për të cilët jemi dëshmitarë që bëhen në shumicën e takimeve të tilla.

Së pari, ne duhet ta pranojmë: po lexohet gjithnjë e më pak. Pse? Çfarë po ndodh? Nëse më përpara, rruga për të shkuar deri tek libri ka qenë realisht me shumë ndalesa, pra mjaft e gjatë, sot ky proces është i realizueshëm më lehtë, më shpejt. Asnjëherë nuk ka pasur kaq shumë mundësi ekspozimi apo përhapje të librit sa ka sot, mjafton të përmendim rrugën e rrjeteve virtuale. Por sërish po lexohet pak. Ndaj dhe strategjitë duhen dryshuar e përshtatur sipas gjendjes aktuale në të cilën po rreth-rrotullohemi të gjithë.

Mendojmë se janë disa sfida që duhen kapërcyer:

Sfida e parë: Si të shkojë lexuesi tek një libër i mirë? Lexuesi gjendet tashmë mes një mori burimesh prej nga ku merr produktin letrar dhe krijohet tek ai gjendja e çorientimit. Ashtu si mund të ketë libra me cilësi botimi ndër më bashkëkohoret por me vlera estetike-letrare të dobëta, po ashtu tek ne po ndodh edhe dukuria tjetër: biblioteka të tëra personale (cilësore) të disa personaliteteve i gjejmë të ekspozuara në "*vitrinat e trotuarit*" (shitjet në trotuare).

Duke lexuar vepra të dobëta, duke iu larguar kënaqësisë estetiko-shpirtërore që fitohet gjatë leximit të një vepre të mirë, po ndodh që të humbasim lexues; numri i tyre po pakësohet ose përndryshe, po rritet ndjeshëm keqleximi. Prandaj, një punë e mirë e kritikës letrare në këtë drejtim do ta zbuste çorientimin e krijuar.

Sfida e dytë: Zhvillimi global i teknologjisë dhe lehtësia e informimit përmes televizionit dhe internetit, ka bërë që sidomos brezi i ri (meqënëse ky brez duhet të jetë fokusi ynë) t'i largohet librit. Ka ndryshuar forma e të lexuarit-thonë disa. Përderisa edhe nga stafet akademike universitare kemi konstatime mbi rënien e të lexuarit, do të thotë se as kjo formë e re leximi (on-line) nuk ka ndikuar tek të rinjtë që të lexojnë më shumë. Pra mbetet që të gjejmë rrugë se si të sensibilizojmë të rinjtë t'i rikthehen leximit në letër, i cili fal një ndjeshmëri krejt tjetër krahasuar me atë çka na fal ekrani i një kompjuteri.

Sfida e tretë: *Si duhet lexuar sot një vepër letrare?*

Në kohët e sotme, është në 'modë' letërsia postmoderne. Nëse shpesh ndeshim libra komercialë, një vepër letrare postmoderne prezantohet si një sfidë për

lexuesin. Ajo shpall sfidë sepse i kërkon lexuesit të vet të jetë një bashkëpunëtor në krijimin e veprës më shumë se sa të jetë një konsumues/lexues pasiv. Pra, ka ndodhur një përmbysje e marrëdhënies "klasike" mes shkrimtarit dhe lexuesit: i pari nuk konsiderohet më "gjeniu" krijues kurse i dyti nuk është një receptues i thjeshtë. Ky lexues sfidohet vazhdimisht nga pyetje që duan përgjigje mirëpo për të mbërritur tek përgjigjet duhet lexuar, sepse sot ne jemi në kohën e letërsisë "së tejmbushur", ku brenda saj gjen vend dokumentari, gazetaria, historia, mitologjia, kinematografia, shkenca etj. Mirëpo, sa janë të predispozuar lexuesit të ndjekin këtë lloj letërsie dhe a ka ndikuar kjo letërsi që të bëhet më e dashur për ta apo e kundërta?
Është e vërtetë që një libër i mirë gjen gjithnjë lexues por ka rëndësi edhe që ne t'ia lehtësojmë lexuesit rrugën që e çon tek libri. Le të mos jetë më leximi një pasion i konsideruar si 'jashtë kohe' por, një hobi i së tashmes dhe i së ardhmes si dhe një domosdoshmëri e përditshme.
Lind pyetja, si ta bëjmë të mundur këtë?
Për të gjitha sa thamë më sipër, mendojmë se një rol të rëndësishëm luajnë aktivitetet promovuese, organizimi i orëve letrare por vetëm përmes aplikimit të procesit të të lexuarit. Fragmente romanesh, tregime, poezi etj., mjafton që të lexohet. Vetëm kështu, të rinjtë nxisin njëri-tjetrin dhe rritet dashuria për librin dhe rrjedhimisht dëshira për lexim.
Duke shmangur leximin si detyrim dhe duke i mëshuar më fort leximit si kënaqësi- kjo strategji na ka rezultuar e suksesshme krahasuar me të tjerat që kemi provuar vit pas viti në bibliotekë. Sepse, ne kemi dy kategori lexuesish për të cilët duhet të kujdesemi:

1. *Lexuesin e pranishëm*: lexues që e gjen vetë rrugën për tek libri. Ndaj tij, ne duhet të kemi kujdes që t'ia realizojmë pritshmëritë dhe ta rrisim nivelin e bashkëpunimit dhe komunikimit me të në prani.
2. *Lexuesin në mungesë*: lexues që ka nevojë për motivim dhe orientim. Ndaj tij, ne duhet të zbatojmë strategji se si ta nxisim të bëhet, fillimisht frekuentues i sallave të leximit në bibliotekë (edhe i librarive etj.) e më pas të bëhet një lexues i rregullt dhe i paisur me vetëdije përzgjedhëse për librin.

Fundja, këtë mision duhet të ketë një bibliotekë: të rrisë numrin e lexuesve por sidomos të rrisë mendjet e tyre e kjo kurrsesi nuk mund të bëhet më mirë sesa përmes dialogut me letërsinë, përmes dialogut me librin.

Tuz, 23 prill 2016

Dorian KOÇI
ZvDrejtor i Muzeut Historik Kombëtar

RRUGËTIM DREJT EVROPËS PËRMES LIBRIT

Ndër qytetërimet e lashta shquan qytetërimi antik greko-romak, trashëgimia e të cilit është një nga faktorët bashkues të Evropës së sotme. Pikërisht në këtë adhurim të vetive dhe cilësive të qytetërimit greko-romak, i ka rrënjët dhe mendimi evropian i Rilindjes dhe Iluminizmit gjatë së cilit u konceptua dhe artikulua ideja e Evropës së Bashkuar. Në këtë mënyrë ideja evropiane e Ballkanit, brenda së cilës gjallon dhe Ideja evropiane e shqiptarëve, qëndron në thelb të artikulimit të gjithë ideve të mëvonshme të ndërtuar gjithandej nëpër kontinent. Gadishulli Ballkanik është në fakt djepi i idesë së qytetërimit evropian. I ndodhur në kryqëzimin e rrugëve Lindje-Perëndim ai u bë shumë shpejt një nga kryeqendrat kryesore të shkëmbimit të këtyre kulturave duke reflektuar në këtë mënyrë jo vetëm diversitetin e tyre por dhe rrafshin gjeografik dhe politik ku ato u ngjizën për tu bërë një. Është interesant fakti se sëbashku me fillimin e këtij qytetërimi të shkëlqyeshëm, të cilit vazhdimisht do ti referohen dhe në shekujt e mëvonshme mendjet më të ndritura të njerëzimit, lind dhe ideja e qytetërimit evropian dhe së bashku me të merr rrugë dhe ideja e një qytetërimi mbarë evropian.

Në gjithë këtë rrugëtim që ideja e Evropës dhe qytetërimi evropian kanë evoluar duhet theksuar fakti se lindja e kësaj ideje i korrespondon dhe të gjitha fakteve dhe etapave historike që kaloi ai që ne të gjithë e quajmë qytetërim evropian dhe historia e këtyre territoreve. Kështu në ravijëzimin e tij mund të dallohen të qartë etapa proto-helenike dhe helenike, romake, krishterimi dhe mesjeta, iluminizmi, revolucioni francez dhe nacionalizmi. Në varësi të këtyre etapave historike dhe fakteve është sendërtuar dhe ideja e qytetërimit evropian të Ballkanit duke reflektuar jo vetëm shkëlqimin e qytetërimit të tij në periudhën helenike por dhe degradimin e qytetërimit të vet në epokën e fundit të qytetërimit bizantin apo kur Ballkani shndërrohet në një territor përleshjesh midis Krishterimit dhe Islamit në kacafytjen e tyre tragjike në shekullin XV kur shfaqet për herë të parë në Ballkan, Perandoria Otomane si formacion politik por dhe entitet kulturor i veçantë nga ai evropian.

Për herë të parë sidomos në brigjet e Adriatikut lindor do të kemi dhe krijimin e qyteteve republika të cilat do të kenë një tregti të zhvilluar por dhe statuset e tyre shumë të rëndësishëm për qeverisjen e qyteteve por dhe për të rregulluar marrëdhëniet me jashtë dhe të shtetasve të tjerë me qytetet. Këto statute janë të ngjashme me ato të qyteteve italiane dhe një pjesë të madhe zë koncepti i lirisë së qytetarëve dhe administrimi kolegjial i tyre nëpërmjet një këshilli të zgjedhur të përbërë nga qytetarët më të shquar. Po kështu familjet fisnike shqiptare fillojnë të mbajnë anale dhe kur botohen veprat e tyre më vonë si ato të Engjëllorëve p.sh një familje fisnike shqiptare nga Drishti, origjina e tyre do

të jetë e lidhur gjithmonë me trashëgiminë greko-latine dhe legjenda të frymëzuara nga ngjarjet e mëparshme në rajon.[2] Ky tipar është shumë i rëndësishëm pasi përcakton përkatësinë i identitetit që këto familje fisnike ndjejnë por dhe sepse ato përfshihen në afërsinë midis tyre dhe familjeve të tjera evropiane duke përforcuar kështu idenë evropiane të rajonit që zë fill nga miti i lashtë i Evropës por që ushqehet rrugës dhe me mite të rinj.

Kështu p.sh heroi kombëtar i shqiptarëve Gjergj Kastriot Skënderbeu(1405-1468) në letrën që i dërgon princit të Tarantit i përmend origjinën e vet, atë epirote dhe përmend një personalitet të botës antike si Pirron e Epirit. Po kështu Gjon Muzaka në veprën e vet "Gjeonalogjia e Muzakajve"(1510) përveç burimeve të shkruara që ati zotëron dhe citon në vepër, përmend së familja e tij vjen nga Molosia, krahinë e vjetër e Epirit e lidhur shumë ngushtë me emrin e Pirros së Epirit[3].Natyrisht që kontakti kulturor që pati Adriatiku lindor me botën perëndimore qoftë nëpërmjet shkëmbimeve kulturore në të dyja anët e Adriatikut por dhe nëpërmjet administrimit të drejtë për së drejtë të territorit si është rasti i Mbretërisë së Arbrit(1272) nën familjen e njohur fisnike franceze Anzhuinët, por dhe administrimi qyteteve nga Venediku krijuan një perceptim tjetër për idenë e Evropës dhe shtrirjen e saj, në dallim nga provincat e tjera të Perandorisë bizantine ku nuk shikojmë fenomene pasi janë më thellë në gadishull dhe nuk kanë mundësinë që të marrin pjesë në perceptime të tilla të drejtë për së drejta. Ndaj në këtë kohë , fillimet e shekullit të XIV dhe shekullin e XV në brigjet e Adriatikut Lindor do të kemi përjetimin e një lëvizje humaniste që do të jetë shumë afër Rilindjes Evropiane. Kjo lëvizje do të ketë një konceptim të qartë të idesë së Evropës, unitetin gjeografik dhe atë moral dhe kulturor ku për herë të parë do të ketë kontakte dhe me prurjet e reja si Polonia, Transilvania dhe deri Anglia.

Kjo gjë do të vërehet më shumë sidomos gjatë konfliktit traumatik me osmanët , konflikt që largon territoret e Ballkanit për mëse tre shekuj nga ideja e Evropës dhe projektet rreth saj. Epopeja e madhe e Gjergj Kastriot Skënderbeut , përveçse ndikimeve gjeopolitike që pati në rajon ka meritën se solli në vëmendje të Perëndimit , nëpërmjet thirrjeve për ndihmë krijimin e aleancave dhe mobilizimin kulturor, moral dhe fetar ndaj osmanëve që po mundoheshin nëpërmjet pushtimeve të ashpra të asimilonin brenda perandorisë së tyre këto territore. Në Arbëri, ku bëhet rezistencë zbarkojnë vullnetarë dhe trupa ushtarake napolitanë, katalanë, gjermanë dhe anglezë të gjithë të përbetuar për të luftuar osmanët dhe për të mbrojtur Evropën dhe krishterimin. Edhe pse numri i tyre nuk është i përfillshëm për të ndaluar valën e pushtimit otoman, letrat dhe kancelaritë që përfaqësojnë, idetë dhe kulturën që sjellin bëjnë të

[2] P.Petta, Despoti d' Epiro e principi di Macedonia, Lecce, 2000, fq 211-214, O.J.Schmitt, Skënderbeu, Tiranë, 2008, fq 483.

[3] Kronika e Gjon Muzakës në P.Xhufi. Nga Paelologët te Muzakajt. Shtëpia Botuese 55, Tiranë, fq 423

mundur që ideja e Evropës të konkretizohet nëpërmjet aleancave të ndryshme që ata i kërkojnë Papës së Romës për të udhëhequr kundër osmanëve . Vetë, udhëheqësi shqiptar, Skënderbeu është i ndërgjegjshëm se vepron në mbrojte të Evropës në gjithë korrespodencën që ai ka me princat evropianë por dhe ata vetë nuk mënojnë ta njohin kontributin e tij në këtë përpjekje fatale. Papa i Romës e shpall atë Atlet të Krishtit, kurse i dërguari special i Papës , kalorësi anglez John of Neëport do ti shkruajë atij se e vetmja rezistencë serioze ndaj osmanëve ishin shqiptarët dhe se po të binte kjo fortesë, atëherë shumë shpejt ata do të ishin në Itali. Librat, "Rrethimi i Shkodrës" dhe "Historia e Skënderbeut" nga Marin Barleti janë pasqyrë më e mirë sesi ideja evropiane e arbërëve shtegton përmes librave. Barleti është humanist, por ai ishte dhe patriot;ai ishte patriot humanist. Nën nxitjen e patriotizmit dhe në emër të tij ai predikonte dhe ngrinte lart trimërinë, si virtut i parë që i duhej shqiptarit në atë kohë. Argumentet në të mirë të tij Barleti, si humanist i merr nga e kaluara e lashtë greko-romake, por si patriot i merr dhe nga realiteti historik i popullit të vet.[4]

Shqipëria edhe pse ishte vendi i fundit që fitoi pavarësinë nga Perandoria Otomane duke pasur një histori shumë më komplekse se fqinjët e saj, pati një zgjim disi më të ngadaltë por dhe një komplisitet lidhjesh me Evropën dhe idenë rreth saj. Së pari , komiteti katolik shqiptar edhe pse më i persekutuari në vend si rezultat i luftërave të vazhdueshme Veneto-Turke apo dhe Austro-Turke kish sendërtuar një paradigmë krejtësisht evropiane përsa i përket botimeve të vet qenë shumicën ishin në latinisht por që nga shekulli XV i gjejmë dhe në shqip duke kontribuar kështu në ruajtjen e gjuhës dhe kulturë kombëtare. Në të gjitha këto vepra të Buzukut, Bardhit, Bogdanit, Kazazit ka një rikujtim të Motit të Madh të Skënderbeut dhe të shpresë për një aleancë evropiane për të larguar otomanët nga Ballkani. Libri i parë shqip, Meshari i Gjon Buzukut, një prifti katolik nga rrethinat e Ulqinit, ka në thelb të tij , jo vetëm mesazhin universalist të Krishterimit, por edhe mesazhin e lirisë së etnosit arbër, përmes shkrimit të gjuhës vernikulare. Karekteristikë e figurave të larta klerikale viseve të pushtuara nga osmanët, është pikërisht kjo lloj simbioze midis fesë dhe humanizmit, çka i bën krejt të veçantë këta personalitete fetare në jetën kulturore të kombit të vet. Kjo gjë ndihet sidomos në veprën e vet "Pasqyrat e të Rëfyemit", të Pjetër Budit, ku ai sjell një moral të tërë humanist, bëhet një nga njerëzit e kulturës sonë, që ka hedhur themelet e shkencës etike në Shqipëri.

Islamizimi i popullsisë, solli një traumë të madhe shpirtërore pasi dhe një pjesë e madhe e popullsisë filloi të hynte dhe të merrte pjesë në qarkun kulturor lindor, ku në mes të tjerave shquan rryma e bejtexhinjve dhe literatura e sekteve të ndryshëm islamë. Në këtë kohë në këtë pjesë të popullsisë nuk kemi

[4] Zija Xholi. "Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare".Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tianë:2003, fq 33

një ligjërim të idesë së Evropës pasi shpesh herë dhe nëpërmjet luftërave që bënin osmanët, trupat shqiptare merrnin pjesë në këto beteja dhe nuk ktheheshin me emocione pozitive nga to.
Ndërkohë në veprat e humanistëve shqiptarë nuk ka një paradigmë mohuese ndaj pjesës së islamizuar të popullsisë shqiptare. Kështu në ë letrën e Budit dërguar Kardinalit Godacino, nënkuptohet qartë afërsia e etnike e tij me popullsinë lokale kur shkruan për kryengritësit "më të shumtit janë të gjakut tim dhe miq të ngushtë të mij"[5]. Për më tepër , pavarësisht se në letër ka një mobilizim dhe thirrje të identitetit fetar, një kundërvënie e natyrshme në shekullin e XVI, sërish gjejmë një frazë të rëndësishme që është pararendëse e ideve të mëvonshme të zgjimit kombëtar të shqiptarëve. Islamizimi i një pjese të popullsisë ka sjellë në eksistencë një faktor të ri, të të arbërve të konvertuar, të cilët mund të mendohet se janë bërë palë me pushtuesit, por që sipas Budit, në planet e tij të kryengritje, janë gati të vdesin me armë në dorë jo vetëm të krishterët por edhe të "parët turq"[6]-emër me të cilët nënkupton parësinë e islamizuar arbëre. Është meritë e padiskutueshme e Budit që dëshirën dhe kryengritjen e ardhshme të arbërëve nuk e ka parë vetëm si një dëshirë të një pjese të popullsisë por mesazhin e lirisë që shpërndan shërben si enë komunikuese midis gjithë popullatës arbëre, pavarësisht ndasive fetare. Pjetër Budi, si me të drejtë ka vënë në dukje Profesor Selman Riza, është pararendësi i letërsisë së lëveuar shqipe si në prozë ashtu dhe në poezi. Si për nga risia e temave dhe gjinisë, ashtu për nga aftësia kompozicionale, gjithashtu për nga fuqishmëria e shprehjes Pjetër Budit kurrsesi nuk mund t'i mohohet cilësia jo vetëm e të parit lëvrues, frymëgjatë të poezisë letrare shqiptare, por njëherazi edhe e të parit poet shqiptar, të pajisur me një ndjeshmëri fetare-kombëtare të pasionuar.[7]
Rrethin vicioz të mospërdorimit të gjuhës shqipe vetëm si përkthime por në një krijimtari të mirëfilltë letrare e kapërcen Pjetër Bogdani me veprën e vet "Rrethi Profetëve". Në parathënien që shoqëron veprën e tij Bogdani shkruan se "lutesha që të më shtampohej libri, ashtu si kur të kthenja prej dheut si në të kësha nji qirij ndezun ndorë për të ndritur atë të vobek dhe të Arbënit".[8]Ideja e ndriçmit të popullsisë, aq e njohur në Evropë me Iluminizmin përftohet nga Bogdani si pjesë e vetëdijes intelektuale, tipar i mëvonshëm që e hasim dhe në Rilindjen Kombëtare.
Pjesa tjetër ortodokse e popullsisë ashtu si dhe në rastin rumun dhe bullgar u influencua nga elitat greke por dhe kontribuoi në Iluminizmin grek nëpërmjet Voskopojës, akademisë së saj dhe prelatëve ortodoksë. Emrat e Kavaliotit,

[5] Zija Xholi. "Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare".Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tianë:2003, fq 87
[6] Po aty, fq 88
[7] S.Riza."Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe", fq 91
[8] Zija Xholi. "Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare".Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tianë:2003, fq 156

Daniel Moskopolit shënjuan jo vetëm kulturën regjionale të Voskopojës por dhe atë greke pasi u shkruan në atë gjuhë. Gjithsesi duhet theksuar se përdorimi i gjuhës greke shprehte dhe mentalitetin ekumenist të epokës, ku ajo shikohej si një transmetuese e vlerave bizantine dhe në planet e iluministëve ballkanikë zinte një vend të veçantë si gjuha që do të bashkonte të gjitha popullsitë e Ballkanit . Pikërisht në këtë kohë kemi një përpjekje për një zhvillim kulturor të shqiptarëve ku si paradigmë zhvillimi u morën veprat dhe autorët e Iluminizmit grek, pasi dhe një pjesë e këtij zgjimi kulturor erdhi nga figura që ishin formuar në shkolla kulturore greke dhe ishin personalitete të kulturës ekumenike ortodokse. Gjatë kësaj epoke, sidomos pas forcimit të pushtetit të Ali Pashë Tepelenës, në fillimet e shekullit të XIX dhe rritjes së pranisë diplomatike në Janinë, ku dy përfaqësues të shquar, njëri i Francës republikane Fransua Pukëvil dhe tjetri i Mbretërisë Angleze, Ëilliam Martin Leake ishin dy personalitete shumë të kulturuar që kontribuuan shumë në nxitjen dhe lëvrimin e kulturave vendase. Të frymëzuar të dy nga Filohelenizmi dhe ringjallja e interesit për trashëgiminë greko-romake, ata nuk do të qëndronin indiferent edhe ndaj kulturës shqiptare pasi një pjesë e madhe e botës antike që ata adhuronin shtriheshin në territoret shqiptare. Kështu Pukëvili do të ishte nxitësi kryesor i Marko Boçarit të shkruante në 1809 një fjalës greqisht-shqip nga bisedat me familjen e shquar të Boçarëve, të shpërngulur në Korfuz.

Kjo situatë do të ndryshonte disa vite më vonë ku ashtu si dhe në Evropë etnitë ballkanike do përqafojnë nacionalizmin si platformë ideologjike në rrugën e krijimit të shteteve të tyre por trashëgimia dhe influenca e kësaj kulture ekumeniste të rajonit do jetë e dukshme jo vetëm në zgjimet kombëtare por dhe në dëshmitë e udhëtimit që na kanë lënë udhëtarët e huaj në shekullin e XIX. Pikërisht nga kjo elitë dhe përfaqësuesi i saj Naum Veqilharxhi do të vijë dhe artikulimi i idesë së tij në "**Letrës Enciklike Për Të Gjithë Të Pasurit E Të Mësuarit Ortodoksë Shqiptarë**", ku ai do tu kërkojë shqiptarëve që të hyjnë në "në radhën e kombeve të qytetëruara" duke nënkuptuar Evropën. Por suksesi më i madh i idesë evropiane mes shqiptarëve do të jetë përqafimi i saj nga komunitetit mysliman shqiptar çka përbën një rast unikal në dallim nga komunitetit e tjera myslimane në Ballkan. Edhe pse kjo ide mund të gjendet e vagullt në projektin konstitucional të federatës Panilirike që Karamahmud Pashë Bushatlliu kishte ndërmend të formonte si një shtet të përbashkët mes shqiptarëve myslimanë, atyre katolikë dhe malazezve ortodoksë të përmendur nga shënimet e udhëtimit të konsullit francez Francois Pouqeuville, apo dhe në dëshirën e në fund të zotërimit të Ali Pashë Tepelenës që i kërkoi Meternikut, kancelarit të Austrisë një kushtetutë të shkruar, gjithsesi duhet pranuar fakti se pas reformave të Tanzimatit dhe lindjes së idesë kombëtare për shqiptarët kjo ide fillon të dallohet më tepër. Ideologë të saj janë vëllezërit Frashëri, Hasan Tahsini, Isamil Qemali etj të cilët ndikojnë jo vetëm në atdheun e tyre por dhe në vetë Perandorinë Otomane për të artikuluar këtë ide.

Ideja për Evropën ashtu si dhe në vendet e tjera ballkanike do të eci paralelisht me zgjimin kombëtar ku arsimimi në gjuhën kombëtare dhe evokimi i figurës së Skënderbeut do të përbëjnë dy nga shtyllat e këtij zgjimi. Tekstet shqip të abetareve dhe copëzave të këndimit të hartuara nga rilindasit shqiptar e pozicionojnë Shqipërinë në Evropë duke shprehur dhe konsideratat e larta për qytetërimin evropian. Pranimi i Skënderbeut si hero kombëtar të tyre do të ishte një nga hapat e para të shqiptarëve për afirmimin e kësaj ideje pasi princi tyre mesjetar kish qenë në ballë të koalicioneve anti-osmane për të shpëtuar Evropën. "Jakë o dritë e bekuar që lind andej ku perëndon" do të shkruante Naim Frashëri duke shprehur qartë jo vetëm adhurimin e tij për Perëndimin por dhe influencën e kulturës evropiane, sidomos asaj franceze që kish influencuar aq shumë në botëkuptimin e tyre. Poema e gjatë në vargje "Istoria e Skënderbeut" e Naim Frashërit është testamenti politik i Rilindjes Kombëtare, ku kundërvënia me otomanët pasqyrohet me tone epike dhe lidhjet e Shqipërisë me Evropën përforcohen dhe rikujtohen përmes betejave të arbërve. Do të ishte ky adhurim i elitë shqiptare ndaj idesë evropiane që do ti bënte ata që të gjithë në kuvendin e Vlorës të këmbëngulnin për një princ evropian për të ardhur në krye të vendit dhe që do ta detyronte Sër Edward Grey, sekretarin e jashtëm britanik të asaj kohe që të shkruante në ditarin e tij në 1913 se edhe pse "Shqipëria dhe popullata në numër më të madh i përket besimit Islam, e gjithë elita e tyre pa përjashtim është pro evropiane". Kjo qasje drejt Europës do të përcillej gradualisht edhe te shtresat e tjera të popullsië derisa me konsilidimin e shtetit shqiptar do të bëhej ligjërim dominant i ligjërimit publik shqiptar.

Biblografi:

1- Kronika e Gjon Muzakës në P.Xhufi. Nga Paelologët te Muzakajt. Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2009
2- O.J.Schmitt, Skënderbeu, Tiranë, 2008
3- P.Petta, Despoti d' Epiro e principi di Macedonia, Lecce, 2000.
4- S.Riza."Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe"
5- Zija Xholi. "Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare".Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tianë:2003.

Msh. Liridona SINISHTAJ

FORMAT E TOPOSIT DHE KRONOSIT NË PROZËN SHQIPE NË MAL TË ZI

Në vështrimin që i kemi bërë korpusit të letërsisë shqipe që krijohet në Mal të Zi kemi vërejtur se si në prozë dhe në poezi paraqitet e ndërlidhur hapësira si vend real duke kaluar në temë letrare; *topos (tema):Fjalë për fjalë një pasazh letrar që haset shpesh ose mbizotëron në një vepër letrare*[9]dhe *kronosi (koha) në letërsi bëhet një fakt i prekshëm dhe i dukshëm, i bën ngjarjet narrative konkrete, të cilat mund të komunikohen, ai shndërrohet në informacion i cili mund të jap të dhëna të sakta për vendin dhe kohën e paraqitjes së saj.*[10] Prandaj në këtë punim përmes analizës tekstore kemi receptuar shfaqjen e kronosit si kohë/hapësirë e njëjtë në rrëfim përmes formave/shenjave të teksteve që na japin referenca reale historike, te veprat në prozë: *Zonja nga kryeqyteti, Rruga e pamëshirshme, Dashuri e dhunuar , Dosja e tmerrit, Passio* dhe *Vdekja e valëve.*

Zonja nga kryeqyteti, Asllan ***Bisha***

Toposi me kronosin lidhet përmes elementeve leksikor si: Agait[11] (emër personazhi), hyzmeqar, pra element që na çon në kohën e Perandorisë Osmane.

*''...ndërsa flokët krral-krrela me kordhelë kadifeje, ia shtonin bukurinë vajzës dhe **Agait** i përkujtonin të shoqën...''*

Pastaj ndërlidhet me toposin si hapësirë gjeografike:'' *-Trandofilën mund ta kesh nuse në ëndërr. Biro. Atë s 'e dhanë në kullat e **Anës së Malit**, e po ta jep vajzën Agai, në kasolle!?''*

- **Toposi dhe kronosi përmes utopisë/disutopisë**

''Utopia e disutopia, si teori praktike, nëpërmjet ligjërimit letrar e përtej letrar, krijojnë letërsinë e ideve e ideologjinë. Pra jo letërsinë e zbulimit, po

[9]Në retorikën klasike topos ishte një veçori e zakonshme retorike për sa i përket strukturave të veçanta *loci communes* ose të marra së bashku. E.R Curtis përdori termin retorikë për t'iu drejtuar situatave të shpeshta letrare ose tematikave të Epokës së Mesme, të tilla si qortimi që poetët i bënin vetvetes për paaftësinë e tyre për të vlerësuar siç duhet veprat e tyre, ilustrimi i një bote të çorganizuar etj.

Në epokën moderne të kriticizmit termi më i zakonshëm për këtë është Motivi ose Ideja. A Handbook to literature, C.Huch Holman, Ëilliam Hormon, Mac million Publishing Company, 1986, f. 504.(perkthimi ynë).

[10]Michael Bahtin, The dailogic imagination, Four Essays, University of Texas Prees, Austin, 2006,f,250.

[11]Aga ose Agai ishte titull për një pronarë të vogël tokash. Po ashtu ky titull është bart nga oficerët e ushtrisë së vjetër osmane të cilët kishin nën komandë jeniçerët.

letërsinë e mbulimit, të shërbimit të ideve, qofshin këto besimtare, nacionale apo sociale.''[12]

Fakti historik i kthyer në fakt letrar përmes utopisë dhe disutopisë lidhet me toposin si hapësirë, Shqipëria toka-mëmë, dhe me kronosin si kohë, viti '93.

Toposi si utopi

''Unë s'jam budalla, më detyroni të iki. Do të shkoj ***<u>në anën tjetër të Barbanës</u>****. Është* ***<u>toka ime</u>****...* *''(Unë, Ana Xixi ,f. 106)*

Toposi si disutopi

''-Mos ***<u>luaj me mua</u>*** *koleg! Unë jam* ***<u>në tokën mëmë.</u>***

*- Ha, ha, ha, -****<u>gajasej së qeshuri kosovari</u>****.-Ti mendon se je në klasë?* ***<u>Këtu s'i besojnë askujt.</u>***

(Unë, Ana, Xixi, f. 122)

Ne ***<u>vuajmë për bukë të bardhë</u>****, kurse ti s'ngopësh me bukë thekre.'' (Dashuri buz Barbanës f.110)*

Elementet tekstore të shfaqjes së kronosit:

Jepet koha\viti, ***<u>Vjeshtë e parë '93</u>.*** *Në* ***<u>Barbanë</u>*** *shpërtheu ahengu. Dasmë me mot të mirë dhe me diell të butë. Fytyra e pastër e qiellit i gëzoi kryshqit.* ***<u>Ata nxitonin, kërcenin lumin pas 47 vjetësh</u>****. (Dashuri buzë Barbanës, f. 119)*

Utopia dhe disutopia përmes toposit real Barbanës/Buna (e cila lidh Shkodrën me Ulqinin, pra lexuesi duhet të ketë njohje jashtëtekstore, prandaj e kemi quajtur letërsia e toposeve) lidhet me kohën reale të periudhës pas 45-ës deri në 90-ën ***(Vjeshtë e parë '93***) , pra ndarja e kombit për 50 vite. ***<u>Ata nxitonin, kërcenin lumin pas 47 vjetësh.</u>***

Këto analogji me faktetet historike, te novelat *Zonja nga kryeqyteti* jepen përmes ndërthurjes së detyrueshme të toposit me kronosin, e quajmë të detyrueshme sepse vetëm kjo ndërthurje u jep kuptim këtyre elementeve që për lexuesin semiotik janë jashtëtekstore.

Rruga e pamëshirshme, Dashuri e dhunuar, Dosja e tmerrit, Fran **Camaj**

Në romanet sagë të Fran Camaj toposi ka si qëllim rrëfimi kronosin, sepse elementet e formës së letërsisë dokumentare mbizotërojnë.

Të gjitha rrëfimet/dëshmitë lidhen me topose reale si *vend i përbashkët* në romane, por që janë në sinkroni me kohën e rrëfyer. Tema e vdekjes ndërthuret me kohën dhe hapësirën e rrëfyer në romanet e Camaj.

Rruga e pamëshirshme

Koha e rrëfyer është fillimi i viteve 70-të personazhet, ngjarjet ndërlidhen me kohën e rrëfyer dhe toposin.

Makina iu afrua ***<u>kufirit jugosllavo-italian</u>****, në <u>Sllloveni</u>. (f,51)*

Ishte ditë ***<u>verë e viti 1970</u>****, festa tradicionale e fisit të Mark Lul Hasit (f,75)*

Toposi si temë/motiv dhe si vend lidhet me kronosin:

[12] Sabri Hamiti, Utopia letrare, Akademia e Shkencave, Prishtinë, 2013, f.11.

*Ai e kishte porositur vajzën që kur të vinte **ndonjë shqiptar**, ta priste mirë dhe t'i jepte ushqim pa pagesë. Atëherë kishte filluar **shpërngulja e malësorëve** dhe e **shqiptarëve tjerë nga Mali i Zi** për **në Amerikë**. (f,90).*

Dashuri e dhunuar

Koha e rrëfyer shfaqet që në temë si kohë historike, sepse ngjarjet jepen në kohën e sundimit Osman në Ballkan. Kronosi shfaqet përmes personazheve që janë heronjtë e Kryengritjes së Malësisë në vitin 1911 në Malin e Deçiçit, hapësirë në pjesën Veriperëndimore të Shqipërisë së sotme dhe në pjesën Jugore të Malit të Zi.

Pra, historia kthehet në letërsi ndërsa toposi dhe kronosi shfaqen si rrëfime.

*U mor **fortifikata e Deçiqit**, kurse në maje të Bratilës **Nikë Gjelosh Luli** me shokë, hoqën **flamurin e Turqisë** dhe në vend të tij, **sipas porosisë së Dedë Gjo' Lulit**, vendosën **Flamurin Kombëtar**. (f,100)*

Dosja e tmerrit

Koha e nënkuptuar nga teksti është fillimi i viteve '45 dhe ngjarjet që pasojnë, në këtë roman toposi brenda kronosit shfaqet më i theksuar në tekst si topos real si: Shqipëria, Jugosllavia (e atëhershme), pra referencat historike janë qartësisht të kuptueshme si: persekutimi ndaj klerit katolik, mbyllja e kufirit dhe izolimi i Shqipërisë, të gjitha këto dhe shumë të tjera rrëfehen përmes jetës dhe fatit tragjik të personazheve. ***Patër Zefi*** *me dorën e djathtë mori kryqin, iu afrua Vaselit, e rrëfeu me zë të ulët edhe i dha bekimin e fundit. Pastaj u kthye me fytyrë nga xhelatët, të dy duart e puthitura i çoi lart e tha:**''Rroftë Shqipëria! E bekoftë Zoti popullin shqiptar!** Megjithatë, edhe ju qofshi bekuar''* (f,47) .

Të tre romanet e Camaj që kemi vështruar kanë elemente të utopisë për Shqipërinë si vend i shenjtë, i ndaluar për ata që janë jashtë saj, të të gjithë jepet periudha e ngjarjeve përmes tekstit si temë, rrëfim dhe si datë. Ndërthurja e toposit me kronosin, pra vendi dhe koha e caktuar (rrëfyer) në romane i bën që të mos etikohen si romane anakronike në disa raste.

Sepse kjo lloj ndërthurjeje "anakronike" ka si qëllim të shembin idealet që shkojnë deri në utopi, përmes disutopisë dhe dokumentimit duke përdoruar fakte historike, gojëdhënat, dhe fakte reale të hapësirës së Malësisë.

Passio, Anton **Gojçaj**

Kronosi dhe toposi- Të dyzuar

Kronosi dhe toposi si kohë dhe hapësirë janë të ndarë dysh, janë përballë dy botëve, asaj perëndimore Amerika (topos) dhe Europës (Mal i Zi, Kroaci, Kosovë...).

Prolepasat dhe analepsat përshkojnë romanin dhe japin fillimin e rrjedhës së ngjarjeve: *Në fazën **përfundimtare të Luftës së Dytë Botërore**, Jozef Montanaro **ishte 15 vjeç** dhe quhej Zef Gjoni...**Në Arzë** si kudo **në Malësi**, ato ditë ishte varfëri. (f.46)*

Kronosi si kohë reale shfaqet përmes fakteve historike që kthehen në fakte letrare (madje tipar i romanit është shndërrimi i fakteve historike në fakte letrare, përmes rrëfimit figurativ dhe stilit lakonik). *Fatkeqësisht, po atë natë **kur pushkatuan babain e Zefit**, ushtria e kishte pushkatuar edhe **Patër Zefin, famullitarine Hotit**.(f.52)*

- Toposi dhe kronosi shfaqin dy botë përmes identitetit personal e kombëtar.

***Në Amerikë** askush nuk e dinte se **ai ishte shqiptar**. As ai vetë nuk ishte i sigurt , në çaste pështjellimi, për këtë gjë. Vetëm një herë, derisa e përcolli në ekran ceremonialin e pranimit të **Çmimit Nobel nga Nënë Tëreza në Oslo**, kur spikeri përmendi **se ajo rrjedh nga një familje shqiptare**, Montanaro **ndjeu t'i lëvizte nervi shqiptar**. (f.41)*

- Konfliktet kombëtare (ballkanike) shenjëzojnë një vend dhe hapësirë të caktuar, duke rrëmuar në thellësinë e një psikologjie kolektive.

Disa radhe ulësesh para tij, dy burra në moshë grindeshin mes tyre, dhjetë mijë metra mbi oqean.
*-Prej nga ''bregdeti ynë''?Ku e keni **bregdetin ju**?*
*Bregdeti është **i yni i kroatëve**, kuptojeni këtë njëherë e përgjithmonë.*
*-Kurrë s'do të ishte juaji, po të mos kishim qenë **ne serbët**... (f.31)*

- Toposi dhe kronosi si temë dhe kohë reale përmes ligjërimit

*Në agjenci, pavarësisht nga mirësjellja profesionale, nëpunësja nuk e fshehu çudinë që ky dëshironte të shkonte pikërisht **në Mal të Zi**, **ku para më pak së një viti bëhej luftë**, të cilën e **udhëhoqi SHBA-ja.** Prandaj, si qytetar amerikan, duhej të ishte më i kujdesshëm, **sepse ballkanasit janë të njohur për gjaknxehtësi dhe hakmarrje**. (27-28)*
Pavarësisht se fakti historik dhe gjeografik është kthyer në fakt letrar, nga teksti lexuesi nxjerr si kohe reale periudhën e pas viteve 90-të.

Vdekja e Valëve, Anton **Gjuravçaj**

- Toposi dhe kronosi si rrëfim për rrëfimin

***Në kohën kur ushtria turke** kishte gjithnjë e më pak suksese në shtypjen **e kryengritjeve të shumta që e dridhnin Ballkanin e kur Evropa**, gjithnjë e më zë më të lartë, e quanin i sëmuri i Bosforit dhe mendonte se e tërë kjo ishte në rrjedhojë logjike e një organizimi, i cili prej kohësh kishte arritur kulmin dhe tani qëndronte në një ëndërr të brishtë. (f,36)*

- Takimi i dy linjave të rrëfimit në roman përmes toposit dhe kronosit.

***Osmani** veproi sipas skemave tanimë të mësuara në rininë e vet. **Torturoi, shpërnguli, internoi, por kurrë nuk ia arriti qëllimit që t'i bëjë këta njerëz të kuptojnë se çfarë është komunizmi**, diktatura e proletariatit, raporti në mes forcave të prodhimit dhe mjeteve prodhuese. Përkundrazi, populli mendonte se **Osmani ishte pashai turk-Osman Pasha,** të cilit djemtë e zgjedhur të kësaj anë*

i kishin dalë përpara në krye ***<u>me një burrë të fuqishëm e trim e që e quanin Gjergj</u>.*** *(f. 56)*

Narratori i gjithëdijshëm luan me hapësirën dhe kohën reale duke i zhvendosur në vend të njëra-tjetrës, përmes personazheve të cilët kanë emrat e figurave që simbolizojnë historinë:Osmani të shtypjes/sundimit dhe Gjergji të lirisë. Ndërsa veprimet e personazheve lidhen dhe ndodhi në bashkëkohësi.

Në këto vepra lidhja me toposin shkon përtej përdorimit si material krijues, ai është është *vend i përbashkët*[13]në jetën reale dhe i tillë shfaqet edhe në letërsi.

Në vend të përfundimeve vetë natyra e këtij receptimi ka krijuar një formë tipologjike të shkurtër të shfaqjes së toposit dhe kronosit në tekste që mbeten mes historisë si vende reale dhe letërsisë përmes ligjërimit artistik.

1. Toposi dhe kronosi si vend\kohë reale

Në novelën *Zonja nga kryeqyteti* toposi shfaqet si personazh përmes personifikimit të Ulqinit, detit, kalasë e rërës. Në novela rrëfehet për Ulqinin sikur për një qenie njerëzore, ai ndien, merr frymë. Pra, toposi përveçse si shprehje e autoktonisë, që është e përbashkët për të gjithë, është rrëfim dhe vend rrëfimi.

Toposet reale në këto novela janë: Barbana/Buna, Ulqini, Rozafa, Shkodra, por pothuajse gjithmonë janë të personifikuara.

Në romanet *Rruga e pamëshirshme*, *Dashuri e dhunuar* dhe *Dosja e tmerrit*, toposi si vend mbizotëron, ai është pjesë e strukturës së romaneve.

Të dy toposet, ai real dhe letrar janë të lidhur, sepse të gjitha ngjarjet që rrëfehen ndodhin në topose reale si Malësia (Tuz, Hot, Grudë, Triesh), Amerikë (Detroit, New York), Kosovë (Prizren, Prishtinë), Shkodër .

Historia si fakt real i dokumentuar përdoret po ashtu në funksion të toposit dhe kronosit. Në *Dashuri e Dhunuar* koha historike e rrëfyer në roman është kohë dhe vend real historik, edhe në romanet tjerë koha e dhënë është historike dhe gjithmonë shfaqet përmes toposit real si vendi për të cilin rrëfehen ngjarjet.

Ky lloj toposi në *Passio* shfaqet si parodi ndaj historisë, si traditë në bashkëkohësi, kurse në *Vdekja e Valëve* shfaqet si ironizim i historisë, sepse jepet si kohë historike Perandoria Osmane në bashkëkohësi; përmes rrëfimeve për pushtime, për strategjitë sulmuese, për lavdinë dhe pushtimet e Osmanit personazh simbol i cili jeton me të kaluarën dhe pret në të tashmen ardhjen e Gjergjit, i cili gjithashtu është personazh simbol për Gjergj Kastriotin.

Figurat historike, janë forma e fundit që shfaqet përmes toposit real si vend, e cila përmes figurave historike identifikohet me kombin si vend dhe hapësirë e caktuar gjeografike.

[13]Topos në greqisht do të thotë vend. Ai hyn në fushën e të folurit, të shkrimit dhe të abstragimit, duke u bërë nocion që në diskutimet e mëvonshme letrare e jo letrare merr kuptimin e ‘’vendit të përbashkët’’, ‘’vendit të përgjithshëm’’, Sabri Hamitit, Poetika shqipe, shtpb 55, Tiranë, 2010,f, 128.

Në *Dashuri e dhunuar* shfaqen si personazhe (Dedë Gjo' Luli), në *Passio* si rrëfim përshkrues (Skënderbeu, Gjergj Fishta, Nënë Tereza). Përmes figurave historike të përdorura në letërsi, bëhet takimi me traditën, kulturën shpirtërore, ndërsa toposi si vend real zgjerohet, sepse i përket gjithë hapësirës shqiptare.
Në *Passio* toposi real shfaqet brenda rrëfimit përshkrues të hapësirës së personazhit, dhe konkretizohet përmes figurave historike. Toposet reale në roman janë: *Dinosha, Gruda, Ura e Zharnicës, Mali i Shypshanikut, Maja e Helmit, Deçiqi.*
Në *Vdekja e valëve,* toposi si vend real në bashkëkohësi nuk ekziston, ai krijohet vetëm përmes ligjërimit filozofik dhe figurave simbolike. Ndryshe nga autorët e tjerë Anton Gjuravçaj krijon toposin e bashkëkohësisë përmes toposit të së kaluarës siç është Perandoria Osmane.
Pra, figurat historike krijojnë toposin e identitetit, kurse toposet reale paraqesin toposin e vendlindjes si simbol i autoktonisë/dëshmisë.

2. Toposet Letrare

Toposet letrare në prozë shfaqen si tema, duke filluar nga romanet sagë të Fran Camaj, ku tema e vdekjes shfaqet si strukturë e veprave. Ajo është e ndërlidhur me toposin si *pasazh që përsëritet* dhe si vendi ku rrëfehen/ndodhin vdekjet.
Në *Passio* si ligjërim bilblik, ndërsa te *Vdekja e Valëve* si ligjërim alegorik, në *Zonja nga kryeqyteti* si personazh, sepse toposi i detit, Ulqini, kalaja, rëra personifikohen përmes rrëfimit duke qenë vetë rrëfimtar në disa raste.
Në romanet e Camaj, tema e vdekjes strukturohet përmes fabulës, toposit si vend ku ndodhin dhe rrëfehen ngjarjet (Malësi, Amerikë, Kosovë), dhe përmes ligjërimit të personazheve.
Mbizotëron tema e vdekjes për atdheun në *Dashuri e dhunuar*, për nderin dhe burrërinë në *Dosja e tmerrit*.
Si temë me motive dhe parabola biblike shfaqet toposi letrar në *Passio*, i cili lidhet me toposin real Malësinë përmes temës së ëndrrës si simbol i pavetëdijes dhe brejtjes së ndërgjegjes.
Si temë universale e lidhjes atë/bir, motër/vëlla, Amerikën përmes temës së vetmisë, Ballkanin përmes temës se konflikteve nacionale.
Në *Vdekja e Valëve* toposi letrar shfaqet përmes ligjërimit alegorik dhe personazheve simbol Osmani e Gjergji. Temën e vdekjes e ka zëvendësuar dhuna fizike dhe psikologjike e personazheve si Marku. Pra, kemi temën e robërisë, dhe kërkimit të lirisë, vetëm në fund titulli *Vdekja e valëve* simbolizon përfundimin e krizës së individit për identitet.
Duam të shtojmë se në të gjitha veprat shfaqet tema e mërgimit, e cila kalon në topos stukturor përmes pasazheve që përsëriten dhe toposit si vendi për të cilin rrëfehet.
Nga ky vështim i shkurtër tekstor mendojmë se shfaqja e toposit dhe kronosit shpesh e zbeh rrëfimin nga ligjërimi poetik dhe figurat letrare, sepse toposi real dhe koha historike kthehen në qëllim tematik dhe rrëfimor, vetëm për të dëshmuar "historinë''.

Bibliografia

A Handbook to literature, C.Huch Holman, Ëilliam Hormon, Mac million Publishing Company, 1986.
Anton Gojcaj, PASSIO, BUZUKU, Prishtinë, 2004.
Anton Gjuravcaj, Vdekja e Valë, Toena, Tiranë, , 2009
Asllan Bisha, Zonja nga kryeqyteti, Art Club, Ulqin, 2014.
Fran Camaj, Dashuri e dhunuar, Toena, Tiranë, 2006.
Fran Camaj, Dosja e tmerrit, Toena, Tiranë, 2012.
Fran Camaj, Rruga e pamëshirshme, Toena, Tiranë, 2004.
Michael Bahtin, The dailogic imagination, Four Essays, University of Texas Prees, Austin, 2006.
Sabri Hamitit, Poetika shqipe, shtpb 55, Tiranë, 2010.

STUDIMORE

HISTORIKE

Prof.as.Dr. Simon LUFI
MA Marsel NILAJ

ZGJEDHJET E VITIT 1923 NË SHQIPËRI DHE VEÇORITË NË LIDHJE ME SHKODRËN.

Institucioni i parë parlamentar në Shqipëri, i ashtuquajturi Këshilli Kombëtar e nisi jetën e tij në prillin e vitit 1921. Legjislatura e parë e Parlamentit të parë shqiptar, qëndroi e hapur për dy vjet e 5 muaj, nga prilli i vitit 1921 deri në gusht të vitit 1923. Me gjithë ato probleme që pati që nga koha e fillimit të fushatës zgjedhore për nxjerrjen e deputetëve, veçanërisht në Shkodër, e deri në fundin e saj, mbetet një ndër periudhat më të mira të parlamentit shqiptar. Megjithatë, në kohën kur flasim koncepti parlament, koncepti pushtet legjislativ për vendin tonë, ishte akoma në shkallën më minimale dhe të thjeshtëzuar të nocionit. Sistemi parlamentar nuk kishte parti të mirëfillta të krijuara me një organizim institucional. Partitë e krijuara vonë, para zgjedhjeve të 1921, në kohën kur flasim, në përfundim të legjislaturës së parë, ishin shpërbërë plotësisht, si ajo popullore ashtu edhe ajo përparimtare[14]. Në kohën e fundit të sesionit parlamentar të 1923, një ndër veprimet kryesore që duhej të bëhej ishte përcaktimi i Ligjit për Zgjedhjet, tashmë jo të një sistemi thjeshtë parlamentar, por atij kushtetues.

Shumë kohë më parë ishte kërkuar për të pasur një Asamble kushtetuese, madje që në kohën e Senatit të vitit 1920, shumë deputetë kishin bërë kërkesë që mos të votohej për Këshillin Kombëtar, por për një Asamble Kushtetuese. Edhe gjatë gjithë kohës, brenda tre viteve parlamentare, ishte bërë shpeshherë një thirrje e tillë. Edhe deputetët e Shkodrës jo rradhë herë kishin shprehur nevojën për një veprim të tillë. Megjithatë, hapja e një Asambleje do të thoshte rishikimi edhe një herë i shumë prej proçedurave qeverisëse apo institucionale. Do të rishikohej së pari krijimi i një kushtetute, e në të do të vihej në pikëpytje institucioni i Këshillit të Naltë, gjithashtu mund të hapej edhe pikëpyetja e fjetur deri në këtë kohë për një kryeqytet.

Dy mbledhjet e fundit të Këshillit Kombëtar, u bënë paraditen e pasditën e datës 30 shtator 1923[15]. Këto dy mbledhje nuk ishin thjeshtë mbledhje rutinë të një mbyllje parlamenti; për veprimet që ato ndërmorën mund të jenë ndër mbledhjet më të rëndësishme për gjithë 1923. Në këto dy mbledhje u miratua ligji i zgjedhjeve për zgjedhjet që do të mbaheshin brenda atij viti.

[14] A. Sh. "Historia e Shqipërisë", Vol 2, Tiranë …… , fq. 214
[15] Mbl. 31, v. 1923. Fq. 423

Ligji zgjedhor që në nenin e tij të parë thoshte se sistemi është universal i tërthortë[16]. Kjo nënkuptonte se zgjedhjet duhet të ishin me dy kohë. Vetë ky sistem ishte realisht i mangët sepse një sistem i tillë, në kohën kur flasim, nuk aplikohej në pjesën më të madhe të Evropës. Një deputet (Miss), zgjidhej në një raport të tillë: 1 për 8000 banorë, dhe votuesit ishin meshkuj. Kjo tregonte një mangësi tjetër se nuk kishte në përfshirje të këtij votimi kombëtar gjysmën e popullsisë duke lënë jashtë femrat, çka çonte përsëri në një të metë të dytë të tij. Të përjashtuar ishin edhe ato meshkuj të cilët ishin në burg apo me të meta mendore (art. 8) Të gjithë ata që nuk kishin të drejtë votimi sikurse ata që duhet të votonin shpalleshin në dyert e bashkive dhe të prefekturave[17]. Këto të fundit shërbenin si qendra elektorale për të gjithë zonën e prefekturës. Për t'u bërë deputet i Asamblesë Kushtetuese, mjaftonte vetëm të dije shkrim e këndim shumë mirë në gjuhën shqipe (art. 9)[18]. Kjo ishte një kërkesë mjaft minimale për një person i cili do të merrte pjesë në një institucion kaq me përgjegjësi e që do të hapej për herë të parë në Shqipëri. Këta duhej të regjistroheshin për t'u bërë deputet së pakut 15 ditë[19] para afatit dhe të nesërmen duhet të dilnin listat me kandidatët. Gjithashtu një zgjedhës i dytë do të dilte në raportin 1 me 250 banorë. Raporti i daljes së zgjedhësve të dytë kishte qenë një debat i hapur mes qeverisë dhe opozitës, në fakt qeveria kishte dashur raportin 1 me 500[20], ndërkohë që opozita 1 me 200[21]. Në favor të këtij raporti të fundit opozitar ishin edhe pjesa më e madhe e deputetëve të Shkodrës të cilët i përkisnin grupimit opozitar. Arsyeja kryesore ishte se do të kishte më shumë zgjedhës të dytë, çka do të thoshte më shumë pjesëmarrës në votime. Kjo e dyta ishte në favor të kombit shqiptar se raporti i dytë do të nxirrte rreth 1200 zgjedhës të dytë kundrejt 240 vetëve që kërkonte qeveria. E kjo do të thoshte se një numër më i madh ishtë më i vështirë për t'u korruptuar nga kushdo manipulator.

Një pikë tjetër e kritikueshme nga opozita, edhe nga ajo shkodrane, ishte edhe problemi i ushtrisë ditën e zgjedhjeve. Qeveria ishte shprehur në projektin e saj për zgjedhjet që atë ditë duhet të ishte në gatishmëri për të ruajtur qetësinë, ndërkohë që opozita kishte kërkuar të ndryhej në kazerma[22]. Kjo, pasi opozita kishte frikën se ajo do të ndërhynte në krahun e qeverisë, gjë që në incidente jo të rralla edhe ndodhi kështu. Në fakt në Parlament u votua si pjesë e ligjit zgjedhor që të ndryhej ushtria atë ditë nëpër kazerma, (art. 92)[23] ashtu siç e kishte kërkuar opozita.

[16] Mbl. 31, v. 1923., Po aty
[17] Mbl. 31, v. 1923. Fq. 425
[18] Mbl. 31, v. 1923., Po aty
[19] Mbl. 32, v. 1923, fq. 427
[20] A. Sh. "Historia e Shqipërisë", Vol 2, Tiranë …… , fq. 215
[21] HD, v. 1923, Nr. X, fq. 436
[22] HD, v. 1923, Nr. X, fq. 433
[23] Mbl. 32, v. 1923, fq. 477

Me gjithë kundërshtitë që pati ky ligj arriti të merrte votëbesimin e Këshillit Kombëtar. Edhe pse opozita doli përjashta, ajo arriti të kalonte numrin e nevojshëm. Përsa i përket deputetëve të Shkodrës nuk kemi asgjë të papritur, deputetët e krahut proqeveritar si Halid Rroji, Patuk Saraqi, Nikolla Ivanaj, dhe Kol Thaçi, në rolin e Ministrit të financave nga krahu i qeverisë, votuan pro miratimit të këtij ligji, ndërkohë që deputetët e krahut opozitar nga shkodra sikurse ishin At. Gjergj Fishta, Xhemal Bushati, Hil Mosi, Riza Dani, Dom Ndre Mjedja, Luigj Gurakuqi, Shuk Gurakuqi, ishin kundra këtij ligji[24].

Gjatë gjithë periudhës së fushatës zgjedhore shohim se kemi dy grupime në Shkodër. Krahun pro qeveritar, të cilin krahu opozitar e quante krahu Musajukan, i cili në krye të këtij grupi kishte Musa Jukën , drejtuesin e bashkisë së shkodrës dhe një mik i afërt i Ahmet Zogut, dhe në krahun tjetër me drejtim opozitar, kundër qeverisë aktuale, e veçanërisht kundër Ahmet Zogut, ishte grupi katolik i Orës së Maleve.

E reja e këtyre zgjedhjeve ishte se problemi fetar nuk ishte më aq i theksuar brenda besimit katolik, sikurse në zgjedhjet e vitit 1921, ku pamë grupin e krahut klerikal, në një anë, e grupin e katolikëve laik në anën tjetër, që edhe pse në pamje të parë ishte një fillesë e një opinion publik në shkodër, u përdor nga krahu i Ahmet Zogut. Në këto zgjedhje kjo nuk do të përsëritej, sepse grupimi katolik për herë të parë po dilte në një bllok katolik, të cilët ishin regjistruar në bashki si një bllok i vetëm në mesin e nëntorit 1923[25], në kohën e fundit të afatit të përcaktuar nga ligji.

Megjithatë krahu qeveritar kontrollonte me vëmendje veprimtarinë e klerit katolik në këto zgjedhje, në shkodër, e jo vetëm të atij katolik por edhe të komunitetit musliman dhe atij ortodoks. Një kontroll i imtësishëm dhe një raportim i hollësishëm i shkonte Ministrisë së Brendshme në lidhje me veprimtarinë që bënte kleri shumë kohë përpara zgjedhjeve, që në tre mujorin e parë të vitit 1923.

Këto zgjedhje kishin disa ndryshime nga ato të vitit 1921, sepse në atë kohë, grupet konkurronin me njëri tjetrin, por nuk ekzistonte koncepti pozitë – opozitë; parlamenti që do të dilte në 1921 ishte i pari si nocion dhe grupet luftonin pothuajse njëlloj pa u provuar më parë. Në kohën kur flasim kishte një ndryshim. Shohim se tashmë deputetët e Shkodrës, gjatë dy viteve e gjysëm, pothuajse kishin qenë të ndarë; një grup i vogël me pozitën, ku njëri prej tyre për një kohë jo të shkurtër kishte qenë Ministër Finance, Kolë Thaçi, kurse pjesa më e madhe e deputetëve të Shkodrës kishin qëndruar si një grup i veçantë në parlament, i cili bashkohej me qëndrimet e opozitës. Fushata të cilin ato bënin, ku një pjesë e tyre ishin përsëri si candidate, e vënin nën siglen opozitare. Grupi Ora e Maleve edhe pse i paprovuar më parë, duke pasë

[24] HD, v. 1923, Nr. X, fq. 443
[25] Ora e Maleve, V. I, Nr. 37, 19 nanduer 1923, fq. 2

parasysh se bazën e kandidatëve e kishte me deputetët që kishin qenë më parë në Parlament nga ish deputetët opozitarë, e quante veten opozitar.
Krahu opozitar në këtë kohë ishte më i bashkuar se sa krahu qeveritar. Organizimi i tyre dhe përdorimi i gazetës me të njëjtin titull Ora e Maleve, ishte një propagandë e fortë pro tyre dhe kundra qeverisë. Mundoheshin që të preknin të gjitha pikat që qeveria shqiptare e deputetët e pozitës, sikurse edhe ato shkodranë të cilët ishin në pozitë, nuk kishin bërë më parë në Shkodër.
Pikë e gjatë e fushatës ishte edhe rreziku verior i Vermoshit, ku në disa artikuj rresht u fol për këtë problem, jo vetëm tek gazeta e lartpërmendur por edhe tek Hylli i Dritës. Kjo çështje bëri një bujë jo të vogël në popull e për një veprim të tillë, duke dashur të ulte afërsinë e njerëzve me opozitën katolike, prefekti i shkodrës, A. Nepravishta, i cili në këtë kohë edhe pse ishte nëpunës i shtetit vepronte për krahun politik të qeverisë së asaj kohe, bëri një meting në Shkodër, për Vermoshin, me anë të komitetit "Vllaznia Popullore" e cila kishte edhe një gazetë të tyren në Shkodër dhe ishte pro qeverisë dhe Ahmet Zogut. Ky meting u bë vetëm që të mos i mbeste në dorë kjo çështje opozitës[26]. Metingu u mbajt vetëm një javë para mbylljes së Parlamentit, me 23 Shtator[27]. Edhe pse ishte pothuajse i balancuar ku kishin marrë pjesë në fjalime edhe katolikë, apo edhe të krahut opozitar, metingu dhe fjalimet ishin të kontrolluara dhe nuk lejohej asnjë fjalë kundra Jugosllavisë[28].
Problemi i Vermoshit në prag të fushatës i kishte bërë aq shumë presion qeverisë dhe i kishte ulur pikë asaj në vlerësimin e opinionit në Shkodër, nga artikujt që kishte shkruar kryesisht gazeta opozitare, saqë ato kishin tentuar ti mbyllnin dhe ti konfiskonin plotësisht numrat e asaj gazete në atë kohë. Madje ishin mbajtur në polici edhe shpërndarësit e gazetës[29]. Kundërshtia e fortë që iu bë nga deputetët e Shkodrës, mbështetës dhe drejtues të kësaj gazete sikurse ishte vetë Luigj Gurakuqi, e bënë Kryetarin e Parlamentit t'i drejtohej kryeministrit (A. Zogu) me anë të një shkrese zyrtare , që të vijë në interpelancë Ministri i brendshëm për t'u pyetur se ç'masa kishte marrë kundrejt veprimit të Prefektit të Shkodrës, lidhur me këtë veprim[30].
Gjithashtu gjatë gjithë vitit 1923, në Shkodër kishte pasur raste kur ishin hedhur trakte të ndryshme ose ishin vënë në vende publike kundra qeverisë dhe grupit të Klikës, duke i bërë thirrje që herët që të mos votohej më kjo lloj qeverisjeje apo këto lloj deputetësh[31]. Këto lloj shpalljesh apo traktesh jo rradhë herë kishin rënë edhe në dorë të organeve kompetente të gjandarmërisë së asaj kohe e cila e shihte me shqetësim dhe që jo rrallë herë e dinte se pas

[26] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 67, fl. 1
[27] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 67, fl. 2
[28] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 67, Po aty
[29] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 100 fl. 57
[30] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 100 fl. 59
[31] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 101 fl. 1

tyre fshiheshin njerëzit që mbështesnin grupin katolik të asaj kohe në parlament.
Veprimtaria e klerit katolik kontrollohej dhe studiohej imtësisht në atë kohë në Shkodër. Ministrisë së Punëve të Brendshme i shkonin telegrame të herëpashershme në këtë kohë në lidhje me lëvizjet e priftërinjve katolikë. At Pal Dodaj ishte shpeshherë në vëmendje të tyre sidomos pas vizitës së tij në Greqi në gushtin e vitit 1923. Ai dyshohej se mos kishte shkuar në atë vend për të bërë një lloj lidhje politike me ortodoksët të cilët dyshoheshin se mos lidhja dhe mbështetja do ju vinte nga Greqia, dhe do të dilnin së bashku në zgjedhje[32].
Në të vërtetë rruga për atje ishte në kuadrin e konvertimit të një pjese të shqiptarëve të besimit ortodoks në atë katolik, dhe lidhjes me Kishën Uniate në Shqipëri, të këtyre zonave[33].
Gjatë kohës zgjedhore dhe më përpara politika nuk ishte duke u bërë vetëm nëpërmjet metingjeve dhe gazetave apo shtypit në përgjithësi, por disa herë përdoreshin edhe vendet e kultit për një veprim të tillë. Në Kisha dhe Xhamia jo rradhë herë në predikimet e tyre përdoreshin edhe ide politike. Në të dy krahët kishte ndikim politik aspekti fetar. Grupimi politik Ora e Maleve i përkiste katolikëve dhe drejtues ideologjik kishte Imzot Lazër Mjedën, arqipeshkvin e Shkodrës, dhe vëllanë e Dom Ndre Mjedës, deputet që ishte në krahun e bllokut të ri katolik. Aktivitet i fortë zhvillohej jo vetëm në Shkodër por edhe në zona të forta katolike siç ishin Mirdita apo edhe Lezha, ku ipeshkvinj dhe priftërinj të ndryshëm bënin mbledhje[34] e propagandonin në lidhje me votimin në krahun e opozitës katolike.
Ndërkohë Z. Kalluçi nënprefekti i Lezhës shpeshherë kishte bërë thirrje që të arrestoheshin një grup prej këtyre priftërinjve sepse shihej se propaganda ishte kundra qeverisë[35]. Megjithatë asnjëherë nuk ndodhi një veprim i tillë, arsyeja ishte se në një kohë të tillë një veprim si ai i lartkërkuari, do të kishte bërë bujë tepër të madhe dhe do të përdorej politikisht nga blloku katolik, duke akuzuar qeverinë për një cënim të së drejtave zgjedhore. E kështu qeveria edhe pse ishte në dijeni nuk merrte asnjë masë të tillë, edhe pse nënprefekti, edhe pse jo brenda kopetencave të tija, jo rrallëherë vepronte në krahun e mbështetjes së krahut zogist.
Megjithatë edhe ndërmjet klerit kishte mosmarrëveshje edhe pse ato ishin sporadike. Disa prej tyre tashmë nxiteshin të dilnin edhe jashtë urdhërit të fretërve duke u lidhur me interesa përtej kufirit shqiptar, siç mund të ishte lidhja që kishin ato në Zadrimë me Jugosllavinë dhe pagesat që merrnin nga ky shtet. Apo siç ishte rasti i Monsinjor Kolecit i cili akuzohej nga qeveria se bashkë me fretërit e tjerë merrte subvencione nga 5 – 25000 franga ari[36]. Një

[32] A.Q.SH. F. 152, V. 1923, D. 1041 fl. 1
[33] M.Ë.E. Peters "Përballja e …." Tiranë 2010, fq. 64 – 65
[34] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 197 fl. 6
[35] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 197 fl. 11
[36] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 200 fl. 19, 21

pjesë e subvencioneve merreshin nga ndërlidhësi Lukë Luka[37], i cili njihej edhe në Shkodër si filojugosllav, e që nuk kishte fort emër të mirë që në përfshirjen e Shkodrës nën qeverinë e Tiranës në 1920.

Një element tjetër në këto zgjedhje që u përdor më së tepërmi ishte edhe përdorimi i tezës kantonale nga katolikët në këtë kohë. Vetë Monsinjor Lazer Mjeda kishte shprehë këtë mendim, për një veprim të tillë. Ai e shihte zonën me besim katolik si një zonë e cila mund të përfshinte një kanton të katolikëve në veri të Shqipërisë. Ai e shihte zonën katolike si pa hapësira në politikë dhe në qeverisje, sepse këtë qeveri e kishin zënë më së shumti toskët[38]. Megjithatë kjo propagandë nuk zuri fort rrënjë në pjesën më të madhe të atyre kandidatëve të mëvonshëm, Ishte një tezë që mund të ketë shtuar pikë për t'iu afruar më shumë këtij grupi një pjesë e elektoratit të kohës. Por kjo nuk ishte aspak e favorshme e aq më shumë e nevojshme për të ndodhur në Shqipërisë e asaj kohe, kur vetë gazeta opozitare propagandonte se kufiri i veriut ishte në rrezik nga Jugosllavët[39].

Gjithashtu nën kontroll ishte edhe besimi ortodoks edhe ai musliman. Tek i pari kontrolli ishte më i pakët në përgjithësi, ato kontrolloheshin në lidhjet që kishin me Jugosllavinë për shkak se krahu ortodoks i veriut e kryesisht i Prefekturës së Shkodrës lidhjen e kishte me këtë Shtet. Besimtarët ortodoks duke qenë se ishin të pakët në numër nuk kishin ndonjë organizim politik të mirëfilltë në prefekturën e Shkodrës. Megjithatë gjatë gjithë vitit 1923 kishte pasur një ardhje më të shpeshtë të priftërinjve ortodoksë nga Beogradi[40]. E gjithashtu disa prej tyre kishin shpërndarë edhe para[41] për të pasur një mbështetje më të madhe tek popullsia ortodokse në vend, në krahasim me ato që kishin qenë më parë. Por asnjëherë nuk shihej se kishte një propagandë politike, ngaqë fuqia politike ishte pothuajse inekzistente në Prefekturën e Shkodrës.

Komuniteti Musliman në këtë prefekturë përbëhej nga besimtarë etnik të hershëm që gjendeshin në pjesën më të madhe të zonave elektorale të kësaj prefekture, duke qenë në një numër më të paktë në Mirditë dhe në Lezhë. Pjesa më e madhe e atij grupimi që njihej si musajukan, nga grupimi i orës së maleve, i përkisnin besimit musliman dhe në të njëjtën kohë ishin mbështetësit më të shumtë në numër të qeverisë. Por nuk shohim në këtë kohë se kishte një parti politike të mirëfilltë por kishte një gazetë e cila mbështeste pozitën. Gazeta Vllaznia ishte një gazetë e cila ishte në krahun e pozitës dhe në këtë kohë ishte gazeta më e fortë pro zogiste në prefekturë. Propaganda politike ishte më e pakët ose më e fshehur në kultet fetare. Vetë hoxhallarët kërkonin një nxitje më të fortë për të nxjerrë më tepër figura politike nga ana e

[37] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 200 fl. 18
[38] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 200 fl. 13
[39] Ora e maleve, V. I, Nr. 25, 29 Shtatuer 1923, fq. 1
[40] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 201 fl. 3
[41] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 201 fl. 6

hoxhallarëve, për t'u përballë me krahun katolik sikurse ishte At Fishta, apo Imzot Bumçi[42]. Kjo tregonte se mbështetja politike që bënte kleri katolik ishte duke dhënë rezultate edhe politike. Një gazetë e vetme nuk kishte forcë përballë gazetës Ora e Maleve, dhe revistës Hylli i Dritës që i jepnin mbështetjen kryesore bllokut katolik.

Qeveria nuk ushtron kontroll të madh mbi besimin musliman apo njerëzit e fesë muslimane, por mbi elementë të veçantë të besimit Musliman të cilët mund të shiheshin se ishin kundra krahut qeveritar. Një vëzhgim i imtësishëm në këtë kohë shohim se bëhet mbi Sulçe beg Bushatin. Ai ishte ndër njerëzit të cilët ishin kundra qeverisë. Gjatë gjithë vitit 1923 shtëpia e tij ishte vëzhguar dhe dihej që bëheshin mbledhje për të bërë propagandë anti qeveritare[43] e gjithashtu botoheshin edhe libra kundra qeverisë. Në një kundërpërgjigje të dhënë nga vetë Ministri i Brendshëm, ku mban firmën e Ahmet Zogut, ai lajmëron që Libri automatikisht të mos lejohet të botohet e të shpërndahet[44]. Grupimi që do krijojë në këtë kohë Sulçe begu do të bashkëpunojë më vonë gjatë fushatës zgjedhore për t'u përfshirë me grupimin e Orës së Maleve[45], kundër grupimeve pro zogiste. Një gjë e tillë dihej me kohë nga Ahmet Zogu i cili kishte bërë një kontroll të imtësishëm të veprimtarisë së tij. Por ky bashkëpunim duhej parë me sy pozitiv dhe në një kuadër vërtetë model, përsa i përket bashkëpunimit fetar dhe mungesës së incidenteve sikurse kishte ndodhur në zgjedhjet e mëparshme. Tashmë nuk diskutohej aspak raporti fetar mes dy grupimeve, sepse ishte i ruajtur aq sa kishte qenë më parë. Një problem i tillë nuk diskutohej as brenda grupimit katolik.

Ajo që shihet nga çka u tha më sipër është fakti se ndër tre komunitetet fetare krahu katolik ishte kontrolluar gjatë gjithë kohës nga qeveria dhe veçanërisht nga Ahmet Zogu. Deputetët katolikë, ato që i përkisnin opozitës, ishin ndër kundërshtarët më të fuqishëm të tij edhe para zgjedhjeve në replika të shumta parlamentare. Megjithatë konkurrencë dhe akuza nuk kishte vetëm me krahun qeverisës dhe atë musajukan në Shkodër, por edhe më një grup tjetër pro qeverisë dhe kundërklerikal.

Një grup tjetër i cili u krijua në Shkodër ishte edhe grupi i krijuar nga vëllezërit Ivanaj, grupimi Republika. Edhe ky grupim kishte gazetën e vet me të njëjtën emër, i cili si kryesues kishte Nikolla Ivajan, ish deputetin e Shkodrës në legjislaturën e parë të vitit 1921. Grupi gjithashtu kishte mbështetje nga Ahmet Zogu dhe konsullata Italiane të cilët edhe e subvencionon[46]. Karakteristikë e këtij grupimi dhe risi e këtyre zgjedhjeve në këtë kohë në Shkodër është larmia që sollën jo vetëm në ide por edhe në koncepte. Që në emrin e tij flitej për një sistem republikan të qeverisjes së Shqipërisë. Ky grupim nuk shihte thjeshtë

[42] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 202 fl. 7
[43] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 201 fl. 12
[44] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 202 fl. 16
[45] Ora e maleve, V. I, Nr. 43, 24 Dhjetuer 1923, fq. 1
[46] K. Çefa, Luigj Gurakuqi në një optikë të re, Tiranë 2013, fq. 129

një luftë idesh por një luftë njerëzish e interesash[47]. Në programin e saj të shprehur që në numrin e parë të gazetës ajo ishte për një sistem republikan, një shkollë shtetërore fillore dhe të mesme, e gjithashtu ndarjen e fesë nga shteti dhe heqjen e simboleve fetare, pasi kjo nuk është askund në shtetet e mëdha perëndimore[48], shprehet ky grupim në programin e tij. Kjo gjë tingëllonte dhe replikonte edhe me grupimin e orës së maleve i cili ishte një grupim pro klerikal dhe i krijuar nga vetë ai. Ajo që në këtë rast është si kundërpërgjigje është fakti se si gazeta ashtu edhe revista katolike, nuk merren aspak me konceptin e grupimit politik partiak republikan sesa me nëntekstin që ai përmbante.

Në muajin dhjetor 1923 janë dy shkrime njëri tek Hylli i Dritës, e tjetri tek gazeta Ora e Maleve, të cilët janë si paralajmëruese të rrezikut të socializmit[49] si dhe masonerisë[50]. Me anë të këtyre artikujve mundoheshin të paraqisnin rrezikun që i kanosej vendit nga këto dy rryma fort të lidhuna me njëra – tjetrën. Ky botim në këtë kohë, aq më tepër në kohë prag votimi të zgjedhësve të dytë ishte më tepër një kundërshti ndaj grupimit politik të Republikës, dhe drejtuesit të saj Nikolla Ivanaj, i cili ishte një antiklerikal dhe një njeri framason të cilin edhe vetë e deklaron[51]. Ato deklarojnë se masonët thonë se ne nuk jemi kundra fesë po kundra klerit[52], e si pjesë e kundërshtisë së një sistemi klerikal në jetën politike ishte edhe grupimi Republika. Element pozitiv i grupimit ishte fakti se ato kërkonin njëherë e mirë zgjidhjen e problemit të qeverisjes, kërkonin një sistem republikan sepse kjo nuk e personifikonte në një njeri shtetit por në një të mirë të përbashkët[53], e personifikimi në një njeri të vetëm ishte sistemi mbretëror, ku edhe Këshilli i naltë ishte në atë kuadër. Kurse grupimi i Orës së maleve njihte tërthorazi apo direkt vendimin e Konferencës së Ambasadorëve të cilët kishin lënë për Shqipërinë një sistem mbretëror.

Megjithatë edhe grupi i Republikës nuk pati ndonjë mbështetje të madhe në popull. Ai nuk arriti të nxirrte asnjë deputet dhe vetë Nikolla Ivanaj nuk arriti të fitonte edhe pse kishte një njohje të mirë në Shkodër. Por duke pasur parasysh lidhjen e fortë shpirtërore të shqiptarëve akoma me nocionet fetare e duke pasur një lidhje të fortë të idesë politike me atë fetare në bllokun katolik, idetë dhe mendimet e tija e patën të vështirë të krijonin pasuesit e nevojshëm pas vetes.

Shprehja më e lartë e përfshirjes së Klerit Katolik të asaj kohe në zgjedhje, në mbështetje politike që i jepte grupit të Orës së Maleve është letra që i drejtohet

[47] Republika, V. I, Nr. 1, 24 Tetuer 1923, fq. 1
[48] Republika, V. I, Nr. 1, 24 Tetuer 1923, Po aty.
[49] H. D., V. 1923, Nr. XII, fq. 543 - 545
[50] Ora e maleve, V. I, Nr. 39, 4 Dhjetuer 1923, fq. 1
[51] N. Ivanaj, "Historia e Shqipëniës së Re" P. II, Tiranë 1944, fq. 67
[52] Ora e maleve, V. I, Nr. 39, 4 Dhjetuer 1923, Po aty.
[53] Republika, V. I, Nr. 1, 24 Tetuer 1923, Po aty.

zgjedhësve të parë dhe të dytë me anë të një letre përmbi zgjedhjet e Kuvendit Kushtetues[54]. Mbi bazën e kësaj letre e cila mbante datën 30 tetor 1923, shprehej mbështetja që i jepej grupimeve politike të cilat mbështesnin zhvillimin e politikës mbi baza e parime të krishtera. Në fakt letra është e tillë e cila flet në parim dhe nuk përmend aspak grupimin ora e Maleve, por lë të nëkuptohet se përderisa ky grupim është i krijuar mbi këto parime se edhe Kleri i lartë i jep mbështetjen. Nënshkrues të kësaj letre ishin Arqipeshkvi i Shkodrës, dhe Durrësit, si dhe Ipeshkvit e Sapës, Pultit, dhe Ipeshkvi Abat i Mirditës[55]. Letra ishte pothuajse një muaj përpara zgjedhësve të parë, të cilët kishin për të votuar me datë 26 nëntor, ndërkohë që zgjedhësit e dytë një muaj më vonë. Numri i zgjedhësve të dytë për Shkodrën si qytet ishte 40 vetë[56], çka nënkuptonte se numri i zgjedhësve të parë, sipas rregullit të vendosur 1 zgjedhës i dytë për 250 zgjedhës të dytë, duhet të ishte rreth 10 000 zgjedhës të parë.

Zgjedhjet në fakt përfunduan me një sukses të plotë të grupit opozitar të orës së maleve dhe të Sulçe begut. Nga 6 Zona që kishte Prefektura e Shkodrës, raporti ishte 5 me 1 për Opozitën, ku vetëm në Nënprefekturën Koplik fitoi grupimi proqeveritar[57]. Opozita arriti të fitojë mbi 66 % të votimeve në rang Prefekture e duke shpallur si Mis të Kuvendit kushtetues vetëm kandidatët e Opozitës. Prefektura e Shkodres ishte ajo që nxirrte më shumë deputetë, rreth 13 deputetë, të cilët ishin të shpërndarë në një numër 8 katolikë dhe 5 muslimanë. Deputetët katolikë ishin Luigj Gurakuqi, Shuk Gurakuqi, Nush Bushati, Dom Ndre Mjeda, At Ambroz Marlaska, Luigj Koliqi, Hil Mosi, Pjetër Bumçi, ndërkohë që deputetët musliman ishin Xhemal Bushati, Ibrahim Gjyrezi, Hafiz I. Repishta, Iliaz Muka, Riza Dani[58]. E nga këto 7 deputetë ishin për herë të parë deputet nga Prefektura e Shkodrës.

Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese të dhjetorit 1923, në krahasim me zgjedhjet për Këshillin Kombëtar të prillit 1921, në prefekturën e Shkodrës, ishin më mirë të organizuara. Nuk pati asnjëherë probleme madhore apo incidente gjatë zgjedhjeve; tashmë kishin një organizim më tipik politik, dhe jo një rrëmujë sikurse kishte ndodhur dy vite më parë. Këtu partia proqeveritare doli më dobët se askund tjetër, e grupimet liberale ishin më të fortë edhe falë ndihmës që u dha Kleri katolik[59]. Problemet fetare ishin inekzistente, ndërkohë që grupimet ideologjike nuk munguan. Për sa i përket klerit katolik, ai arriti kulmin e tij politik në atë kohë, duke krijuar një grupim politik të mirëfilltë me baza demokristiane, të përngjashme me ato evropiane.

[54] Fletore e Klerit Katolik të Shqypnis, V. I, Nr. 5, 1923, fq. 107 - 110
[55] Fletore e Klerit Katolik të Shqypnis, V. I, Nr. 5, 1923, Po aty
[56] A.Q.SH. F. 346, V. 1923, D. 7 fl. 2 - 6
[57] Ora e maleve, V. I, Nr. 43 (Shtojcë), 28 Dhjetuer 1923, fq. 1
[58] Shtypi, V. I, Nr. 57, 28 Dhjetor 1923, fq. 1
[59] Dielli, 26 Prill 1924, fq. 2

MA Anton LULGJURAJ
Arkeolog

TRASHËGIMIA ARKEOLOGJIKE E KRAHINËS "HOTIT"

Hoti është një krahinë malore e cila ndodhet në verilindje të liqenit të Shkodrës. Në perëndim kufizohet me fushën e Zetës, ndërsa në veri me krahinën e Grudes. Përgjatë gjithë anës lindore shtrihet krahina e Shkrelit, ndërsa në jug kufizohet me Bajzen e Kastratit. Pjesa më e madhe e Hotit është kryesisht zonë malore, me male të zhveshura dhe me shkëmbinj gëlqerorë. Ultësirat kanë një shtrirje të kufizuar në lindje dhe në perëndim. Në territorin e Malit të Zi bëjnë pjesë fshatrat malore: Traboin, Helmicë, Skorraq, Spinjë, Bardhaj dhe Drume ndërsa në pjesën fushore dhe në brigjet e liqenit të Shkodrës shtrihen fshatrat: Vuksanlekaj, Dreshaj, Narhelm, Ploçë dhe Bozhaj. Në territorin e Shqipërisë bëjnë pjesë fshatrat malore : Brigje, Stare dhe Rapshë si dhe fshati fushor i Kushës.

Krahina e Hotit ka pasur pozitë të volitshme gjeografike sepse ndodhej në kryqëzimin e mëparshem të rrugëve që kalonin nga deti Adriatik në drejtim të Ballkanit qendror dhe Dalmacisë. Lidhjet e këtij regjioni me krahinat tjera kryesisht janë bërë përmes rrugëve natyrore që kalonin nëpër qafa malesh dhe pranë bregut të liqenit. Rruga kryesore dhe me lehtë kalonte pranë brigjeve të liqenit, duke u nisur nga fshati Kushe, nëpër Bozhaj pastaj në drejtim të Narhelmit apo Ploçës e cila në fund bashkohej në Vuksanlekaj. Ndërsa rruga tjetër ka ndjekur lugun karstik që fillonte nga Kalaja e Hotit, nëpër gropat e Drumës dhe përfundon në Spinjë (Qafë Kishë) e cila pastaj zbriste në Vuksanlekaj dhe prej aty merrte drejtime të dryshme.

Përveç pozicionit të favorshëm të rrugëve, të cilat ishin përcaktuese për kontaktet kulturore dhe ekonomike me krahinat përreth, në territorin e Hotit përfshihet edhe një pjesë e konsiderueshme të liqenit të Shkodrës dhe të ultësirave pranë saj, që në të kaluarën siguronin kushte të mira për pështkim dhe bujqësi. Lehtësisht mund të shpjeguhet përqendrimi i madh objekteve arkeologjike pranë këtyre rrugëve dhe përreth ultësirave si dhe liqenit të Shkodrës, që u siguronte atyre të mira ekonomike dhe kushte të favorshme jetese.

Duke gëzuar të gjitha këto favore natyrore, Hoti është një zonë me trashëgimi të pasur arkeologjike në të gjitha periudhat historike. Që nga shekulli i XIX krahina e Hotit ka qenë objekt studimi për shumë studiues të huaj si: Hahn[60], Evans[61], Ippen[62] , Nopça[63], Prashniker[64], etj.

[60]Hahn, J. , Albanische Studien, Jena1854.
[61] Evans, A.,Antiquarian researches in Illyricum I-IV, Westminister1883.
[62]Ippen,Th., Die Gebirge des nordwestlichen Albaniens, Wien1908.

Periudha prehistorike

Kjo periudhë është më së miri e përfaqësuar në krahinën e Hotit në të gjithë shtrirjen e saj kohore, duke nisur me epokën e bronzit në mijëvjeçarin e III-II para Kr. deri në shek. XI p.e.r.[65] Epoka tjetër në vazhdim është ajo e hekurit që fillon nga shek XI-V para Kr., e cila solli zhvillimin e shumë degëve të ekonomisë. Territori i krahinës së Hotit, në këtë periudhë, përfshihej në grupin kulturor të njohur me emrin Mat-Glasinac[66]. Bartësit kryesor të kësaj kulturë ishin ilirët e Ballkanit Perëndimor. Po në këtë periudhë fillon edhe formimi i fiseve dhe nënfiseve të ndryshme, të cilët më pas do të lënë shumë dëshmi në historinë e shkruar. Një ndër fiset më të rëndësishmit është fisi i Labeateve. Sipas autorëve antikë Tit Livit[67] dhe Plinit plak[68], i gjithë territori përreth liqenit të Shkodres në atë kohë është quajtur "Lacus Labeatis" apo ndryshe "Liqeni i Labeateve".

Karakteristike për këtë periudhën prehistorike janë vendbanimet e fortifikuara me mure të trasha të ngritura me gurë të pa punuar të madhësive të ndryshme, kryesisht me forma rrethore ose elipsoide. Ky tip vendbanimesh ka pasur karakter mbrojtës dhe kanë qenë të vendosur nëpër maje kodrash apo vende veshtirë të arritshme. Në gjuhen e popullit dhe në literaturë këto fortifikime njihen me emrin "Gjyteza" apo "Gradina".

Në Hot njohim dy gradina. Njëra ndodhet pranë fshatit Ploçë , në majen e një kodre të quajtur "Gjyteza". Nga ana lindore e mbrojtur nga Balta e Mretit, pjesë e ujrave të liqenit të Shkodres, nga jugu mali i Helmit ndërsa nga ana veriore nga shkëmbijtë të cilët zbresin thikët tëposhtë. Kodra e Gjytezes përbënte një vend shumë mirë të mbrojtur nga natyra. Gjithashtu zotëronte një fushë të gjërë shikimi mbi fushën e Zetes. Nga te tre anët e saj është e mbrojtur nga muri me gurë të lidhur me teknikën në të thatë. Në majën e këtij fortifikimit ndodhët edhe një tumë prej gurësh.

Përveç Gjytezes, jo më shumë se dy kilomtetra larg në juglindje, ndodhet një tjetër fortifikim, i quajtur Samobor[69], i vendosur mbi një gadishull të vogël që hyn në liqenin e Shkodres. Ky fortifikim e ka zanafillën e vet nga një

---

[63] Nopscha, F.. Beitrage zur Vorgeschichte und Ethnologie Nordalbaniens. Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegowina, Wien1912

[64] Praschniker, C - Schober, A. , Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien1919.

[65] Marković, Č. Arheologija Crne Gore, Podgorica 2006, fq.225

[66] Prendi, F. Studime arkeologjike, Unitet dhe veçori në kulturën Ilire të epokës së hekurit në territorin e Shqipërisë, Prishtinë 2008, fq. 742

[67]Livius. Ad urbe condita

[68]Plinius(maior). Naturalis historia

[69]për Samoborin shih autoret : Praschniker, C. - Schober, A., Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien 1919 ; Garašanin, D – M.. Crna Gora u praistorijska doba, Istorija Crne Gore I, Titograd1967 ; Kovačević, M. - Mijović, P. Gradovi i utrđenja u Crnoj Gori, Ulcinj 1970; Mijović, P. Alata-Ribnica-Podgorica, Tragom drevnih kultura Crne Gore, Titograd 1970; etj.

vendbanim prehistorik, i cili më vonë do shëndërrohet në një fortifikatë antike. Analogjia më e afërt e këtij vendbanimi gjendet në Kalanë e Moksetit[70] e cila ndodhet në 4 km largësi në vijë ajrore, në anen tjetër të Liqenit të Hotit dhe komunikojnë lirshem në linjë pamore.

Një tjetër veçori për këtë periudhë është varrimi me tuma.Tumat kanë forma gjysmë sferike dhe varret janë të mbuluar nga dheu, gurët ose nga dheu me gurët bashkë. Të tilla varrime janë karakteristike për popullsinë ilire të kësaj kohe. Zakonisht tuma kanë qenë të vendosura nëpër maje kodrash pranë lumenjve dhe në gjuhën e popullit këtu i thërrasin "mogila" apo si "sukëza". Mënyra më e zakonshme e varrimit, qoftë në tuma apo varreza të dysta, në epokën e bronzit dhe në fillim të asaj të hekurit, është ajo me vendosje trupi me këmbë të mbledhura[71]. Shumica e studijuesve janë sot të një mëndjeje se ky rit varrimi në Ballkan duhet lidhur me shtegëtimet e blegëtorëve indoevropianë të stepave veripontike që në fillim të epokës së metaleve.[72] Ky rit varrimi ishte dominues të popullsia ilire dhe është i përhapur pothuajse në të gjithë Ballkanin Perëndimor dhe Qëndror.

Krahina e Hotit, si pak ndonjë krahinë në rajon, ka një numër mjaft të madh tumash në një hapësirë të vogël gjeografike. Për këtë arsye kjo krahinë paraqet një interes të veçantë për për studimin e këtyre nekropoleve. Për fat të keq shumica e këtyre tumave janë dëmtuar rëndë ose shkatërruar nga ndërtimet ushtarake, nga lirimi i tokave si dhe nga veprimtaria e grabitësve të varreve në kohë të ndryshme. Sidoqoftë, në ditët tona kemi arritur të identifikojmë një numër të madh nga këto kodërvarre. Në shumë vende ato janë të vendosura me grupe. Në disa vende tjera ato janë të veçuara dhe qendrojnë larg nga njëra tjetra. Pjesa më e madhe e tyre janë tuma prej gurësh, përpos tumave në Vuksanlekaj, të cilat janë ndërtuar me dhé. Nga hulumtimi në territorin e kësaj krahine kemi arritur të identifikojmë rreth 80 tuma, të shpërndara rrespektivisht në këto fshatra: në fshatin Drume 22 (afërsi të liqenit 10; në Gjonikaj 9; në Nikgjonaj 2;Vatnikaj 1); në fshatin Skorraq 16 tuma; në Malin Kalturk 13; në fshati Arzë 12; në Malin Doleq 5; në fshatin Spijë 5; në fshatin Vuksanlekaj 3(më heret egzistonin gati 20[73]); në fshatin Traboin 2; në fshatin Ploçë 2, etj.

Periudha antike

Siç u tha edhe më lart, burimet historike na njoftojnë se territori i Hotit ishte i banuar nga fisi ilir i Labeateve. Po ashtu këto burime e përmendin Shkodrën si kryeqytet të Labeateve dhe Meteonin[74] si një qytet tjetër të banuar nga ky fis ilir. Në Meteon ishte edhe strehuar familja e mbretit Gent gjatë luftës me romakët.

[70] Hoxha, G. Kalaja e Moksetit, Candavia 1, Tiranë 2004. f. 246.
[71] Prendi, F. Epoka e bronzit në Shqipëri, Studime arkeologjike, Prishtinë 2008, fq. 581
[72] Po aty.
[73] Jovićević, A. Naselja i stanovništva, knjiga 15, Beograd 1923. Fq. 13
[74]Livius. XLIV 32,3.

Një vendbani tipik i kësaj kohe është përsëri kalaja e Samoborit në fazen e dytë të zhvillimit historik të saj. Ky vendbanim pati ngjallur interesin e studiuesve austriakë Kamilo Prashniker dhe Arnold Shober, qysh në periudhën e Luftës së Parë Botërore. Ata zbuluan këtu muret rrethuese me planimetri në formë eliptike, që qarkonin dy majat e kodrës. Dy faza ndërtimi pasojnë këtu njëra tjetren: faza e parë përkon me periudhën prehistorike, faza e dytë me periudhën helenistike shek. III-I p.e.re[75]. Muri i fazë së dytë ndërtimore është i ndërtuar me tekniken me blloqe gurësh të mëdhenj të latuar dhe të lidhur në të thatë. Autoret në fjalë kanë konstatuar një hyrje në anën juglindore, e cila mbrohet nga ana e majtë e saj me një bastion dhe një kullë mbrojtëse. Në këtë vendbanim janë gjetur shumë fragmente amforash të periudhës helenistike. Po ashtu këtu janë gjetur edhe një numër i madh monedhash, të cilat janë të preranë punishtet monetare të qytetev antike si : Korinthi, Apollonia, Dyrrahu dhe Scodra në intervalin e viteve 225-100 para Kr[76]. Këto gjetje na deshmojnë direkt për kohen e funksionimit të këtij vendbanimi ilir. Si bashkëkohës të vet, faza e dytë e vendbanimit të Samoborit, ka ngjajshmeri me Gjytetzen e Dinoshës[77], me Kodren e Moksetit[78] dhe me fortifikimin e Obollonit[79].

Periudha e zotërimit romak, fillon në vitin 168 para Kr., me fitoren e romakëve në betejën pranë mureve të Shkodrës. Kjo periudhë solli mjaft ndryshime, sidomos në fushën e ndërtimtarisë dhe punimeve inxhinierike. Kështu u ndërtuan vendbanime të reja, ura, rrugë etj. Një shembull tipik për këtë periudhe në këtë krahinë kemi vendbanimin në fshatin e sotëm të Vuksanlekajve. Dëshmi të këtij vendbanimi janë sot, shumë fragmente arkitektonike dhe qeramikë të gjetura gjithandej në territorin e këtij fshati. Nder gjetjet më të rëndësishmet janë dy mbishkrimet funerare në gjuhen latine të përshkruara nga studiuesi austro-hungarez Franc Nopça gjatë vizitës së tij në këtë fshat.[80] Të dy këto mbishkrime ruhen sot nga freterit e urdhërit Françeskan në kishen e Tuzit. Ato paraqesin një interes të veçantë sepse përmbajnë në vetvete emra ilirë si psh.: Pletia Titulla (Plaetia Titulla), bija e Pletorit Jul (Pletoria Julia)[81].

Një tjetër vepër e kohës romake është këtu rruga rëndësishme regjionale, që fillonte në Shkodër dhe përfundonte në Narona. Kjo rrugë duhej të kalonte patjetër përmes brigjeve të Hotit apo ndoshta pak në brendësi të saj. Sipas

[75] Prashniker, K. dhe Shober, A. Kerkimi arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi, Tiranë 2003, fq. 92

[76]Prashniker, K.-Shober, A., Kerkimi arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi, Tiranë 2003, fq. 94 .

[77] VELIMIROVIĆ-ŽIŽIĆ, O. Ostaci fortifikacione arhitekture na gradini Djuteza u Dinošima kod Titograda, Materijali XXII, Novi Sad 1986

[78] Hoxha, G. Kalaja e Mokseti, Candavia 1-2003, Tiranë 2003, fq. 245

[79] Mijovic, P. – Kovacevic, M. , *Gradovi i utvrdjenja u Crnoj Gori*, Ulcinj 1975.

[80] Prashniker K. dhe Shober A. , Kerkimi arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi, Tiranë 2003, fq95

[81] Garašanin , D – M. Istorija Crne Gore, Titograd 1967. fq.200.

studiuesve Prashniker dhe Shober ajo duhej të kalonte në fshati Drume, emri i te cilit mund të shpjegohet me fjalën greke δρομος[82] që d.m.th rrugë.
Jemi në dijeni për disa gurë miliarë, pjesë të kësaj rruge të identifikuara më herët në Malësi. Një ndër to është gjetur në Vuksanlekaj[83]. Kjo rrugë është e regjistruar gjithashtu në itinerarin e Antoninit[84] dhe në Tabula Peutingeriana[85]. Më rëndësi është këtu edhe përmendja e disa stacioneve rrugore si : Birsimno dhe Cinna. Sipas mendimit të shumë studiuesve [86] këto stacione janë vendosur në fshatin Vuksanlekaj apo në Samobor pranë liqenit.

Antikiteti i vonë

Territori i sotëm i krahinës së Hotit bënte pjesë në provincen e Praevalis, si provincë kufitare e Perandorisë së Lindjes[87]. Karakteristike për këtë periudhë janë dyndjet barbare, përpjekja e vazhdueshme për rivendosjen e pushtetit Bizantin në këtë provincë dhe përhapja e gjërë e Krishtërimit[88].
Nga kjo periudhë në krahinën e Hotit kemi kalanë me të njëjtin emër 'Kalaja e Hotit'[89], që ndodhet pranë Liqenit të Hotit, e ndërtuar për të mbrojtur rrugën që kalonte nëpër lugun e Drumes, gjatë periudhës së perandorit Justinianit në gjysmen e parë të shek. VI[90]. Kjo kala ka ngjajshmëri me Gjytezen e Dinoshës[91]. Jo larg nga kjo kështjellë në Fushen e Kushës ndodhet Bazilika Paleokristiane[92] çka e përforcon mendimin se këtu ishte një vendbanim i madh. Poashtu jo larg nga fshati Vuksanlekaj[93] janë gjetur gjurmë varrezash me tjegulla të mëdhaja tipike për antikitetin e vonë e që i përkasin shek. e IV të ngjajshme me varret e Docleas.

Periudha mesjetare

Në shek. IX-XII territori i Malësisë apo i Hotit në veçanti, ndodhej në një zonë konfliktesh të shpeshta në mes shtetit të Bizantit me shtetin Dukles. Nga shek.

---

[82] Prashniker K. dhe Shober A. , Kerkimi arkeologjike në Shqipëri dhe në Mal të Zi, Tiranë 2003, fq. 91.
[83] shih për Vuksanlekaj : Nopscha, F., Beitrage zur Vorgeschichte und Ethnologie Nordalbaniens. Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegowina, Wien 1912; Praschniker, C - Schober, A., Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro, Wien 1919; Garašanin, D – M.. Crna Gora u doba Rimskog carstva, Istorija Crne Gore I, Titograd 1967a; Mijović, P. Alata-Ribnica-Podgorica, Tragom drevnih kultura Crne Gore, Titograd 1970; Marković, Č., Arheologija Crne Gore, Podgorica 2006.
[84] Itinerarium Antonini Augusti, Itineraria romana (tek: Ilirët dhe Iliria nga autoret antik)
[85] Tabula Peutingeriana, ed Miller Iteneraria Romana (tek: Ilirët dhe Iliria...)
[86] Istorija Crne Gore,Prva knjiga,Titograd 1961,fq.171
[87] Hoxha, G. Scodra dhe Praevalis në antikitetin e vonë, Shkodër 2003, fq.17
[88] Po aty. fq.127
[89] Hoxha, G. Kalaja e Hotit, Candavia 1-2003, Tiranë 2003, fq. 89
[90] Po aty. Fq. 89
[91] Velimirović-Žižić, O. Ostaci fortifikacione arhitekture na gradini Djuteza u Dinošima kod Titograda, Materijali XXII, Novi Sad1986.
[92] Gëzim Hoxha, Kalaja e Hotit, Candavia 1-2003, Tiranë 2003, fq. 89
[93] Pravilović, M. Arheološki Pregled, Vuksanlekići – Kasnoantička nekropola. 1986. fq.182-183.

XII deri në shek. XIV kjo zonë ishte nën pushtimin serb të Nemanjiqve dhe do të lirohet me vdekjen e carit Dushan në vitin 1355. Kjo periudhë tranzicionit një shekullore do të pasojë me luftëra të shpeshta në mes të feudalve të fortë lokal të Balshajve me Republikën e Venedikut e cila do të dalë fituese dhe do ta mbajë pushtetin në këto troje deri me ramjen e Shkodrës në vitin 1479.
Nga burimet historike të shek. XIV-XV, fisi i Hotit përmendet si një fis shqiptar luftarak i cili shpesh ndodhej në konflikt me Balshajt në shërbim të Venedikut[94]. Poashtu sipas defterit turk nga viti 1497, perfshinte fshatrat : Tigomiri, Machalani, Pobresani, Bexichi apo Bachsi, Lubici dhe Chechi. Në grupin e katundeve të dhënë në vitin 1455 rreth Hotit haset edhe Nelmica dhe Fichsta[95]. Me gjithë informacionin historik që disponojmë, gjurmët e këtyre fshatrava mesjetarë janë pothuajse te pamundura të lokalizohen.
Faktor dominues dhe i pazëvendsueshem në jetën shoqërore janë kisha dhe krishterimi. dëshmohet për herë të parë në fillimet e shek. të IV pas Kr. Në Hot dëshmi të vetme nga mesjeta që mund të shihet edhe sot është kisha në vendin e quajtur Qafëkishë në jugperëndim të fshatit Spijë.
I pari që e zbuloi këtë kishë ishtë arkeologu austriak Theodor Ippen[96] dhe bashkë më të dhe një mbishkrim. Duken sot në sipërfaqe disa murinjë të mbuluar nga vegjetacioni. Nga përmasat e saj duket një kishë e vogël një nefeshe dhe e rrethuar me varreza. Mbishkrimi i zbuluar nga Ippen, ruhet sot gjysma e tij ne Kishën e Shën Ndout në Tuz. Ky mbishkrim na lë të kuptohjmë vetëm që është e vitit 1500 dhe ka pasë të bëjë me një murg. Po ashtu ka gjurmë kishash në fshatrat Sukruq = Kirza; Narhelm = Livadi i Kishës ; Ploçë = Livadet e Ploç's

Disa fjalë përmbyllëse

Kështu pra duke parë rezultatet e kërkimeve më të hershme arkeologjike në këtë rejon si dhe ato çfarë disponojmë në ditët tona mund të themi lirshëm së kjo krahinë paraqet një vend të pasur dhe me interes për arkeologjinë.
Krahina e Hotit përben një ndër krahinat më të pasura arkeologjike jo vetëm në Malësi por edhe më gjerë. Në këtë krahinë i kemi të përfaqësuara të gjitha fazat e zhvillimit njerëzor dhe sidomos periudha prehistorike me atë antike.
Shpresojmë që për këto monumente dhe gjurme te lashtesise të rritet perseri interesimi i studiuesve te arkeologjise dhe historise se vjeter. Gjithashtu mendoj se trashegimia e pasur arkeologjike kesaj krahine eshte nje potencial mjaft atraktiv per turistet. Studimi shkencor dhe valorizimi arkeologjiko-historik i ketyre monumenteve, te kombinuara se bashku, do të ishin zgjidhja me e mire ne dobi te komunitetit te kesaj krahine.

[94]Schmitt, O. Arbëria Venedikase, Tiranë 2007.
[95]Božić, I. Vladavina Crnojevića, Istorija Crne Gore II tom-2, Titograd 1970. Fq. 348-370
[96]Ippen , Th. 1909; përkthimi shq. : (Ippen , Th., Malësia e Shqipërisë veriperëndimore, Shqipëria e vjetër, Tiranë 2002. Fq. 31)

Dorian KOÇI

ARAPËT NË SHQIPËRI

Prania e popullsisë zezake ka qenë e pakët në Shqipëri. Edhe pse territoret shqiptare bënin pjesë në Perandorinë Osmane, në një perandori konglomerat për nga popullsia, etnitë dhe besimet fetare , prania e kësaj popullsie nuk ka lënë gjurmë të forta në këto territore. Zakonisht njerëzit nga popullsia zezake shërbenin pranë pashallarëve të fuqishëm shqiptarë dhe ishin objekt kurioziteti mes shqiptarëve. Ata ishin robër lufte apo dhe ushtarë që kishin marrë pjesë në fushatat e mëdha osmane për të nënshtruar territore afrikane, si ishte rasti i pushtimit të Sudanit nga fuqitë e Mehmet Ali Pashës. Në këtë fushatë morën pjesë shumë forca mercenare shqiptare, prijësit e të cilëve kur u kthyen në Shqipëri, sollën me vete edhe robër zezakë apo dhe ushtarë të rekretuar që u shërbenin besnikërisht. Gjurmë të drejtë për së drejta të këtyre personave nuk gjejmë, në popullsinë e sotme në Shqipëri, por përmes shkrimeve dhe tablove mund të evidentohen lehtë prania e tyre në Shqipëri. Bajroni në takimin e famshëm me Ali Pasha Tepelenën në tetor 1809 , kur përshkruan hyrjen e personazhit letrar Child Harold në kështjellën e Tepelenës përmed mes popullsive të tjera që baresin në oborr, dhe etiopianë.

Rëndom mbi prag të portës që kërcet,
Nget kalin shpejt ndonjë tartar fesgjatë.
Turq, grekë, shqiptarë, arapë aty përzien
Në lloj-lloj ngjyra gjer sa zëri i mbytur.

Më poshtë kur përshkruhen popullsitë përmenden sërish etiopianët.

Delinë me qylaf e jatagan,
Grekun dinak, të zinë bir me cen
T'Etiopisë.

Nuk mund të nxjerrësh nga këto vargje sesa duhet të ketë qenë numri i tyre në Tepelenë, por të paktën për një personazh historik, gojëdhëna e ka sjellë deri në ditët tona se mund t'i përkiste kësaj popullsie. Vetë , Jusuf Arapi, një nga besnikët e Ali Pasha Tepelenës, mendohej se ishte një mulat dhe gjysëm vëlla i Pashait, që i ati i tij Veliu, e kishte me një skllave

haremi etiopiane. Mbiemri i tij është një provë linguistike që dëshmon origjinën e tij. Po kështu në tablonëe njohur të Dypre-së, ku Ali pasha Tepelena është duke gjuajtur në liqenin e Butrintit , ai është i paraqitur si esmer , i veshur me rroba popullore shqiptare dhe qëndron në krye të kiçit të barkës.
Gjithësesi përqëndrimi më i madh i kësaj popullsie, çuditërisht gjendej në Ulqin, , në pjesën më veriore të aeralit etnik shqiptar që pas pushtimit të tij nga otomanët në 1571, kishte hyrë n disa zhvillime të vrullshme demografike. Për aq sa dëshmon historiani anglez Anoel malcom në librin e vet "Agjentët Perandorakë", Ulqini ishte një qytet etnikisht shqiptar, me popullsi që i përkiste besimit katolik. Dy nga familjet më të mëdha fisnike të kohës , Brutti dhe Bruni do të luanin një rol të madh në historinë e rajonit dhe të Evropës. Rënia e Ulqinit në duart e osmanëve, ndryshoi strukturën urbane, sociale por edhe ushtrimin e ndryshëm të zejtarive. Ulqini gradualisht fillon dhe merr pamjen e një qyteti oriental, me ndërtime të objekteve të kultit islam, krojeve si vend relaksimi dhe meditimi por edhe me ndalimin e prodhimit të verës dhe vazhdimin e prodhimit të vajit të ullirit. Ai vazhdon të mbetet një derë komunikimi midis Lindjes dhe Perëndimit, përderisa mendohet se Sabaedin Zeevi, i ashtëquajturi Messia hebre , brakstis Beratin dhe shkon dhe vendoset në Ulqin. Një nga zejet më të përhapura bëhet si në asnjë qytet tjetër shqiptar të bregdetit, ndërtimi i anijeve dhe lundrimi. Venedikasit në luftërat dhe paqen e nënëshkruar me osmanët bënin çmos që deti Adriatik të mbetej një liqen venedikas, pa lejuar ndërtimin e porteve osmane në brigjet e Adriatikut lindor. Kjo luftë e hapur midis tyre kishte dëmtuar dhe lundrimin në brigjet shqiptare, të cilat nga një element mbizotërues dikur me popullsinë ilire, ishin kthyer tani nënjë popullsi që nuk e mbarështonte ndërtimin e anijeve dhe në përgjithësi kulturën e detit. Ulqini, bënte një përjashtim në këtë drejtim dhe llojet e ndryshme të anijeve që prodhonte si dhe flota që mbante e kishin shndrruar në një qytet të rëndësishëm për Perandorinë Osmane, pasi flota e tij përdorej në ballafaqimet dhe betejat detare të saj me Perëndimin. Përdorimi dhe mbajtja e kësaj flote lidhet ngushtë dhe me praninë e popullsisë zezake në Ulqin. Popullsia zezake fillimisht kishte ardhur aty si skllevër te blerë në pazare të skllevërve në Vlorë nga detarët ulqinakë për të shërbyer në anije. Pazare të tillë skllevërish siç dëshmon Pouqeuville kishte dhe Butrint apo Prevezë, ku sundimtarët lokalë blinin robër të kapur nga anijet e piratëve. Duke qenë se lundrimi vazhdonte të ishte ende i bazuar dhe në rrema, ky proces kërkonte një fuqi të madhe njerëzore që qyteti i ulqinit nuk mund ta përballonte me popullsinë e vet. Kjo ishte dhe një nga arsyet e blerjes së skllevërve dhe vendosjes së tyre në Ulqin në një lagje të veçantë. Kaq e rëndësishme ishte kthyer prania e këtyre familjeve dhe skllevërve zezakë sa dhe fuqia ekonomike e familjeve ulqinake varej pikërisht prej numrit të zezakëve qe kishte në kuadër të familjes. Nuk ka të dhëna të sakta se sa ishte realisht numri i zezakëve në Ulqin, por afërsisht themi se ishin disa dhjetëra, e kjo ka të bëjë sidomos në shekujt e XVII dhe XVIII e deri në fillimet shek.XIX. Për shkak se ra kërkesa

për fuqi njerzore për anije me rrema, numri i tëardhurve rishtaz u pakësua. Në këtë kontekst duhet të ketë ndikuar edhe ndalimi i skllavërisë nga Franca në 1803 dhe Anglia në 1807, si dhe hyrja në urbanizimin kapitalist dhe modernitetin në legjislacion të Perandorisë Osmane. Kjo populsi e mbetur në Ulqin, më vonë fitoi lirinë dhe u integrua ne jeten e qytetit. Në aspektin social, komuniteti i harapëve siç quhen në Ulqin, në shumë aspekte ata u bën pjesë e familjeve ulqinake, duke punuar në bashkësitë familjare por edhe angazhimin në detari, bujqësi e shërbime tjera. Ata, bashkëjetuan me shqiptarët, morën nga kultura shqiptare por edhe i dhanë kulturës shqiptare aq sa kishin mundësi, ku në mënyrë të veçantë dallohet fusha e folklorit. Interesant është mbiemri dhe etnonimi që kjo populsi ndan që nga jugu i Shqipërisë e deri në veri, një formë arkaike e shqipes harapi ose arapi.

Duke ndarë fatin me shqiptarët ata moren mbiemrat e familjeve shqiptare ku ishin vendosur, por edhe u shperngulen me agallarët e beglerët ulqinakë siç ishte rasti në vitin 1880, duke u vendosur në Shkodër, kur Ulqini iu dorëzua Malit të Zi nga ana e Fuqive të Mëdha.Si dëshmi kemi pasardhësit e tyre që janë edhe sot në Shkodër ndonëse në numër të reduktuar, sikurse edhe në Ulqin. Në 1916, piktori i njohur Kol Idromeno na ka lënë një pikturë të titulluar “Arapi i Beledijes”. Ka të ngjarë që Arapi, që shërbente pranë bashkisë së Shkodrës të jetë një prej këtyre zezakëve të Ulqinit.

Gani KARAMANAGA

RRËNJËT
(fragment)

Dorëzimi i Ulqinit

Pas 309 vjetësh të sundimit otoman,Ulqini përfundimisht i është dorëzuar Malit të Zi me 26 nëntor 1878. Kongresi i Berlinit u hap më 13 qershor 1878. Pas një muaji punimesh,Kongresi morri një vargë vendimesh për rishikimin e Paqes së Shën Stefanit dhe për rregullimin e gjendjes në Ballkan. Morën pjesë Fuqitë e Mëdha: Britania e Madhe, Gjermania, Austro-Hungaria, Franca dhe Italia. Me vendimin e parë Malit të Zi i takonin Plava, Gucia, Podgorica dhe Tivari. Me intervenimin e Rusisë, Sërbisë dhe Malit të Zi Turqia obligohet që Malit të Zi t'ia dorëzojë edhe Ulqinin. Por, pati rezistencë të madhe prej popullit të Ulqinit dhe të Shkodrës…

Anijet e Fuqive të Mëdha të ankoruara në Gravozhë(Raguzhë-Dubrovnik shtator tetor 1880

Lufta e Klleznës për mbrojtjen e Ulqinit

Rreth 3.000 vetë që morën pjesë në mbrojtjen e Ulqinit, nën komandën e ulqinakëve *Mehmet Becit* e *Mehmet Gjylit*, si dhe *Isuf Sokolit* nga Shkodra, zunë pozitat kryesore në rethinat e Ulqinit në fshatin Kllezën, ku edhe u zhvillua lufta(më 23 nëntor 1880). Megjithatë, forcat turke të cilat ishin shumë

më të mëdha, pasi i thyen forcat ulqinake-shkodrane, nuk patën pengesa të tjera për të hyrë në Ulqin.Të gjitha pikat strategjike, duke përfshirëedhe lartësinë e Mozhurës qenë të okupuara nga *Dervish Pasha*, i cili i informoi banorët e qytetit që Ulqini do t'i dorëzohet Malt të Zi. *Dervish-Pasha*,pra ka hyri në qytet më 23.nëntor 1880, kur ulqinakëve të tubuar u drejtuar me fjalët se dorëzimi është definitiv, dhe se duhet t i nënshtrohen këtij vendimi. Kur mbaroi fjalët,nga grumbulli i qytetarëve të tubuar të Ulqinit, befas doli një femër trimëreshë.Ajo i doli përpara,ia kapi frerët e kalit dhe i tha:

*"Aman,more Pashë,për hatër të Zotit,mos na shtjerë në dorë të hasmit,ma mirë të na mbysësh se sa të na lësh nën shqa…"*Ishte kjo ulqinakja, *Sulltana Cungu,* gruaja e Mehmet Cungut, këpuctar, bijë e familjes Idrizaga.

Kështu Ulqini, pas një lufte diplomatike në mes të Fuqive të Mëdha dhe Malit të Zi me Turqinë dhe të demonstrimit, deri atëherë të një flote detare të paparë, më 26 nëntor 1880, i jepet Principatës së Malit të Zi dhe hyri në një periudhë të re të historisë së vet.

Meqë ishte puna për një qytet të banuar vetëm me popullësi shqiptare pasojat e një akti të tillë sollën mjaftë vështërsi. Një pjesë e madhe e popullatës shumë vështirë u është adaptuar kushteve të reja të jetesës të cilat ishin fare të tjera nga kushtet e jetesës në kohën e sundimit otoman, i cili në këte qytet ka zgjatur mbi 300 vjet. Prandaj ka qenë i kuptueshëm vendimi i 463 familjeve që ta lëshojnë qytetin dhe të shpërngulen kryesisht në Shkodër, Durrës, Lezhë….por jo edhe në Turqi.

Më vonë Turqia hapi konsullatën në Ulqin. Kur Ulqini bëhet pjesë e shtetit të Malit të Zi, aty kanë jetuar vetëm dhjetë familje malaziase. Më 1894 Ulqini ka qenë qyteti i dytë më popullësi në Mal të Zi. Ka pasur 1.000 shtëpi për banim dhe 4.000 banorë.Në qytet kanë jetuar Arbanasët-detarë, varoshi është ndarë në këto lagje:Rana, Pazari, Kalaja si edhe disa mëhallë.

Ulqini në Mbretrinë shqiptare

Vula e Bashkësisë së Ulqinit 1943

Pas okupacionit të ish Jugosllavisë së Parë në prill më 1941, Ulqini si vend me shumicë popullatë shqiptare i takonte *Mbretnisë së Shqipnisë* prej vitit 1941-1945. Kufiri ka qenë te Ura e Mërkotit (ku edhe sot është kufiri ndërmjet

komunës së Tivarit e Ulqinit). Atëherë Ulqini ka pasur edhe Myftininë e vet. Myftiu i fundit ka qenë *hfz. Hasan ef. Mavriqi.*

Babai im *Hasan Karamanaga,* me një kujdes të veçantë i ka ruajtur dokumentet e vjetra. Pas vdekjes së tij, më 20 gusht të vitit 1968, nëna ime në arkën e nusërisë së saj e ka vazhduar ruajtjen e dokumenteve. Pas saj, vëllau Ismeti e ka marr arkën e nënës me të gjithë dokumentacionin e babës.

Duke finalizuar librin në dorëshkrim *"Rrënjët*" edhe një herë i shikova letrat e vjetra të babait. E vërejta se dokumentacioni prej fundit të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX deri në vitin 1941 është në gjuhën malazeze, ose në gjuhën turke osmanishte të vjetër.*Por, disa dokumente prej datës 1941 e deri më 1944 ishin në gjuhën shqipe. Një dokument është nga notari Eduard Suma nga Shkodra, kurse dokumenti tjetër është nga Bashkia e Ulqinit.* D.m.th. gjuha zyrtare në Ulqin atëherë ishte *shqipja.*

Babai, me siguri me pedanterinë e vet e ka ditur vlerën e këtyre dokumenteve dhe i ka ruajtur me kujdes të madh. Ka qenë njeri i qetë, fetar, punëtor i palodhshëm. Siç shihet ishte edhe patriot i vërtetë.

Kjo gjë e vërteton faktin se në periudhën 1941-1945 në Ulqin është përdorur si zyrtare vetëm gjuha shqipe.Edhe teksti im "*Shkolla Fillore Skenderbeu në Ulqin"* është vërtetimi i tezës së elaboruar.


MBRETNIJA SHQIPTARE
BASHKIJA E ULQINIT
Nr. 52 Data 20-I-943-XXI

Gjykatës Paqtuëse

Këtu

Me palet kontraktuëse Ju dërgohet lutja e shitsit Vlado Jankovig nga Ulqini, me shenim se shpallja ka qendruë e mvarun 8 (tet) ditë nër vende të dukshme dhe gjat ksajë kohë nuk asht paragitë ndonji kundërshtim ose pretendim, nga e cilla arsyë si mbas dispozitave të Kodit civil në fugi nuk ekziston ndonji pengim për vërtetimin e kontratës.

Ulqini, me 28/I-1943 xxi

Kryetar i Bashkisë

BASHKIJA ULQINIT

Dokumenti shqip nga Bashkija e Ulqinit me 20.janar 1943

MBRETNIJA SHQIPTARE

Dr Eduard Suma
Noter Publik
SHKODER

Nr. i Repertorit 13423
Nr. i Koleksjonit 5994

N' E M E N
të
SHTETIT SHQYPTAR

Premtim Akt shitje

Notë Shpenximesh

	Fr. a.	Qind.
Taksë Gjyqsore	2	-
„ Komunale	-	30
„ Arsimi	-	-
Pulla Finance	3	-
„ K. K.	-	40
Shperblim Noteri	2	33
Taksë Arkive		
Gjithsejt Fr. ari	8	03

Vjeti njimiendandqindekaterdhetekater,me njizetendandë-
të mojit të Marcit në Shkoder e në zyre noterjale t'eme
të vendueme në rrugen e Jezuitve Nr.2.----------
Sot perpara meje Dr.Eduard Suma,noter publik,i rregjis-
truem pranë Gjykatës së Shkallës parë Shkoders e në pra-
ni të dishmitarve Zotni Musa Hoxha i të ndyerit Tahir,-
le e banues në Ulqinë,tregtar,e Et-hêm Ademi i të ndye-
rit Adem Kubës,le e banues në Shkoder,sengser,të cillt-
deklaruen se kan të gjitha cillsinat e kerkueme prej li-
gjit,personalisht u paraqitne: ----------
1).Zotni Hasan Kahremanaga i të ndyerit Ismajl,le e ba-
nues n'Ulqin,detar,e ----------
2).Zotni Vllado Jakoviq i të ndyerit Jovan,le e banues-
n'Ulqin,puntuer,per identitetin personal të cillve u si-
gurova nga ana e dishmitarve të njoftun prej meje e qi-
kan cillsi edhe si [illegible],dhe të dy mbas dek[illegible]
të bamë se kan zosni juridike të plotë me vullndetin e-
vet krejtë të lirë më kerkuen kompilimin e ktij akti në
termat qi vijojnë: ----------
Art.I).Zotni Vllado Jankoviq deklaron se,me hirin e -
vet të plotë premton dhe obligohet me i shitë Zotni ---
Hasan Kahremanagës,qi premton me blé,pasuninë e poshtë-
rreshtueme: ----------
1).Tetë rrajë ullij bashkë me token perkatëse në vendin
e qujtun Ana e Malit e kufizueme,Lindja:Ullishta e Vlla-
dos;Prendimi:Ullishta e Hasan Kahremanagës;Veri:Mali i-
bardhë;Jugu:Rruga e ullishtës; ----------
2).Dhetë fije ullij bashkë me vendin perkatës në ve--
ndin e qujtun "Ana e Malit"te kroni i thatë,e kufizueme,
Lindja:Ullishta e blesit;Prendimi:Ullishta e Vllados;Ve-
ri:Mal'i bardhë;Jugu:Rruga e Ullishtës; ----------
3).Katermbdhet rrajë ullij bashkë me token perkatëse-
në vendin e qujtun "Mal'i Bardhë"e kufizueme,Lindja:Ul--
lishta e Hysejn Lamos;Veri:Mali i bardhë;Jugu:Ullishta
e Vllados; ----------
4).Gjashtë rrajë ullij zbashkut me token perkatëse në
vendin e qujtun Ana e Malit e kufizueme,Lindja:e Veri:
Hasan Kahremanaga;Prendimi:Vllado Jankoviq;Jugu:Hysejn-
Lamovija.----------
Art.II).Çmimi i shitjes u caktue per shumen e Frang -
Shqyptar 6340(gjashtmietreqindekaterdhetë)të cillen shumë
premtues shitsi deklaron se e ka marrë krejtsisht dhe me

Dokumenti nga Eduard Suma në Shkodër

Kepi "Suka"

Kepi "Suka" në anën e majtë, dhe Kalaja në anën e djathtë të Gjirit përqafojnë Plazhin e qytetit dhe janë ndër ëmblemet më të rëndsishëm të Ulqinit.

Gjatë shekullit XX, kepi " Suka" ishte vendëndodhja e disa ngjarjeve lidhur me historikun si edhe dhe hotelierin e Ulqinit.

Shtëpia e Beqir Sumës

Në kepin "Suka" ka qenë shtëpia e bukur e *Beqir Sumës.* Kjo shtëpi më përpara ishte pronë e *Ismail-Pashës*.

" *Mısır ümerasından Mirimiran Ülgünlü İsmail Paşa'nın Ülgün'ün Karadağ'a terkine muhalefet ve mukavemetle istiklal ve muhtariyet fikriyle çeşitli alanlara yazdığı fesat mektuplarının önlenmesi ".*

Përkthimi: Ndalesa e letrave të shkruara prej Bejlerbeut të Egjiptit ulqinakut Ismail Pashes i cili bënte çrregullime në shumë drejtime si, të kundërshtuarit e dorëzimit të Ulqinit Malit të Zi dhe idetë për autonomi e mëvetësi. Arkivi Osman i Kryeministrisë - Stamboll.(Dokument nga katalogu.Fondi: Y..PRK.BŞK. Dosya: No : 3/65.Data: 14/Za/1297 (Hicrî) –e përktheu Ali ef.Bardhi).

Për këte shtëpi shkruan edhe mjeku malazias *dr. Petar Miljaniq* në vitin 1896 në "*Glas crnogorca"*.

Në mënyrë të dhunëshme Beqir Suma shpërngulet prej Ulqinit dhe *Nikolla Petroviq* shtëpinë e tij sundimtari i Malit të Zi e merr për të bërë pallatin e vet për pushim në Ulqin. Atëherë janë bërë përpjekje që këte lokalitet ta emërojnë "*Ratislava*", por mbetet emri i gjithmonshëm *Suka.*

„Avgusta g.1884 javi mi Knjaz telegrafom da će doći s Knjeginjom i velikom svitom i da će ga pratiti sto i pedeset vojnika...Poslije objeda poša je Knjaz da počine, ali prije toga pozva me i naredi mi, da mu svakako oslobodim i prigotovim za konak i dalje bavljenje kuću Skadranina Sume na Suku,...Objašnjava sam mu, da sam ja, za njegovu mirnoću i sigurnost ispraznio sve okolne kuće...To ništa nije pomoglo i morao sam učiniti po njegovoj volji i ako ne bez muke,jer Skadranin ne htje iz svoje kuće, te sam ga jedva i silom diga". („Memoari"Vojvoda Simo Popović,Cetinje 1995).

" Më 19 gusht të v.1884 më lajmëron Knjazi(Nikollë P.) me telegraf se do të vijë me Princeshën ...Pas dreke Knjazi shkoi të pushonte, por që më përpara më thirri dhe më dha detyrë,që t ia liroj shtëpinë e shkodranit Suma, në Sukë…Ia shpjegova që unë, për qetësinë dhe sigurinë e tij i kam zbrazur të gjtha shtëpië përreth. Kjo nuk ndihmoji asgjë, dhe më është dashur të veproja sipas dëshirës së tij, edhe pse pa mundim, sepse shkodrani nuk desht të dilte prej shtëpisë të vet, andej unë me zi e qita jashtë.."("Dija 10"nga MEMOARET e Vojvoda Simo Popoviqit-përgatiti Hajro Ulqinaku).

Beqir Suma, nuk është pajtuar që ta lëshoj shtëpinë e tij, dhe prej atëherë kjo familje shpërngulet definitivisht prej Ulqinit. Kur e kanë larguar prej shtëpisë së tij ai ka thënë:"*Ja Resululla(Zoti i Madh), kush do të vijnë këtu dhe cila kam(këmbë) të shkel në këte shtëpi, mos baftë berhada(mos paçin përparim)…"*

Fadil KROMA

ZHVILLIMI I VEPRIMTARISË BOTUESE DHE I LIBRARIVE NË ULQIN

Përmes hulumtimeve të cekura në librin e Dr.Dushan Martinoviqit ”Shkenca për Librin në Mal të Zi”faqja 60 përmendet edhe emri i botuesit Lukë ulqinaku (Lluka Ulcinjanin), i cili kish jetuar në Venedik prej me 1517- 1558. Ky tipograf i pa njohur nga fillimi i shekullit të XVII u gjeti shënuar në një postinkunabulë të Fratit Jerolim Sevanorole. Paramendohet që mbiemrin ky botues e kish marrë nga prejardhja latine e emrit të qytetit të Ulqinit (Olcinium, Olchinium, Dolcingo), që dëshmon se ky botues ishte me origjinë ulqinake..
Ashtu siç patëm dëshmuar Ulqini një kohë të gjatë ishte nën sundimin e perandorisë turke. Në periudhën e cekur nuk ishte e zhvilluar botimi i librave, por kryesisht kishte vetëm libraria private. Dhe pronarët e këtyre librarive, librat i siguronin nga anash.
Librarinë e parë e hapi Ilija Mashanoviq në vitin 1931 e cila punoi deri në vitin 1963. Ky qytetarë i dall-uar, përveç librave për nxënës, shiste edhe material tjetër që ishte i nevojshëm për nxënës dhe administratë (lektyra shkollore, ngjyrë shkrimi për nxënës, bloqe shkollore, ngjyra dhe lapsa, letër shndritëse etj). Shiteshin edhe panorama me pamje nga Ulqini të cilat botoheshin në Beograd apo Zagreb.
Pas vitit 1947, lokali i Ilija Mashanoviqit, kalon në sektor shoqëror, kështu që Mashanoviqi u bë zyrtar punë drejtues, deri në pensionimin e tij. në vitin, 1963. Libraria u bë edhe vend i tubimit të intelektualëve ulqinakë. Nga ajo që u cek më parë lihet të kuptohet se libraria e Mashanoviqit, me shitjen e librave të ndryshme si të librave dhe materialit shkollor, dhe me mbledhjen e intelektualëve aty pat luajtur një rol të rëndësishëm kulturor në kultivimin dhe rritjen e vetëdijes së tillë të popullsia e cekur. Nga libri i cekur “shkenca për librin në Mal të Zi, të Dr Dushan J. Martinoviqit, lihet të kuptohet se në Ulqin ka ekzistuar edhe libraria Petër Jurkoviqit (1919-1925). Sipas hulumtimeve shkencore dhe tubimit shkencor të organizuar në Ulqin dedikuar Dom Gjon Buzukut, 1996 në organizim të Art Clubit, vërtetohet që në Ulqin duhet të ketë ekzistuar shtypshkronja në të cilën u botua libri i parë i gjuhës shqipe”Meshari”i Gjon Buzukut botuar,më 1555, para 460 vjetëve.

ZHVILLIMI I BIBLIOTEKAVE PRIVATE PREJ 1881-1940

Një rol të rëndësishëm në fushën e arsimit dhe kulturës si dhe ngritjen e vetëdijes intelektuale e patën luajtur edhe bibliotekat private që i kishin intelektualët e njohur të kohës së përmendur.

Biblioteka e vojvodës Sima Popoviq

Një bibliotekë të pasur kish edhe Simo Popoviqi, i cili kish qenë guvernator i Tivarit dhe i Ulqinit. Si dashamir i librit në bibliotekën e tij kish rreth 150 libra, qysh prej kohës kur kreu gjimnazin në Pozhim (Srem), kish filluar të mbledh librat, kurse me kalimin e tij në Beograd në fakultetin e shkencave juridike në shkollën e madhe, blen libra të rinj, kryesisht libra nga fusha e drejtësisë dhe e historisë. Ai u mor me gazetari dhe me shkrime letrare. Librat në bibliotekën e tij nuk ish i vetëm në gjuhën serb por kish edhe në gjuhën gjermane, franceze dhe ruse. Simo Popoviq ka qenë sekretar i knjazit Nkollë, ministër i arsimit kurse një kohë punoi edhe si ministër shtetëror. Bashkëpunoi me gazetën "Crnogorac", kurse është i njohur me përkthimin e epit indian "Mahab Harata" dhe "Ramajana" nga gjuha gjermane. Pas vdekjes së tij një pjesë e librave të tij mbet në Beograd, kurse pjesa tjetër i takon djalit të tij Marko Popoviq. Gjatë luftës së dytë botërore një pjesë e fondit të tij në Beograd dhe Ulqin është asgjësuar, kurse mbetja prej 50 librave ruhet te djemtë e Dr Marko Popoviqit.

Biblioteka e Todor Hajdukoviqit

Todor Hajdukoviqi është i lindur me 1880 kur se vdiq me 1971 në Ulqin. Ku edhe është varrosur. Ka kryer shkollën bogosllovike të mësuesisë, pas mbarimit të së cilës punoi si mësues në Ulqin deri më 1931. Prej me 1931 -1940 shërbeu në Dubrovnik, kurse pas çlirimit nga viti 1945 punoi si drejtues i shkollës fillore në Ulqin, kur edhe u pensionua në vitin 1952. Si nxënës i shkollës së përmendur dhe gjatë viteve të shërbimit ka qenë adhurues i librit të mirë. Në veçanti ka qenë i interesuar për blerjen e librave nga fusha e arsimimit dhe edukimit, historisë edhe beletristikës. Biblioteka e tij në prag të luftës kishte 115, që lihet të kuptohet prej regjistrit të ruajtur. Fatkeqësisht gjatë luftës së dytë botërore u dëmtua pjesa më e madhe e tyre, kurse pjesa e mbetur prej 30 librash ruhet në shtëpinë e nipave të tij.

Për punën e tij dhe kryerjen e saj me nderë është shpërblyer me dekoratën e Shën Saves dhe dekoratën e meritave të punës, kurse si drejtor i shkollës shumë herë është shpërblyer nga ministria e arsimit të Malit të Zi. Ka qenë mësues i dashur nga ana e fëmijëve dhe shumë i respektuar nga ana e qytetarëve të komunës së Ulqinit.

Biblioteka e Gjuro Marko Vujanoviqit

Gjuro M. Vujanoviq është i lindur, më 1890, kurse vdiq 1969. Derisa ishte nxënës i bogusllovisë (mësim fetar) mësuesi, në Cetinë, dëshmoi një interesim të madh leximi, por edhe në mbledhjen e librave të fushave të ndryshme. Kjo dëshirë për librin, kryesisht i erdhi në shprehje gjatë shërbimit të tij në fshatin Salç e më vonë edhe në Ulqin. Pas disa viteve shërbim vazhdon studimet në fakultetin filozofik të Beogradit, kurse pas kthimit në Ulqin punon si profesor i matematikës. Para luftës së dytë botërore kalon në Dubrovnik, ku përveç bibliotekës në Ulqin formon edhe bibliotekën në Dubrovnik ku për dallim të asaj të Ulqinit e cila kishte karakter fetar dhe të beletristikës, kishte edhe libra të matematikës. Është interesant të cekët se në çdo libër ka qenë e vënë etiketa

e shtypshkronjës, në të cilën figuronte numri rendor i tij dhe të dhënat kryesore për te. Biblioteka e tij kish rreth 30 libra dhe ruhej te djali i Vojo Vujanoviqit, ndërsa librat e bibliotekës së Dubrovnikut kaluan në pronësi të bibliotekës së qytetit të Dubrovnikut.

Biblioteka e prof. Milutin Plamencit

Profesori Milutin Plamenac lindi, më 1894 në Crmnicë. Qysh si student i historisë së artit figurativ, kishte arritur të sigurojë një numër të konsiderueshëm librash të kësaj lame, kurse një numër të madh librash kishte arritur ti sigurojë gjatë qëndrimit të tij në Francë, kështu në bibliotekën e tij ishin rreth 110 libra. Si profesor i gjuhë franceze pat punuar pranë gjimnazit të ulët në Ulqin. Edhe pse gjatë luftës së dytë botërore ishte dëmtuar një pjesë e fondit ë librave, me gjithë këtë, nga biblioteka e tij kishin shpëtuar rreth 50 libra, të cilat ruhet te djali i tijë doktor i medicinës në Sarajevë- Dragutin Plamenci. Profesori Plamenac, ishte i njohur edhe si artist. Punoi shumë pamje nga Ulqini, portretin e Branko Radiqeviqit, të cilin ia fali gjimnazit. Ky portret në periudhën 1933-1934 ishte i vendosur në sallën e leximit dhe pas kësaj nuk është e njohur se kush e mori këtë portret dhe ajo sot do të kishte një vlerë të madhe artistike.

Biblioteka e Ilija Mashanoviqit

Ilija Mashanoviq (1898-1968), si librar i njohur kish edhe një bibliotekë mirë të përgatitur. Pas kthimit të tij nga Austria 1930 dhe me dëshirën që të ngris vetëdijen e ulqinakëve, bëri mbledhjen e shumë librave nga beletristika dhe historia dhe po këto iu jepte për lexim intelektualëve të interesuar, që kishin mbaruar arsimin e mesëm dhe të lartë kurse punonin në administratën lokale në Ulqin. Biblioteka e tij posedonte rreth 80 libra, kurse në bazë të shembujve të ruajtur shihet se ata ishin blerë në Beograd ose në Zagreb. Librat nga biblioteka e tij u dëmtuan gjatë bombardimeve të luftës së dytë botërore, ndërsa librat e ruajtura, ruhen në bibliotekën e familjes Ilija Mashanoviqit.

Biblioteka e proterejer Radojica Bozhoviq

Protejereji Radojica Bozhoviq ka lindur me 02.09.1948 në Nikshiq, prej babës Blazhos dhe nënës Jaglika, e lindur Bojaniq. Shkollën fillore e ka krye në Nikshiq e shkollën fetare, pes vjeçare,"st.Kirila dhe Metodija"në Prizren, me 1969. Për prift u emërua me 12.05.1972 në manastirin Ostrog. Për rektor të kishës krishtere-ortodokse në Ulqin u emërua me 01.06.1972, ku ka shërbye deri në penzion.Pas ardhjes në Ulqin është regjistrua si anëtar i rregullt në bibliotekën e Ulqinit ku ishte anëtar i rregullt reth 20 vite.Pas takimit tim të parë me të nderuarin protojerejin e kam vërejt se ishte intelektual i mirëfillt çka e vërtetonte edhe zgjedhja e literaturës që e merrte për lexim.

Mas një kohe formon edhe bibliotekën e vetë.Në bised me të nderuarin Bozhoviq,më njoftoi se kishte filluar me ble libra prej lamive të ndryshme siç janë nga historia, letërsia, filozofija, psihologjija, leksikone, fjalor të ndryshëm. Libra nga fusha e pedagogjis,librat fetare,dhe enciklopedi të ndryshme të shkruara në gjuhën srbe,greke,greke të vjetër,dhe në gjuhën angleze dhe ruse.

Biblioteka e projerejir bozhoviqit posedon edhe disa libra të vjetra e shumë të çmueshme të cilat janë botuar para 100-250 vite.Në bibliotekën e tij personale ishte libra më e vjetër dhe më e çmueshme fetare "Trebnik",e botuar 1766 dhe libra e N.V.Gogolit "Mrtve dushe"në gjihën srbe e botuar me 1872.
Biblioteka e protejerejit Bozhoviq është shum e pasur me afër 2500 libra e në biseda me te disa herë më ka treguar se librat (biblioteka)e tij është pasuria ma e madhe të cilën e ka krijuar në jetën e tij.

Biblioteka e kadiut hafiz Hysejn Mujalit (1854 – 1940)

Hafiz Hysejn Mujali lindi në vitin 1854 në Ulqin. Sgkencat teologjike me sukses i përfundoi para dijetarit (alimit) të njohur Haxhi Salih ef.Hulejma, kurse hafizllëkun e ndoqi te Haxhi ef. Tirana në Ulqin. Gjatë vitit 1879 u emërua për imam mualim i Xhamisë së Kryepazarit. Dhe këtë funksion e kreu deri më 1909, kur u emërua për kadi, në mënyrë që në vitin 1919 u zgjodh për myfti të Srezit (qarkut) të Ulqinit., këtë detyrë e ushtroi deri në vitin 1923, kur si themelues i kësaj shkolle që ishte barazi me gjimnazin e ulët e pastaj edhe të medresesë në Ulqin. Dhe pranë kësaj medreseje punon si profesor. Fliste shqip, serbisht, turqisht, kurse gjithashtu njihte mirë gjuhën arabe dhe persiane. Kishte bibliotekën e vet prej rreth 30-40 librash. Librat kryesisht ishin në gjuhën turke arabe dhe persiane. Një pjesë e literaturës ishte nga ajo e së drejtës së sheriatit. Librat tani gjenden te stërnipat e tij.

Biblioteka e myftiut Hafiz Hasan Mavriqit

Hasan Mavriqi, është i lindur në Ulqin, më 1883, kurse vdiq, më 1969. Pas mbarimit të shkollës fillore, bën regjistrimin në medrese për tu përgatitur për predikues fetar. Pas mbarimit të shkollës në Ulqin,më 1898 shkon për të kryer fakultetin e teologjisë në Stamboll, ku qëndron deri më 1910 ku mbaron të drejtën e sheriatit. Pas kthimit punon si imam shtetëror deri në vitin 1924. Në të njëjtën kohë ka qenë edhe sekretar i myfti Mujalit. Në periudhën prej 1925 – 1930 u emërua për myfti të rrethit të Tivarit dhe Ulqinit, pas të cilës edhe u pensionua. Hasan Mavriqi qysh gjatë shkollimit në medrese u dashurua në libër dhe qysh në kohën më të re siguroi libra që kishin karakter fetar. Duke qëndruar në Stamboll kishte blerë një numër të konsideruar librash nga lëmi e të drejtës së sheriatit dhe kështu në kuadër të bibliotekës ekzistuese kish formuar grupin me literaturë drejtësie. Librat ishin në gjuhën turke persiane dhe arabe. Me tu kthyer nga Stambolli viti 1910 me vete solli rreth 20 libra. Si dashamir i librit dhe i të drejtës e duke njohur edhe gjuhën serbe siguroi edhe libra drejtësie malazeze e serbe dhe kështu që biblioteka e tij para vdekjes kishte rreth 90 libra. Me keqardhje gjatë bombardimeve të luftës së dytë botërore shtëpia e tij është djegur duke mbetur nga biblioteka vetëm disa dhjetëra libra, të cilat edhe sot ruhen te trashëgimtarët e tij.
Si njeri i shquar dhe i arsimuar fliste para prindërve që është detyrë e tyre që njëkohësisht të shkollojnë fëmijët femra dhe meshkuj. Shpesh shërbehej me citate Kurani në të cilat fliste për tolerancën ndër njerëzore dhe respektimin e të tjerëve. Duke qenë i dashur për njerëzit e të tre besimeve në vitin 1944 ka qenë

i zgjedhur për kryetar komune në të cilin funksion ka qëndruar për rreth 1i muaj. Prej vitit 1946 -1968 ka qenë kryetar i Bashkësisë Islame në Ulqin dhe anëtarë i lartë i eprorëve të besimit të Malit të Zi.

Biblioteka e hafiz Junuz Llunjit 1884- 1923

Hafiz Junuz Llunji lindi në Ulqin 1884. Babai i tij Hasani e regjistroi djalin e tij në shkollë – mejtep, të cilin e kryen me sukses. Rrjedh prej një familjeje të shquar Llunji, e cila në fushën e xhematit të Ulqinit dha 5 hafizë (titulli hafiz nënkupton mësimin e Kuranit përmendësh). E këta ishin: Hasan Llunji i pari, dhe djemtë e tij Hafiz Alush Llunji,Hafiz Jonuz Llunji dhe Hafiz Dalip Llunji, si dhe djali i Alushit, Hafiz Hasan i dytë Llunji, Hafiz Junuz LLunji, pas mbarimit të mejtepit dhe Hafizllekut, të cilin e mëson te Hafiz Mujali dhe babai Hasani, u vu të punojë, fillimisht si imam, në Ostros e më vonë edhe në Kollomzë. Pas 6 viteve u vu të punojë si imam pran Xhamisë së Merajes.

Hafiz Junuz Llunji, ishte shumë aktiv në mësimin e gjuhës arabe dhe ajeteve të Kuranit, kurse në një kohë pat punuar edhe në mejtepin e Xhamisë së Namazgjahut dhe mejtepin e Xhamisë së Merajës. Në dhomën e tij të punës kishte edhe librarinë e tij në gjuhën turke,arabe e persiane. Një pjesë e librave të tij (diku rreth 30 libra) edhe sot ruhen te nipi Admir Lunji.

Hafiz Junuz Llunji ka qenë shumë i respektuar te bashkëqytetarët e vet-xhemati. Vdiq i Ri në moshën 39 vjeçare në Ulqin ku edhe u varros.

Biblioteka e myftiut Hafiz Hasan Llunji (1897- 1944)

Myftia dhe myderizi hafiz Hasan Llunji ishte djalë i hafiz Alush Llunjit. Kishte lindur në Ulqin në vitin 1897. U rrit në një familje të edukuar dhe arsimuar drejtë për së drejti. Qysh prej së vogli kur kishte vetëm 13 vjet mbaron me sukses hifzin duke fituar titullin hafiz. Përveç kësaj, më 1916 -17 mbaron shkollën fillore dy vjeçare në gjuhën kroate dhe shqipe. Sipas dëshirës së tij, me përkrahjen e prindërve të vet, vazhdon shkollimin pranë medresesë në Sarajevë që e përfundon me sukses të shkëlqyeshëm. Hafiz Hasan Llunji kishte në dispozicion një bibliotekë të pasur që e trashëgonte nga prindi i tij që ishte mësur dhe një hafiz i begatë. Në bibliotekën e tij kishte libra që ishin nga fusha e besimit në gjuhën arabe, turke, osmane, persiane.

Myftiu Hafiz Hasan Llunji, në kohën e punës së vet një vëmendje të veçantë i kushtonte gjurmimeve dhe hulumtimeve në fushën e sheriatit..Në këtë lëmi, pati specializuar në Shkodër te Sabri Begu, i cili në atë kohë ishte myftiu kryesor i Shkodrës.

Në kohën e shërbimit të tij, kishte shërbyer si mësues fetar në periudhën prej vitit 1918- 1944, në Krajë, Katërkollë,Tivar, Zalev, Tuz e më së shumti në Ulqin. Shërbeu si imam në Xhaminë e Pashës, Xhaminë e Marinerëve dhe të Namazgjahut. Në nëntorin e vitit 1944 OZNA ia ka konfiskuar bibliotekën.Për fat të mirë një pjesë e bibliotekës së tij, afër 50 librash, ia kanë dhanë hoxhë Kaleziqit (Kroqit), të cilët edhe sot ruhem në familjen e tij. Para disa vitesh është zbuluar libra **“Ilahit e hafiz Cen Bushatit-Nexhatinit”.**

Të parët e kësaj familje ishin detar, tregtar, pronar tokash e ullishtash dhe persona të respektuara fetare: mujezin, mualim, imam, hafiz, myderiz, madje edhe muftinj. Gjithnji përkrah paris së qytetit dhe mbrojtjes të nderit të tij, në rrugën e tyre,aspak të lehtë, veç të tjerave i ka ndjekur edhe syri i zilis dhe i xhelozis, duke i shkaktuar trazira e prapaskena që përfunduan edhe me humbje jete. Pavarsisht nga këto dhe presionet permanente, ata, si familje dhe individë dolën faqebardh,punëtor të pathyer në realizimin e aspiratave të tyre. Veçoheshin për dije dhe me libra me alfabetin arabo-osman,në kohë brez pas brezit krijuan biblioteka të konsiduerueshme për kohën.

Biblioteka e Dom Simon Filipaj

Është i lindur, më o1. 5.1925 në fshatin Kllezën Poshtë, pranë Liqenit të Shasit, komuna e Ulqinit. I përket atij brezi të rinisë shqiptare që u rrit u shkollua dhe jetoi në kushte të vështira. Si birë i një familje fshatare, por arsimdashëse, ai e ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe më këmbëngulje shkollimin. Shkollën fillore dy vjeçare kreu në Selitë, kurse dy të tjerat në Katërkollë të Ulqinit. Pas përfundimit të shkollës fillore, gjatë viteve 1939-1941, vazhdon mësimet në Shkodër, e pastaj studimet në fakultetin teologjik në Zagreb, të cilin e mbaron me sukses të shkëlqyeshëm në vitin 1945. Me një herë pasi u diplomua u shugurua meshtar (prift) në katedralen e Zagrebit. I pajisur me mësime filozofike në fillim shërbeu në Malësinë e Madhe dhe në Trieshë, në Kojë e Grudë. Gjatë viteve 1960 -1966 Dom Simon Filipaj, nga viti 20. 11. 1966, pa ndërprerje, deri më 02.9. 1999, kur ndërroj jetë ka shërbyer si famullitarë në Shën Gjergj të bregut të Bunës. Dom Simon Filipaj, krahas punës së tij të pa lodhshme si përkthyes të teksteve biblike u mor me shumë dashuri me mbledhjen e folklorit popullor shqiptar që im ka botuar Instituti Albanologjik i Prishtinës. Në vjetarin "Gjurmime Albanologjike- Folklor dhe etnologji"Prishtinë, 1971- 1978- 1982. Falë këtyre veçorive dhe për tu dhënë shqiptarëve një "Bubël"të plotë në gjuhën standarde shqipe, si ëndërr të kamotshme e kreu në vitin 1994, kur u botua "Bibla "në Ferizaj.

Kam pas fat që së bashku me Zejnel Katanën dhe prof Riza Rexhën ta vizitoj atë, në banesën e tij në Shën Gjergj. Aty e vërtetova se Dom Smon Filipaj, kish një bibliotekë shumë të pasur me enciklopedi, leksikone, shumë fjalorë në gjuhë të ndryshme dhe libra me tematikë fetare, historike, gjeografike dhe folklorike. Kjo për mua ishte një befasi e këndshme nga se biblioteka kishte afër 3000 libra me vlerë të jashtzakonshme.

Të gjithë këta dijetarë dhe arsimdashës së bashku me shumë dijetarë të tjerë janë adresa të identitetit dhe të personalitetit tonë, jo vetëm fetar, por edhe kombëtar.

ZHVILLIMI I ARSIMIT DHE I BIBLIOTEKAVE TË SHKOLLAVE (PREJ 1885 DERI MË 2003, 2006-2007)

Nuk ekzistojnë dokumente të cilat do të dëshmonin për shkollim deri në shekullin XIX, por dihet se në fillim ekzistonin objektet shkollore fetare pranë manastireve dhe xhamive. Këto kryesisht ishin shkolla fetare, siç ishin mejtepet në qytetin e vjetër, në Meteriz dhe në Krye të Pazarit. Pas futjes së qytetit të Ulqinit në Mal të Zi, në vitin 1880, kuptohet që nuk kishte shkollë për fëmijët malazezë. Me vendim të Mbretërisë Malazeze në vitin 1882 u bë edhe hapja e shkollës së parë fillore në Ulqin. Këtë shkollë në fillim e kanë ndjekur gjithsej 14 fëmijë meshkuj malazezë, të moshës prej 12 deri në 18 vjet, ndërsa mësimi bëhej nëpër shtëpia private. Mësuesi i parë i saj ka qenë ALEKSA F. VUKÇEVIQ nga Shkodra, kurse për drejtor u emërua MITËR GJURIQI. Numri i nxënësve sa vinte e shtohej për çdo vit dhe në vitin 1886 shkolla pati 31 nxënës. Prej atëherë si mësues filloi të punonte Mitar Iveliq. Në vitin 1903 shkollën e ndoqën 71 nxënës meshkuj dhe 8 femra, kurse si mësues punonin Ilija Lopiçiq dhe Nikolla Stojoviq.

Mësuesi M. Iveliq me nxënësa 1910

Prej vitit 1910 shkolla kishte 4 paralele. Në mënyrë që shkolla të punonte normalisht, në vitin 1910 u blenë edhe shtëpitë nën kalanë e Ulqinit, e ndër to edhe ajo e Files, vajzës së Pashë Begut, përmes të autorizuarit të plotfuqishëm, Man Hoxhës, për 24 napolona ari. Gjithashtu u ble edhe shtëpia e Zylfijes, vajzës së Pashë Begut, përmes të autorizuarit të vet dhe dhëndrit Ahmet

Mollabeqirit, për 24 napolona ari, si dhe shtëpia e Beqir Osmanit, për 40 napolona ari, dhe kjo përmes vëllait të gruas Beto Buzukut. Më vonë është blerë edhe shtëpia e Cafo Hodo Alibegut, përmes të autorizuarit të vet Sulë Selim Begut, si dhe dajës së tyre Dul Shurdha për 95 napolona ari. Të gjitha këta shtëpi u blenë për 180 napolona.

Pamja e shtëpive që u blenë për nevoja të shkollës fillore 1910

Gjatë Luftës së Parë Botërore (1915-1918), mësimin e zhvilluan motrat e nderit nga Kroacia, kurse prej vitit 1919 mësimet filluan e i ndoqën edhe nxënësit shqiptarë. Pasi që fëmijët shqiptarë nuk e zotëronin gjuhën malazeze për të ndjekur mësimin, për ta u vendos regjimi i paraleleve përmirësuese të aftësimit të tyre. Duke filluar nga viti shkollor 1920 -1921, në Ulqin hapet edhe Gjimnazi i Ulët, e nga viti 1922 u hap edhe Shkolla Profesionale për Vajza. Gjatë luftës, shkolla nuk punoi, ndërsa në periudhën 1945-46, u rihap Gjimnazi i Ulët, i cili në vitin shkollor 1951-52 u zgjerua në shkollë 8-vjeçare, ndërsa nga viti 1960-61 kemi shkollën fillore në Ulqin.

Është e vërtetë se për më shumë se 35 vjet radhazi kam punuar në bibliotekën "Mirko Srzentiq"në Ulqin. Duke pasur parasysh faktin se kam kryer Shkollën e Mësuesisë në Nikshiq dhe që kam punuar si punonjës i arsimit për 3 vjet në shkollat e Shtojit, Braticës dhe në Ulqin, në shpirt ndihem si punonjës i arsimit. Andaj mu për këtë arsye e ndiej nevojën të shkruaj edhe për zhvillimin e arsimit në Ulqin.

Klasa VI_2 me kujdestarin e klasës Fadil Kroma

Vitin shkollor 1966/1967 kam qenë kujdestar i klasës VI_2 në shkollën fillore "Boshko Strugar". Në të njëjtën kohë i kam dhënë matematikë klasave të gjashta. Për këtë dëshmon fotografia e klasës VI 2, të cilën e bashkëngjis me emrat e nxënësve të kësaj klase.

Prej majtas nga e djathta,

Rendi i parë: Idriz Cungu, Maksud Rejzi, Suad Shurdha, Qame Hoxha, Sabahete Hysa, Branka Kalugjeroviq, Radmila Kostiq

Rendi i dytë: Miqo Gjakonoviq, Gjyste Dushoviq, Muhamed Spuzha, Branko Çausheviq, Hakile Çaushi, Feraset Dragovoja, Fadile Meqikukiq, Syrmije Mavriq

Rendi i tretë: _____, Shpresa Tuliq, Mikica Hoxhiq, Nada Karagjinoviq, Bahri Karaminxhoja, Fatmir Kraja, Pajo Raduloviq, Habiba Axhemoviq

Rendi i katërt: Jakup Stamkoviq, Niko Stojanoviq, Gjoko Stanishiq, Nail Vukoviq, Rizo Hasanaga,_____, Noc Dobreci, Momçillo (Baro) Gjurishiq.

Moikom ZEQO

KONICA PËR SERVANTESIN SHKRUANTE 1900

Viti 2016, si viti i 400-vjetorit të vdekjes së Miguel Servantesit na tendos vëmendjen në pikën inkandeshente të emrit të Servantesit, të lidhur me shqiptarët. Në këtë 400-vjetor Shqipëria duhet të bënte një program reflektimi dhe nderimi për Servantesin në sintoni me Spanjën dhe Europën.
A nuk është kjo një modus vivendi të integrimit europian? A nuk qe rasti që Ministria e Kulturës të bënte diçka për Servantesin, Fan Nolin dhe Petro Zhejin, të ribotohej kryevepra e Servantesit etj.? Te revista "Albania", nr.6 e vitit 1900, Faik Konica ka një shkrim të parin e këtij lloji,- pikërisht për Miguel Servantesin. Konica e formulon titullin si: "Servantesi, albanologu më i vjetër". Dhe ja ç'thuhet: "'Albania' botoi përkthimin në shqip të një tregimi të Servantesit, 'Forca e gjakut'. Meqë ra fjala, është mirë të marrim shënim një fakt shumë pak të njohur. Migel Servantes e ka ditur shqipen më parë se kalorësi flamand Arnolt van Harff, të cilit ne i kemi botuar vitin e kaluar fjalorin e tij të vogël shqip-holandisht të vitit 1590 (shiko Albania B 15). Autori i Don Kishotit, që kishte marrë pjesë në betejën e Lepantes, ishte zënë rob nga ushtria turke dhe, si skllav, i ra në pjesë piratit shqiptar Mema. Kjo robëri, që zgjati pesë vite, i lejoi Servantesit të mësonte gjuhën shqipe dhe nëse shkrimtari nuk e përmend në librat e tij, shpesh ai e hedh fjalën për shqiptarët, veçanërisht në tregimin me titull 'Spanjollja angleze'".
Pse Faik Konica e mbiquan Servantesin "Albanologu më i vjetër"? Në fakt, Faik Konica e ka bërë këtë formulim në mënyrë pompoze. Nuk bëhet fjalë që Servantesi ka shkruar një studim albanologjik. Por, Faik Konica është i bindur se Servantesi duke jetuar mes një grupi shqiptarësh, qofshin këta edhe piratë, e ka mësuar gjuhën shqipe dhe pra, e ka ditur gjuhën shqipe. Por, kjo është një hamendje e guximshme dhe befasuese. Por, mbiquajtja si "albanolog" është e tepruar. Por, Faik Konica padyshim që di diçka. Diçka që e lidh Servantesin me gjuhën shqipe. Faik Konica është i pari shqiptar që e përmend Servantesin në vitin 1900, vitin e fillimit të shekullit XX. Vite më vonë Fan Noli, dioskuri i Konicës, e përkthen mrekullisht librin e parë të "Don Kishotit". Fan Noli shkroi edhe pesë ese për Servantesin, kryeveprën e tij dhe reflektimin te shqiptarët dhe problematika sociale e Shqipërisë.
Fan Noli bën kështu edhe një "shqiptarizim" (aktualizim) të Don Kishotit. Figura e Don Kishotit përdoret si metaforë në betejat e tij politike me kundërshtarët.
Po le të rikthehemi te Faik Konica. Ky erudit ka lexuar dhe e di literaturën dhe bibliografinë shkencore për Miguel Servantesin. Tek libri "Albania, the rock garden of Sautheastern Europe" ("Shqipëria, kopshti shkëmbor i Europës Juglindore".) Faik Konica shkruan se "vetë Servantesi na rrëfen se robëruesi dhe padroni i tij në Algjer ishte një pirat shqiptar, i quajtur Arnaut Mami, ose

Shqiptar Memi". Faik Konica u referohet autorëve Henry A. Ormerod, "Piracy in the Ancient World", London, pp. 24-25, përkatësisht Mariano Thomas, "Life and Misadventures of Miguel de Cervantes", London, (përkthyer në anglisht nga Waren B. Wells), 1934 p. 49.
Miguel Servantes mori pjesë në Betejën e Lepantos, ku u plagos dhe e humbi krahun e majtë. Në 26 shtator 1575 Servantesi me vëllain e tij Rodrigon është kapur rob me anijen "El sol" nga pirati shqiptar Arnaut Mami, ndryshe i njohur si Muhamet Shqiptari. Nuk dihet viti i lindjes. Ka vdekur në 1600. Vetë Servantesi tregon në librin e parë të "Don Kishotit" se në robërinë e tij disavjeçare "pirati shqiptar e trajtoi veçmas dhe mirë robin spanjoll". Pra, Servantesi ka një vlerësim pozitiv për piratin e tmerrshëm Arnaut Mamin.
Miku im ulqinak, prof. dr. Ruzhdi Ushaku botoi në vitin 2014 në Ulqin librin "Servantesi në Ulqin – mes gojëdhënave dhe realitetit". Ai është marrë hollësisht me tezën se Servantesi i ka njohur shqiptarët, për më tepër në një rrafsh folkloristik gjoja Servantesi ka qenë edhe në Ulqin, ku qenka dashuruar me një vajzë të bukur ulqinake dhe se emri Dylqinja, e dashura e hamendësuar dhe mitike e kalorësit Don Kishoti e ka emrin të tillë prej emrit Dulqinea, në të cilin thirrej Ulqini në mesjetë.
Faik Konica, përpara tërë shqiptarëve që në 1900 mendon se gjatë robërisë, Servantesi ka komunikuar në gjuhën shqipe, por bën një tejkalim gazetaresk kur e cilëson "albanolog". Më saktë, mund ta thërriste "albanofil". Te shkrimi i Konicës ka një lapsus për kalorësin Arnolt Von Harfinin, i cili e shkroi fjalorthin e tij gjermanisht (apo dialektin gjerman i holandishtes) dhe shqip në 1496 dhe jo siç thotë gabimisht Konica në 1596.
Po të mos harrojmë se revista "Albania" botoi tregimin e Servantesit në shqip "Forca e gjakut". E kam lexuar këtë tregim të stilit pikaresk. Çuditërisht tek "Albania" nuk thuhet përkthyesi. Mungon emri i përkthyesit. Po pse? Mendimi im paraprak është se ky përkthyes i parë shqiptar i Servantesit ka një meritë të padiskutueshme për njohjen e emrit të madh të Servantesit për letërsinë shqipe.
A mos e ka përkthyer "Forcën e gjakut" vetë Faik Konica?
Nuk duhet të nxitohemi. Duhet bërë një analizë serioze gjuhësore dhe stilistikore.
Tregimin "Spanjollja angleze" nuk e kam gjetur ende për ta lexuar.
Në spanjisht tregimi quhet "La Espanola inglesa".
Është botuar përpara "La Fuerca de la sangre" ("Forca e gjakut")

Prof. dr. Maksut XH. HAXHIBRAHIMI

MBI DISA FAMILJE DETARE ULQINAKE

Përmbledhje
Mbështetje kryesore e këtij punimi janë burimet dokumentare arkivore vendëse dhe të huaja, të panjohura dhe të pastudiuara deri sot për temën e dhënë. Duke shfrytëzuar një material mjaft të pasur burimor të dorës së parë, jo vetëm që patëm mundësi të ndërtojmë strukturën e këtij punimi mbi një bazë dokumentare të re, të panjohur, por, duke e veshur atë më këtë lëndë të re, plotësuam zbrazëti të mëdha, të cilat më burimet ekzistuese nuk do të ishim në gjendje t'i kryenim. Këto burime na dhanë gjithashtu mundësinë të kontrollojmë dhe të hetojmë në shumë raste vërtetësinë e të dhënave të nxjerra nga bibliografia dhe nga tradita gojore.
Autori është përpjekur të analizojë dhe të shohë më syrin kritik literaturën e shfrytëzuar, më qëllim që t'i ndriçojë këto problemë historike të rëndësishme të kulturës materiale, shpirtërore dhe aspekte detare – tregtare të anijeve ulqinake. Studimet në këtë fushë, ashtu si studimet e krijimtarisë detare në përgjithësi, për vetë natyrën e tyre nuk janë vetëm studime kabineti, ato përfshijnë një gamë relativisht të gjerë veprimtarie shkencore që fillon më gjurmimin dhe dokumentimin e vlerave të krijimtarisë detare, si bazë e domosdoshme për të kryer studime të vërteta shkencore.

Hyrje
Ky punim ka për qëllim të përmbushë një zbrazëti të ndjeshme në fushën e studimeve mbi çështjet e detarisë së lashtë dhe zhvillimin e flotës detare – tregtare ulqinake në periudhën më të re të detarisë ulqinake, si në Shkodër ashtu edhe në Durrës.
Mbasi Ulqini, si qendër bregdetare ruan më tepër karakterin e skelës tregtare të lidhur më botën e jashtme, këtu u zhvillua një numër zejesh dhe u krijua një shtresë shoqërore e gjerë zejtarësh dhe profesionistësh që prodhonin për nevojat dhe kërkesat e tregut të brendshëm dhe të jashtëm.
Ulqinakët u dalluan për shpirtin e vetëmohimit, pa kursyer të vënë në shërbim të njerëzimit dituritë dhe përvojën e tyre, duke dhënë, kështu, një kontributë, sado të vogël, në pasurimin e thesarit të madh të kulturës ballkanike dhe evropiane.
Ulqini, si vend më tradita të lashta në fushën e kulturës, me një nivel të caktuar social – ekonomik, u zhvillua një jetë e lulëzuar qytetare më një shtresë të gjerë detarësh, zejtarësh dhe tregtarësh, si dhe kapidana të njohur, të grumbulluar në

organizata esnafore. Kështu, flitet se ulqinakët kishin këshillin (mexhlisin) e tyre drejtues për punët e lundrimit brenda dhe jashtë vendit (gildet tregtare).

Familja Cakuli – Mujo Cakuli (Ulqinaku)

Mujo Ulqinaku Cakuli u lind në një familje patriote Ulqinake në vitin 1896. Babai i tij Ismaili, si të gjithë burrat Ulqinake ishte rritur me detin, ndaj dhe e shoqja Emineja shihte tek ky femijë i porsalindur, një detar e burrë të zotin që do të përballonte me sukses sfidat e familjes e të jetës. Mujo u edukua qysh në fëmini me ndjenjën e atdhedashurisë, sakrificës e thjeshtësisë. Ai vizitonte të atin e shokët e tij sa herë zbrisnin nga anija dhe i ndihmonte ata. Ulqinakët më të vjetër i edukonin rreptë dhe vendosmërisht bijtë e tyre me detin. Ata detin e kishin zanat po aq të moçëm sa vetë jeta, një nevojë të dorës së parë prej nga siguronin të ardhurat për familjen. Mujo u rrit me tregimet e detarëve, legjendat, ndodhitë e tyre, heroizmin dhe trimëritë e Haxhi Alisë, Hysen Reizit, etj. Qysh në moshë të re i jati e merrte në lundrime, duke bërë detyra të ndryshme në anije. Kështu ai u formua si një detar i zoti që në këtë moshë.

Në vitin 1925, familja e Mujos u vendos në Shkodër, në lagjen "Tophane". Mbi supet e Mujos dhe të vellait të tij Ymerit, edhe ky detar, ra pesha kryesore e kujdesit për familjen pasi, prindërit ishin sëmurë dhe motrat të vogla. Mujo vazhdoi të punonte në zanatin e tij si detar, në limanin e Bunës. Qëndrimi në Shkodër dhe zanati i detarit e burrëruan Mujon. Në vitin 1929 në moshën 33 vjeçare, Mujo u martua me një vajzë Ulqinake: - Hava Mujushi, një grua trime që nuk ju nda deri në vdekje dhe më pas rriti të katër fëmijët e tij. Mbas martesës Mujo filloi punë në Rojen e Financës në portin e Durrësit ku u shqua për korrektësi në zbatimin e kësaj detyre të vështirë. Në vitin 1931 mbasi gjeti strehë e solli dhe familjen në Durrës. Në vitin 1933 pasi u la pa punë në Durrës për pengesat që u sillte kontrabandistëve shkoi në Vlorë dhe gjeti punë atje. Në vitin 1930 në saje të aftësive të tij morri gradën e kapterit në marinë dhe komandonte motoskafin e vogël tip "Mas" – "Tirana". Midis n/oficerëve Mujo gëzonte respektin e marinarëve jo vetëm për karakterin e tij të fortë e burrëror, për komunikimin e thjeshtë me rekrutët, por edhe për aftësite e tij profesionale. Ai njihte dhe zotëronte të gjitha detyrat brenda anijes, motorrist, timonier, sinjalist, etj, - ndaj ekuipazhi i thoshte atij baba Mujo. Ai reagoi me ekuipazhin e vet në Qershor të vitit 1934, kur luftanijet italiane bënë demonstrimin në gjirin e Durrësit. Mujo shërbeu 8 vjet në anije civile e 7 vjet në marinë ushtarake. Ai kujdesej vetë për riparimin e të gjitha pjesëve të anijes së tij për ta patur atë në çdo kohë funksionale e të gatshme për lundrim.

Si detar profesionist Mujo i takonte sa marinës luftarake dhe asaj tregëtare.

Kishte 4 femijë: (Hamitin i cili vdiq para disa vitesh), Ismailin, Samiun dhe Ruhien të cilët kanë punuar me ndershmëri në detyra të ndryshme që ata kanë patur. Në ditët e para të Prillit 1939, ai me kolegët e tij, ndiqte me vemëndje dhe ishte i shqetësuar nga lajmet sensacionale në radio e gazeta për rrezikun e pushtimit fashist. Ndaj ata ditët e para të Prillit i shtërnguan radhët me njëri – tjetrin dhe nuk i zinin besë lajmeve të ndryshme që qarkullonin vesh me vesh.

Ky grusht marinarësh u bë njësh me Torrën Veneciane siç quhet kjo kala me histori të rallë. Ata qenë të parët që së bashku me dhjetra vullnetarë të ardhur nga rrethet e tjera i rezistuan pushtimit fashist të 7 Prillit 1939.
Dy marinarë të vjetër, kolegë të tij, kapiten Ahmet Luli e Beqir Golemi e furnizonin me armë e municione skuadrën e Mujos përmes mureve të kalasë. Gjatë kësaj rezistence u vra kapteri i marinës Mujo Ulqinaku i cili është edhe dëshmori i parë i Luftës antifashiste të popullit tonë. Akti dhe vepra e tij përkujtohet me nderim e respekt jo vetëm nga brezat e detarëve por nga gjithë populli Shqiptar. Ndaj në çdo 7 Prill përulemi me respekt para monumentit të tij dhe dëshmorëve të tjerë. "Mujo mëngjesin e asaj dite të zezë Prilli doli si kapter dhe përfundoi si admiral për këtë vend", - më thotë qytetari i thjeshtë durrsak Perlat Keraj, mbas ceremonisë përkujtimore të 7 Prillit 2012.

Familja Luli - Profesionalizmi sipas kapiten Ahmet Lulit

O zot më ruaj nga i paafti, sepse ai
nuk të mbyt pse do, por pse nuk di...

Mbi barkën e re "Reshit Çollaku", flinte në kabinën e saj, kapidan Isuf Luli, i cili dhe pse në moshën 72 vjeçare, drejtonte ende barkën: Isha.... 13 vjeç, kur i solla shpinën tokës dhe deri sot, gjithnjë mbi det, 60 vjet jetë detare, - tregon kapidani. A ke familje kapidan? – Posi, kam në Shkodër gruan dhe 4 djelm të martuar, njani më i mirë se tjetri. – Po përse nuk i kalon vitet e fundit pranë familjes, me pushue tashmë, mjaft je lodhë? – Më han toka, biri im! Unë nuk jam i tokës, jam i detit.
Kapiten Ahmet Luli lindi më 25 maj 1900 në qytetin e Shkodrës në një familje me prejardhje ulqinake. Ashtu si dhe shumë familje të tjera ulqinake, dhe familja Luli, djemtë dhe burrat, brez pas brezi, ushtruan profesionin sa të bukur aq dhe të vështirë të detarit. Me këtë traditë dhe dashuri të pashoqe për detin ai u rrit që në djepin që e përkundi, dhe në moshën 14 vjeç filloi punën si detar, (muço), në pronat e Lulëve në Turqi. Kështu, ai po realizonte e po vinte në jetë një ëndërr dhe një dëshirë që e kishte shoqëruar gjatë viteve të fëmijërisë së tij. Më pas, me kalimin e viteve, falë aftësisë së tij, këmbënguljes, punës së palodhur, pasionit dhe dashurisë për profesionin e detarit, dëshirës për të mësuar dhe për t'u bërë dikushi, ai punoi si marinar derisa gradualisht u bë kapiten anije. Në rinin e tij, për shumë vite, me një grup detarësh ulqinake, ai punoi në jahtit turistik „Nimet Allah", pronë e princit Faruk të Egjyptit. Vitet e shumta të punës dhe lundrimi nëpër dete dhe oqeane, si ai Atlantik dhe Indian, nga fjordet e Anglisë deri në Indi, bënë që Ahmet Luli të fitojë një eksperiencë të vyer në lundrimin detar si dhe të farkëtoje tiparet e një njeriu të vendosur e të papërkulur përballë vështirësive. Me një përvojë shumë të madhe në det, Ahmeti kthehet në një simbol të vlerave të detarit, që është në gjendje të kryejë të gjithë detyrat. Mbas çlirimit të vendit, për shkak të vlerave të tij si detar i zoti, emërohet nga Ministria e Transporteve me detyrën e pilotit të portit të Durrësit. Kjo nuk ishte detyre e lehtë për tu kryer, pasi deri në atë kohë nuk

ishte bërë thellimi i kanalit hyrës në port, ç'ka vështirësonte futjen dhe nxjerrjen e anijeve në port. Por, si gjithmonë, kapiten Ahmeti, falë aftësive të tij si dhe korrektësisë në punë, arriti të pilotojë për në port dhe jashtë tij, anije të kapaciteteve të ndryshme. Kjo bëri që ai të gëzonte gjithmonë respektin e kapitenëve dhe ekuipazheve të anijeve jo vetëm shqiptare por dhe të huaja, me të cilat komunikonte me shume saktësi gjatë dhënies së komandave detare në gjuhën angleze, por dhe në atë frënge, italiane, turke, etj.
Falë aftësive dhe njohurive të tij të plota dhe të thella për detin dhe detarinë, ai ishte gjithmonë i gatshëm dhe angazhohej duke marrë detyra të rëndësishme, siç ishte ai për thellimin e kanalit hyrës në portin e Durrësit.
Për më shumë se dy vjet ai punoi si zv/kapiten i anijes "Borova", e cila u mor dëmshpërblim nga lufta. Si atdhetar i vërtetë, ai refuzoi të mbetesh në atë detyrë me rrëmbimin e saj nga jugosllavët.
Ahmet Luli, praktikonte shtatë gjuhë të huaja. Gjatë 30 viteve në detyrën e pilotit të Durrësit, krahas punës së palodhur me përkushtim, pasion e profesionalizëm, ishte dhe një njeri me virtute të jashtëzakonëshme.
Brezat e detarëve që kanë punuar me të e kujtojnë me respekt kapiten Ahmetin. Ai njëhërësh ishte shembull i njeriu korrekt dhe të ndërshëm, duke përballuar sakrificat që sillte jeta e vështirë në punë dhe familje, duke mbetur tillë për shokët, miqtë dhe familjen e tij. Për punën dhe kontributin e tij të paçmuar, ai është dekoruar me medalje të shumta nga Kuvendi i Shqipërisë, madje një anije 500 t, prodhuar në kantjerin detar Durrës, u emërtua "Kapiten Ahmet Luli", në shenjë respekti për figurën dhe punën e tij në detari. Ai ka lënë një kujtim të paharruar për detaret, ndaj ulqinaket që jetojnë në Durrës dhe mbarë qyteti i Durrësit i është mirrënjohes për gjithëshka çka ka bërë.
Mehmet Luli, kapiten anije, në ekuipazh ka pasur 6 djemtë e tij dhe 6 të vëllait, si dhe një djalë me origjinë egjyptiane, Said Adem Luli, të adaptuar, i cili vite më vonë vdiq në Aleksandri. Mehmeti kishte dhe dy vëllëzër të tjere, Ademin dhe Hasanin, dhe ata kapitene të zotë, të anijeve me vela, ku bazë për lundrim kishin sekstanin dhe mënyrat astronomike.
Mehmeti ka qenë guximtar i pashembullt, në vitin 1916, ai me 3 anijet e tij ishte i rrethuar tek ishulli i Rodit, por në këtë situatë i bëhet garant konsulli Frances, dhe mbasi shet anijet shkon në Stamboll, ku e priti i vëllai dhe djali i tij Ahmet Luli. Ai fillimisht nuk e njohu të birin, por zakoni i detarëve të vjetër ishte që djali t'i ulej në gjunjë në tokë dhe t'ja puthte dorën babës. Kur Ahmeti u ul t'ja puthte dorën, Mehmeti e largon me mospërfillje, ndërkohë i vëllai Ademi i thotë që është djali juaj Ahmeti. Mbasi e kuptoi që ishte djali i tij Ahmeti, i tha: - bir ndiqe atë arapin, hamallin, sepse ka fatin tonë në dorë. Vërtet, sepse ai kishte çantën me floririn e tre anijeve të shitura në ishullin e Rodit. U vendosën në Stamboll, ku blenë një anije tjetër me emrin "Elkahire", me të cilën lundruan për disa vite, dhe më vonë ja shitën shkollës së marinës së Egyiptit, e cila aktualisht është pjesë e muzeut të kësaj shkolle.

Të tre vellëzërit vdiqën në Stamboll, Mehmeti në vitin 1918, u varros në Jupi – Sulltan, dhe dy të tjerët vdiqën më vonë. Pjesa tjetër e familjes Luli mbeti në Shkodër dhe këtu ka pasur një fabrikë sapuni, të cilën në vitin 1929, e shesin për shkak të falimentimit. Ndërsa fëmija i adaptuar, Saidi, morri pjesën e vet dhe shkoi në Egjypt. Zoti bën mrekulli, jo më kot populli ynë thotë, - "mali me malin s'piqen, por robi me robin, piqen". Kështu në vitin 1948, Ahmet Luli, Xhemal Peku, etj, ishin pjesë e ekuipazhit të anijes "Borova", e cila punonte në interes të jugosllavëve në këtë kohë dhe ata bënin rrugë të ndryshme në Mesdhe, midis tyre dhe rrugën e Aleksandrisë. Në një nga këto rrugë, kur u ulën në një lokal për kafe në këtë port, Ahmeti i thotë kamarierit: - ma lajmëro pak zotin Said. (Ndërkohë Saidi kishte krijuar një shoqëri anijesh në Egjypt, kujtojmë se shqiptarët derisa në pushtet ishte mbreti Faruk, kishin preferencë në këtë shtet).... Vjen Saidi, një takim vëllezërish, që i bëri përshtypje të gjithëve, madje konsulli anglez habitet, - ç'është ky përqafim midis një shqiptari të bardhë dhe një ezmeri nga Egjypti?! – Ishte një surprizë për të gjithë klientët e atij lokali. Ahmeti u prezantua në detyrën e tij si detar, si një nga nostromët më të vjetër, për të cilën ju rezervua një pritje e veçantë.
Mbas rrëmbimit të "Borovës" nga jugosllavët, Ahmeti bashkë me ekuipazhin u kthye në Shqipëri. Vëllai egjyptian Saidi vdiq në vitin 1957, i biri i tij i çon telegram për vdekjen e babës, vëllezërve të tij Luli në Shqipëri, - o axhë na vdiq baba! por rregjimi i asaj kohe nuk e la me i kthye përgjigje djalit të tij. Kjo ndodhi futet ke paradokset e asaj kohe.
Hysen Luli, kapiten i MV (motovelierë) "Dalip Luli", më pas në kantjerin detar, Vehbi Luli, detar e kapiten anije.

Familja Kapidani

Ahmet Kapidani ishte një përfaqësues tipik i kapidanëve ulqinak. U diplomua në shkollën e detarisë në Stamboll. Emigroi në Shkodër e pastaj në Durrës, ishte përparimtar e me kulturë të gjerë jo vetëm në fushën e detarisë. Në qeverin e mbretit Zog u emërua komandant i marinës luftarake dhe ishte pronar i anijeve "Anjeza" dhe "Pema". Ahmet Sul Kapidani, lindi në Ulqin më 1886 dhe vdiq në Durrës, në lagjen Kala në vitin 1957, ku j'u bë përcjellje e denjë nga të gjithë detarët e qytetarët.
Sulejman Kapidani lindi në vitin 1896 në Ulqin, ai punoi si drejtues i agjencisë detare spedicionere „Kapidani" deri në vitin 1943. Ai ishte pronar i barkës „Posta e Shqipnisë" që bënte lundrimin Durrës – Bari, dhe komandant i kapitenarisë në portin e Durrësit.

Familja Kalamishi

Mustafa dhe Tahir Kalamishi, djemtë e Asllanit. Më 1934, kjo familje ja shiti MV(motovelierë) „More", - zotit Selim Truma. Vëllëzërit Taip, Qazim dhe Xhemal Kalamishi, djemtë e Kapllanit, më 1926 u shpërngulën nga Ulqini në Shkodër dhe me vonë në Durrës. Më 1938, Taipi dhe Qazimi punuan si axhentë në agjensinë e Sul Kapidanit, më pas ata hapën agjensinë e tyre

„komisioneri spedicioni“, me të cilën punuan edhe në Shëngjin. Anija maune „Kalamishi“, pronë e vellëzërve Kalamishi u shtëtëzua në dhjetor 1944.
Më 1933, Tahir Kalamishi ishte kapiten i anijes „Kruja“ me kapacitet 400 t. Ai po transportonte kafshë të gjalla drejt Maltës ku i zuri një fortunë gjatë rrugës dhe anija u mbyt. Shpëtuan kapiten Tahiri dhe 6 marinarë.
Më 1943, anija „Vlona“ me kapacitet 120 t, pronë e Mustafa Kalamishit u mbyt në afërsi të Durrësit, kurse anija „Golfo bel Area“, pronë e Tahir Kalamishit u mbyt në afërsi të Shkodrës. MV(Motovelierë) „Rafaela“, me kapacitet bartës 150 t, më 1935 duke lundruar në itinerarin Durrës – Venecia u mbyt bashkë me të dhe kapiteni i saj dalmatin me pronarin Xhemal Kalamishi e 6 marinarët.
Mund të përmendim rastin e anijes „Dalmacia“, pronë e vëllëzërve Kalamishi, që humbi pa lënë gjurmë në detin Adriatik gjatë lundrimit të saj nga brigjet e Italisë në Shqipëri, ku nuk arriti të mbijetojë asnjë anëtar i ekuipazhit.

Familja Brasha

I pari Qerim Brasha në moshën 18 vjeçare ka ardhur me fllugë nga Ulqini në Durrës dhe këtu ka punuar me mjete të ndryshme të asaj kohe. Mustafa Qerim Brasha ka lindur në vitin 1894, dhe në moshën 18 vjeçare ka punuar me flluga dhe anije të ndryshme si nostrom.
Besim Qerim Brasha ka lindur në vitin 1897 dhe nga mosha 15 deri 24 vjeçare ka punuar në disa anije dhe me vonë kallafator në kantjer. Adem Besim Brasha, nga viti 1960 deri në vitin 1978 ka punuar elektromekanik në anijen „Teuta“. Fehmi Besim Brasha nga viti 1965 deri në vitin 2003, ka punuar në anijet „Dajti“ i vogël, „Mati“, „Liria“ dhe „Dajti“ – „Baxha“, si kaldaist dhe mekanik. Alban Fehmi Brasha, nga viti 1995 deri në vitin 2005 ka punuar në anijet „Baxha“, „San Arbëri“, etj.
Të nënshkruarit Besim Gjeli dhe Qamil Krymi, nostromo tek transporti detar i kohës, deklarojnë se zoti Besim Brasha, (Qerimi), ka ushtruar profesionin e detarit me mjetet shqiptare të asaj kohe, nga viti 1912 deri në vitin 1939, në këto mjete me flamur shqiptar.
Nga 1912 deri 1921, tek „Kaval Marino“, pronar Cen Beqiraga, ekuipazhi 9 vetë. Nga 1921 deri 1925, tek „Marshallo“, pronar Riza Jakupi, ekuipazhi – 6 veta. Nga 1925 deri 1928, tek „Miku i mirë“, pronar Brahim Salabegu, ekuipazhi – 5 veta. Nga viti 1928 deri 1936, tek „VII. Veli“, pronar Ali Velija, ekuipazhi – 9 veta. Nga viti 1936 deri 1939, tek „Llampa“, pronar Caf Kalamishi, ekuipazhi – 6 veta.

Familja Stari

I pari i familjes Nexhip Stari detar ulqinak. Dy djemtë e tij Dauti dhe Dalipi, kanë ardhur më 1913 në Durrës ku filluan të ushtronin zanatin e babës. Dauti ka punuar me fllugën e vet deri sa ja shtetëzuan në 1945, më pas punoi dhe 25 vjet të tjera ne det me MB (motobarkë) e anije të ndryshme, derisa doli ne pension në vitin 1970, - pra plot 60 vjet në det.

Nga fëmijët e Dautit dy djem morën zanatin e babës: - djali i madh Muhameti lindur në vitin 1936, që 17 vjeë filloi punë në det. Kështu ai në vitin 1953 filloi mekanik me barkat e drunit si „Kajo Karafili“, „Beqir Nova“ e me radhë tek AA (anije me avull) „Lirija“, „Partizani“, „Durrësi, etj. deri me 1994, kur filloi privatizimi i flotës. Ndërsa Mustafa Stari lindur me 16. 5. 1947, ka filluar më 1973 si muço në barkat e drunit, „Vjosa“, „Kajo“ Karafili“, „Mesapliku“, më pas nostromo e mekanik tek AM(anije metalike) „Butrinti“, „Skenderbeu“, „Durrësi“, „Lezha“ dhe e mbylli tek „Gjirokastra“ më 1994.

Familja Kalziqi

I pari i kësaj familje, Mehmet Kalziqi, ulqinak, qysh në vitet ’30 (M. H. - të shekullit XIX) ka pasur një bark druri, 120 t. Në vitin 1937 u vendos familjarisht në lagjen Livadhaj në Shkodër. Djali i tij, Adem Kalziqi në vitin 1939 erdhi ne Durrës ku ka punuar si marinar i thjeshtë dhe ka ndihmuar lëvizjen antifashiste.

Në dhjetor 1945, filloi shërbimin si marinar në ishullin e Sazanit, ku punoi ne anije druri të Flotës Luftarake, dhe në vitet 1945 – 1957, kjo anije bënte furnizim me ushqim, veshje dhe lëvizjen e personelit të ishullit, Sazan – Vlorë.

Në vitin 1957, Ademi punoi si mashinist tek anijethelluese „Ali Kelmendi“, deri në vitin 1961, ku punon si oficer i 1 – rë tek MB(motobarkë) „Ali Kelmendi“, kapiten Xhemal Bleta, me këtë MB u përplasën në një shkemb, në Xarë të Kroacisë, ku në sajë të aftësive të ekuipazhit, arritën të shpëtonin.

Në vitin 1963 punon tek AA (anije me avull)„Mati“, në vitin 1967 rrikthehet përsëri tek „Ali Kelmendi“, dhe përsëri tek „Mati“, në vitin 1973.

Para se të dilte në pension në vitin 1979, punoi tek anija ndihmuese „Gromone“. Djali i tij Muhamet Kalziqi, lindi në Durrës në vitin 1951. Dhe ky vazhdoi traditën e detarit pasi kreu shërbimin ushtarak si elektriçist në N/D(nëndetëse), në vitet 1970 – 1973 me komandant Dashamir Ohri. Menjëjerë u fut në Flotën tregtare si marinar, (asokohe kushdo që kryente shërbimin ushtarak në marinën luftarake i kishte dyert e hapura në tregtare), fillimisht me MB(motobarkë) „Ishmi“ me kapiten Vasil Xhaxho. Pastaj në vitet 1974 – 1975, marinar tek anija „Rinia“ me kapiten Pashko Gega

Familja Tafa

Beqir Isuf Tafa (ulqinak) ka lindur në Shkodër me 17. 07. 1923. Ky marinari i vjetër, rrëfen:

- Baba im, Isuf Tafa, ka qenë detar, pilot, në kohën e Zogut kemi pasur MB(motobarkë) “Tirana”. Gjatë luftës na u prish motori, e riparuam dhe mbas çlirimit barka na u sekustrua. Pra lufta na shkatrroi komplet. Në këto kushte u shpërngula nga Guri i Zi në Durrës në vitin 1950, në moshën 23 vjeç. Këtu me dhanë shtëpi dhe pune. Fillova si mekanik tek MB(motobarkë) “Kurveleshi”, me Xhemal Bletën kapiten, bënim rrugë në Italie, çonim trupa arre, krom, etj. Dhe merrnin mallra të ndryshme. Duhet përmendur se mbas çlirimit merrnin bukë nga shtëpia dhe e mbanim poshtë jastëkut, aq me vlerë ishte për ne. Në një rrugë Venecie, po lidhnim cimën në kalatë, ulëm sanallën; - pamë që aty

ishte vëllai i Mujo Ulqinakut, Bajrami, sanalli ishte mbrapa anijes, ka qenë një kohë e keqe, u mbytën te dy dhe i nxorri një anije e huaj nga poshtë eliçes. Niko Konomi ka qenë kapiten i MB(motobarkë) "Beqir Nova", tek "Teuta" – Ahmet Kotorri, "Mesapliku" – Muharrem Baze, "Qemal Stafa" – Ramazan Pici, "Toma Kalefi", - Xhemal Bleta, etj. Barkat e drunit në mungesë të rrugëve tokësore përgjatë bregdetit në atë kohë kanë bërë punën e transportit të makinave e mjaft mallrave të nevojshme.

Më pas në vitin 1962 kalova si mekanik tek "Skenderbeu" dhe në vijim tek anijet e tjera metalike: - "Sazani", "Butrinti" deri në vitet 1970, pastaj me "Teutën" 6 muaj me kapiten Xhevdet Gashi, ku punova si mekanik i parë. Na ndrronin shpesh nga anija në anije, "Vampo" ka pasur 50 e ca vetë. Mbaj mend një lundrim të vështirë me "Vlorën" për në Kinë, kapiten ishte Qemal Hate, nga Singapori në Shangai u prish koha për katër ditë, nafta u mbarua, u furnizuam në Singapor dhe kapiteni me një aftësi të jashtëzakonshme na shpëtoi nga rreziku. Qemali ishte oficer i rregullt e i përpiktë. Sa kam qenë unë me "Vlorën" mbaj mend se dëmtime nuk kemi pasur, dola në pension rrugën e fundit me "Vlorën" për në Kinë, në vitin 1978 – 79, po si mekanik. Nga brezi i vjetër mbaj mend Ruzhdi Gjurën, Rexhep e Sahit Lulin, Muharrem Bazen, Xhemal Bletën, etj.... respektoj ketë brez që bëri aq shumë për flotën.

Familja Cungu

Firma e kapiten Met Cungut

Kapiteni Mehmet (Met) Cungu ka lindur më 8. 07. 1920 në Ulqin. Kapiten Meti ka punuar si pilot në Misir në vitin 1921, kuptohet që në dinastinë e mbretit Farruk, (pasi ky ishte me origjinë shqiptare), kishte shumë shqiptare, midis tyre dhe marinarë.

Në një lundrim ai drejtoi një anije nga Aleksandria në Marsejë, dhe kur vajti atje, sipas rregullit do vinte një firmë në një dokument që ja kerkoi kapiteni frances, kuptohet që ai vuri gishtin, në vend të vulës.

Kapiteni francez, u habit.

- Si ka mundësi që ky kapiten pa shkrim e këndim ta sjellë anijen përmes Mesdheut deri këtu?! – tha.

Ai gjeti një mënyrë për të provuar aftësitë e kapiten Metit.... i dha dy koordinata, dhe i tha ma hidh pikën në hartë. Pa e zgjatur kapiten Meti, mori gjilperën dhe e vuri në pikën e duhur në hartë, sipas asaj që i tha kapiteni francez. U habit nga zotësia dhe mençuria e këtij kapiteni pa shkollë, por me barrën e dhjetëra viteve eksperience dhe lundrimesh pa fund në det. Për nder të kapiten Metit ai shtroi një drekë ku ftoi gjithë personalitetet e portit të Marsejës.

* * *

Në vitet 1920 – 1930, pronarët italianë i merrnin marinarët në provë (i testonin) direkt në vark, për të gjithë proceset që duhet të dijë një marinar në MV(motovelierë), dhe më pas mund të bëheshin pjesë e ekuipazhit të tyre.

* * *

Në vitin 1920, në përbërje të ekuipazhit të jahtit "Nimet Allah", të mbretit Farruk kanë qenë 15 shqiptarë – ulqinakë: Malo Hoxha, Emin Beci, Mustafa Karaminxhoja, Jonuz Dema, Halil Guçi, Cuf Vogliqi, Reshit Hasanaga, Ganush Tulishmi, Riza Fici, Sul Fani, Muhamet Pulti, Hysni Resulbegu, Riza Çaushi, Cano Lazoja dhe Muhamet Arapi.

Familja Matlia

Kapiten Hysen Matlia ka lindur në Ulqin më 1890. Në vitet '30 të shekullit XIX ka qenë pilot në kanalin e Suezit, më pas është arsimuar në Itali për marinar, në vitin 1958 – 1960 ka qenë instruktor tek anija shkollë "Mujo Ulqinaku", më pas kapiten tek barkat e drurit.

Në vend të përfundimit

Në fund të shekullit XVII – te në Ulqin kishte gati 250 anije dhe barkë me vela. Pronarët e anijeve, agallartë ulqinakë, lundërtarë të guximshëm, preknin me anijet e tyre jo vetëm skelat shqiptare por edhe limanet e qyteteve tregëtare të Adriatikut dhe Mesdheut.

Me humbjen e Ulqinit, tregëtia e jashtme e Shkodrës u dëmtua rëndë sepse Ulqini konsiderohej skelë e Shkodrës. Ulqinakët u gjendën në mes dy rrugëve: - Turqia nga njëra anë u premtonte ndihma të mëdha dhe u fali një gji deti pranë Stambollit, që i përngjiste atij të Ulqinit, në të cilin mund të vendoseshin ata me familjet dhe vetë. Porta do ta ndërtonte qytezën për muhaxhirët ulqinakë Ndërsa në anën tjetër Mali i Zi i jepte parisë e bejlerëve, premtime dhe favore për të pranuar pushtetin e tij. Në këto kushte Ulqinakët si rrugë shpëtimi zgjodhën Shkodrën, qytet me të cilin që në lashtësi e lidhnin marrëdhëniet ekonomike, tregëtare e lundruese.

Ulqinakët shkuan në qytetin e Shkodrës si refugjatë dhe u vendosën në lagjet afër Bunës: - Tophane, Luçugesmë, Parrucë, etj. Shkodra ka qenë stacioni i parë i detarëve ulqinakë dhe nga këtej në Durrës dhe më tutje. Në bazë të një rregjistri të Shoqatës "Ulqini" në Shkodër dëshmohet se kur dhe sa familje ulqinake e kanë lëshuar vendlindjen dhe janë vendosur në qytete të tjera. Në vitin 1780 është çuar një familje, ajo e Isuf Hysejn Rejzit; - më parë është shpërngulur në Lezhë, e më pas është vendosur në Shkodër. Në vitin 1850, Ulqinin e la vetëm një familje, ajo e Cen Hasan beg Dizdarit. Në vitin 1880 shpërngulen nga Ulqini 180 familje dhe në vitin 1900 ikin 7 familje. Në vitin 1913 kërkojnë strehim në Shkodër 64 familje. Në vitin 1920 ikin 5 familje.

Me shpresën për një jetë më të mirë dhe për të ushtruar zanatin e vjetër të trashëguar brez pas brezi, dhjetra familje si Gjyli, Kotorri, Peku, Tivari, Shapalaku, Kalamishi, Bilali, Kapidani, Fani, Molla, Mujali, Bazi, Luli, Veseli, Dermani, Uruçi, Majushi, Gorana, Bekteshi, etj. u vendosën në Durrës; - rreth viteve '20 të shekullit XIX, një valë e re e familjeve ulqinake nga Shkodra u vendosën në Durrës, në disa lagje si Sefer Efendiu, Varosh, Kala, etj, pjesa më e madhe e të cilëve filluan të merren me detari.

Mes viteve 1930 deri 1944 i braktisën trojet e veta 12 trungje familjare ulqinake. Shumë familje, më pas janë shuar ose kanë dalë në Lezhë, Tiranë, Durrës etj. Edhe sot në Shkodër jetojnë familje ulqinake të cilat e ruajnë prejardhjen dhe mbiemrin si Bilali, Fani, Pelinku, Ulqinaku, Krymi, Dizdari, Ulqini, Luli, Sakti (Mani), Bimi, Kadija, etj. Shoqata "Ulqini" i ka regjistruar 600 familje me prejardhje ulqinake, pa evidentuar ato të vendosura nëpër fshatra. Ulqinakët në ambientet e reja u përshtatën shpejt dhe krijuan jetën e re, duke mos harruar kurrë vendlindjen. Fillimisht me barkat e tyre me vela, më vonë edhe me motor, i sollën gjallëri tregtisë dhe ekonomisë së qytetit të Shkodrës. Shumë prej ulqinakëve ishin pasanikë dhe si muhaxhirë ndërtuan shtëpi të reja. E filluan përsëri profesionin e lundrimit e detarisë. Me anijet e tyre të shpejta e të sigurta vazhduan tregtinë me qytetet në brigjet e deteve: - Adriatik, Egje e Mesdhe, duke tregtuar me Aleksandrin, Marokun, Egjiptin etj.

Literatura

1.Shefqet H. Kerçelli, Në 100 vjetorin e pavaresisë, Antologji e detarisë Shqiptare, Pjesa e Parë, Nga lashtësia deri në vitin 1960, Durrës, 2012.
2.Hasan Ulqini, Dhe krisht, dhe mëkatar, Durrës, 2006.
3.Dyrrah, Nr. 4. Botimet "Pal Engjelli", Durrës, 2005.
4.Hajro Ulqinaku, Deti, detarët e Ulqinit, Ulqin, 2000.
5.Hajro Ulqinaku, Detarë, peshkatarë, Ulqinakë, Ulqin, 2002.
6.Hajro Ulqinaku, Detaria, detarë, dokumente, Ulqin, 2004.
7.Hajro Ulqinaku, Libri për Ulqinin dhe Ulqinakët, 2010.
8.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Detaria e Ulqinit nëpër shekuj, Ulqin, 1994.
9.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Flota shekullore detaro – tregtare e Ulqinit, Ulqin, 2011.
10.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Veprimtaria detare – tregtare e anijeve ulqinake gjatë shekullit XVII deri në fund të shekullit XIX, KOHA, nr. 2, Viti V, Titograd, 1985.
11.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Popullsia e shpërngulur nga Ulqini në fund të shek. XIX dhe fillimin e shek. XX, Seminari II Ndërkombëtar "Shkodra në shekuj", Shkodër, 22 – 23. qershor, 1995, Shkodër, 1996.
12.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Detarët ulqinakë të shpërngulur në Shkodër pas vitit 1880, Simpoziumi shkencor, "Ulqini në rrjedhat e kohës", Ulqin, 26 – 27 maj 2000, Ulqin, 2000.
13.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Haxhi Mehmet Beci dhe Lufta për mbrojtjen e Ulqinit, KRONIKA, e pavarur në gjuhën shqipe, nr. 43, shtator 2002, Ulqin, 2002.
14.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Mujo Cakuli – Ulqinaku, si nënoficer i marinës ushtarake shqiptare në Durrës, KRONIKA, gazetë informative e pavarur, nr. 30., shtator 2001, Ulqin, 2001.
15.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Shënimet e para mbi Ulqinin, KRONIKA, gazetë informative, nr. 18, shtator 2000, Ulqin, 2000.
16.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Terminologjia detare Ulqinake, LIBERALI, 27 prill 1998, Podgoricë, 1998.
17.Maksut Xh. Haxhibrahimi, E kaluara e Kalasë së Ulqinit, LIBERALI, 30 mars 1998, Podgoricë, 1998.
18.Maksut Xh. Haxhibrahimi, "Esnafët detarë" të Ulqinit, FATI, nr. 3, Viti I, Ulqin, 1994.
19.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Servantesi dhe Fransua Pukëveli robërit e piratit ulqinak Uruç Aliu, KRONIKA, E pavarur në gjuhën shqipe, nr. 47, Viti VI, shkurt 2003, Ulqin, 2003.
20.Maksut Xh. Haxhibrahimi, Emrat e anijeve të flotës detare ulqinake, DIJA, nr. 6, Ulqin, 2008.

Dr Bahri BRISKU

ULLISHTARIA DHE MULLINJTË E ULLIRIT NË ULQIN ME RRETHINË

Përfitimi i vajit nga ullinjtë

Mënyra më e vjetër e përfitimit të vajit nga ullinjtë është ajo me thes: mbushet mirë thesi me ullinj, vihet përmbi magje druri dhe shkilet me këmbë zbathur ose me ”qeruce”[97] të pastruara mirë. Thesi shkilet gjer s të krijohet brumi i ullirit. Gjatë kësaj veprimtarie thesi laget me ujë të ngrohtë. Thesi është i punuar me lesh dhish ose nga liri. Pastaj, nga përzierja e ujit, kuqlës dhe vajit: me një enë të punuar nga druri ose poçi i kungullit i regjur dhe i prerë, ndahet vaji nga kjo përzierje. Ky është lloji më i mirë i vajit. Quhet ***Vaj magje***, i thesit. Ky lloj vaji përmban në vetvete më pak thartirë, nuk ka aromë të rëndë. Përveç se përdoret për gjellë të ndryshme, është shumë i kërkuar për sallata, lyerje të lëkurës nëpër plazha kundra djegëjes nga rrezet e diellit dhe për ta pirë si ”ilaç” kundër sëmundjeve të barkut. Gjatë sundimit të fundit të Austro-Hungarisë (1914-1919), shumë familje në mënyrë ilegale e përfitonin vajin, duke e shkelur me thes, sepse austrohungarezët pjesën më të madhe të vajit që e gjenin nëpër mullinj e plaçkitnin. Kjo mënyrë e përfitimit të vajit në shpatijet e Rumisë përdoret ende sot, se këto lokalitete i kanë larg mullinjtë. Kështu e përfitojnë vajin vetë, megjithëqë kjo mënyrë kërkon shumë punë të mundimshme.



Fig. 14. Skicë mulliri me një gurë

Gjer në Luftën e Parë Botërore, në Ulqin kishte më se 100 mullinj, të cilët shtypnin ullinjtë me një ose me dy gurë. Të gjitha pjesët që e venin në lëvizje gurin, përbëhen nga druri: boshti, sirenat;[98] lopatat e brendëshme dhe të jashtme, kularët dhe çdo send tjetër.

[97] *Qeruce* – këpucë gome që i punojnë këpucëtarët privat.

[98] *Sirenat* – janë mërtekë (qepra) të drejtë, të cilët shtërngohen me boshtin kryesor (vertikal) dhe boshtit horizontal me të cilin është shtërnguar vetë guri i mullirit.

Mullinj kishte më së shumti në Mhallë të Re dhe në fshatin Krruç. Gjer në shekullin XIX kishte tre mullinj edhe në qytet të vjetër – Kala. Mbeturinat e mullinjve të Kalasë shihen ende sot. Ka gjasë që ata të kenë qenë mullinj të modelit të vjetër me një gurë, tri sirenash dhe me mashtër të punuar kryekëput prej gurëve në formë të dybekëve. Kjo do të thotë se ata janë më të vjetër se ç'kishte filluar të përdoret çimentoja. Gurët e këtyre mullinjve ishin diçka më të vegjël se të tanishmit në Mhallë të Re. Gjithashtu edhe suntina[99] ishte punuar prej guri, gjë e cila paraqet një gjë posaçërisht të rrallë në etnografinë e ndërtimit të mullinjve të këtij lloji. Këta mullinj viheshin në lëvizje me anë të fuqisë punëtore, kurse më vonë, për lëvizjen e mullinjve të kësaj dore filloi të përdoret edhe kali, të cilit ja mbyllnin sytë dhe ai sillej vetë rreth e rreth mashtre[100], duke gërguar sirenat nëpërmjet të cilave viheshin në lëvizje gurët. Këta ishin mullinj të tipit më të lashtë, faza e parë e përfitimit të vajit pas thesit. Tani, në qytet s'gjendet asnjë mulli i tipit të vjetër. Në fshatin Krruç tani ka 3 mullinj, dy prej të cilëve janë të tipit më të vjetër: me vegla të punuara nga druri. I tillë është mulliri i Palës Pjetrushit Andrisë. Ky lloj mulliri është me një gur dhe fund e majë i punuar prej drurit nga mjeshtrit e vendit. I tillë është edhe mulliri i Omer Millës (Fig. 15), por ky ka dy gurë. Mulliri i tretë, që gjendet në këtë fshat, është bashkëkohor, gurët e të cilit vihen në lëvizje me anë të motorit që punon me naftë dhe me kalë.



Fig. 15. Mulliri i Omer Millës me dy gurë

[99] *Suntina* – është rezervoari, ku mblidhet kuqla përzier me vaj, kur kullohet nga shportat në mandravidë.
[100] *Mashtra* – lëmi i gurit, ku qiten ullinjtë për t'i bluar.

Kështu ishte gjendja e mullinjve në trevën e Ulqinit gjer më 1906, kur detari i njohur Fazli C. Lazoja bie me barkën e tij nga Italia tri presa të vogla dhe dy të mëdha. Ky, gjithashtu i pari, montoi në Ulqin mullirin me tre gurë, të cilin e vinin në lëvizje kuajt (një çift). Pjesët kryesore të tij ishin punuar nga hekuri. Përdorimi i presave moderne zëvendësoi fuqinë punëtore dhe më vonë edhe kuajt dolen nga përdorimi i gjerë, megjithëqë përdoren edhe sot në Krruç, Kunje (fig. 16) dhe Kaminë. Pra, është modernizuar mënyra e lëvizjes së mullirit (gurëve) për shtypjen e ullinjve, kurse e gjithë veprimtaria tjetër në mulli ka mbetur në nivelin e mëparshëm, përveç që aty-këtu edhe shtrydhja e shportave bëhet me anë të shtypjes së ujit, me të cilën gjë është zëvendësuar fuqia e punëtorëve. Pas 1920 shumë ulqinakë sollën nga Dalmacia dhe Italia presa të ndryshme, kështu që Ulqini para Luftës së Dytë Botërore kishte 15 mullinj të tillë, të cilët paraqesin një fazë më të lartë modernizimi.



Fig. 16. Mulliri më i vjetër në Krruç me presa druri, pronë e Lekë Milanit

Mullirin e parë modern, të cilin e kanë quajtur fabrika e vajit, e ndërtoi Anton Pogu, pasanik i njohur. Ky u lëshua në veprim më 1942 dhe kishte tre gurë dhe tri presa, të cilat janë vënë në lëvizje me anë të motorëve. Kjo godinë është ende në gjendje të mirë, por është shndërruar në punishtë bukëpjeksie, kurse mullirin e kanë montuar në fabrikën e sotme të vajit, e cila gjendet në një godinë tjetër të re. Ky kalim është bërë më 1946. Fabrika pastaj u pajis dhe u modernizua me pajime më bashkëkohore. Montimi i pajimeve për zbatimin e teknologjisë së re dhe mbushjen e shisheve me vaj u bë më 1961. Pas riparimit të kësaj fabrike u krijuan kushtet që vaji i ullirit të fitohet gjer në maksimum, pushuan së punuari shumë mullinj të vjetër të cilët nuk mundën të ecin krahas

me të mbërrimet teknologjike në këtë lëmë. Por, prapëseprapë këtu ka ende katër mullinjë privat.

Në Ulqin mullinjtë ndërtoheshin kryekëput nëpër ahrinje të shtëpive ose nëpër hajate. Janë raste shumë të rralla kur për mulli ka ekzistuar ndonjë lokal i posaçëm. Mulliri është i përbërë prej tri pjesësh kryesore: mulliri, mandravida dhe manavelat[101] për shtrëngimin e shportave[102] të mbushura me brumë ullinjësh (fig. 17). Pjesa më e rëndësishme e mullirit është mashtra (fig. 18.), e cila përpara ka qenë punuar e tëra prej kapakësh të gdhendur gurësh, kurse më vonë, mashtra është punuar me beton. Kjo i ngjan një lëmi minatural e ndërtuar gjer në një metër lartësi, me mure anësore që kur të zbrazen ullinjtë mos të derdhen jashtë. Ky mur është i gjërë 30 cm i lartë nga rrasa, ku shtrihen ullinjtë për t'u bluar.



Fig. 17. Skicë e mullirit me dy gurë me pjesët e tij përbërëse: 1. Boshti, 2: Gurët, 3. Sirenat, 4. Mashtra

Lartësia e mashtrës gjer në një metër bëhet më tepër për arsye të përshtatshmërisë së rrotullimit të gurëve me anë të sirenave (fig. 19), të cilët vihen në lëvizje përmes fuqisë punëtore ose kuajve. Gjerësia e mashtrës është 2 m, kurse perimetri i saj gjer 8 m. Në mes të mashtrës përforcohet një gur i rrumbullakët me një lartësi prej 70-100 cm. Në kohët e vona montohen nga dy gurë të tillë, kurse dy mullinj kanë pasur edhe nga tre gurë. Gurët në mashtër montohen në mënyrë vertikale. Këta janë të rrumbullakët, kanë një trashësi prej 25-35 cm. Kur në mashtër montohen dy gurë, atëherë ata kanë largësinë njëri prej tjetrit gjer më 60 cm. Këta i gëdhendin mjeshtrit e vendit me rrasa të xjerra në Malin e Bardhë. Gurët pjesën e poshtm, shkelëse, e kanë të vrazhdët. Në këtë mënyrë gdhenden nergut për t'i shkelë më mirë ullinjtë. Në pjesën e fundit të mashtrës gjendet një rrasë e rrumbullakët me një gjerësi prej 40 cm dhe të lartë afër 30 cm me një vrimë të vogël në mes. Në këtë vrimë shtrëngohet boshti, i cili është i punuar nga druri i lisit, i pishës ose i ahut. Boshti montohet ne gjendjen vertikale (Fig. 17.(, i kapur për çardak (trarin e çardakut të dhomës,

[101] *Manavelat* – janë dorëzat e breshkave të mandravidës, të cilat kanë nga një vrimë anash për të tërhequr brenën e gjatë 3 m për të shtrydhur më lehtë brumin e ullinjve në shporta.
[102] *Shportat* – janë të punuara në formë të rrumbullakët nga xungat.

që zakonisht gjendet në pjesën e sipërme të shtëpisë). Boshti është i gjatë afër 2 m, me një gjerësi prej 20-25 cm. Nga të dy anët boshti është i shtrënguar mirë. Ky në vimën e rrasës është shtrënguar me një bosht hekuri me një trashësi prej 10 cm. Një bosht i tillë në formë të gozhdës së trashë, është i shtrënguar edhe për tra të çardakut. Secili bosht i gurëve të mullirit ka nga dy ose katër sirena, të cilat shtrëngohen me pyqe dhe përmes vrimës që është hapur në bosht vertikalisht. Sirenat janë të punuara gjithashtu prej drurit të gështenjës ose të lisit. Përmes tyre vihet në lëvizje mulliri, duke e shtyrë 3-4punëtorë ose kali.[103]

Fig. 18. Dy gurët e mullirit rrotullohen mbi mashtër



Fig. 19. Dy sirenat të shtrënguara për bosht, në mes të gurëve të mullirit, të cilët qëndrojnë mbi mashtër

[103] Mullirin e vë në lëvizje vetëm një kalë, kurse tjetri e ndërron atë, se në një mulli s'ka vend për dy kuaj përnjëherë.

Sirenat janë të vendosura 30-40 cm mes të gurëve. Këto janë të gjata gjer në tre metra dhe dalin jashtë mashtrës nga 60-80 cm, aqë sa është e përshtatshme për shtyrje të punëtorëve ose gërgim të kalit. Sirenat janë të përforcuara njëra me tjetrën përmes brenave gjysmëharkore, të cilat montohen 5-10 cm larg murit të mashtrës. Dy prej këtyre brenave formojnë rrethin e mashtrës. Tani, në vend të këtyre brenave më tepër përdoren disa lloje ganxhash të gjata hekuri, të cilat janë më praktike dhe më të forta. Me këto sirena s'luajnë nga vendi. Sirenat me ganxha ose me krraba druri përforcohen edhe për pjesën e lartë të boshtit kryesor. Gurët lidhen njëri me tjetrin përmes një boshti, i cili kalon nëpër boshtin kryesor dhe i lidh dy gurët e mullirit. Ky bosht, në të shumtën e rasteve, është i punuar nga druri i gështenjës, kurse tani vihet edhe boshti i hekurt. Ky është i gjatë gjer në një metër dhe i trashë 6- cm.



Fig. 20. Skicë e magjes (govatës) së drurit



Fig. 21. Magje (govatë) e betonit e mbushur me vaj

Në kohët e fundit gurët e mullinjve bëhen nga betonarmeja. Në mashtër qitet përnjëherë një gurë (200 kg) ullinj. Shtypja e tyre gjer në brum zgjat pothuaj një orë, varësisht nga shpejtësia me të cilën sillen gurët. Prej këtej, brumi i ullinjve të bluar, bartet me babune[104] dhe qitet në magje, e cila është e punuar nga druri, guri ose betoni (fig. 20 dhe 21).

Magjen ca e quajnë edhe "govatë", sidomos nëqoftëse ajo është e punuar nga druri. Punohet nga druja e plepit, e vidhit ose arrës. Magjja (govata) montohet ose ndërtohet në afërsi të mashtrës së mullirit, në një kënd, ku nuk e pengon qarkullimin e punëtorëve dhe të personelit shërbyes të mullirit. Kjo zë gjer dy gurë ullinj, sasi kjo që është përafërsisht baras me 400 kilogram. Këtu nga brumi i ullinjve kullon vaji i parë, i cili është vaji më i mirë, i njohur si vaji i magjes, të cilin pronari i mullirit e ruan kryesisht për nevojat e veta. Ky vaj është i ngjashëm me vajin që përfitohet prej shtrydhjes së ullinjve në thes. Ky lloj vaji nuk përmban thartirë në vetvete ose përmban një pjesë minimale të

[104] *Babune* – enë druri prej 10 kg.

kësaj përmbajtjeje, e cila dobëson kualitetin e vajit. Vaji që përfitohet nga kullimi natyral i brumit në magje, është vaj i mishit të ullinjve e jo edhe i bërsisë (bërthamave të tij). Prandaj ka kualitet të lartë se në një magje, nga një gurë ullinj mund të kullojnë vetëm 2-3 litra vaj, respektivisht dy okë, se kjo është masa dominante e mullinjve të ullinjëve.



Fig. 22. Mandravida me pjesët përbërëse: 1. Drelat, 2. Boshti, 3. Pela, 4. Breshkat, 5. Torku, 6. Shportat me brum ulliri, 7. Lugu, 8. Suntina, 9. Ballat

Brumi i ullinjve nga govata, magjja, vendoset në shporta speciale për këtë qëllim. Këto mullisit i vendosin në mekanizimin, i cili kryen funksionin e shtrydhjes. Kjo është pjesa e dytë e mullirit, e cila quhet presë ose mandravidë (fig. 22). Kjo është faza e dytë e përpunimit të ullinjve dhe përfitimit të vajit nga kjo pemë industriale. Kjo lloj mekanizmi përbëhet prej shtatë pjesëve, e secila nga ato kryen nga një funksion: dredhat janë të gdhendura në dy shtylla të cilat janë vendosur vertikalisht në tork.[105] Breshkat: janë të punuara në formë breshke me tri ose katër manavela (dorëza) të gjata gjer 50 cm. Të tilla ka dy copë, secila është e vendosur në shtyllën e drelave (dredhave) përmbi pjesën e mandravidës, e cila quhet pela. Këto janë të trasha gjer 20 cm, kurse në vrimën që shtrëngohet për shtyllat e dredhave, ka gjithashtu të gdhendura ca dredha me të cilat shtrëngohet pela, e cila, duke rrëshqitur prej së lartit poshtë bën

[105] *Torku* është pjesa e fundit e mandravidës.

shtrydhjen e shportave, të cilat janë të mbushura me brumë. Pela është e shtrënguar për dredha, mbi të cilën janë të shtrënguara breshkat ose katër kamzat e breshkave.



Fig. 23. Mandravida druri e mullirit më të vjetër, në Krruç, pronë e Lekë Milanit.



Fig. 24. Lekë Milani i ulur mbi torakun e mandravidës së mullirit të tij, që është më i vjetri në Krruç



Fig. 25. Qypa të vajit

Kamzat e breshkave që quhen manavela, përdoren për ta shtrënguar pelën se duke sjellë ate ajo shtrydh brumin e shportave. Kështu, një punëtor shtrëngon një anë, kurse tjetri anën tjetër, duke shkuar paralelisht nëpër dredhat e shtyllave vertikale gjersa të tejkalohet gjysma e lartësisë së renditjes së shportave. Përnjëherë vihen në mandravidë gjer 20 shporta të mbushura me brumë. Lartësia e tyre kur palohen në shtyllën e mezit, e cila kalon nëpër lug të torakut përmes shërben që mos të pengohet shtylla gjatë shtrydhjes. Kështu, pela me shporta ulet teposhtë nën presionin e breshkave dhë vidohen nëpër dredha nga lartë.

Toraku është pjesa e poshtme e mandravidës (presës). Në të janë të shtrënguara dy boshtet e dredhave, boshti i shportave dhe lugu, i cili kryesisht gdhendet në vetë torakun. Toraku është i punuar prej drurit të trashë vidhi. Ky është i gjatë 3 metra, i gdhendur në formë të katërkëndëshit (prizmës). Lugu që kryesisht është i gdhendur në vetë torakun, është më i gjërë se shporta (80 cm) dhe shërben për pengimine vajit nga derdhja që rrëshqet nga shportat. Pra, ky lug mbushet me vaj e kuqël dhe përmes një çyçi kalon në suntinë.

Suntina është gjithashtu një pjesë e mandravidës dhe e mullirit në përgjithësi. Kjo ndërtohet ose montohet në dhé (brenda). Mullinjtë e parë suntinë e kanë pasë ndërtuar në këtë mënyrë: kanë hapur një gropë të thellë 1,5 m dhe aty kanë vendosur rezervoarë (dybekë) të mëdhenj të gdhendur prej guri ose qypa dheu. Më vonë suntinat kanë filluar t'i punojnë edhe prej çimentos, duke i bërë si saranxha gjer dhjetë kubikësh. Disa për këtë qëllim përdorin edhe vozgat e drurit ose tinat e hekurt por suntinat më të mira dhe më atraktive kanë qenë dhe kanë mbetur ato që janë të punuara nga guri ose edhe mermeri. Këto të fundit janë sjellë nga Egjipti dhe vendet e tjera arabe. Rënja e vajit në suntin, është përpunimi final i vajit. Tani prej suntine merret vaji dhe vendoset nëpër qypa (fig. 25), vozga, damxhana, dybekë specialë për vaj dhe tina, tëcilat janë të punuara nga druri ose hekuri. Vaji në suntinë del sipër, kurse poshtë rri kuqla, e cila është përzier me ujë se gjatë shtrydhjes së brumit të ullinjëve në shporta të vendosura në mandravidë (presë), hidhet ujë i ngrohtë për të nxjerrë vajin nga bursia. Kur pronari donte që bursia, e cila mbetej të shtrydhet sa më tepër, punptorët e mullirit shtrëngonin në manavelat (dorëzat) e breshkave nga një brenë ahu ose gështenje të gjërë 3 metra, me anë të të cilave arrihet maksimumi i shtrëngimit të shportave, por këtu duhet cekur faktin që vaji i fundit është vaj i fortë, pra i kualitetit të dobët, i cili përdoret për lyerje ose për të zier sapun.

Fig. 26. Pamja e jashtme e mullirit më të vjetër në Krruç, pronë e Lekë Milanit, sjellur në miraz nga e shoqja Mara

Tani mandravida, me të gjitha pjesët e saja, punohet prej hekuri, i cili është më praktik dhe më i qëndrueshëm. Mandravida të tipit të vjetër në Ulqin dhe rrethinat, janë ruajtur edhe tri sosh. Dy të tilla gjenden në fshatin bregdetar në Krruç[106] njëri është i Omer Millës (fig. 15) dhe tjetri është i Marës së shoqes së Lekë Milanit, së cilës i ka mbetur si miraz prej babait Palës së Pjetrushit Andrisë, që e ka ndërtuar vetë (fig. 26). Ky mulli është i vetmi "yrnek" që ka mbetur prej mullinjëve me një gurë dhe që është punuar i tëri prej druri, kurse ai i Omerit është me 2 gurë. Mulliri i tretë, i cili gjithashtu mandravidën e ka të punuar nga druri, është mulliri i Pjetrit të Andrisë në fshatin Braticë. Mullinj të tillë gjer në Luftën e Dytë Botërore kanë pasur këta pronarë: **Nuti i Adem Manit, Hysnia i Murtezajt, Caf Mavriqi, Meti i Muharremit, Januzi i Muharremit, Alo Kasmi, Duli i Haxhimollës, Mani i Mehmet Fatimes, Daut Katana, Daut Mavriqi, Latifi i Haxhibrahimit, Halil Milla, Janus Milla, Dalip Myrtoja, Janus Myrtoja, Caf Fici, Nuro Kollari, Bim Canka, Cafo Çapunja, Cufo Buzhina, Lit Qyrkoja, Hysejn Brisku, Shevqet Cungu, Bet Buyuku, Lit Qyrkoja** dhe **Ali Kaceni**. Në **Krruç** gjer vonë kishte mullinj të këtyre pronarëve: **Januz Milla, Oso Milla, Fadil Milla, Mehmet Milla, Pala i Pjetrushit Andrisë, Tula i Fazlos, Januz Myrtoja, Pjetri i Ndrekës** (në Braticë), **Omeri i Usta Halilit, Mara e Prenç Sqepës, Bet Gjyli,**

[106] Në Meteris ka pasë ekzistuar një mulli, i cili punonte me erë. Ende sot ky breg quhet "Te mullini i erës" gërmadha e të cilit është zhdukur nga gjermanët në vitin 1943.

Omer Hysejni (Kunje)**, Emro Gjylameri** (Kaminë)[107]**, Bet Karaminxhoja, Daut Mavriqi** etj. Sot përveç fabrikës, kanë mullinj privatë edhe këta persona: **Fadil Milla, Alo Kasmi, Shevqet Haxhibrahimi, Omer Milla, Bahri Hoxha, Nazif Milla** dhe **Mara e Pjetrushit Andrisë**. Edhe mullisët privatë u japin pronarëve të ullinjëve aqë kilogram vaj për kuintal sa u jep atyre edhe kolektivi i fabrikës.[108]



Fig. 27. Motiv nga fabrika moderne e vajit në Ulqin

Fabrika është e pajisur me mjete më moderne bashkëkohore (fig. 27). Kjo brenda një dite mund të bluaj gjer 2,5 vagona ullinj. Industria e vajit ka një kolektiv të vogël, ndërsa veprimtaria e bluarjes së ullinjve gjer vonë kishte karakter sezonal. Tani fabrika ka blerë edhe maqinën e mbushjes së shisheve me vaj origjinal ulliri dhe të përzier, për të cilin kualitet dëshmon edhe ”etiketa” e ngjitur në shishe: ku, përveç të tjerash, shënohet se a është vaji i përzier apo jo. Kapaciteti i mbushjes së vajit të prodhimit të kësaj fabrike është 1600 litra për tetë orë. Vaji i ullishtës së Ulqinit është i kualitetit të lartë, i cili kërkohet shumë në mbarë bregdetin Adriatik, sidomos e kërkojnë fabrikat e konzervimit të peshkut. Pasi ky lloj vaji përmban fare pak thartirë në vete, është vaji më i përshtatshëm për konzervimin e peshkut dhe për disa konzervime të tjera. Duke përdorur këtë vaj, konzervat e tilla qëndrojnë më tepër, sepse oksidimi i kutisë në pjesë të brendëshme s’mund të bëhet.

Ndërtimi i mullinjëve dhe të thururit e shportave

Pas të dhënave të banorëve, mulliri i parë për bluarjen e ullinjve, është sjellë nga Venediku, në kohën e sundimit të tyre në këtë trevë. Pastaj, duke marrë

[107] Pronarët që kanë pasur ose që kanë mullinj në afërsi të Krruçit, lokalitetet e tyre janë vënë në kllapa.
[108] Tani marrin 2 kilogram vaj ujëm për një kuintal ullinj të bluar. Bërsia i takon mullisit.

këtë si ”yrnek”, ata erdhën duke u shumuar dhe i ndërtonin vetë mjeshtrit e vendit. Ndoshta edhe mulliri i parë është ndërtuar këtu, duke pasur si mostër atë të venedikasve, të cilin mund ta ketë sjellë këtu ndonjë nga detarët ulqinakë.

Fig. 28. Shportë e vjetës, e punuar nga xungat, e përdorur gjer para 50 vjetësh

Fig. 29. Shportë e kohëve më të vona, e punuar nga fijet e lirit dhe kërpit

Më vonë në Ulqin kishte edhe gurëgdhendës, të cilët vetë i gdhendnin edhe gurët e mullirit, dybekët e mëdhenj për vendosjen e vajit, brumit të ullinjve dhe bërsisë të pashtrydhur mirë. Gjer vonë ekzistonte një numër i madh mjeshtrish, të cilët merreshin me ndërtimin e pjesëve dhe montimin e mullirit në vendin e duhur. Mashtrën në fillim mjeshtrit ndërtonin prej pllakave të mëdha guri, kurse sirenat, boshtin dhe pjesët e tjera të mashtrës i bënin nga druri i fortë, më së tepërmi nga druri i gështenjës, i lisit dhe i fajletës (caracit). Me të tillë drunj gdhendnin edhe mandravidën. Mjeshtrit e tyre ishin kryesisht zdrukthtarë dhe muratorë të dalluar. Nergut mullinj ndërtonte **Demë Brahimi, Omer Sulaj** (është gjallë, jeton në fshatin Krruç 7 km larg qytetit), **Sylo Brisku, Simë Pepgjoni, Riza Hoxha** etj. Për ndërtimin e mullirit përdoreshin këto vegla: çekani, daltal pergjeli (përdorej për të bërë vija të rrumbullakëta), qeseri, zdrukthi, latusha, turjela, metra, sharra etj.

Shportat janë dy llojesh: të dendura dhe të rralla. Të rrallat janë më të vjetra dhe punoheshin prej zhugave[109] dhe xungave,[110] (fig. 28), kurse të shpeshtat

[109] *Zhuga* është një lloj druri bregdetar, i cili lëshon fije. Degët e saj i mbledhin në pranverë dhe të lidhura i vënë në ujë të detit. Ato lëshojnë fije të holla, prej të cilave gjer vonë banorët e kësaj treve kanë endur për nevojat e veshjes.

[110] *Xunga*, bimë moçalike

punohen nga fijet e lirit dhe kërpit, të cilat së pari dridhen në formë të sixhimit (spagës) dhe pastaj enden shportat me to (fig. 29). Edhe shportat ulqinakët i thurnin vetë. Kështu, ende sot ka mjeshtër të tillë: **Muho Katana, Bet Kallari, Caf Milla, Osman Kroma, Fadil Milla, Salë Hoxha, Hasan Guçi**.[111]

Bursia dhe përdorimi i saj

Bursia është fundrinë që mbetet prej ullinjve të bluar. Kjo përbëhet kryesisht prej pjesëve të lëkurës dhe të bërthamës së ullirit. Bursia mbetet në shporta kur, edhe pas shtrydhjes së fundit në mandravidë, nuk lëshon më vaj. Kjo pastaj përdoret gjithashtu për shumë gjëra: për ushqin të shpezëve, të kafshëve (sidomos derrave), për djegëje, e cila jep shumë kalori. Njëpjesë e bursisë, që së pari kalbet, përdoret edhe si pleh për plehërimin e ullishtës ose të arave.



Fig. 30. Detal nga presa moderne prej metali

Gjer pas Luftës I Botërore, kur mandravidat e mullinjve punoheshin të tëra nga druri, me anë të të cilave nuk mund të nxirrej krejt vaji nga bursia, pronarët e mullinjve ngarkonin barkat dhe e dërgonin bursinë gjer në Itali ose vinin vetë tregëtarët italianë dhe e merrnin. Ata përsëri e përpunonin këtë, në presa moderne dhe e nxirrnin vajin e mbetur. Më vonë, presa të tilla kanë blerë edhe vetë vendasit (fig. 30). Thuhet që në bursi ngelte pa u nxjerrë gjer gjysma e vajit, por vaji i mullirit të drurit ishte shumë i imirë.
Vaji i bursisë është vaj i dobët, me shumë thartirë dhe përdoret më tepër për fabrikimin e sapunit.

[111] Sot nuk thuren më me xunga dhe zhuga, por ka ”mustra” që kanë mbetur me kohë nëpër mullinj.

Gostitë e fillimit dhe të mbarimit të vjeljes së ullinjëve

Pasanikët, e sidomos mullisit e ullinjëve, rregullisht bënin gosti dhe ahengje kur fillonin të bluajnë dhe kur mbaronin stajen ose vjeljen e përgjithëshme të ullinjve. Njëri prej pasanikëve dhe pronarëve të mullinjëve, ftonte farefisin dhe të gjithë mullisit e Ulqinit, ku, pas ahengut merreshin vesh[112] se sa do t'u marrin për gurët e ullinjve, respektivisht sa kilogram vaj do t'u japin pronarëve të ullishtës për një gurë, sa do t'u paguajnë punëtorëve të mullirit, sa kalin (se edhe kali merrte hakun e vet në mulli), sa mledhtarëve dhe sa shkundësve të ullinjve.



Fig. 31. Kazani i madh bakri (që zë gjer më 150 kg.), ku zihet hallva dhe sapuni

Në ato gosti ndodhte që zienin hallva në kazanë të mëdhenj bakri që zinin mbrendë rreth 150 kg, duke e përzier hallvën mbrendë me rrema të sanallave dhe të lundrave (fig. 31). Pjesën tjetër të hallvës, ajo që tepronte, ua falnin të varfërve dhe punëtorëve të vet. Mledhtarëve ua dërgonin në ullishtë.
Marrëveshje të tilla shkonin në dëm të pronarëve të ullishtës se pas kësaj marrëveshje nuk ekzistonte konkurenca dhe mullisit i jepnin vaj aq sa donin vetë.
Për këto ahengje të posaçme, pasanikët pregatiteshin me kohë. Në to ftoheshin: lodraxhitë, bejtexhitë dhe këngëtarët e njohur të qytetit. Kësi gostish organizoheshin në çdo mëhallë. Diku-diku, në raste të tilla, qitej edhe ndonjë fejesë ose i bënin fëmijët synet. Ende sot janë ruajtur shumë këngë dhe bejte të atyre kremtimeve. Kështu, gjellëbëreset (akçeshat) në kuzhinë këndonin këngë të ndryshme. Ka mbetur gjer sot kënga e pilafit dhe e hallvës. Kur gjellëbërësja piqte hallvën, me qëllim që kjo të piqet mirë, mos të digjet e mos të marrë shkrum, kur hallvës ja qitnin ujin e nxehtë, duke përzier kazanin, i këndonin kazanit:

O kazan, kazan-o!
Lëshoje, lëshoje hallvën-o!

[112] Marrëveshjet e mullisve bëheshin në mënyrë diskrete pa dijeninë e pronarëve të ullishtës dhe mbledhtarëve.

Rueje, rueje, mos na e diq,
Se sonte na kemi miq.
Lëshoje, lëshoje hallvën-o[113]
Se e lëshoj Isa-aga të shoqen-o![114]

Siç shihet, në këtë këngë pasqyrohet veprimtaria e gjellëbërëseve. Pra, është një këngë pune, me anë të së cilës në një mënyrë të butë i luten fuqisë magjike që mos t'ja djegë hallvën (gjellën), se, përndryshe, burri i rreptë do ta lëshojë gruan e vet për arsye të djegëjes, për shkak se e ka turpëruar para burrave, duke i qitur hallvë ose duke sjellë gjellë të shkrumosur. Gjellëbërëse ishin kryesisht harapeshat (zezaket). Këto edhe i argëtonin zonjat e Ulqinit. E njohur ka mbet **Zara, Labja** dhe harapesha **Hatixhe**.
Gjer para do kohe në Ulqin ka pasë ekzistuar një zakon i bestytnisë magjike në lidhje me prodhimin e ullishtës. Ulqinakët shkonin pa lindur dielli në ditën e Shën Gjergjit në ullishtë. Me vete merrnin një kaçile (shportë) me petulla, edhe një sëpatë të vjetër. Kur arrinin në bylyk, i merrnin mbarë ullinjtë, sidomos ata që nuk kishin kokrra. Ndaleshin përpara ullirit dhe njërit prej tyre, zakonisht më i riu, çonte sëpatën lart gjoja për të prerë ullirin, kurse tjetri i thonte atij: "Mos e pre, se vjetës tjetës ka me ba kokrra. Lene edhe simjet pa pre!" Pastaj lenin një petull te trungu i tij, duke thënë: "Hajt, ishalla me bereqet të ri Shën Gjergjit tjetër". Disa në këto raste, përveç që lenin petulla, lagnin ullirin me ujë nga katrova, ku gjendej një degë e lejlakut.

Prodhimi i ullishtës

Ullinjtë bëhen edhe nëpër djerrina të liga dhe gurina, prandaj quhen bimë fisnike. Luftëtarëve të dalluar, me shekuj u janë ndarë dekorata me filiza të gjetheve të ullinjëve. Kështu dega e ullirit ishte dhe ka mbetur simbol i paqës. Italiani Pica, në veprën e tij përmend vajin e varietetit më të mirë ilirian. Ndërsa Marin Barleti dhe Pjetër Budi, cekin që kjo trevë ishte e njohur për prodhimin e vajit.[115]
Ullishta e Ulqinit pas gojëdhënave dhe të dhënave të tjera, në kohët e lashta prodhonte shumë. Thuhet që kjo mesatarisht prodhonte në vjet afër 5.000.000 kilogram ullinj, prej së cilës sasi nxirreshin afër 1.000.000 kilogram vaj. Ende sot mbahet në mend, kur më 1937 ullishta pat prodhuar aq shumë sa që nuk kanë mundur ta bluajnë tërë atë prodhim mullinjtë e Ulqinit, por e kanë dërguar edhe në Tivar. Atëherë kanë ngelur ullinjtë pa rënë mirë në tokë gjer në pranverë. Edhe pse s'dihet me saktësi se sa është rendimenti i saj gjatë

[113] Këngën e kazanit ose të hallvës edhe sot e dinë shumë plaka të Ulqinit
[114] Këndoi Sulltane Ishmi, Meteriz - Ulqin
[115] Nevruz Kafazi, *Lashtësia e kulturës së ullirit* (emision i Radio Tiranës mbajtur në Shtator 1968).

1937/38, është për t'u besuar thënieve se ka pasur afër 4.000 vagona ullinj prej të cilës sasi u përfituan afër 800 vagona vaj. Me pak dallim prej 1937, ka pasë prodhuar edhe gjatë vitit 1945.
Prej 1958-1962, ullishta ka prodhuar 6.379.400 kilogram ullinj, prej së cilës sasi u përfituan 1.430.356 kilogram vaj. Prej kësaj sasie vetëm në fabrikë janë bluar 2.578.839 kilogram vaj ullinj, kështu që janë përfituar 569.369 kilogram vaj.[116] Prej 1963-1971 ullishta ka prodhuar 8.934.030 kilogram ullinj më afër 2.000.000 kilogram vaj. Siç shihet, prodhimtaria vjen duke u pakësuar.

Organizimi i punës në mulli

Pronarët e ullinjvei sjellin ullinjtë e mbledhur me anë të shtazëve. Ullinjtë mullisi i matë me bagasha dhe babune.[117] Pastaj i qesin në një grumbull duke i ndarë sipas llojit të tyre. Kështu, pas dy-tri ditësh, i ndajnë në grumbuj të tjerë sepse kualiteti i ullinjve ndryshon edhe sipas stajës.[118] Prandaj, për të dalë vaji i klasifikuar, duhet patjetër që punëtorët e mullirit të bëjnë këtë punë sa më me kujdes se edhe pronarëve të ullinjve u jep vajin sipas kualitetit të ullinjve që i ka sjellë i zoti dhe i çmon ata sipas kohës dhe kualitetit që kanë vetë ullinjtë. Duhet të kemi kujdes të posaçëm që ullinjtë mos të "ndizen". Sepse atëherë shtohet përqindja e thartirës së tyre, kështu që dobësohet kualiteti i vajit. Prandaj, mullisit, respektivisht punëtorët që punojnë në të, duhet ta hedhin sa më shpejtë grumbullimin e ullinjve në mashtër për ta bluar. Ullinjtë vendosen në depo të posaçme. Në kohët e fundit edhe mullisit privatë përdorin kandarin për matjen e tyre, kurse gjer në vitin 1946 kryesisht matja e tyre bëhej me babune, bagasha kashiq, gurë.[119] Depoja e ullinjve duhet të jetë gjithnjë e freskët dhe e thatë. Kjo ndërtohet pranë mullirit ose bashkë me të.
Në mulli punonin zakonisht 5-6 punëtorë, varësisht prej sasisë së ullinjve dhe kapacitetit të tyre. Zakonisht, njëri prej punëtorëve është mjeshtri kryesor-udhëheqës. Këtë punë e bën kryesisht pronari i mullirit. Puna në mulli fillon në mëngjez dhe varësisht nga numri i ullinjve q duhen bluar, punohet edhe në turne, gjer në tre turne.
Përnjëherë në mashtër të mullirit mund të qiten 12 bagasha, një gur ullinj. Kështu, duhet të rrijë mashtra e zbrazët për 20 cm që të mos hidhen poshtë ullinjtë gjatë bluarjes. Dikur gurët e mullirit përmes sirenave i vënin në lëvizje vetë punëtorët e mullirit, kurse që nga Lufta I Botërore e tehu, mulliri vihet në lëvizje nëpërmjet fuqisë së kalit, ku përdoren të gjitha ato vegla që i vihen kalit

[116] Shënimet janë marrë në Fabrikën e vajit dhe ndër mullisit privat të Ulqinit (këtu s'është llogaritur sasia e ullinjve që shtihen në kripë (të regjet), e cila mund të jetë gjer në 10 përqind të prodhimit vjetor).
[117] *Bagasha*, enë prej dy babuneve, 20 kilogram, ndërsa babunja ka 10 kg.
[118] *Stajë* është edhe mbledhja e një hovi të rrënjës së prodhimit të ullishtës. Gjatë një sezone ka 4-7 staje.
[119] *Guri* ka afër 200 kilogram ullinj.

gjatë tërheqjes së karrocës. Për tërheqje në mulli përdoren edhe mushkat, nganjëherë edhe qetë. Këtyre u lidhen sytë dhe sillen rreth e rreth mashtrës nga e majta në të dathtë. Gjersa shtaza të mësojë të ecë, nuk ja lidhin sytë dhe e mban për dore nga një punëtor ose fëmijë. Më vonë, me sy të mbyllur, ai ecën vetë. Kur ullinjtë janë të njomë, bluarja e tyre nuk zgjat më tepër se një orë, kurse kur janë të thatë, siç ndodh gjatë shtatorit, bluarja e tyre zgjat gjer një orë e gjysmë. Gjatë bluarjes një punëtor sillet rreth e rreth mashtrës për ta shtyrë nën gurë me nagaçë[120] (tërplotë) ullinjtë e pabluar, kurse ullinjtë e bluar një punëtor tjetër i hedh në govatën e drunjtë (fig. 20(. Kjo është e gjatë gjer 2,50 e gjërë 1,3 m, kurse e thellë gjer 40 cm. Prej aty, më vonë punëtorët e hedhin brumin me babune të drunjta nga govata në një dybek të madh guri, druri ose të punuar nga çimentoja. Ky zë 5-8 kuintal. Këtu punëtorët i mbushin shportat me brumë të bluar dhe i rëndojnë ne mandravidë. Puna në mandravidë gjer në shtrydhjen e përgjithëshme të ullinjve zgjat afër dy orë. Në mandravidë së bashku me atë që lag shportat me ujë të nxehtë, punojnë katër punëtorë. Uji nxehet ne ndonjë kazan të hekurt ose bakri jashtë mullirit.



Fig. 32. Një dybek guri

Vaji më mirë ruhet në dybek guri, (fig. 32) qypa dheu (fig. 25) dhe saranxha të punuara nga çimentoja. Rezervuaret e ndërtuara nga guri zënë gjer 500, qypat e dheut gjer 300 kilogram, kurse saranxhat e çimentos ndërtohen në dhé e zënë gjer në 1.000 kuintal. Qypat ruhen nëpër ahrinje, depo, kurse rezervuaret e gurit dhe ato të çimentos shtihen fare në dhé, në oborr pranë mullirit. Në këtë mënyrë vaji ruhet më mirë. Rezervuaret e mëdha, të punuar nga çimentoja, quhen ***saranxha vaji***. Në to mullisi fut edhe vajin e myshterinjve të tij që mos t'i ngushtojë ata që të vijnë ta marrin vajin e tyre. Pronarit të ullinjve mullisi i jep të drejtë që ta marrë vajin kur të dojë. Pronari i mullirit zakonisht edhe blen vaj prej myshterive dhe bën tregëti me vaj dhe ullinj. Tani, në kohë të fundit, edhe mullisi privatë shtypin librezat e veta për nevojat e tyre. Kështu – myshterive që i sjellin ullinjtë pët të bluar te ai, u jep librezën dhe ua shënon se

[120] *Nagaçi*, një lloj tërplote, pra vegël në formë të lopatës së lehtë e punuar prej druri.

sa i ka marrë ullinjtë dhe sa ja ka zënë përqindjen e ullinjve.[121] Se varësisht nga koha dhe sezona e ullinjve, ata përmbajnë në vetvete më shumë ose më pak vaj. Mullisi mban edhe kontabilitetin privat, ka librin ëmë, ku shënon kohën dhe sasinë e ullinjve që ka prurë te ai çdo pronar. Më parë, kjo punë mbahej në mënyrë mjaft primitive: mullisi mbante ullinjtë e sjellur dhe i shkruante në një tefter vetëm për vete, kurse pronarëve të ullinjëve u thonte vetëm: "kaq ke sjellur për kaq vaj!" Kështu ai që s'dinte të shkruaj mbetej në besë dhe mëshirë të pronarit të mullirit.

Vaji ndahet në katër lloje: ullinjtë e parë, ata të shtatorit, kanë vaj ma pak dhe me kualitet të dobët. Kjo gjë vërehet nga se ka shumë thartinë dhe vaji mund të përdoret vetëm duke e përzier me vaj lulesh. Sa më vonë që të vilen ullinjtë, aqë më i mirë është edhe vaji. Kokrrat që zgjasin në degë gjer në muajin shkurt, kanë vaj me kualitet më të mirë dhe qesin shumë më tepër se të parët, pothuaj dyfish. Gjithashtu, ata ullinj që i than era e verës, murlani dhe tramuntana,[122] janë ullinj të rreshkët dhe mbajnë vaj shumë të mirë. Ullinjtë e fundit janë shumë të përshtatshëm edhe për t'i vënë në regjje me kripë. Ata kanë ngjyrë të zezë në të kuqe vizëlluese.

Matja e vajit atëbotë bëhej me okë, kurse tani bëhet me litra ose kilogram. Pronari që ka për të shitur vaj, sasinë e vajit të tij e tregon me qypa ose fuçia. Pronari për sasinë e vajit që ka për shitje thotë: "Kam dhjetë qypa ose 12 fuçi vaj për të shitur". Për bartjen e vajit gjer tani janë përdorur butat, të cilët punoheshin prej lëkurës së regjur të bagëtive. Atyre u është qethur mirë leshi dhe janë lidhur mirë me spaga lëkure. Kështu, ata nuk e lëshonin vajin dhe hamajt e bartnin me buta nga mulliri gjer në shtëpi të pronarit ose blerësit të vajit. Në ta kanë mundur të futen gjer 50 kilogram vaj. Ishin të përshtatshëm shumë për bartjen e vajit. Me ta bartnin vajin tregëtarët edhe kur e transportonin në vende të tjera me barkë. Kjo mënyrë e bartjes kishte përparësi të madhe në ngarkim dhe zhgarkim të anijes, sidomos kur nuk ekzistonin vinçat dhe makaret.

Vaji i ullirit është si vera: sa më tepër të rrijë në enë (të gurit, dheut ose në saranxhë) aq më i mirë dhe më kualitativ bëhet. Kështu, ata vendas që blejnë vaj, sëpari pyesin a është "i vjeçëm" ose sa vjeç është. Nëqoftëse blerësi nuk e pyet shitësin për vjetërsi, ky i tregon vetë se vaji është i moçëm, me të cilin i bën me dije blerësit se vajin e ka kualitativ.

Ajo sasi e vajit që mbetet në fund të rezervuarëve, qypave dhe dybekëve, është e kualitetit të dobët, është i trashë dhe përmban shumë fundrrina ulliri. Prandaj ky lloj vaji quhet baltë dhe përdoret kryesisht për zierjen e sapunit. Sapuni i përfituar në këtë mënyrë përdoret shumë për larjen e rrobave dhe është shumë i mirë. Në kohën kur bën ullishta, në Ulqin, rrallë kush blen sapun tjetër për

[121] Ullinjtë jepen në mulli me përqindje, të cilën e caktonte pronari i mullirit, p.sh. për 100 kg ullinj caktohen 17-28 kilogram.

[122] *Tramuntana*, erë deti që nuk sjell shi.

larjen e teshave. Zierjen e këtij sapuni di ta bëjë secila amvise e Ulqinit. Për sapun përdoret edhe vaji i bërsisë.

Fig. 33. Skicë e një mulliri tipik në rrethin e Ulqinit[123]

Ruajtja dhe kujdesi ndaj ullishtës

Siç kemi thënë, ullishtaria ishte me shekuj njëra ndër degët më të rëndësishme të ekonomisë dhe burim të ardhurash personale të ulqinakëve. Këta ullishtën e ruanin me kujdes nga shtazët dhe dëmtorët e tjerë. Kështu, me qëllim që me forca të përbashkëta të zhvillohet sa më tepër ullishta, pronarët e saj më 1925 formuan një grup njerëzish, të cilin e quajtën Këshilli i ullishtës. Ky këshill kishte 13-17 anëtarë. Pronarët më të mëdhenj të ullishtës janl edhe anëtarë të këtij këshilli. Kjo udhëheqësi ka edhe kryetarin, sekretarin, arkëtarin, kurse të tjerët janë anëtarë. Titujt e këtij këshilli janë tituj nderi dhe nuk i paguan askush me rrogë, por marrin dhurata sipas punës. Për çdo vit, pronarët e ullinjve së bashku me këshillin e ullishtarisë mbajnë mbledhjen vjetore, me ç'rast shoshisin problemet e ndryshme në lidhje me mbarëvajtjen e kësaj dege të ekonomisë. Këshilli zgjedhet gjithashtu në mbledhjen vjetore, por në rast se ullishta nuk ka pasur atë vjet fryte sa duhet, ky këshill i vjetër s'ka pasur as punë në lidhje me të, mandati i Këshillit vazhdohet edhe për një vit. Sipas rregullave të këtij këshilli, anëtar i tij mund të bëhet secili pronar i ullinjve. Për ruajtjen e ullishtës nga bagëtia, vjedhësit dhe kafshët e egra caktohet personi që ka obligim për ruajtje dhe quhet ***karrxhi.***

[123] Skicat e këtij punimi janë bërë nga Mexhit Bajrami ndërsa fotografitë i ka bërë autori i këtij punimi.

Sami MISHERRI

SINONIMET E ULQINIT: ULLISHTARIA, LUNDRIMET, TREGTIA

Ullishta isht sinonim i Ulqinit. Ja, gati gabova, detarija e ulIishta janë sinonim i Ulqinit.

N'sy t'parë duket si e palogjikshme, sepse detarija isht fare e lidhun me det, kurse ullishta me tokë.

Par në Ulqin, këta veprimtari, jetike, kanë qenë të lidhuna shumë ngusht, aq sa nuk ka ba asesi njina pa tjetrën.

Deti në Ulqin ka qenë e vetmja lidhje me vendet e huja e të largëta. Detarët kajnë ba bartjen e mallit për ata qi janë marrë me tregti, par në shumicën e rasteve, detarët kajnë qenë vet tregtarë.

Tregtija ka qenë e lidhun me vendet bregdetare në detin Adiatik, kryesisht me qytetet e Dalmacisë (Kroacisë), par edhe me Itali.

Detarët ulqinakë, ja ma pak, kanë ba tregti edhe me vendet bregdetare të detit Jon e detit Egje e deri në Stamboll dhe, në Mesdhe, me vendet e bregdetit deri në Maltë, Tarabullus, Misir dhe vende të tjera të Mesdheut, deri në brigjet e Francës e Spanjës, kryesisht në anën e Mesdheut.

Detarët Ulqinak kanë qenë detarë të zotë e me famë. Ulqinakët kajnë lundru edhe në Oqeanin Atllantik dhe kajnë ba tregti me vendet e bregdetit të Marokos, Spanjës, Portugalisë, Francës, par edhe ma gjatë, deri në veri të Evropës.

Në bisedat e detarëve të moçëm ulqinakë shpesh janë bisedu ngjarjet e fyrtonat në detin e tërbumun e motin e lig. Pjesa ma e rrezikshme për lundrim ka qenë Gjini i Biskajës, i cili gjindet në anën e Oqeanit Atllantik, në Francë. Detarët këtë gji të keqfamshëm e kajnë thirrë *Varrezja e anijeve*.

Pra, deti ka qenë rruga kryesore e tregtisë, ndërsa malli kryesor ka qenë voji i ullinit i cili ka qenë i njoftun për cilsinë e tij, në të gjithë vendet ku isht shitë. Edhe sat në Kroaci dihet për vojin e Ulqinit.

Par kohnat kanë ndryshu.

Sat në Ulqin puna e ullishtës isht sekundare. Ullishtarija sat në Ulqin ma shumë ka randësinë e kujtesës për kohnat e kalume dhe traditës e cila isht pjesë e kulturës të këti vendi. Sat pothujse asnji ulqinak nuk jetan ma prej ullishte. Personalisht mendoj se prej ullishte kishte me mujtë m'u jetu edhe sat.

Par, kultivimin, mënyrën e punës, prezentimin dhe shitjen e ullinit e vojit në treg, duhet me e akordu me nevojat dhe kushtet e tregut evropjan e botnor. Natyrisht, puna isht ngusht e lidhun me interes dhe me jetesë. Për këto arësy ullishtarija sat nuk mundet me siguru kërkesat e jetesës.

Sat vendin e parë e xe turizmi. Secili ulqinak, në këto ose n'atë mynyrë, merret me turizëm.

Megjithate, mendoj se nuk gaboj në qoftëse tham se, xhdo ulqinak kudo që jetan, në katund ose në qytet, ullinin e ka në zemer. Në Ulqin në gjellë e në sofër nuk përdoret vaj tjetër përveç vojit të ullishtës tonë.

Detarët që kanë pasë sukses në detari e tregti në det, me kapitalin e fitumun kanë ble mall e ullishtë. Puna në ullishtë ka qenë profitabile dhe ka siguru jetesën. Par, mbi të gjitha, puna në ullishtë nuk ka qenë me rrezik si puna në det. Nuk isht thanë kat se: *Buka e detarit ka shtat korca*.

E unë pa tham se: *Buka e peshkaxhive ka edhe nji korcë ma tepër se buka e detarit*.

Puna në det, sa isht e randë aq isht edhe me rrezik. Peshku nuk xehet për *bonacë* e për mat të mirë, par për turbullinë e *furfullec*.

Deti nep bukë me shumë punë, rrezik e kasavet, kështu thojnë ulqinakët e moçëm.

Anija edhe kur isht e *gastume* në lima, isht kasavet për marinarët, e sidamas për kapidanin.

Kur puna i ka shku marë e mirë, detarët kajnë mujtë me ba kapital, kurse peshkaxhija me peshkim, vetëm ka mijetu edhe ate me shumë mund.

Për këtë arsy shumica e ulqinakëve janë marrë me ullishtë.

VOJI I ULLINIT

Ullini - florini.
Voji isht ar qi rjedh.
Voji isht fisnik si ari.

Voji i ullinit asesi nuk përzihet me ujë ose me denji lang tjetër. Isht aq fisnik saqë nuk pëzihet as me vojin e luledielit ose me çfardo vojit tjetër.

Gjyshja jeme kur *ka ba shybe*, se voji nuk isht temis, e ka qitë në nji gotë xhamit të tejdukshme dhe e ka lanë në *akshihane* (kuzhinë) deri në mëngjez, pa e prekë. Atëherë, në mëngjez e ka shiku gotën në dritën e dillit dhe, në qoftëse voji në gotë ka ba vizë e isht da, atëherë isht vërtetu se voji isht i përzimun me vaj luledillit. Në temperaturë të ulët voji i pastërt i ullinit kristalizon sikur mjalti. Në bazë të kësaj vetije, voji mundet të futet në frigorifer dhe, në qoftë se nuk kristalizohet fare, atëherë vërtetohet se isht i përzimun me vaj tjetër. Përkundër ksaj, voji i ullinit i nji cilsije mundet me u përzi me voj tjetër çfaritdo cilsije qoftë. Zakonisht isht përzi *voji i fortë* me shumë idhni e acid, me *vojin e butë* e të cilsisë së mirë. Voji i ullinit nuk isht hedhë kurrë. Edhe në qoftë se ka qenë shumë i fortë, prej ati vaji isht ba capu për me u la. Ulqinakët deri vonë për lamje nuk kanë përdoru capu tjetër përveç caponit të bamun prej vojit të fortë të ullinit ose prej *baltës se vojit*.

Në të vërtetë prej ullinit nuk hidhet askurgja.

Druni i ullinit isht landë djegëse me cilësi shumë të mirë. As druni i lisit nuk digjet ma mirë se druni i ullinit. Druni i ullinit, përpos aromës së veçantë,

shumë kakrakteristike dhe të kandshme, ka edhe kalori shumë të fuqishme për nxemje. Sat druni i ullinit përdoret për dekorimin e *çardaqeve* (dyshemeve) tavaneve, mobiljeve dhe për prodhimin e sendeve artistike.

Landë djekse isht edhe *bërsija* e cila gjithashtu ka shumë kalori, sepse pëmban yndyrën e vojit.

Kuqla gjithashtu isht përdoru për lamjen e: *tinave, butave, qypave, gaviçave, arkave të gurit* dhe të gjitha enëve ku isht mbajtë dhe rujtë voji i ullinit.

Caponi prej vojit të ullinit - caponi i shpisë

Caponi budallë.

Caponi krekc.

Caponi prej vojit të ullinit bahet fare thesht. Caponi isht zi në xhdo shtëpi. Edhe ai që nuk ka pasë ullishtë vojin e fortë ose baltën e vojit për capu e ka ble ke *mullinsi*. Voji ose balta e vojit, për capu e ka pasë çmimin e ulët, sepse ka qenë vaj i fortë, me shumë acid dhe nuk isht përdoru për ushqim.

Caponi prej vojit të ullinit isht përdoru për lamjen e durve e sidomos për lamjen e trupit.

Gjyshat e prindët e mi janë la veç me capu shpije. Unë, gjithnji edhe sat lahem vetëm me capu shpije. Ka shumë ulqinakë që për lamje përdorojnë vetëm caponin e shpisë edhe pse sat ka me qinda lloje caponi dhe mjete kimike industrijale për lamje e pastrim në forma dhe paketime të lloj-llojshme.

Caponi i shpisë përgaditet - zihet në mynyrë të thjeshtë. Në kazan, ku zihet caponi, duhet me qitë:

- pesë (5) kilogram vaj të ullinit ose baltë,
- nji (1) kilogram sodë kaustike dhe,
- shtatë (7) litra ujë.

Në shpinë tonë zakonisht isht zi sasija prej 15 kilogram vaj ullinit ose baltë, 3 kilogram sodë kaustike dhe 21 litër ujë.

Kja ka qenë sasija e nevojshme spakut për dy vjet, në kushtet kur caponin e shpisë e kajnë përdoru të gjithë antart e shpisë.

Pra, *kazani i caponit* ka qenë enë e madhe e cila s'pakut ka mujtë me marrë sasinë prej 50 deri në 70 litra vaj dhe ujë s'bashkut. Kazani i caponit isht vendosë përmbi *kasaxhak*, nën të cilin isht ndezë zjarmi. Kasaxhakun e ka ba farkatari, prej hekurit të fortë, sepse kazani e caponi kajnë peshë të randë. Mbasi që isht përgaditë kështu, caponin duhet me e zi afërsisht dy orë, në zjerm me intenzitet mesatar. Gjatë përgaditjes caponi ishtë përzi me lugë drunit dhe gjithnji isht vu kujdes zjarmit mas të jetë me intenzitet të madh. Kur në lugën e drunit vehet re se caponi ka ardhë në gjendje si mjalti, atëherë kazani isht lergu prej zjarmit dhe, pa e lanë me u ftofë, caponi isht qitë në enë përkatëse, të përgaditun ma përpara. Mbasi kalojnë 4 ditë, caponi isht pre me thikë *kallba-*

kallba dhe isht lanë përfundimisht me u farcu. Mas këti procesit, caponi isht vendosë në *arkë drunit* prej ku isht marrë për përdorim.

Në procesin e përgaditjes munden me ndodhë edhe gabime.

- Filanit *i ka dalë caponi budall* ose *I ka dalë caponi krekc* - kanë mujtë me u ndigju komentet kur dikush ka ba denji gabim tuj e zi caponin.

Përgaditja e caponit isht proces kimik. Në raste kur nuk ka qenë sasija dhe cilsija e vojit në proporcion të duhun me sodën kaustike dhe me ujë, caponi ka mujtë me dalë shumë i butë dhe isht thirrë *budall* ose ka mujtë me dalë shumë i fortë, *krekc*.

Në këta raste, caponin isht dashtë me e zi përsëri, për me përmirsu gabimin. Isht dashtë me i shtu vaj, në qoftë se ka qenë shumë i fortë - krekc ose me i shtu sodë kaustike, në qoftë se ka qenë i butë.

Caponi mundet me u zi edhe me aroma kimike të ndryshme, par për mendimin tem, aroma e ullinit isht e veçantë dhe nuk ka nevojë të qitet aromë tjetër.

Në Kroaci, Greqi dhe vendet bregdetare të Mezdheut, caponi i ullinit ka çmim shumë të naltë dhe merret si natyror dhe shumë i mirë për lamjen e trupit.

Voji ban baltë e lule

Nji mullins i vjetër ulqinak më pati thanë:

- Në fund të *tinës* mbetën *baltë* dhe çkado qoftë tjetër, kurse në maje të tinës *voji ban lule*. Ven nji mazë të hollë rrathë-rrathë, kurse në midis, voji i ullinit nuk ma askurgja, sepse isht ma i letë se uji ose ndonji send tjetër që mundet me ra në tinë ose enë të vojit.

Voji i ullinit isht shitë e ka mujtë m'u ndrru me xhdo mall tjetër. Voji ka mujtë m'u ndrru: me grunë, kallamaq, me tlyn, djathë, mish e me xhdo prodhim tjetër ushqimor.

Bukurija e nuses

Thjesht, ullini në Ulqin ka simbolizu jetën e mirëqenjen.

Edhe kangët që kanë përshkru bukurinë e nuses, e kanë krahasu me ulli.

E ka synin si ulli,
E ka gojën si kuti,
E ka buzën si qerrshi,
Edhe dhambët si inxhi,
E ka shtatin si selvi,
E bukur par si perri.

Ullini në shkrimet e vjetra

Ullini në *Bibël* përmendet ma shumë se njimi herë. Isht simbol i *dhuratës* që ja ka dhanë Zoti njerëzve.

Në kohë të *Hazreti Musas (Mojsiut),* ata që e kajnë kultivu ullinin kajnë qenë të lirumun prej lufte.

Në shkrimet e vjetra fetare lexohet se në *Arkën e Hazreti Nuhit (Noe),* degën e ullinit e ka pru në sjep pëllumbi.

Për këtë ullini isht i shenjtë dhe paraqet simbolin e mirsisë dhe paqes.

Baba i mjeksisë, *Hipokrati*, vojin e ullinit e ka propozu si ilaç për ma shumë se 60 smundje.

Ullini isht edhe simbol i pjellshmënisë, begatisë, qëndrushmënisë dhe lashtësisë.

Lirisht mund të thohet se *ullini isht i përjetshëm dhe i pavdekshëm*.

Ullini e fiku në *Kuran*

Ullini e fiku, përmenden edhe në *Kuran*, në surenë *95, Al Tin – Fiku*.

Në ajetin e parë të kësaj sureje, Zoti ban be për fikun e ullinin:

Në emër të Zotit, Mirëbërësit, të Mëshirshmit,

[95:1] Pasha fikun dhe ullirin.

[95:2] Malin Sinai.

[95:3] Dhe këtë qytezë të nderuar (Mekën).

[95:4] E krijuam njeriun në mynyrën më të bukur.

[95:5] Pastaj e shndërruam në më të ulëtin e të ultëve.

[95:6] Përveç atyre që besojnë dhe çojnë jetë të drejtë; ata pranojnë shpërblim që është fare mirë i merituar.

[95:7] Pse e refuzojnë besimin prapë se prapë?

[95:8] A nuk është Zoti Më i Mençuri, prej të gjithë të mençurve?

Fiku, ullini, Sinai dhe Meka mund të simboli-zojnë pejgamberët a.s. Ademin-Adamin, Isanë-Jezusin, Musanë-Moisiun, Ibrahimin-Abrahamin dhe pejgamberin e fundit, Muhamedin.

Përkatësisht, përfaqsohen të gjitha fetë e mëdha.

Edhe fakti se kja sure i paraprin suresë *96 - Al Alaq-Lang*, ose *gjak i ngjizur*, ka domethanjen e vet. Sepse, pesë ajetet e parë të suresë *Alaq* janë ajetet e para që janë shpallë Muhamedit a.s. dhe flasin për krijimin e njeriut në këtë botë. Ajeti i parë i kësaj sureje fillon me fjalën *Lexo* dhe në disa vende kjo sure kështu titullohet dhe merret si urdhni i Zotit për shpallje.

Muhamet NIKA

DY FJALË PËR DIMENSIONIN SHQIP TË EMRIT GREK HIPOS (KALIT) DHE AGA (IMERIT)

Një emër i radhës – foljor , që reflekton lashtësi dhe ndeshet në të folmen e Ulqinit, dhe i cili lë dimension interpretimi me greqishten , është edhe fjala : HI(HIPI), në kuptimin i hipi kafshës që shërben për hipje- kalit. Kështu , me këtë emër njihet vetë kali , të cilit me sa duket kështu i thonë pellazgo- ilirët dhe që kësaj fjale grekët i shtuan mbaresën e tyre –OS, duke dhënë një hipos?!
6. PO ATY. F. 328
Duke qenë i hipshem dhe një qenie mitologjike që e shoqëroi njeriun për tërë jetën , fjala e këtillë që sot ruhet të grekët ishte prodhimtare e të folmes lokale duke marrë shpesh si folje edhe kuptimin figurativ të ndryshme- nuk po cekim këtu se kali paraqitet edhe si simbol ilir.

Dimensioni mitik shqip i këngës së Aga Ymerit ?!

Pasi duke zbërthyer mitologjinë greke dhe folëm mjaftueshëm për atë që merr kuptim përmes shqipes së gjallë , si :Zeusi, Zana, Pani – Apolloni, hipos-kali, tashti duhet shpjeguar atë që gjetëm në folklorin e trevës ,rreth Aga Ymerit, trimit legjendar , të një kënge baladike të rinjohjes së burrit me grua , punë të cilën e trajtuam në vëllimet e më parshme të librit Një bisedë antiko arkaike..., por që këtu do të ndalemi vetëm në aspektin e zbërthimit mitologjik të kësaj figure të dashur të folklorit shqiptar e për të cilën thamë se ishte me origjinë ulqinake , që dëshmojnë vargjet , në të cilat thuhet se Agai Imeri merr dorinë .... për 5 ditë e zë Ulqinë..?!!
Duke gjurmuar në këtë mitologji, fillimisht kujtojmë se mendimtarët cekin se vetë emri i autorit të Ilijadës dhe Odiseut- Homeri , është me bazë shqipe; HOMERI= O MERË ; O MIRË. Emri shpjegohet me një thirrje admiruese tipike pellazgo shqiptare dhe do thotë " sa këndshëm sa bukur..". Ky shpjegim , përmbush kriterin e atyre që thonë se Homeri kurrë nuk ka ekzistuar, se Iliada dhe Odiseja janë krijime – poema "të mira e të bukura ", para helene që si balada- dashuri dhe trimëri e besë këndohen nga brezi në brez nga rapsodët anonimë . 7
Sipas neve edhe vetë rinjohja e burrit me grua te kënga e Aga Ymerit dhe pritja e gjatë e bashkëshortes ndaj agait të zënë rob të kujton në esencë pritjen që i bëri , Penelopa Odiseut?! Ndërsa kjo si praktikë e pritjes së "fatit të vet" edhe sot çmohet dhe respektohet, për sa kohë ai nuk ish të shtëpia për arsye të ndryshme.

Prefiksi Aga që shoqëron emrat mitikë ?

Ia vlen të thuhet se vetë emri Aga që shoqëron shumë emra të mitologjisë greke dhe që shoqëron edhe Ymerin legjendar në këngë , vërejmë të jetë titull i cili shoqëron bijtë e mbretërve grekë me gjak hyjnor .Prefiksi duhet kërkuar në etimologjinë mitike të vetë shkronjës së parë **A, që simbolizon njëshin**

suprem?! Heronjtë me këtë titull shohim që të kenë lindur nga martesat e shpeshta të perëndive me femra të përzgjedhura të njerëzve, kujto këtu, psh.Agamedi, Agamemnoni, Agagapenori,etj të grekët , kurse në mitet oqeanike , ndeshim Agnin, perëndi indiane e zjarrit; ***Agnia-*** quhet edhe lopa e shenjt që si emër do të thotë , ajo që nuk duhet vrarë. Edhe ky rast vetëm se përforcon atë që u cek si dimension e origjinë hyjnore çështje- në këto mite- Aga Hya , shënon njërin nga emrat e diellit dhe ka kuptimin e atij që nuk dëshiron të mbështillet- mbulohet me vel, pra me vel?! 8..

Tradita popullore që edhe sot për tituj të ndryshëm të familjeve të zgjedhura , vazhdimisht të përdoren si tituj ndershmërie tregon origjinë lashtësie. Bile shënohet se me këtë llagep - nuset, ashtu si në mitologjinë greke bashkëshortin e vet ta quajnë, me tirtullin- zatni, vjehrrin – zatni madhi, kurse kunatin aga, në kuptimet autoritative. Kurse ai që lind , nga martesa e saj me zatnin- në Ulqin – për dallim tëshqipes , cekëm se quhet za(o)g- biri i nënës. Një zog , është edhe flamuri kombëtar.

Kjo të kujton hierarkinë familjare të mitologjisë pellazge që u ruajt në rendin shtëpiak grek. Mbase edhe emri që përdorin për bashkëshort , që zakonisht në trevë e quajnë burrë, vjen nga emri mitologjik i njërit prej djemve të gjigantit gjermanik –Hilerit(Imerit), që quhej ***Burri*** dhe ishte baba i ***Borit.Kujto këtu burri i dheut, të mitit(besimit)të krijimit të njeriut të parë nga dheu.***

Hileri gjermanik qyhej edhe IMERI ?!

Mund ta besojmë po deshëm apo jo , por sipas një miti të Evropës së Veriut, me emrin IMERI , njihet vetë Hileri gjermank që i bie të ishte gjiganti i zanafillës. Ai besohet të ketë lindur nga avujt e shkrirë të ujit nga era e jugut dhe sipas këtij miti , nga djersa e dorës së tij të majtë lindi njeriu dhe gruaja e parë. Nga këmbët e tij dolën gjigandët tjerë të akullt, e nga disa pika tjera lindi pela, që për tu ushqyer lëpinte shkëmbinjtë dhe ku njëkohësisht me qumështin e vet ushqente gjigandët tjerë. Tjetër , gjithashtu në këtë mit shohim se njëri prej tyre ishte ***BURRI*** , babai i ***Borit- krahaso shqip edhe emrin o-bor(r). 10*** *Shkrimi i shenjtë kujtojmë që edhe vetë Ademin as. –babain gjithë njerëzimit e përshkruan të ishte një gjigant- 36 parakrahë- masë e dikurshme për metër...?!*

Imeri do të vritej më pas nga Odini dhe Vili , fëmijë të vajzave të tij me vëllezërit e tyre të cilët , rrëzojnë nga pushteti dajën e vetë.

Sipas mitit , pjesët e kufomës së tij do të përdoren nga perënditë për të ndërtuar kupën qiellore- gjithësinë, kurse me gjakun e Imerit, u krijua oqeani, nga mishi u krijua toka, nga kockat malet, nga dhëmbët gurët, nga truri retë, dhe me krimbat xhuxhët. ***Collana po atyf. 321***

RANA

Kështu me këtë emër quhej gruaja e Imerit- perëndisë së detit, e cila shpesh herë dërgonte erërat dhe me këta fundoste anijet në det.

Thjeshtë njihej si ajo që krijonte stuhitë dhe më pas mblidhte kufomat e të vdekurve duke i dërguar në pallatin e saj poshtë detit. Ajo me bashkëshortin

IMERIN që jetonin në pallatin nënujor, pati 9 vajza të cilat ishin ***valëzat*** që kujdeseshin bashkë për thesaret e humbura. **11**
Nuk ka dyshim se e gjithë kjo që cekëm , vetëm se e forcon tezën që Aga Imeri, është Ulqinak sepse lidhet edhe me 2 emrat tjerë mitik. Të gjeografisë bregdetare ulqinake –rana dhe valëzat.

FJALË FLORI TË SHESTANASVE*

A doli fjala - s'kthehet mâ.
Aj qi dânë – kjânë.
Aj qi digjet i frynë edhe kosit.
Aj qi digjet me çorbë, i frynë edhe kosit.
Aj qi isht i zoti, mos i kjothtë i zi moti.
Aj qi knon - keq s'menon.
Aj qi mytet, kapet edhe për shkumë.
Aj qi s'isht për veti, s'isht për kërrken.
Atí qi punon Zoti i nimon.
Baktinë, â mê, â vrê.
Bân mirë e gjien mirë.
Bân mirë e hidhe n'detë.
Besë kí, e besë mos zè.
Borçi t'ha.
Ç'bân dekiku, s'bân mot-moti.
Ç'do e keqe e ka edhe t'mirën.
Ç'do përpjetse e ka teposhtsën.
Ç'isht nji ditë s'isht përditë.
Çka di dhia ç'isht tagjia.
Çka ka shpija e qet thmija.
Çka mjell - korren.
Çka ta bân vetja s'ta bân kurrkushi.
Ç'ká mrenë vekshi (vegshi) e di luga.
Dardha e ka bishtin.
Dardha e ka bishtin mrapa.
Dardha bje nën dardhë.
Delja qi dahet pej tubet, e ha ujku.
Dita shihet n'nâtje.
Dor-dhânit kurrë kurrqâ nuk i mungon.
Duhet me u regjë n'likurë t'vet.
Dvet nji qin vetë e bân si di vetë.
E mira e ka t'mirën.
Faji isht jetim.
Fjala xjerr fjalën.
Fjalë shum e punë pak.
Fjaltë e mira e gurtë n'strajcë.
Fjaltë i merr era.
Fjalët e halkut e birat e gardhit s'myllen kurr.

Floktë e g'jatë - ment e shkurtë.
Fyti - vllaji i detit.
Gërrbeti – hukubeti
Goja llap e shkopi dap.
Gomarit huej i kputet nënbishtja në përpjecinë (përpjetë).
Gurçit kurrë kurrgjâ nuk i tepron.
Gjâja bashkë e bötha jashtë.
Gjâja lirë ta shet shpinë.
Gjikush hallet e veta, e mullisi t'ujit.
Gjikush ka men për veti.
Gjikush t'vetën, e mullisi t'ujit.
Ha hudër se s't'ha gjarpni.
Halku ta njet bishtin edhe kur s'e ké.
Hiq e mos ven, marohet.
Hiq nji kasht, e dalin gjashtë.
I dekuni me t'dekun, i gjalli me t'gjalltë.
Idhnimin e mrâmjes lé për natje.
Inati - bark thati.
I nginjuni nuk ja di t'untit.
I ri – i zi.
Iriqi n'ferrë se n'ferrë.
Kalon vapa me gusht.
Kashata e madhe t'meten n'fyt.
Ka zi e mâ zi.
Kija mni e folja hakun.
Kollomoq e grunë – mâ e mira punë.
Kryet gjog e menen zog.
Ku dhem dhâmi shkon g'juha.
Ku ka tym ka dhe zjarm.
Kur s'ke ç'i bân gomarit, bjeri samarit.
Kush çohet me gjela – bje me pula.
Kush e fitoj s'e harxhoj.
Kush e shton s'e mungon.
Kush i ra i doli.
Kush priton, gjimon.
Kush punon, keq s'menon.
K'tu e gjetem - k'tu kena m'e lânë (tokën, botën).
Kush dvet nuk tret.
Kush e bân – vetit ja bân.
Kush isht i zoti – mos i kjothtë i zi moti.
Kush punon edhe gabon.
Kush punon - Zoti i nimon.
Kush ma bani - vetja ma bani.

Larg syshë – larg zemret.
Larg shpijet - larg zemret.
Lum i forti, mjerë i ligu.
Lum i pari, mjerë i mrâmi.
Mají' huej thehet ta thye kumuj.
Ma keq gërrgási se vrási.
Mâ mirë diç se hiç.
Mâ mirë pak se aspak.
Mâ shum men se gjá.
Ma zi shtisi se dorási.
Me dhanë ujë isht sevap.
Me nimue isht sevap.
Me ken shoqnohe, ashtu je.
Men'ja isht ujë.
Men'ja madhe ta then qafën.
Me nji gur s'bahet mur.
Me nji lule s'çil prenvera.
Merr e mos venë, marohet.
Mjerë i ligu, lum i forti.
Mos e vrash as gjarpnin me dorë t'huej!
Mos m'é dvetë se t'kalxon vetë.
Mos t'i kalxonj t'mijat, se i harron tujat.
Natja mirë thuhet n'nátje.
Ng'jati kâmtë sa ke jargânin.
Nuk di dhia ç'isht tagjia.
Nuk hahet pema pá pjekë.
Nuk isht gjaku ujë.
Nuk janë t'bléme si t'léme.
Nuk kā gjá pā gjá.
Nuk shohin sytë, po men'ja.
N'verë shi – pikë e flori.
Nj'erë vera vjen kah dera.
Njeriu isht mā i fortë se guri.
Nji mos di ç'me bâ, lueje derën.
Pa hangër hudër nuk t'vjen era.
Péni kputet ku isht mā'j hollë.
Për nji plesht s'digjet jargâni.
Pikë, pikë – mushet pusi.
Plaka me nji dhâm ha kalánë.
Plaku s'e ka kurrsesi taman.
Pleqnia nuk vjen ta qitë topa.
Pleqnia s'vjen me topa.
Pshtyj përpjetë e t'bje n'fytyrë.

Pshtyj përpjetë e t'bje n'turinj.
Puna natsë e gazi ditsë.
Punët e mira bâhen kadal.
Qefë-qefë dynjája.
Qefi mâ i madh se Stamolla.
Qeni lehen ku ka lugun.
Qinji butë nërgon dy nâna.
Rueju se t'ruen edhe Zoti.
Rrashtë nuk ká pa belá.
Rrena i ka kâmtë e shkurta.
Rri shtremtë e fol nreqtë.
Rruga shkurtë del e gjatë.
Rruga vâde s'ká.
Sabër – selamet.
Sa bánë robi – mos e thântë Zoti.
Sá e ká grykën aq edhe nafakën (pushka).
Sa njerëz n'ket dynjá, aq edhe huqe ká.
Sa njerëz n'ket dynjá, aq edhe sifate ká.
Sa njerëz n'ket dynjá, aq edhe teke ká.
Sa punë ka burri, aq bira ka muri.
Si isht veni bahet kuveni.
Si koha, edhe na nryshojmë.
Si t'jetë e shkrueme, ashtu bâhet.
S'isht e bléme si e léme.
S'isht kiveti sa vullneti.
S'ka gjâ pa gjâ.
S'ka insán pa naksán (të meta).
S'ka kulaça n'ferra.
S'rri kungulli daj përmi ujë.
Shi i butë lagën t'marrë e t'urtë.
Shi n'maj - plot vaj.
Shkon e njoma me t'thata.
Shkon e zeza te i ziu.
Shpija bashkë e bötha jashtë.
Shpija vet e pordha vet kurrkuj s'ja përg'jet.
Shpija vet kurrkuj s'ja përg'jet.
Shtriji kâmtë sa ke jargânin.
Ta njesin bishtin edhe kur s'e ké.
Ta u rritë ta u çroditë.
Thngill'i mluem t'djeg e t'shuen.
Thupra ka dalë pej Parrizit.
Ujku qymen nrron, hadetin s'e harron.
Ush si gjikush.

Vapa kalon me gusht.
Veni vet kurrkuj s'ja përng'jet.
Veç mordja merr e s'nep.
Vesha – kopilesha.
Zemra e frytë t'i pëlset sytë.
Zgidhe shokun ma t'mirë se vetin.
Zjarm e dritë e burrë e shpirtë.

*****Shestanasit – shqiptarë me banim ose me rranxë në Shestan, Pinç, Ljare, Brisk ose Thtjan (pjesa perëndimore e Kranjës, në jug-perëndim të Liqenit të Shkodrës, rrethi i Tivarit).
Mblodhi **Simë Gjon Dobreci**

Shevqet DRAGAJ

NGJARJE DHE NDODHI NË ANË TË MALIT

INFORMIMI I GABUAR

Shefqet Draga kishte caktuar datën e martesës së vajzës së vet, e cila datë në vete përmbante numër 6 (gjashtë). Ky numër i ngatërroi disa miq të shtëpisë të cilët vinin të dhuronin vajzën që martohet sipas zakonit të vendit.

Në mes të tjerëve, nga ata që do vinin për të pirë kafenë e martesës së vajzës e të dhuronin, ishin edhe dy miq si Tahir Syli dhe Halit Mehja. Të dy kishin biseduar dhe informuar për datën e martesës, sepse ato të dy nuk thirreshin në dasëm, por ata donin vullnetarisht të jepnin peshqeshin, e peshqeshi jepet para dhe në ditën e dasmës.

Pasi kishin debatuar në katund për ditën e martesës, kishin dëgjuar shumë numëra e sidomos numrin gjashtë, a është 16, 26 apo 6 ditë apo 16 ditë nga dita kur kishin biseduar. Në të vërtetë data ishte 16 e muajit.

Këtë bisedë e kishin bërë një muaj para, dhe pas do kohe ata të dy ishin takuar se ishin miq dhe bënë llogarinë se kur duheshin të shkojnë të "falin" vajzën e Shefqetit. Sipas hesapit të tyre e vendosën që i bie të shkojmë me filan datë e i bie e dielë. Dita që ata vendosën – me hamendje – i bie të shkonin të pasnesërmen. Të pasnesërmen Tahiri niset prej Shtodrit dhe merr një kilogram sheqer dhe kalon kah shtëpia e Halitit (ishin miq) dhe e merr me vete. Edhe Haliti mori një kilogram sheqer dhe nisen dhe mbërritën afër mëhallës së Dragajve. Prej se largu vërejtën se të gjithë Dragajt ishin nëpër oborre dhe ara duke punuar. U çuditën, si është e mundur që nuk janë në dasëm axhat e nipat? Megjithatë, ne po vazhdojmë ku jemi nis se ndoshta nuk kanë raporte. Në mes të mëhallës në oborr të Qazimit shikon vajzën e vet që ishte e martuar dhe i lajmërohet, e ajo kur i sheh të veshur e të mbathur si për dasëm i pyet: Ku jeni nisë, nuk ka dasëm, ku po shkoni? Haliti i thotë: A e marton vajzën sot? Çfarë vajze, kush ju ka thënë? Unë të kam treguar more babë, të kam thënë disa ditë përpara se martesa është me 16. Haliti i nevrikosur i kthehet të bijës. Dëgjo moj bijë, nuk di unë ato data çka keni thanë ju,nuk di unë gjashtat e të shtatat, është dashtë me thënë: Sot një javë apo sot dy javë, por eja Tahir të shkojmë të kryejmë qëllimin tonë. Vazhduan deri në fund të mëhallës dhe mbërritën te shtëpia e Shefqetit.

Thirrën në derë, hynë mbrenda dhe Shefqeti i gostiti se e mori me mend që këtu ka keqinformim. Edhe ata vetë u arsyetuan duke kërkuar falje. Uruan për martesën e vajzës dhe tash e morën vesh se martesa bëhej pas një javë, dorëzuan të falurat dhe shkuan.

Informoi: Halit Mehja (1984)

MBJELLJA E MANIT NË RASHTISHË

Familjarët e Sait Canit – Nikaj në Rashtishë, tregojnë se deri në fillim të shekullit XX në fshat nuk kishte të mbjellur asnjë pemë të manit.

Mbjelljen e manit të parë e bëri nëna e Sait Canit e quajtur MINE. Ishte iniciativa e Minës të mbjellin katër mana në afërsi të lagjes. Për pemët e mbjella kujdesej Min'ja, gjë që ajo e bënte me dëshirë. Herjati i Minës, nuk u mirëprit nga disa fshatarë. Kjo u dëshmua se një ditë u manat u gjetën të shkulur. Më vonë u zbulua se kush e kishte bërë shkuljen. Aktori keqbërës ishte kojshia i quajtur Salë Xhurreta. E bëri se nuk i pëlqente që herjatin e kishte bërë një femër, e jo një mashkull. Megjithatë, Min'ja nuk humbi moralin e saj dhe vendosi t'i mbjellë manat përsëri. Tani nuk kishte si t'i shkulte zemërkeqi manat se ruheshin nga familjarët e Mines.

Me kujdesin e Mines për ujitje, manat u rritën shpejt dhe dhanë fryte. Frytet e manave i hanin të gjithë, fshatarët dhe kalimtarët. Deri sa shtrinë rrënjë, manat u ujitën me ujin e kronit të MALLIMIT që buronte në luginë ku ndahet rruga e Nikajve me Curaj. Manat dhanë fryte në vitin 2000, bile, një rrënjë edhe sot është aty, në rrugën që të çon kah Sadik Metët.

Informoi: Daut Nika (2002)

LUGËT E SHPËTUAN NUSEN

Vjehrra kishte vërejtë se nusja e shtëpisë nuk ngopej kur familja kishte miqë në shtëpi. Ajo vërejti se nusja shërbente miqtë pa u plotësuar tavolina me ushqime, miqtë fillonin e hanin e nusja ende shërbente. E keqja më e madhe ishte kur miqtë vinin për iftar. Në këto raste vjehrrës i dhimbsej më shumë, se edhe ajo agjëronte.

Për të mos u dënuar nusja në këtë mënyrë sa herë që vijnë miq, vjehrra e këshillon nusen. Ajo i bisedon se musafirët nuk i respektojnë rregullat njerëzore. Prandaj në të ardhmen kur të shërbesh ushqimin në tavolinë, vendosi gjërat mbi tavolinë, por lugët mos i vendos në tavolinë. Kur të bëhesh gati me të gjitha, atëherë merri lugët sa nevojiten dhe ulu.

Prej asaj kohe, nusja nuk ngrihej nga tavolina pa u ngopur. Ka ndodhur në Selitë.

Informoi: Riza Geka (2000)

DARKA E PARË E DHËNDËRIT

Mehmeti i Asllan Mehos nga Boret u martua dhe sipas zakonit pas një jave duhej shkuar në miqësi të re si dhëndërr në Brajshë. Ishte zakon t'ia ngjesin ndonjë qylym me çatall fshehtas pas shpine, që kur të ngrihet në këmbë të marrin qylymin pas. Ishin edhe disa cicmica tjera, por më kryesorja ishte paraqitja e dhëndërit gjatë darkës. Si të hajë dhe kur duhet të ngritet nga sofra. Duhej të ngritej kur në sofër të ulin kosin. Për këtë e këshillon i ati se "*kur ta prekë këmbën ti ke me u çue nga sofra*". Në sofër u ulën babë e djalë buzë njëri tjetrit. Të gjithë u ulën në sofër. Filloi darka. Filluan të hanë nga sahani i parë, e pas tij duhej të ulnin sahanin me gjellë tjetër. Duke filluar ta marrin gjellën në sahanin e dytë, gabimisht i ati e hasën me këmbë të birin (dhëndërr) e ai e kuptoi se pasi e preku me këmbë, duhet të ngrihet nga sofra dhe djali çohet nga sofra. Të gjithë u habitën dhe i lutën se ka edhe gjellë të tjera. Iu lutën disa herë, por ai nuk ulej. Më në fund reagoi edhe i ati duke i thënë: ULU MORE DJALË SE TË KAM HAS KAMBËN GABIMISHT. Djali u ul përsëri në sofër, por e tregoi sekretin. Pastaj e preku përsëri kur u ul sahani i kosit dhe dhëndërri u ngrit nga sofra.

Për korrektësi nuk u emërtuan personat.

Informoi: Dul Asllani (1990)

A I PAGOI SHEGAT?

Shevqet Dragaj në vitin 2000, nga shegat e veta që i prodhon, u ujdis me një blerës – tregtar që kishte edhe kamionin e tij për të tregtuar duke transportuar mallin për ta shitur në Podgoricë.

U morën vesht për çmimin e shegave. Tregtari në ditën e caktuar mbërriti në oborr të shtëpisë. Shegat u volën u peshuan dhe u ngarkuan në kamion. Shevqeti priste se kur po i jep të hollat për shega, por nuk bënte zë. Kur çdo gjë u bë gati, e duhej të ikte me kamion, në vend që të paguaj të hollat, tregtari i drejtohet Shevqetit duke i thënë: Shevqet a i ke 20 marka se më duhen që të paguaj naftën për kamion në Tivar se do shkoj në Podgoricë e nuk kam asnjë markë.

Shevqeti fillimisht u habit pak, por për të mos u koritur, shkon në shtëpi, merr markat dhe ia jep. Tregtari iku me kamion. Në mbrëmje, Shevqetin e pyet vëllau – hoxha – se sa të holla more nga shegat? Shevqeti përgjigjet: Jo që nuk m'i pagoi shegat, por më lypi edhe 20 marka. Mirë se i ha dreqi shegat, por po i ha edhe markat që ishin në shtëpi. Ky rast u bë qesharak për sa vonoi t'i paguajë. Pas dy javësh i solli të hollat e shegave dhe markat. Të gjithë u çuditën që i pagoi se mendonin se shkuan edhe njëra edhe tjetra.

Informoi: Shevqet Draga (2000)

PORTRET

Gazmend ÇITAKU

MARK PJETËR LEKË DOBRECI
MJESHTRI SHQIPTAR I VIOLINAVE ME FAMË BOTËRORE

Ulqini është një vend i vogël bregdetar shqiptar i cili ndodhet në Malin e Zi. Përveç historisë së vet të bujshme mbi 2500 vjeçare, nga ky qytet dolën njerëz shumë të famshëm në fusha të ndryshme. Ulqini u përfshi në ngjarje dhe situata historike shumë të rëndësishme kombëtare që nga Lufta e parë Iliro-romake, Beteja e Lepantit e deri te Kongresi i Berlinit ku me vendim të Fuqive të mëdha i takoi Malit të Zi.

Shkrimet e para për Ulqinin janë ato të Plini Plakut (23-79 e.re) që këtë vend e identifikojnë si qytet nga viti 250 p.e.re. Nëpër Ulqin kalojnë dy kalorës irlandez Hugo Iluminatori dhe Simon Simeoni në vitin 1321 dhe në relacionet e tyre që më vonë botohen nën titullin Itinerarium Symonis Semeonis Ab Hybernia Ad Terram Sanctam. Scriptores Latini Hiberniae, Volume IV., përveç tjerave tregojnë se rruga për në Jerusalem i ka çuar nëpër Ulqin dhe ne mendojmë se ky duhet të jetë shkrimi mesjetar më i vjetër për Ulqinin. Nga Kepi i Rodonit shihet Kalaja e Ulqinit, dhe lidhjet e Skënderbeut me qytetin e Ulqinit ishin të shumta madje disa historianë thonë se Skënderbeu zgjodhi Ulqinin si vendin ku do të kalonte ditët e para të martesës me Donikën?! Pason Arnold von Harff-i më 1466-1469 ku fjalorin e vet me fjalë shqipe i mbledh mu në Ulqin. Më 1666 në Ulqin internohet Sabataj Zevi, i vetëshpalluri Mesi dhe reformatori i librit të shenjt të hebrejve, Talmud, ku edhe ndodhet tyrbja e tij. Të zënë rob nga detarët ulqinakë hasim edhe Servantesin dhe mjekun i njohur franqez Fransua Pukëvili etj.



Ulqini nga gjiri i vet ka nxjerrë edhe personalitete të shquara si historike ashtu edhe shkencore e humanitare. Një nga të shumtit është edhe violinë-ndërtuesi

*me famë botërore, **Mark Dobreci** (Marko Dobretsovich 1891-1957) i lindur në fshatin Braticë, Ulqin më 1891.*

***Pjetër Lekë Dobreci** kishte tre fëmijë: **Zefin, Markun** dhe **Diljen**. Kjo familje pesë anëtarëshe jetonte në kushte të rënda dhe puna të cilën bënin u mundësonte të zhvillonin jetë modeste. Zefi, vëllau i madh i Markut, punonte me dru dhe konkretisht ishte ndërtues i kundakëve të pushkës[124]. Kjo lloj veprimtarie nuk ishte edhe aq profitabile ndërsa kërkonte angazhim dhe përkujdesje maksimale që nga zgjedhja e drurit e deri te puna me te. Marku i ndihmonte vëllaut dhe kjo punë do të jetë njohja e parë e Markut me teknikën e punimit të drurit. Në vitin 1914[125] për shkaqe të paqarta Marku merr vendim dhe në moshën 23 vjeçare zhvendoset në Aleksandri (Egjipt) prej nga kurrë më nuk do të kthehet në Ulqin. Mund vetëm të hamendësojmë se çka e shtyri atë të zgjedhë Aleksandrinë si vendbanim të përhershëm ndoshta ishte lidhja e fortë e detarëve ulqinakë të cilët lundronin rregullisht për në portet mesdhetare si Aleksandria, Tripoli (Tarabulluzi[126]) etj., apo ndoshta favorizimi i shqiptarëve nga Mbreti i Egjiptit (Misiri) i cili ishte me prejardhje shqiptare, **Mbreti Fuad I** (1868-1936) më parë i njohur si **Ahmed Fuad Pasha**[127]. Kjo mbetet e pasqaruar por një gjë është evidente se ai atje krijoi famë me punën që bëri dhe se rezultatet e punës së tij ende janë të pranishme.*

*Viti 1920 Mark Dobrecin e gjen në Bolonja të Italisë si nxënës në punëtorinë e njërit nga mjeshtrit më të mëdhenj italian të violinave **Augusto Pollastri** (1877-1927) mjeshtër i cili zanatin e ndërtimit të vilonave e kishte marrë nga mjeshtri i madh italian **Raffaele Fiorini**[128]. Ndikimi i mjeshtrit Augusto ishte shumë i madhë mirëpo edhe shkathtësia e Markut që këshillat e mjeshtrit t'i zbatonte me përpikëri bëri që gjatë punës së tij në Kajro dhe Aleksandri të mos ketë konkurencë në këtë fushë. **Gjokë Stanoviqi** (1925) kur ishte pesë vjeç (1932) kishte shkuar me babanë, nënën dhe motrën e vet për të jetuar në Aleksandri. Atij i kujtohet, që si fëmijë, kur prindërit e tij për pushime erdhen në Ulqin më 1935-36, ai me dy motrat e tija ndenjën në shtëpinë e Markut për më shumë se dy javë dhe i kujtohet se maestroja përveç se i ndërtonte prej fillimit kishte shumë të interesuar që vinin të riparonin violina dhe se gjithashtu vëmendjen e Gjokës, atëherë 10-11 vjeç, ia kishin tërhjekur edhe dy diploma të varura në murë të puntorisë së mjeshtirt Mark, e që mesiguri ishin certifikata për punën që kryente. Gruaja e maestro Markut ishte italiane dhe njëherit kumbara e motrës së Gjokës - **Rozës**.[129] Atij i kujtohet gjithashtu që maestroja pothuaj*

[124] Tregoi Gjokë Stanoviq (91) lindur më 30 mars 1925 në Braticë. Biseden e zhvilloi Gazmend Çitaku më 17.07.2016 në Braticë

[125] https://www.bromptons.co/reference/articles/details/marcodobretsovitch.html

[126] Tarabulluz e quanin detarët ulqiakë Tripolin sipas emrin në origjinal Ṭarābulus al-Gharb

[127] Encyclopedia Britanica, https://www.britannica.com/biography/Fuad-I

[128] https://en.wikipedia.org/wiki/Augusto_Pollastri

[129] Tregoi Gjokë Stanoviq (91) lindur më 30 mars 1925 në Braticë. Biseden e zhvilloi Gazmend Çitaku më 17.07.2016 në Braticë

gjithë kohën e kalonte në punëtorinë e vet ku ndodheshin violina dhe drunjë enkas të porositur për ndërtimin e violinave.
Puna që bënte maestro Dobreci ishte e pakrahasueshme dhe teknika e finesa që përdorte padyshim se lanë një gjurmë të pakrahasueshme në violinë-ndërtimtarinë e shekullit XX. Italianët e përvehtësuan maestro Dobrecin si të vetin dhe atë e gjejmë shpesh në publikime të ndryshme si mjeshtër italian i violinave.[130] Si ilustrim po sjellim një violinë të ndërtuar në vitin 1924 në Kajro e cila sot vlenë 49.500,00 Euro.

Maestro Dobreci dallohej përnga finesa dhe përsosmëria në punë. Kështu që modeli i violinës ishte i kallëpit Stradivari, me funde të lëmura deri në perfeksion i dekoruar me ornamente fundore që përdoreshin në instrumentet me tela. Druri që përdorte ishte shumë i bukur, fundi i violinës njëcope prej drurit të çinarit të tharë me zjarr dhe veçanërisht ndikimi i teknikës së maestro Augustit shfaqej në bishtin e violinës ku kokat e çelësave u gjason syrit.
Maestro Marku krijoi familje në Egjipt, siç u tha më lartë gruan e kishte italiane dhe me te kishte dy fëmijë djalin Pjetrin dhe vajzën Silvana[131]. Pas vdekjes së Markut familja shpërndahet, gruan e Markut e merr vëllau i vet në itali ndërsa fëmijët shkojnë të jetojnë në Sao Paolo të Brazilit. Siç tregon Gjokë

[130] Jost Thoene, "Italian & French Violin Makers" Vol 3, 2003
[131] Tregoi Gjokë Stanoviq (91) lindur më 30 mars 1925 në Braticë. Biseden e zhvilloi Gazmend Çitaku më 17.07.2016 në Braticë

Stanoviqi nga Ulqini deri vonë ka mbajtur korrespodencë me djalin e Markut, Pjetrin. Për të cilin thotë se ishte gjetur mjaftë mirë në Sao Paolo dhe se kishte krijuar familje atje. Kjo korrespodencë ndërpritet me fillimin e krizës në ish Jugosllavi.

Maestro Mark Dobreci, ndërtoi violina të cilat sot janë shumë të çmuara dhe se emri i tij gjendet në katalogjet më prestigjoze të violinë-ndërtuesve më me famë botërore. Instrumentet e mbetura kanë çmime të larta dhe sillen nga 19.500,00 deri në 45.000,00 Euro. Për fat të keq këtë mjeshtri prej tij askush nuk e trashëgoi. As dajli i tij si pasardhës direkt e as ndonjë nxënës i tij. Fama e ulqinakut në Egjipt mbaron me te ndërsa violinat e tija ende prodhojnë tinguj mahnitës.

Propozoj që si kujtim për maestro Mark Pjetër Lekë Dobrecin nga Ulqini, violinë-ndërtuesin me famë botërore, të cilin e nderon bota mbarë si nderim dhe kujtim për te shkolla e muzikës në Ulqin të emërohet me emrin e tij. Mendoj se një personalitet i tillë e meriton.

Dr Nexhat AVDIU

TURIZMI SI FENOMEN ZHVILLIMOR DHE PRIRJET E SOTME TË TIJ ME NDIKIMIN E TYRE NË HAPËSIRËN E MARRË NË STUDIM

1.1. Përcaktimi i turizmit si degë udhëheqëse e shekullit të XXI

Progresi shkencor-teknik, zhvillimi i mjeteve transportuese, rritja e nivelit të kulturës dhe nivelit të standardit ekonomik kanë kushtëzuar ndryshime të shumta në lëvizjet shoqërore, duke ndikuar kështu edhe në zhvillimin e turizmit. Duke pasur parasysh nivelet mesatare të rritjes vjetore, të cilat i ka shënuar në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, turizmi përbën degën ekonomike që realizon rritje të vazhdueshme. Rëndësia e turizmit vërehet edhe në lidhjen e ngushtë me një varg veprimtarish, siç janë: komunikacioni, kultura, shëndetësia, politika, etj. Autorët kanë pikëpamje të ndryshme lidhur me lëvizjen e turizmit në të ardhmen. Disa autorë japin parashikime shumë pesimiste, të tjerët përgjithësisht optimiste të zhvillimit të turizmit në periudhën e ardhshme. Megjithatë, të gjithë pajtohen në parashikimet e tyre, se turizmi në të ardhmen varet nga zhvillimi i zonave specifike, e veçanërisht atyre kufitare. Madhësia dhe struktura e popullsisë, potenciali ekonomik, inovacionet teknologjike, lëvizjet politike dhe kulturore paraqesin më së shumti faktorët nga të cilët varen orientimet e zhvillimit të turizmit në periudhën e ardhshme. "E ardhmja e turizmit do të varet në masë të konsiderueshme nga faktorët jashtë këtij fenomeni, sesa nga faktorët brenda vetë atij"[132]. Duke pasur parasysh se ekzistojnë mendime të ndryshme të autorëve mbi faktorët kyç të zhvillimit të turizmit në të ardhmen, ku secili nga pozicioni i vet parashikon zhvillimin e mundshëm të situatës, në punim jepen qëndrimet e autorëve për të cilët mendoj se kanë qasje më gjithëpërfshirëse, si Cooper dhe Middleton, të cilët theksojnë këto faktorë nga të cilët varet zhvillimi i turizmit:

- kufizimi i rritjes së tregut;
- cilësia, ripërtëritja e destinacionit dhe diferencimi;
- marketingu i përgjegjshëm ose social;
- ndryshimi i strukturave politike;
- ndryshimi i distribuimit në turizëm (lëvizja e zhvillimit sidomos nga veriu drejt jugut).[133]

Një skenar interesant mbi lëvizjen e turizmit në të ardhmen e prezanton edhe autori i njohur Poon. Në punimin e tij me titull: "Tourism, Technology and

[132] Vukonić B. – Rethinking of Educations and training for Tourism , Zagreb – 2002 , fq. 496

[133] Cooper C. Tourism , Principles and practice , London – 1993 , fq. 256 dhe Middleton V. – Marketing in Travel and Tourism , Oxford – 1993 fq. 359

Competetive Strategies" ai përmend ciklin jetësor të turizmit, duke filluar që nga mesi i shekullit të kaluar, deri te zhvillimi i tij i mundshëm në të ardhmen. Në cikël përshkruan karakteristikat e turizmit shikuar historikisht, duke filluar që nga diversiteti i turizmit *të vjetër*, të cilin e ka karakterizuar turizmi masiv, deri te turizmi *i ri*, të cilin e karakterizojnë kushtet e reja të përmbajtura në kërkesat e ndryshueshme, pritjet e turistëve si dhe mënyrës së tyre të sjelljes.

- ***Konsumuesit e rinj***. Në bazë të hulumtimeve, konsumuesit e rinj janë më tepër të sofistikuara në drejtim të përgjegjësisë ekologjike, duke synuar përvojën dhe cilësinë e jetës më shumë sesa pushimin në diell. Shkurtimisht, tregu është shumë më tepër i diferencuar sesa ka qenë njëzet vjet më parë dhe vetë kjo paraqet sfidë për hulumtuesit e strategjive të marketingut, të cilët kanë si synim standardizimin;
- ***Teknologjitë e reja***. Mënyra e aktivitetit sipërmarës, ose që ka lidhje me biznesin në përgjithësi, e vendos theksin në përparësitë e teknologjisë, e cila mund të gjejë zbatim edhe në turizëm. Teknologjia është zhvilluar me dinamikë më të madhe sesa zhvillimi i tregut turistik, gjë që ka rezultat në mundësinë e përcaktimit më të saktë të turistëve, përgjithësisht zgjedhjes së tyre të destinacionit dhe shërbimeve, pa ndihmën e turoperatorëve dhe krahas minimizimit të riskut.
- ***Kufijtë e zhvillimit***. Faktorin e tretë të zhvillimit e përbën fakti se rritja e numrit të kufizimeve në të gjithë sektorët ndihmon ruajtjen e mjedisit. Po punohet në organizimin e normave dhe masave të caktuara për shërbimet turistike, në mënyrë që ato që përfshijnë shfrytëzimin e madh të energjisë dhe shkatërrojnë mjedisin, nuk janë më të pranueshme. Në lidhje me këtë që thamë, koorporatat dhe qeveritë kanë arritur në përfundimin që ndikimet negative të zhvillimit të përcillen ose analizohen me vëmendje në strategjitë e dekadave të ardhshme.
- ***Politika globale e re***. Sipas grafikut nr. 1 cikli jetësor i turizmit, ndryshimet e reja, shkalla ekonomike dhe përvojat negative nuk janë më të zbatueshme në të gjitha aspektet e turizmit. Autori shpreh mendimin se organizimin e ri e karakterizon fleksibiliteti i masave, i cili manifestohet në shumëllojshmërinë dhe specializimin, harmonizimin e sistemeve dhe inovacionet .

Natyrisht, duhet të merret parasysh edhe procesi i globalizimit, i cili nuk është paraqitur në grafikun e mëparshëm .

Autori Mules parashikon dy skenarë të mundshëm të globalizimit në të ardhmen[134]. Sipas njërit, në anën e kërkesës rritja e shpejtë e turizmit ndërkombëtar në shumë shtete paraqet hulumtim, i cili kërkon përcaktimin e dimensioneve të ndikimeve ekonomike në turizëm. Sipas skenarit të dytë, nga pikpamja e tendencave për të ushtruar biznes në nivel global do të sjellë realizimin e të ardhurave të organizatave në ekonominë turistike (për shembull: hotelet, etj), deri te qytetarët (aksionarët), madje edhe në shtetet që nuk janë destinacione te mirëfillta turistike.[135]

1.2. Mega-Trendet dhe globalizimi i turizmit

Shekulli XXI paraqet një të panjohur të madhe. Në njërën anë një sfidë, në anën tjetër gjithpërfshirje për të gjitha fushat e veprimtarisë socila-ekonomike, politike, teknologjisë etj. Rezultati i qëndrimit të tillë bazohet në dinamikën e tyre, e cila është e theksuar sidomos në pjesën e dytë të shekullit të kaluar.

Ky mijëvjeçar mbart me vete një numër të madh pyetjesh të ndryshme, të cilat në fushën e turizmit do të shtroheshin kështu: Cilat forma të turizmit do t'u interesojnë turistëve? Cilat forma të turizmit janë më të preferuara në raport me format e tjera? A ka vend për hapësira (mjedise) të reja turistike në tokë? A do të jenë disa mjedise gjeografike të lëna pas dore në shekullin XX në fokus të interesimit në shekullin XXI? A do të jenë mjedise turistike të së ardhmes Sahara, Antarktiku, majet e maleve, thellësitë e deteve dhe oqeaneve, apo hapësirat e kozmosit?[136] Secila prej këtyre pyetjeve mbart me vete sfidën e shekullit XXI, e cila kërkon përgjigje.

Autorë të ndryshëm në veprat e tyre japin parashikime të mega-trendeve, të cilat do të kenë përparësi në lëvizjet turistike në të ardhmen. Sipas mendimit tim, parashikimin më gjithëpërfshirës e jep WTO, natyrisht duke marrë parasysh parashikimet e autorëve të tjerë, të cilat pak a shumë dallojnë nga ai. Nga segmenti i ofertës WTO theksohen pesë mega-trende të zhvillimit të turizmit (http://world-tourism.org):

1. **Ekoturizmi.** Ekoturizmi nga një bazë e parëndësishme e "udhëtimit të përgjegjshëm ekologjik dhe social" është zgjeruar në "udhëtim me komponentin natyrë". Ekoturizmi në kuptimin më të gjerë ofron, si shanse zhvillimore, ashtu edhe mundësi që të financohen zonat e mbrojtura. Ai kërkon diferencimin në grupe të vogla me interesime të veçanta dhe në grupin e madh të atyre të cilët pushimin në plazh e lidhin me vizitën njëditore të rezervateve natyrore, si pjesë e përjetimeve të tyre në pushimin vjetor dhe argëtime.

---

[134] Martinovic P. – Turisticki proizvod Crne Gore i strateski pravci njegovog razvoja (Punim masteri), Lublana 2003, fq.7

[135] Faulkner B. Moscard G. Laës E. – Tourism in the Tëenthy – First – Century Reflections an Experience , London , Neë York 2002 , fq. 313

[136] Touristic Masterplan of Montenegro, Podgorica 2001

2. Turizmi kulturor. Këtu WTO bën diferencimin e zgjedhjes ndërmjet grupeve të vogla të tregut me interesa të veçanta dhe grupit të madh, të cilat vizitën e monumenteve kulturore e përfshijnë në programin e tyre të pushimit, i cili përndryshe ka pikësynim tjetër.

3. Turizmi tematik. Paraqet turizmin i cili është i orientuar në interesime tejet specifike dhe paraqet një treg relativisht të vogël. Interesimet speciale kanë përparësi, por edhe aspektet e tjera, siç janë klima apo lokacioni. I fokusuar në tri "E" kapitale (të mëdha) - Entertainment, Excitement, Education (Argëtim, Kënaqësi, Edukim) – turizmi tematik mund të veprojë si katalizator i zhvillimit.

4. Turizmi avanturës. Kjo formë e turizmit paraqet një grup qëllimi të vogël tregu, por në rritje. Duke marrë parasysh rrethanat, që gati çdo pjesë e tokës është hulumtuar, ky segment preferon interesimin për hulumtimin e majave të maleve, thellësitë e deteve, Antarktikun dhe kosmosin. Kështu për shembull, rreth dy milionë turistë kanë lundruar me nëndetëse[137] etj.

5. Shëtitja me anije. Karakteristika kryesore ka të bëjë me mundësinë e ofruar që për një kohë të shkurtër të shihet gjithçka ("time poor – money rich"). Përndryshe, këtë karakteristikë nuk e ka asnjë lloj tjetër udhëtimi, pra siç ofrojnë shëtitjet me anije.
Pjesën e dytë të shekullit XXI do ta karakterizoj në mënyrë të ndjeshme revolucioni informatik. Zhvillimi i teknologjisë kompjuterike, ose teknologjisë së informacionit, me qëllim të marrjes dhe përpunimit sa më efikas të të dhënave, si dhe transmetimit të tyre sa më të shpejt, pastaj zhvillimi i teknologjisë në fusha të ndryshme, sidomos në transport, siguria e një numri të madh të destinacioneve botërore, si dhe përmirësimi i nivelit të arsimimit dhe kulturës në përgjithësi, e kanë përcaktuar botën me emërtimin "fshat global". Për këtë arsye, lëvizja deri në destinacionet më të largëta, apo udhëtimi në kontinentet e ndryshme, nuk përbën problem të madh.
Modifikimi i kërkesave të vjetra dhe kërkesat e reja të turistëve për destinacione akoma "të papara", flasin në favor të tezës se edhe fusha e turizmit është përfshirë nga globalizimi. Udhëtimi nga njëri skaj në skajin tjetër të botës nuk përbën më problem. Kështu për shembull, për turistët është krejt normale që të hanë mëngjesin në Paris, të darkojnë në Nju Jork, kurse ditën tjetër ta kalojnë në Tokio[138]. Udhëtimet në pjesë të ndryshme të botës, për një turist mesatar, paraqet (mund të krahasohet) me lëvizjen në periferi të qytetit të tij, të cilën e viziton për herë të parë.

[137] Martinovic P. – Turisticki proizvod Crne Gore i strateski pravci njegovog razvoja (Punim masteri), Lublana 2003, fq.9
[138] http://world-tourism.org

1.3. Lëvizja e rrjedhave turistike në Evropë

WTO parashikon rritje të turizmit ndërkombëtar në 1.6 miliardë udhëtime në vitin 2020, respektivisht një qarkullim prej rreth 2 bilionë US$[139]. Për vendet e Mesdheut WTO parashikon ulje të pjesëmarrjes në treg nga 30% në 22% por në shifra kuantitative, rritje të vizitës vjetore për 3%, nga 167 milionë në vitin 1995 në 346 milionë në vitin 2020 [140].

Parashikimet e theksuara më parë të WTO-së duhet të vështrohen në mënyrë kritike nëse merren parasysh disa pyetje (çështje) [141] si:

- a munden rritja ekonomike, resurset e disponueshme dhe mjedisi të ecin në hap me rritjen e popullsisë, e cila manifestohet në kërkesën turistike?
- a janë të gatshme destinacionet të pranojnë numrin e parashikuar (rritjen e parashikuar) të turistëve dhe t'i kënaqin?
- a do të rritet trendi i papunësisë në Evropë, e me këtë a do të rriten të ardhurat reale apo shpenzimet jetësore?
- a do të vijë deri te lodhja nga udhëtimet, duke marrë parasysh fluksin në komunikacion dhe të turistëve, mbingarkesën e mjedisit, kapaciteteve të banimit, infrastrukturës etj.?
- a e kufizojnë katastrofat natyrore (tërmetet, orkanet, erërat, etj.), sulmet terroriste, problemet shëndetësore (epidemitë e ndryshme) dhe problemet sociale kërkesën turistike?

Lëvizja e kërkesës turistike varet në masë të konsiderueshme nga parashikimet e rritjes/zvogëlimit të popullsisë. Kjo sidomos ka të bëjë me shtetet turistike emetuese, siç janë disa shtete evropiane (natyrisht, si dhe Evropa në tërësi), para së gjithash Gjermania, Britania e Madhe, pastaj vendet skandinave etj,.

Sipas parashikimit të Kombeve të Bashkuara, popullsia evropiane do të zvogëlohet nga 727 milionë që është aktualisht në 692 milionë banorë, përgjithesisht Evropa do të pësojë ulje të popullsisë prej 4.8 për qind. Popullsia e vendeve që tashmë janë anëtare të Bashkimit Evropian do të zvogëlohet nga 375 milionë në 361 milionë banorë, respektivisht me 3.7%[142].

Parashikimet flasin se në periudhën e ardhshme do të ketë rritje të grupmoshave nga 55 deri 64, dhe 65 deri 74 dhe grupmoshës më të vjetër se 75 vjeç. Ndryshimet e parashikuara të shpërndarjes së strukturave të moshave ndikojnë në intensitetin e udhëtimit. Për këtë arsye, është interesant të shikohen parashikimet e intensitetit të udhëtimit në Evropë, ku me intensitet të udhëtimit nënkuptohet përqindja e popullsisë më moshë më të madhe se 14 vjeç, e cila udhëton të paktën një herë në vit, në kohëzgjatje prej më së paku 5 ditë. Intensiteti i udhëtimit flet edhe për tendencat, d.m.th. prirjet e popullsisë që të

---

[139] Touristic Masterplan of Montenegro, Podgorica 2001

[140] http://world-tourism.org

[141] Touristic Masterplan of Montenegro, Podgorica 2001, fq. 133

[142] Martinovic P. – Turisticki proizvod Crne Gore i strateski pravci njegovog razvoja (Magistarski rad), Lublana 2003, fq.12

udhëtojë. Pastaj, intensiteti i udhëtimit mund të trajtohet edhe në kuptimin e gatishmërisë së popullsisë që të udhëtojë, e cila manifestohet para së gjithash në kënaqjen e parakushteve financiare, në varësi të të cilave intensiteti i udhëtimit mund të variojë. Gjithashtu është me rëndësi të theksohet se në intensitetin e udhëtimit ndikojnë: koha në dispozicion për udhëtim, kushtet metereologjike, infrastruktura e komunikacionit etj.

Tab. 1: Tëndencat e lëvizjes së numrit të banorëve në Evropë

VENDI	VITI	POPULLSIA E SHPREHUR NË MILION	PJESMARRJA E GRUPËMOSHAVE E SHPREHUR NË PËRQINDJE				
			< 19	20-54	55-64	65-74	> 75
GJERMANIA	2000	82.7	21.0	49.5	13.2	9.3	7.1
	2020	78.3	15.6	45.9	16.4	11.2	11.0
AUSTRIA	2000	8.19	23.0	51.3	11.0	8.0	6.7
	2020	8.04	16.7	47.6	16.0	10.8	8.9
B.MADHE	2000	58.65	24.8	48.4	10.7	8.5	7.6
	2020	57.46	19.1	45.9	14.4	11.4	9.2
ÇEKIA	2000	10.22	23.1	10.6	10.6	8.3	5.4
	2020	9.61	16.4	13.2	13.2	13.2	8.2

Burimi: Touristic Masterplan of Montenegro, 2001, fq .136

Tab. 2: Intensiteti i udhëtimit në vendet e zgjedhura evropiane në vitin 2008

Shteti	Intensiteti i udhetimit në %	Një udhëtim	Më shumë se një udhëtim	Udhëtime në 100 banorë
Danimarka	77	47	30	118
Suedia / Norvegjia	67	39	28	113
Zvicra	72	48	25	109
Italija	70	45	26	107
Franca	63	36	27	106
B.Madhe	58	31	26	99
Gjermania	77	58	18	98
Austria	54	36	19	81
Polonia	31	22	9	40

Burimi : WTO – Tourist movements in Europe in 2008 , Madrid, 2008

ARKITEKTURË

Korab KRAJA

KULLA E BALSHAJVE NËN KËNDVËSHTRIMIN ARKITEKTONIK

HYRJA

Kulla e Balshajve si objekt i veçantë, për nga karakteri dhe tipologjia funksionale, në kohën kur u ndërtua, në mesjetë, ka luajtur rol vrojtimi dhe bashkë me të edhe mbrojtjeje të Kalasë së Ulqinit. Mund të thuhet se është objekti, i cili, nga këndvështrimet e caktuara të kalasë, nuk ka se si të mos bie në sy. Kullë e lartë, e cila prej hyrjes veriore të kalasë, duket se i vëzhgon banorët e vizituesit dhe njëkohësisht i përshëndetë ata.

Kulla e Balshajve si ngrehinë në vete, me karakteristika të historisë dhe veçoritë arkitektonike që ka, nuk është e studiuar sa duhet. Trajtim të veçantë duhet t'i kushtohet edhe arkitekturës së saj, për të cilën ka çka flitet e interpretohet dhe është fushë e poashtu faktor i veçantë për interesimin e vizitorëve, pasiqë tani kulla shërben si galeri dhe është objekt për vizitor.

I. THEMELIMI DHE ARKITEKTURA E ULQINIT ANTIK – KALASË

Ulqini me tërë bregdetin e Malit të Zi, përkatësisht me rrethinën dhe me bregun e detit të trojeve ilire – shqiptare, është i njohur me ndërtimet e veçuara me arkitekturë karakteristike bregdetare. Kështu, duke filluar prej shtëpive primitive nga parahistoria, kësollat, me të cilat u mundësua dalja nga vendstrehimet në kushtet natyrore, siç ishin shpellat; duke vazhduar me fortifikimet e ndryshme, kodrinore dhe bregdetare, kështjellat; shtëpitë e veçanta me tipare tjera arkitektonike, të veçuara nga llojet e ngjashme, por të ndërtuara nëpër vende dhe terrene tjera, shtëpitë e banimit nga guri, apo kullat, dhe duke u takuar, tani, me arkitekturën bashkëkohore, e cila, domosdo do t'i përshtatet kushteve klimatike në vendet që ato ndërtohen.

Në saje të punës përnjohëse dhe gërmimeve të bëra vite më parë, është provuar se shumë herët, në hapësirën përreth Ulqinit, janë formuar vendbanimet e tipit palafit. Gjetjet parahistorike provojnë se vendbanimi më i vjetër këtu ka

mundur të zërë fill që nga epoka e neolitit (6000 – 3000 p. e. sonë), ose në epokën e bronzit (2100 – 1100 p. e. sonë), sidoqoftë në kohën e ilirëve.[143]
Për vetë natyrën e tyre, monumentet e arkitekturës janë ato që ruhen më mirë nga trashëgimia kulturore e së kaluarës. Shembuj interesante të kështjellave antike dhe mesjetare janë ato të Tivarit, të Ulqinit, të Prizrenit, të Shkodrës, të Lezhës, të Krujës, të Petrelës, të Beratit, të Janinës, të Pargës etj. Kështjellat në fjalë janë të rrethuara me mure, të përforcuara me kulla mbrojtëse, katërkëndëshe ose rrethore dhe rrethoheshin shpeshherë me hendeqe.[144]
Duke dalur nga koncepti në kuptimin e parë të përfytyrimit të kështjellave, mund të themi se, kështjellat nuk kanë qenë vetëm vende të fortifikuara ku janë zhvilluar luftëra të rrepta. Në kohë paqeje dëgjoheshin aty rrahjet e çekanëve të farkëtarëve, që përgatisnin vegla pune; zejtarë të tjerë prodhonin enë prej balte të pjekur, regjnin lëkurë, punonin zbukurime prej bronzi e prej argjendi. Aty pranë ishte edhe tregu ku fshatarët nga zonat përqark sillnin për të shitur prodhimet e tyre dhe blinin mallrat e përgatitur nga zejtarët e kështjellës.[145]



Figura 1. Pamje e Kalasë së Ulqinit

Me këtë përkufizim mund të cilësohet edhe jeta në Kalanë e Ulqinit. Kështu, pothuajse ngjashëm, jeta aty vazhdon edhe sot, që kur ka filluar frymëzimi në këtë kështjellë 2500 vjeçare. Padyshim, se, si pikë referuese për ndërtimin dhe zhvillimin e qytetit, është marrë për bazë deti, buzë të cilit do ngritet kështjella dhe në të cilën do të zhvillohet jeta. Vendi i përzgjedhur për ndërtimin e kalasë, është poashtu i caktuar, së pari nga pozita strategjike që kalaja mund të ketë, dhe së dyti, nga kushtet e jetesës që mund të sigurohen aty.
Për shkak të kësaj pozite, Ulqini, duke filluar që nga koha parahistorike, ka qenë një rajon parakalimi dhe pikësynim për pushtues të huaj, të cilët, duke qëndruar në këtë qytet dhe rrethinat e tij, kanë lënë gjurmë, të cilat pasqyrohen

[143] Doli, Flamur, *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, Shoqata për ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike – SHRTA, 2009
[144] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë, Libri shkollor, 1999
[145] Ceka, Neritan, *Udhëtim në kështjellat ilire*, Tiranë, Shtëpia Botuese Migjeni, 2006

përmes gërmimeve arkeologjike, toponimeve, onomastikës, arkitekturës dhe artit.[146]

Gjurmët më të hershme të Kalasë së Ulqinit, shihen në bedenin ilir ciklopik. Ky beden, është ndër më të vjetërit i këtij lloji në gjithë bregdetin lindor të Adriatikut.[147]

Shtrirja e qytetit antik të Ulqinit është karakteristike me përshtatjen e ndërtimeve të objekteve sipas terrenit. Kjo vërehet që nga ballina e jashtme e murit ciklopik, e deri te ndërtesat e objektet tjera që u përshtaten pozitave të tarracave. Kjo i përngjan tipit të ndërtimit të ashtuquajtur pergan, i cili është zbatuar edhe në ndërtimin e mëtutjeshëm të Ulqinit mesjetar. Gjatë shekullit XIV, bëhet rindërtimi i qytetit, duke angazhuar këtu edhe mjaft raguzianë dhe venedikas, si mjeshtër të njohur ndërtimi.[148]

Elementet arkitektonike të kohës së mesjetës, kryesisht periudhës së gotikës dhe renesancës, ndikuan me futjen e elementeve të ndryshme të këtyre periudhave arkitektonike. Këto elemente kishin ndikim shumë të madh në stilistikën dhe estetikën e paraqitjeve të objekteve publike, sakrale, profane e utilitare. Në vijimësi kohore të Ulqinit, si dhe në vetë kalanë e Ulqinit, kemi një vazhdimësi ndërtimore, si në aspektin e teknikës së ndërtimit, poashtu edhe në aspektin e strukturave hapësinore të shtëpive të trashëguara nga ilirët te shqiptarët.[149]

Deri në pushtimin nga Venediku, Ulqini e kishte autonominë si institucion bashkiak që ishte krijuar gjatë kohës së Principatës së Balshajve. Sundimi i Venedikut futi elemente të reja edhe në strukturën arkitektonike dhe urbane të qytetit.[150]

Gjatë pushtimeve, kështu, të ndryshme dhe të njëpasnjëshme, mbetën gjurmë nga ato kohëra, të cilat mbetën dhe u shtresëzuan në arkitekturën dhe urbanizmin e qytetit antik. Kështu, psh. gjatë Venedikut futen elemente të kulturës e të urbanizmit venedikas të cilat pasqyrohen në rindërtimet e ndërtimet e bedeneve, portave, kullave, pallateve, kishave e shesheve;[151] ndërsa, nga Perandoria Osmane bëhet fortifikimi i qytetit pas shkatërrimeve që pësoi nga lufta, adaptohen shtëpi e ndërtesa, kisha e kohës së renesancës, në afërsi të Portës veriore të kalasë, shndërrohet në xhami. Fillojnë të ngriten objekte publike siç janë hamamet e krojet; adaptohen sheshet e tregjet, prej të

[146] Rexha, Riza, *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878 – 1881*, Ulqin, Art Club, 1998

[147] Doli, Flamur, *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, Shoqata për ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike – SHRTA, 2009

[148] Ushaku, Ruzhdi, *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin, Fondacioni LIKA, 2010

[149] Doli, Flamur, *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, Shoqata për ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike – SHRTA, 2009

[150] Rexha, Riza, *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878 - 1881*, Ulqin, Art Club, 1998

[151] Ushaku, Ruzhdi, *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin, Fondacioni LIKA, 2010

cilave dallohet veçanërisht "Sheshi i Skllevërve" apo *Pazari i Gjytetit* dhe *Kroi i Sinan Pashës*. Përveç xhamive, hamameve, krojeve të shumta që, në shek. XVII u ngritën në lagje të ndryshme jashtë Kalasë, si objekt markant, impozant e i bukur në Ulqin ngritet edhe *Sahat-Kulla* e njohur, e cila u ndërtua në vitin 1754.[152]

Qyteti mori një karakter të theksuar oriental, duke u ndarë në mëhalla. Osmanët gjatë procesit të islamizimit krijuan institucione arsimore, si mejtepe e xhami, përmes së cilave përpiqeshin ta përhapnin mëtej në popull ndjenjën dhe kulturën fetare islame.[153]

II. KULLA E BALSHAJVE

A. Sundimi i Balshajve

Ndër të gjitha principatat feudale shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XIV, ajo që filloi të merrte përmasat e një formacioni mbarëshqiptar ishte Principata e Balshajve. E krijuar fillimisht në vitet '60 të shek. XIV nën drejtimin e vëllezërve Strazimir, Gjergj e Balsha II, Principata e Balshajve bashkoi territoret e dy Zetave, të Veriut e të Jugut, nga Kotorri në Lezhë.[154]

Balshajt, me përmasat e tyre, me ndikimin dhe namin e tyre, ishin mes bujarëve të parë shqiptarë, të cilët formuan principatën e vet të pavarur shqiptare. Poashtu, Balshajt, bashkë me shumë familje tjera bujare shqiptare, me Muzakajt, Dukagjinasit e Kastriotët, morën pjesë në Betejën e Kosovës më 1389[155], duke përbërë, kështu, aleancën ballkanike për mbrojtjen e territoreve kundër perandorisë pushtuese osmane.

Rreth gjysmës së dytë të shek. XIV, pas tërheqjes së pushteteve të huaja nga Shqipëria, feudalët më të fuqishëm shqiptarë e zhvendosën vendbanimin e tyre në qytetet ku deri atëherë qe vendosur administrata e huaj. Kështu, Shpatajt u vendosën në Artë, Zenebishtajt në Gjirokastër, Muzakajt në Berat, Topiajt në Krujë e në Durrës, Dukagjinët në Lezhë, Gropajt në Ohër, Zahariajt në Danjë, Balshajt lëviznin në Shkodër, në Ulqin e në Tivar.[156]

B. Tipologjia e Kullës së Balshajve

Si gjurmë e kohës së sundimit të Balshajve në këtë qytet, veç tjerash, dallohet Kulla e Balshajve në pjesën e sipërme të qytetit, kullë kjo që u rindërtua disa herë dhe sot shërben si muze – galeri.[157]

---

[152] Po aty.

[153] Rexha, Riza, *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878 - 1881*, Ulqin, Art Club, 1998

[154] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë, Libri shkollor, 1999

[155] Rizaj, Skënder, *Shqiptarët dhe serbët në Kosovë*, Prishtinë, Zëri i Rinisë, 1991

[156] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë, Libri shkollor, 1999

[157] Ushaku, Ruzhdi, *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin, Fondacioni LIKA, 2010

Kjo kullë, gjatë kohës së citadelës, në të cilën kanë jetuar familjet e ndryshme feudale të kohës, ka shërbyer si kullë vrojtimi. Mund të thuhet kështu, sepse duke u bazuar në gravurën gjermane, të vitit 1571, e cila paraqet luftën për pushtimin e Ulqinit, shihet qartë qendra e Qytetit të Lartë, pra citadela, e ndërtuar në vend kodrinor, ndërsa në afërsi, në anën e majtë dhe të djathtë të saj, me pamje nga deti, shihen qartë dy kulla të larta të cilat lëjnë përshtypjen e vrojtimit dhe njëkohësisht mbrojtjen e pallatit nga kërcënimet eventuale. Po kësi kullash, dhe të ngjashme, në të njëjtën gravurë, poashtu shihen përreth mureve fortifikuese të kështjellës mesjetare, të cilat mbrojnë qytetin e mbushur me objekte banimi e sakrale nga sulmet nga anët e ndryshme, e sidomos nga deti.



Figura 2. Gravura e Ulqinit 1571

Dukuria e tipareve mbrojtëse në banesa apo më saktë, shfaqja e banesës me tipare të theksuara mbrojtëse, apo *të fortifikuar* me emërtimin arab *kullë*, të themi të mirëfillta janë ato që kanë nga një ambient në çdo kat, po krahas tyre si në fshat, ashtu edhe në qytetet e Kosovës ndeshim zgjidhje me më shumë se një ambient në çdo kat, përjashtuar katin përdhe të pabanuar.[158]

Nga figura 3, vërehen qartë planimetritë e *Kullës së Balshajve*, të cilat, duke filluar nga përdhesa, trashësia e të cilës arrinë 1,9m, deri tek kati i fundit me trashësi të murit 90cm, kemi të bëjmë me kullat me tipologji me nga një

[158] Riza, Emin, *Banesa popullore shqiptare*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010

hapësirë, ambient në çdo nivel të saj. Ky ndryshim i trashësisë së murit, duke filluar nga pjesa e poshtme më e gjerë dhe duke u ngushtuar gradualisht më lartë, ishte ndër kriteret kryesore për ndërtimin në lartësi, e sidomos kur kemi të bëjmë me konstruksion të muratimit nga guri.



Figura 3. Planimetritë e Kullës së Balshajve

C. Konteksti hapësinor i kullës

Nga ana jugperëndimore, pra nga *Sheshi i Skllevërve*, bëhet hyrja përmes portës harkore në formë gjysmërrethore në *Pazarin e Qytetit*. Ky shesh, apo pazar, në anën e majtë të tij ka kthinat e ndërtuara me gurë, në formë të guaskës cilindrike, të cilat pretendohen të kenë shërbyer si burgje. Nga njëra nga këto është hyrja në kompleksin e murit ciklopik, ndërsa tek një tjetër, arrihet sipër "burgjeve". Mund të supozohet, se këto kthina të veçanta, të mbuluara në mënyrë harkore mund të kenë shërbyer edhe si dyqane të asaj kohe, pra në to është lënë malli për shitjen e produkteve të ndryshme dhe kështu ky shesh para pallatit kryesor, pra citadelës, ka shërbyer si pazar, duke plotësuar kështu nevojat tregtare të banorëve.

Në anën e djathtë të këtij sheshi, gjendet kisha e shndërruar në xhami, e cila tani shërben si muze arkeologjik. Në verilindje të Muzeut arkeologjik, apo siç njihet në popull me emrin *kisha – xhami*, gjendet *Kulla e Balshajve*, e ndërtuar në katër kate. Në anën jugore të kullës gjendet Muzeu etnografik, i cili më përpara ka qenë shtëpi banimi.

Në anën veriore të këtij kompleksi gjenden gërmadhat në formë të mureve përdhese, të cilat tregojnë pak a shumë planimetrinë e pallatit qendror të kështjellës, pra citadelës.

III. ARKITEKTURA E KULLËS SË BALSHAJVE

A. Fazat e ndërtimit dhe analiza e funksionit

Kulla e Balshajve ka pasur disa faza të ndërtimit. Rindërtimi i Kalasë së Ulqinit, dhe me të edhe kullës në fjalë, është bërë nga vendasit shqiptarë në

kohën e Balshajve. Gjatë kohës së sundimit të tyre dhe restaurimit të kalasë është shkruar emri i restauruesit *JOHANI BOLANI* në bedenin e kalasë, i cili është emër vendas, shqiptar, pra Pjetër Ivanaj.[159]
Fazat tjera të njohura të ndërtimit apo restaurimit të kullës janë periudhat pas termeteve të viteve 1968 dhe 1979. Pas këtij të fundit, bëhet restaurimi, jo vetëm i kullës në veçanti, por i të gjitha objekteve brenda kalasë dhe jashtë saj, në qytet në përgjithësi.



Figura 4. Kisha – xhami. Në prapavi Kulla e Balshajve

Hyrja në përdhesën e kullës bëhet nga ana e brendshme e oborrit, me anë të disa shkallëve. Përdhesa duhet të ketë shërbyer për mbajtjen e mjeteve të ndryshme, pra ishte në funksion të depos. Poashtu, përdhesa ka qasje edhe nga ana e oborrit të brendshëm të citadelës, apo drejtpëdrejt prej saj.
Hyrja në katin e parë, bëhet me anë të shkallëve të jashtme, të ndërtuara nga guri. Kjo hapësirë duhet të ketë shërbyer si parahyrje e kullës, mbi të cilën duhet të kenë qenë hapësirat me përmbajtje më të veçanta dhe më kryesore.

[159] Brisku, Bahri, *Gjurmime shqiptare*, Tiranë, LABIA, 1994

Kështu psh, në skicat e rilevimit të kësaj kulle, shihet se në katin e dytë, ishin prezente disa hapje, të cilat me restaurimin e fundit, janë mbyllur tërësisht. Ky kat duhet të ketë shërbyer, ndoshta, edhe për fjetje, të rregullt apo të kohëpaskohshme të vrojtuesve apo eventualisht banuesve të kullës.



Figura 5. Brendësia e katit të fundit

Kati i tretë, pra i fundit, është më i veçantë. Për dallim nga katet tjera të mëposhtme, të cilat karakterizohen pa hapje, në katin më të lartë paraqiten hapjet, pra dritaret. Këto hapje kanë sipërfaqe të mëdha ndriçimi. Dritaret janë të ndërtuara me koncept të frëngjive, edhe pse dallimi për nga gjerësia e brendshme me gjerësinë e jashtme të hapjes nuk është i madh, gjegjësisht, 1,20m nga ana e brendshme dhe 1m nga ana e jashtme. Të gjitha sipërfaqet e mureve kanë nga dy dritare, ndërsa sipërfaqja e murit në drejtim nga citadela, nuk ka asnjë hapje të dukshme.
Tipar arkitektonik tjetër interesant, që gjendet në këtë hapësirë, është pjesa e cila shtrihet rreth e përqark katit në formë të divanhanes. Kjo pjesë, e ngritur 45cm mbi nivelin e dyshemesë, duhet të ketë shërbyer për ulje dhe çlodhje.
Në këtë hapësirë, si veçanti e shprehur kulturore dhe, të themi bestytnore, paraqitën dy altarë të vendosur në mes të mureve, përballë njëri – tjetrit.

B. Interpretimi i kulteve në altarë

Altari me formë të biforës, figura 6, ka të gdhendur në reliev tri pisha, bredha apo selvia: dy anash dhe një sipër në mes. Brenda këtyre bimëve, të vendosura anash, është gdhendur gjarpëri. Bredhi si dru zbukurues në gurgdhendje më shumë është i pranishëm në qoshet e derës së shtëpisë e në oxhak a anash oxhakut të vatrës familjare. Bukuria natyrore e bredhit e ka bërë këtë të dashur

në popull se prej këtij, krahas përmbajtjes rituale, u fut si motiv në skalitjet e tij artistike në dru e në gur.[160] Pra, është simbol nga kulti i bimësisë, i cili njëkohësisht paraqet edhe ripërtëritjen e jetës.



Figura 6. Altari me kultet e bimësisë dhe të gjarpërit

Ndërsa, për gjarpërinjtë e gdhendur, nuk ka dyshim se, këtu bëhet fjalë qartë për kultin e gjarpërit, i cili tek shqiptarët, që nga koha ilire, vazhdon të përdoret si gdhendje mbi porta, oxhaqe, qoshnik të shtëpive, kullave, varreve deri vonë. Asnjë kafshë në simbolikën religjioze të ilirëve nuk ka luajtur rol të rëndësishëm sa gjarpëri.[161] Nga të dhënat mitologjike, kemi paraqitjen e gjarpërit si mbrojtës i shtëpisë, pra me një kult të lashtë totemik në popullin tonë. Gjarpëri bënte që shtëpia të kishte mbarësi e lartësime në njerëz, në blegtori, në prodhime bujqësore dhe në mirëqenie të përgjithshme.[162] Pra, siç mund të konstatohet qartë, se tek altari në formë bifore, i punuar nga guri, janë paraqitur kultet e bimësisë dhe të gjarpërit.

Altari tjetër, i cili gjendet në sipërfaqen e murit përballë altarit me kultet nga bota bimore dhe ajo e gjarpërit, është më specifik për nga ana e interpretimit të

[160] Tirta, Mark, *Revista monumentet – Mbi zanafillën e disa motiveve në gurgdhendje në shtëpitë fshatare shqiptare*, Tiranë, Instituti i monumenteve të kulturës, 1982

[161] Stipçeviq, Aleksandër, *Ilirët – Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, Tiranë, Botimet Toena, 2002

[162] Tirta, Mark, *Revista monumentet – Mbi zanafillën e disa motiveve në gurgdhendje në shtëpitë fshatare shqiptare*, Tiranë, Instituti i monumenteve të kulturës, 1982

tij. Në këtë altar, të punuar poashtu nga guri, i profiluar në formë të caktuar, janë paraqitur dy yje gjashtëcepash. Yjet janë të gdhendur në sipërfaqen e gurit, të formuar nga dy trekëndësh barabrinjës, të futur në njëri tjetrin me anë të kundërta. Siç mund të shihet në figurën 7, gdhendjet janë të pasqyrura me njëra – tjetrën.



Figura 7. Altari me kultin e diellit

Nga gojëdhënat e popullit, ky simbol interpretohet si ylli hebrej, apo Ylli i Davidit etj. Këtu, edhe ndoshta mund të cilësohet si i tillë, pasiqë, dihet se, në këtë kullë, për një kohë, ka qëndruar Sabataj Cvi, i cili bëri edhe reformimin e librit të shenjtë të hebrejve. Por shpesh, ky simbol, poashtu mitik, në hapësirat tona, keqinterpretohet, me dashje apo pa qëllim, si yll i hebrejve.
Dihet se, një ndër kultet kryesore ndër shqiptarë, duke filluar nga ilirët e më herët, është kulti i Diellit. Paraqitjet figurative të diellit ndeshën në sasi të mëdha varsesh në trajtën e diskut të rëndomtë, diskut me katër, gjashtë ose me shumë spica, diskun me rreze, diskun me rrathë koncentrikë në të – të gjitha këto në shumë variante.[163] Kjo ornamentikë popullore ndeshet edhe në furka, djepa, veshje, arka e objekte tjera, dhe padyshim, këtij kulti, pra diellit, banorë të ndryshëm, sidomos në afërsi të majave të maleve, ngjiteshin maje tyre dhe me të lindur dielli, i faleshin atij. Kështu veprohej në Krajë, në Lumë, në Berat etj.[164]

[163] Stipçeviq, Aleksandër, *Ilirët – Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, Tiranë, Botimet Toena, 2002
[164] Tirta, Mark, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004

Po të shikohen me kujdes, simbolet e gdhendura në altarin brenda *Kullës së Balshajve*, përkatësisht në mes të ornamentikës simbolike të paraqitur si yll gjashtëcepash, është e gdhendur edhe forma tjetër e paraqitjes së besimit tek dielli – forma me gjashtë spica, të cilën, ylli i hebrejve nuk e ka.
Po të shikohet edhe më me kujdes, dhe, po t'i përmbahemi përkufizimeve të paraqitjes së diellit, i cili si formë kryesore, pra bazë ka diskun, apo rrethin, edhe ky simbol në këtë objekt është i gdhendur brenda një rrethi apo disku, të cilin, simboli i hebrejve në formë të yllit gjastëcepash, poashtu, nuk e ka.
Andaj, mund të vihet në përfundimin se, roli i kultit të diellit, i përhapur masovikisht ndër shqiptarët e të gjitha trevave që nga koha ilire e parailire – pellazgjike, dhe, poashtu, roli i kultit të bimësisë e të gjarpërit, të interpretuar edhe si simbole të mirëqenies dhe të plleshmërisë, kanë ndikuar dukshëm në dekorimin e këtyre "altarëve".
Por, çka dihet, është se këta altarë u ndërtuan në kohën e Sabataj Cvisë, i cili ishte dizdar në atë kohë i Qytetit të Vjetër dhe kanë shërbyer për qëllime të caktuara e rituale të tij. Simbolet përkojnë poashtu me kulturën hebreje, por le të mbetët si hipotezë e ndikimit, ndoshta, nga populli vendas, mënyra e paraqitjes së kulteve të trashëguara nga të parët.

C. Teknika e ndërtimit dhe materialet e përdorura



Figura 8. Prerja karakteristike e kullë

Teknika e ndërtimit, ashtu si vetë kompozimi janë të kushtëzuara kryesisht, nga fuqia ekonomike e porositësit.[165] Kështu lloji i materialit ndërtimor pranë vendbanimit është përcaktues në disa elemente të rendeve të ndryshme për nga rëndësia, që prej kompozimit e deri te teknika e ndërtimit. Vendbanimet, përgjithsisht fshatare, të ngritura pranë zonave pyjore kanë pasur drurin materialin kryesor, ndërsa guri është materiali tjetër tepër i përhapur thuajse në mbarë hapësirën kodrinore – malore të trojeve shqiptare.[166]

[165] Suli, Leonard, *Revista monumentet – Arkitektura e banesës popullore në rrezomën e Delvinës*, Tiranë, Instituti i monumenteve të kulturës, 1985
[166] Riza, Emin, *Banesa popullore shqiptare*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010

Edhe tek *Kulla e Balshajve* si material kryesor i ndërtimit është përdorur guri. Guri, me forma dhe me madhësi të ndryshme është latuar që t'i jepet forma e caktuar, me të cilën do të ngritet e tërë kulla. Kujdes i veçantë i është kushtuar gurëve të skajeve të kullës, apo siç njihen me emërtimin popullor, *qoshnikët*. Qoshnikët janë karakteristikë e posaçme në dhënjen e formës estetike të objektit dhe përpunimi i tyre bëhet shumë saktë, në mënyrë që vija skajore e vëllimit konturor të objektit të jetë sa më e drejtë, gati edhe drejtvizore.



Figura 9. Fasada jugperëndimore



Figura 10. Fasada juglindore

Katet janë të ndara me trarë të drurit masiv. Dy trarët mbajtës, ata primarë, janë të futur në mure dhe të mbajtura në gurë të profiluar; trarët sekondarë janë të vendosur tërthorazi me këta dy trarë, duke formuar kështu një lloj qeprate, mbi të cilët është tavani dhe dyshemeja. Sipër këtij konstruksioni të qepratës, tavani dhe dyshemeja është mveshur e shtruar me dërrasa, ndërsa në mes tyre është një shtresë nga betoni. Me këtë formë qiellzana është e interpretuar me shije arkitektonike të thjeshtë.

Mendohet se kulla në fjalë ka ndikime nga arkitektura veneciane. Po të krahasojmë disa stilizime të dukshme, arrihet në përfundimin se këto ndikime nuk kanë qenë edhe aq të mëdhaja. Tek arkitektura veneciane dhe kryesisht tek arkitektura e renesancës, nga jashtë, në pjesën më të madhe, kështjella nuk kishte hapje, pastaj ishte e ndërtuar prej gurit me bosazh (rustikë) të

theksuar.[167] Ky bosazh, i interpretuar më shumë tek pallatet, por edhe në arkitekturën veneciane në përgjithësi, ishte më i theksuar në katin përdhesë, ndërsa duke shkuar gradualisht në katet e sipërme, duke u zbehur, madje duke u suvatuar në përgjithësi. Në arkitekturën në fjalë, kemi edhe një përzierje stilesh, pra një laramani të dukshme, si në shtylla e mure, ashtu edhe në porta e dritare. Dekorimet e shumta nëpër sipërfaqet e mureve, poashtu nuk janë të pakta.

Ndërsa, tek *Kulla e Balshajve*, më saktësisht tek arkitektura e saj, bosazhin e theksuar poshtë, ndërsa lart më pak ose aspak të theksuar, nuk e kemi; e tëra është e ndërtuar me gurë dhe asnjë pjesë e saj nuk ishte dhe nuk është e mbuluar apo e ngarkuar me ndonjë zbukurim sipërfaqësor. Në të gjitha sipërfaqet e mureve të jashtme të saj është i pranishëm guri si material ndërtimi dhe si element i shprehjes arkitektonike, për dallim nga brenda, të cilat janë të suvatosura dhe të ngjyrosura me të bardhë. Dritaret e kullës përfundojnë me një kornizë të sipërme, kurorë, e cila ka tipare të stilit të renesancës. Në dy skajet e këtyre dritareve, nga jashtë, kemi elementet karakteristike të shtëpive të banimit në Kalanë e Ulqinit: elementet e dalura poshtë dritares në formë të konzollës për mbajtjen e dërrasës për vendosjen e vazove me lule dhe elementet në pjesën e sipërme të dritares, të cilat karakterizohen me një vrimë në mes, në të cilën është futur shkopi, dhe është vendosur çarshafi, ndonjëherë i lagur në mënyrë që të krijojë freski në ambientet e brendshme, por ka shërbyer edhe për mbajtjen e çarshafëve të gjatë, të cilët kanë luajtur rolin e tendave, duke mundësuar hijen nëpër rrugicat dhe sheshet e ndryshme nëpër kala.

Përfundimi i kullës bëhet me kurorën e dalur jashtë konturave planimetrike. Kurora poashtu është nga guri, e cila formohet me dalje të lehtë të një brezi horizontal, mbi të cilin formohet një brez tjetër më i dukshëm në formë të dhëmbëzuar; vazhdohet me brezin tjetër më të trashë dhe përfundohet me pullazin e mbuluar me tjegulla.

PËRMBYLLJA

Mund të thuhet se, *Kulla e Balshajve*, nga këndvështrimi arkitektonik, mund të grupohet në kategorinë e të gjitha llojeve të kullave: të banimit apo të vrojtimit, duke pasur parasysh ndërtimin, paraqitjen arkitektonike dhe funksionale të saj.

Ndërsa, sa i përket interpretimit të saj, duhet pasur kujdes të veçantë. Kështu, psh., në udhërrëfyesin elektronik, në interpretimin që i bëhet kullës, vetëm në fjalinë e parë përmendet me emrin e saj, "Kulla e Balshajve"! E gjithë vëmendja tjetër, i kushtohet, siç thuhet aty, "njeriut inteligjent dhe mistik, që fliste disa gjuhë të huaja, jeta e të cilit, kanë besim që do të zbardhet, Sabataj Cvisë"!

[167] Nixha, Sh., Jerliu F., *Historia e arkitekturës (Historia europiane prej renesansës deri te moderna, shek. XV-XIX)*, Prishtinë, 2007



Figura 11. Kulla e Balshajve

Asnjë fjalë për tipologjinë e kullës; asnjë fjalë për funksionin e për historinë e saj! Se për arkitekturën e saj, jo se jo! As edhe një fjalë për Balshajt! Nuk përmendet sundimi i tyre, shteti i të cilëve arriti të shtrihet në shumë vise shqiptare, duke përfshirë Prizrenin e Pejën, Budvën në veri, e Himarën në jug, të cilët, Balsha II dhe i vëllai Gjergji cilësohen si *Zot i tërë Arbërisë*![168]
Aty, nuk shihet e udhës të përmenden monedhat e Balshajve, të cilat përdoreshin deri në Kotorr, *perperët!*[169]
Principata e Balshajve me anijet e veta luftarake dukshëm pengonte depërtimin e osmanllive në hapësirat ballkanike.[170] As fakti se ndër të gjitha principatat feudale shqiptare të gjysmës së dytë të shek. XIV, ajo që filloi të merrte përmasat e një formacioni mbarëshqiptar ishte Principata e Balshajve,[171] nuk i është dukur me rëndësi të posaçme të përmendet! Sa i përket arkitekturës, vlerave arkitektonike, estetike, materiale e historike, as që bëhet fjalë! Por flitet për Sabataj Cvinë!
Megjithatë, *Kulla e Balshajve* katërkatëshe, e cila qëndron krenare në pjesën më të lartë të kalasë, ka qëndruar aty duke vrojtuar kërcënimet e ndryshme që vinin nga ana e detit dhe tokës. Ndërsa, tani, kjo kullë mesjetare, qëndron duke vëzhguar e dëgjuar, mundin e djersën e derdhur për përpjekjen e fshirjes dhe përpjekjen në të ardhmen të ndryshimit rrënjësor të historisë së saj, duke i kushtuar kështu, rëndësi e vëmendje njërit që ka qëndruar dhjetë vitet e fundit të jetës së tij, në shek. XVII – XVIII, në Ulqin, ndërsa Principatës së Balshajve, e cila në shek. XIV - XV krijoj shtetin mbarëshqiptarë të asaj kohe, nuk i kushtohet asnjë fjali.

[168] Rizaj, Skënder, *Shqiptarët dhe serbët në Kosovë*, Prishtinë, Zëri i Rinisë, 1991
[169] Brisku, Bahri, *Gjurmime shqiptare*, Tiranë, LABIA, 1994
[170] Brisku, Bahri, *Kusarët dhe detarët shqiptarë*, Ulqin, Asociacioni Ulqini, 2011
[171] Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë, Libri shkollor, 1999

Literatura e përdorur

Brisku, Bahri, *Gjurmime shqiptare*, Tiranë, LABIA, 1994
Brisku, Bahri, *Kusarët dhe detarët shqiptarë*, Ulqin, Asociacioni Ulqini, 2011
Ceka, Neritan, *Udhëtim në kështjellat ilire*, Tiranë, Shtëpia Botuese Migjeni, 2006
Doli, Flamur, *Arkitektura vernakulare e Kosovës*, Prishtinë, Shoqata për ruajtjen e trashëgimisë arkitektonike – SHRTA, 2009
Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar*, Prishtinë, Libri shkollor, 1999
Nixha, Sh., Jerliu F., *Historia e arkitekturës (Historia europiane prej renesansës deri te moderna, shek. XV-XIX)*, Prishtinë, 2007
Rexha, Riza, *Ulqini në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878 – 1881*, Ulqin, Art Club, 1998
Riza, Emin, *Banesa popullore shqiptare*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2010
Rizaj, Skënder, *Shqiptarët dhe serbët në Kosovë*, Prishtinë, Zëri i Rinisë, 1991
Stipçeviq, Aleksandër, *Ilirët – Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit*, Tiranë, Botimet Toena, 2002
Suli, Leonard, *Revista monumentet – Arkitektura e banesës popullore në rrezomën e Delvinës*, Tiranë, Instituti i monumenteve të kulturës, 1985
Tirta, Mark, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2004
Tirta, Mark, *Revista monumentet – Mbi zanafillën e disa motiveve në gurgdhendje në shtëpitë fshatare shqiptare*, Tiranë, Instituti i monumenteve të kulturës, 1982
Ushaku, Ruzhdi, *Ulqini në përmasa kërkimi dhe frymëzimi*, Ulqin, Fondacioni LIKA, 2010

DIJA
Revistë vjetore për shkencë, art, kulturë
Nr. 15/2016, viti XIV, Ulqin

E boton
Bashkimi i Krijuesve Shqiptarë në Mal të Zi
Kryetar: prim. dr. Gani Karamanaga

Redaktor teknik:
Gazmend Çitaku

Kontakti
E-mail: ***bkshmz@yahoo.com***
Bashkëpunëtorëve u jemi mirënjohës për ndihmesa.
Artikujt duhet të jenë të regjistruar në WORD dokument.
Duhet të jenë të lekturuar dhe të korrektuar.
Nuk duhet të jenë të faqosur e as të dizajnuar.

Shtypi
PRESS STUDIO
ULQIN, 2016

Tirazhi
300 Copë